



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 5, 6, 7 DHE 10 DHJETOR 2017**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 5, 6, 7. I 10. DECEMBRA 2017. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2017**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018,
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për projektin e konkurrueshmërisë dhe gatishmërisë për eksport ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për financim shtesë për Projektin për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Dnevni red

1. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Budžetu Republike Kosova za 2018,
2. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji finansijskog sporazuma o projektu konkurentnosti i spremnosti za izvoz, između Republike Kosova i Međunarodne asocijacije za razvoj,
3. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji finansijskog sporazuma o dodatnom finansiranju za projekat za poljoprivredu i seoski razvoj između Republike Kosova i Međunarodne asocijacije za razvoj,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o carinskim merama za zaštitu prava na intelektualnu imovinu.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Faleminderit për durimin, kërkoj falje në rend të parë se menduam që mbledhja e Kryesisë do të ishte shumë më e shkurtër, po na mori kohë, po sido që të jetë, kërkoj falje dhe më nuk do të ndodhë, nuk do ta bëjmë në të njëjtën kohë edhe mbledhjen e Kryesisë, edhe seancën.

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra edhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit me pëlqimin e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 29 nëntor 2017.

Ndërkohë në sallë janë 56 deputetë, për fillim mund të procedojmë derisa të rikthehen kolegët deputetë.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Mirëdita, i nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Dy fjalë rreth buxhetit për vitin që vjen, e pastaj ministri Hamza do të prezantojë buxhetin, të cilin e falënderoj për punën e madhe që ka bërë.

Përgatitja e këtij buxheti merr në tërësi parasysh kontestin makroekonomik të vendit dhe më lejoni t'ju them se të dhënat e fundit të Ministrisë së Financave për sa i përket vitit 2017 dhe pritjeve për vitin 2018 flasin për një dinamizëm më të përshpejtuar të ekonomisë së vendit.

Sipas këtyre të dhënave, në vitin 2018 ekonomia jonë pritet të rritet me një normë reale prej 4,6%, ndërsa në periudhën afatmesme me mbi 5%.

Këto projeksione japin shpresë se ekonomia jonë po lëviz drejt një niveli më premtues të rritjes dhe kjo do të ndikojë direkt në nivelin e punësimit në vend.

Duke iu kthyer buxhetit, të hyrat buxhetore priten të kenë rritje përafërsisht njëjtë me rritjen ekonomike, plus një përqindje shtesë për të llogaritur në masat që do t'i ndërmarrim për zvogëlimin e informalitetit.

Pra, total të hyrat buxhetore priten të jenë në vlerë një miliard e 829 milionë euro, vlerë e cila është më e lartë se buxheti i rishikuar i vitit 2017 për rreth 6%, ose 104 milionë euro.

Për më tutje të nderuar deputetë, kam nderin që fjalën t'ia bart ministrit të Financave, zotit Bedri Hamza.

KRYETARI: Faleminderit, zoti kryeministër! Zoti ministër, fjala për ju.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,
I nderuar nënkryetar, zoti Haliti,
I nderuar zoti kryeministër Haradinaj,
Zëvendëskryeministër,
Ministra,
Të nderuar deputetë,
Përfaqësues të medieve,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Më lejoni të paraqes para jush Draft-buxhetin 2018, duke u fokusuar në pikat kyçe të këtij dokumenti me rëndësi.

Para se të flas mbi përmbajtjen e buxhetit, do t'ju informoj mbi procesin, nga se si për çdo ligj tjetër dhe politikë të Qeverisë, edhe në këtë rast procesi që ka sjellë deri te finalizimi i këtij draft-buxheti është shumë i rëndësishëm, ndoshta më i rëndësishëm se rasteve të tjera.

E them këtë duke pasur parasysh faktin se involvimi i të gjitha palëve të interesit në këtë proces është shumë me rëndësi, për t'u siguruar se buxheti i tillë në masë të madhe të mundshme reflekton imputin e të gjitha institucioneve dhe palëve të tjera me interes.

Ministria e Financave, duke respektuar të gjitha procedurat ligjore të parapara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësinë, ka përgatitur dhe ka aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës Projektligjin për Buxhetin 2018, të cilin po e paraqes sot para jush.

Siç e dini, procesi i përgatitjes së këtij buxheti ka filluar në maj të këtij viti me lëshimin e qarkores së parë buxhetore të bazuar në kornizën afatmesme të shpenzimeve, të aprovuar në prill po të këtij viti, ndërsa pas marrjes së imputeve, respektivisht kërkesat e institucioneve publike, janë zhvilluar dëgjimet buxhetore dhe është përgatitur ky draft-buxhet.

Rrjedhimisht, ky projektligj së bashku me Buxhetin 2018 është hartuar nga Ministria e Financave me ndihmën e të gjitha institucioneve publike vendore dhe në konsultim të ngushtë me institucionet financiare ndërkombëtare që na mbështesin në këtë fushë, e në veçanti me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Andaj ky draft-buxhet është i harmonizuar me të gjithë dhe shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e sinqertë të treguar.

Nëpërmjet këtij buxheti jemi të bindur se kemi bërë më të mirën për një shpërndarje sa më të drejtë të parasë publike për financimin e prioritetëve tona reformuese që kanë kthim më të madh në të mirat materiale për qytetarët e vendit.

Ky draft-buxhet me vete ka një numër të madh të projekteve e politikave reformuese, implementimi të cilat do të zgjasë me vite të tëra.

Prandaj, gjatë përgatitjes së këtij buxheti natyrisht se jemi fokusuar në vitin 2018, por duke pasur parasysh implikimet edhe për vitet vijuese.

Rrjedhimisht ky draft-buxhet nuk do të shihet nga një këndvështrim izolues vetëm për vitin 2018, por më shumë se një buxhet që ka implikime për një periudhë afatmesme dhe më gjatë.

Gjëja tjetër që dua të veçoj në fillim të kësaj paraqitje është se nga këndvështrimi i politikave programore dhe reformat e Qeverisë si bazë për përgatitjen e këtij buxheti janë marrë Programi i Qeverisë, Programi për reforma ekonomike që reflekton këto prioritete të politikave publike dhe më pas kemi marrë për bazë edhe kontekstin makroekonomik të brendshëm dhe atë të jashtëm.

Ndërsa objektiv kryesor që kemi pasur gjatë zhvillimit të këtij draft-buxheti është ruajtja dhe forcimi i mëtejme i stabilitetit fiskal të vendit.

Të nderuar deputetë,

Me këtë buxhet, të cilin po e paraqes sot para jush, ne sigurohem se do të kemi rritje ekonomike stabile dhe qëndrueshme, që është bazë për zhvillimin e qëndrueshëm të buxhetit.

Politika tatimore që do të jenë mbështetëse të zhvillimit të sektorit privat. Ne do të bëjmë lehtësi të reja për prodhuesit dhe përpunuesit vendorë.

Dhe kjo do të sigurojë një ambient më të përshtatshëm për zhvillimin e biznesit në Kosovë.

Te shpenzimet buxhetore, do të financohen të gjitha politikat me prioritet të Qeverisë, duke përfshirë programe specifike që për ne janë të një rëndësie të veçantë.

Do të ketë rritje të pagave, do të ketë financim të qëndrueshëm për skema të ndryshme sociale, duke përfshirë ndihma sociale për një grup shumë të rëndësishëm të shoqërisë dhe financim të qëndrueshëm për kategoritë e dala nga lufta.

Do të ketë rritje substanciale për financimin e projekteve kapitale me karakter publik, gjë që do të ndikojë direkt në rritjen e produktivitetit në sektorin privat.

Tani më lejoni t'ju flas më në detale për kornizën makro të vendit, për të hyrat dhe më pas, për shpenzimet.

Projeksionet makroekonomike: Ekipi i Ministrisë së Financave duke u bazuar në të dhënat e fundit të zhvillimeve ekonomike, fiskale, financiare dhe duke u mbështetur në supozimet bazë për periudhën e ardhshme ka bërë projeksione për rritje ekonomike për periudhën e ardhshme.

Sipas këtyre projeksioneve, në vitin 2018 presim që rritja ekonomike e vendit, e matur përmes rritjes së bruto prodhimit vendor, të jetë 4,6% në terma realë, ndërsa në atë nominal rritja do të jetë mbi 6%.

Në periudhën afatmesme rritja reale pritet të jetë edhe më e lartë prej një mesatare vjetore prej rreth 5%. Përafërsisht rritje të njëjtë ka projektuar edhe Banka Botërore, në publikimin e ditëve të fundit “Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor”.

Në fakt, për vitin 2018 Banka Botërore duket të jetë edhe më optimiste se sa projeksionet tona të Ministrisë së Financave, duke projektuar që ekonomia jonë do të rritet me 4,8%, me projeksionet në dallim nga projeksionet e Ministrisë së financave prej 4,6%.

Kjo rritje e projektuar pritet të mbështetet mbi të gjitha nga niveli i rritur i investimeve, duke përfshirë edhe ato publike, konsumi dhe rritja e eksporteve të vendit.

Në periudhën afatmesme kontributi i investimeve dhe eksporteve në rritjen totale pritet të shtohet edhe më shumë.

Më duhet t'ju them se kjo performansë e pritur është e bazuar në atë që e quajmë si “Skenari bazë” i performansës së ekonomisë sonë dhe si të tilla këto projeksione nuk marrin parasysh efekte të mundshme të projekteve të mëdha që mund të implementohen gjatë periudhës afatmesme, siç është rasti me investimet në ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike.

Për sa u përket çmimeve në vitin 2018 dhe në vitet vijuese pritet një stabilitet i theksuar, ku inflacioni i projektuar do të jetë pak mbi 1% në baza vjetore.

Natyrisht se në këtë pikë, duke qenë se jemi një ekonomi mjaftë e hapur, ecuria e çmimeve të komoditeve në tregje ndërkombëtare pritet të ketë efektin e vet.

Ky efekt, në fakt, është integruar në projeksionet tona të Ministrisë së Financave.

Me rastin e zhvillimit të këtyre projeksioneve makroekonomike ne kemi marrë për bazë edhe ambientin e jashtëm regional, evropian dhe më gjerë. Ku të dhënat më të fundit të publikuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar japin sinjale më pozitive në kontestin e së ardhmes.

Para se të kaloj në pjesën e të hyrave të shpenzimeve, dua të përmend edhe një element shumë të rëndësishëm që ndikon në ecuritë ekonomike në vend.

E këtu e kam fjalën për dërgesat nga jashtë, apo për remitencat.

Remitencat si në vitet e kaluara, ashtu edhe në këtë vit pritet të jenë një burim shumë i rëndësishëm i financimit të kërkesës agregate në vend. Dhe, për këtë ne e falënderojmë Diasporën tonë që vazhdon të japë kontribut për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Të hyrat: Projeksionet mbi të hyrat e përgjithshme buxhetore në vitin 2018-2020 janë të ndërtruara mbi bazën e parashikimeve dhe zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik dhe efektet e këtij zhvillimi në bazën tatimore.

Me rastin e zhvillimit të këtyre projeksioneve ne kemi pasur parasysh këto parime. Politika tatimore do të jenë mbështetëse e sektorit privat dhe në asnjë mënyrë barrë për ta.

Administrimi i tatimeve do të përmirësohet, për t'ua lehtësuar punën tatimpaguesve.

Do të merren veprime konkrete për uljen e aktivitetit informal si një parakusht për konkurrencë të drejtë dhe trajtim të barabartë për të gjithë.

Duke u mbështetur në këto parime, ne presim që në vitin 2018 total të hyrat buxhetore të jenë në një vlerë prej një miliard e 829 milionë eurosh, vlerë e cila është më e lartë se buxheti i vitit 2017 përreth 6%, apo nëse shprehem në miliona euro, 104 milionë më tepër.

Kjo rritje planifikohet të vazhdojë edhe për vitet vijuese 2019 dhe 2020, në harmoni me pjesëmarrjet e të hyrave në bruto produktin vendor, e parashikuar.

Kjo rritje planifikohet të vazhdojë se rritja e të hyrave të përgjithshme vjen si rezultat i kontributit prej rreth 74% nga tatimet indirekte, pasuar me rreth 15% nga tatimet direkte dhe rreth 11% të hyra jotatimore.

Kjo strukturë e të hyrave është rezultat i përbërjes së strukturës së ekonomisë sonë, e cila karakterizohet me një deficit të lartë tregtar.

Ministria e Financave parasheh që pas adaptimit të masave të lirimit në prodhim dhe efektit të tyre të plotë, Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, ky raport filloi të përmirësohet nëpërmjet zëvendësimit të detyrimeve doganore dhe TVSH-së së grumbulluar në kufij, me të hyra më të larta nga tatimi në korporata dhe të hyra në të ardhurat personale.

Ndryshimet në Ligjin e TVSH-së që kanë mundësuar pagesën e shtyrë të TVSH-së për imputet e prodhimit po ashtu pritet të kenë efekt të njëjtë.

Duke marrë parasysh edhe ndryshimet që priten të hyjnë në fuqi nga janari i vitit 2018, si heqja e tatimit doganor për të gjitha mallrat që hyjnë në proces të prodhimit si lëndë e parë, të hyrat që mbledhen nga Dogana mund të pritet rënie edhe më tutje nga kjo kategori, por gjithsesi ky impakt do të neutralizohet nga efektet pozitive që çojnë në prodhim më të madh se sa pagesa në vend pas shitjes së produkteve finale.

Nga këndvështrimi i agjencive tatimbledhëse, me Propozim-buxhetin 2018 të hyrat nga ATK-ja parashihen të arrijnë në vlerën prej 446 milionë eurosh, që është një rritje prej rreth 5,4% në raport me buxhetin e vitit 2017.

Ndërsa të hyrat e mbledhura nga Doganat e Kosovës planifikojnë të arrijnë në një miliardë e 175 milionë euro, apo një rritje prej 6% në raport me vitin 2017.

Sa u përket të hyrave jotatimore, ato pritet që përafërsisht të mbesin në nivele të njëjta përgjatë periudhës afatmesme në një vlerë prej rreth 200 milionë eurosh.

Sa u përket të dalave buxhetore, tani më lejoni të flas pak mbi planifikimin e shpenzimeve. Propozimi për shpenzime buxhetore është përpiluar mbi hapësirën që ofron planifikimi i të hyrave buxhetore dhe niveli ligjor i deficitit buxhetor.

Kjo formë e buxhetimit shërben si garanci e disiplinës, e cila mundëson ruajtjen e stabilitetit makrofiskal.

Gjithsesi në kontestin e këtij buxheti ruajtja e stabilitetit makrofiskal nuk është qëllim në vetvete, por parakusht për arritjen e qëllimit përfundimtar të mbështetjes së zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik të vendit.

Duke u nisur nga ky qëllim, Buxheti i propozuar është projektuar në tri parime:

Në përshtatjen e shpenzimeve rrjedhëse që punët të vazhdojnë të papenguara për ofrimin e shërbimeve publike dhe duke parandaluar akumulimin e pagesave të vonuara.

Në ofrimin e financimit shtesë për katër prioritet buxhetore të Qeverisë.

Në strukturimin e financimit të buxhetit për të dhënë shtytje ekonomisë nëpërmjet përfshirjes në qarkullim të brendshëm të fondeve nga jashtë nëpërmjet projekteve me rentabilitet të lartë ekonomik.

Gjithsej shpenzimet buxhetore janë rritur me 272 milionë euro, apo 15% në krahasim me buxhetin e vitit 2017, duke arritur shumën totale prej 2 miliardë e 82 milionë eurosh.

Në kuadër të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike kemi këtë buxhet:

Shpenzimet për kategorinë “Paga dhe mëditjet” për vitin 2018 janë paraparë të jenë 589 milionë euro, një rritje prej 4,3% në raport me shpenzimet e parashikuara për paga dhe mëditje në buxhetin për vitin 2017.

Ky buxhet për paga dhe mëditje parasheh rritjen e pagave për të gjithë të punësuarit në sektorin publik nga 1 janari 2018.

Pagat për rritje të punësimit në sektorë strategjikë të vendit dhe punësimi për institucione të reja.

Subvencionet dhe transferet priten të jenë në vlerë 525 milionë euro në vitin 2018, që është një rritje prej 6% në krahasim me buxhetin e vitit 2017.

Si pjesëmarrje në raport me bruto produktin vendor, subvencionet dhe transferet gjatë vitit 2018 priten të arrijnë në nivelin prej 7,9%, njëjtë sa ishin edhe në periudhën 2017 dhe 2016.

Në këtë buxhet pritet të financohen të gjitha skemat shoqërore, duke përfshirë financimin për kategoritë e dala nga lufta, rritjen e buxhetit për përfituesit e skemave sociale, financimin për trashëgimin e pensioneve kontributdhënëse dhe skema të tjera.

Nëpërmjet buxhetit për transfere sociale do të mbështeten edhe viktimat e dhunës seksuale nga lufta.

Për më tepër, nëpërmjet këtij buxheti parashihet edhe përkrahja e fermerëve me subvencione, për t’u siguruar se ky sektor vazhdon me ritmet e veta pozitive.

Shpenzimet për “mallra dhe shërbime” në vitin 2018 pritet të rriten në krahasim me vitin paraprak. Kjo si rezultat i shpenzimeve paraprake për projekte kapitale dhe nevojës për mirëmbajtjen e tyre.

Vlera e shpenzimeve të planifikuara për “mallra dhe shërbime” në vitin 2018 arrin në 264 milionë euro, apo 7,9% rritje, në raport me Buxhetin 2017.

Shpenzimet kapitale për vitin 2018 planifikohet të rriten për 37% në raport me buxhetin për vitin 2017, duke arritur shumën prej 687 milionë eurosh.

Për më shumë, si pjesëmarrje e bruto produktit vendor, shpenzimet kapitale për vitin 2018 kanë shënuar rritje në 10,3%, nga 8% sa janë planifikuar me buxhetin e vitit 2017.

Pjesë e rëndësishme e investimeve kapitale mbeten projektet e autostradës Prishtinë-Shkup, autostrada Prishtinë-Gjilan, projekti i rrugës M2 për Mitrovicë, M3 për Pejë dhe rruga për Podujevë.

Përfundimi i ndërtimit të rrugës Skenderaj-Drenas e zgjerimi i rrugës Dollc-Gjakovë dhe qarkut të Gjakovës.

Dhe investime të tjera për përmirësimin e infrastrukturës lokale, sportive, arsimore dhe projekte, të cilat krahasuar me vitin e kaluar kanë shënuar një rritje të ndjeshme.

Në kuadër të financimit nëpërmjet klauzolës për investime, ne kemi përfshirë vetëm projekte të cilat kanë përgatitjen e duhur dhe ku ka interesim të institucionet financiare ndërkombëtare për financim.

Trajtimi i ujërave të zeza do të ketë një prioritet, ku gjatë vitit që vjen pritet të fillojë implementimi i projektit për kryeqytetin e Prishtinës, Fushë-Kosovën dhe Obiliqin.

Edhe një gjë sa u përket shpenzimeve.

Qeveria e Kosovës e sheh bartës të zhvillimit ekonomik sektorin privat. Andaj ne kemi përfshirë mbështetje të mëtutjeshme për fondin për garantimin e kredive, në mënyrë që ta rrisim qasjen e financave të rinjve dhe posaçërisht të grave.

Bashkë me donatorë dhe me institucione financiare ndërkombëtare do të arrijmë që ta rrisim në sasi të konsiderueshme kapitalin dhe sektorët, të cilët do të mbulohen nga fondi për garantimin e kredive.

Buxheti për nivelet komunale.

Tani më lejoni që ta bëj një përmbledhje të buxhetit për komuna.

Nga gjithsej rritja e shpenzimeve, 50 milionë euro shtesë janë dedikuar për rritjen e shpenzimeve të buxhetuara në nivel komunal.

Rrjedhimisht në total shpenzimet për financimin e buxhetit komunal kanë arritur shumën prej 491,2 milionë eurosh, duke dhënë mbështetje të rëndësishëm për ofrimin më kualitativ të shërbimeve komunale si dhe zhvillimit ekonomik lokal.

Sa i përket burimit të financimit, kemi këtë strukturë. Rritja e grantit të përgjithshëm prej 30 milionë eurosh në krahasim me vitin 2017, duke shkuar në 179,4 milionë euro.

Granti për arsim ka një rritje prej 6 milionë eurosh, duke shkuar në 169,3 milionë euro si total.

Granti për shëndetësi, rritje prej 4 milionë eurosh, apo totali prej 48 milionë eurosh.

Buxheti komunal është rritur po ashtu edhe me tre milionë euro nga rritja e planifikuar e të hyrave vetjake dhe 3,3 milionë euro nga projektet e huamarrjes për shëndetësi dhe arsim.

Shpenzimet sipas funksioneve ekonomike.

Më lejoni të prezantoj edhe planifikimin e shpenzimeve të Qeverisë sipas funksioneve ekonomike.

Për funksionet e drejtësisë, mbrojtjes dhe sigurisë publike, Buxheti 2018 parasheh një ndarje buxhetore në vlerë prej 246 milionë eurosh.

Institucionet përgjegjëse për sektorin e drejtësisë:

Ministria e Drejtësisë ka rritje të buxhetit 9%.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 12%.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, 27%,

Akademia e Drejtësisë, Ndihma Juridike falas marrin mbështetje të shtuar financiare për 13% krahasuar me vitin 2017.

Për më shumë, këtë vit rritja është koncentruar në ato kategori ekonomike që mundësojnë rritjen e numrit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në këtë fushë.

Krahasuar me punësimin aktual, është krijuar hapësirë për rritje me 690 profesionistë në Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial.

Për më shumë, janë rritur 50% ndarje të shpenzimit kapitale që mbështesin rritjen e efikasitetit të këtij sektori.

Spektori i mbrojtjes dhe sigurisë: Ministria e Brendshme, Forca e Sigurisë së Kosovës dhe AKI-ja janë rritur gjithashtu me 13%, duke krijuar hapësirë për efikasitet më të lartë operacional përbrenda këtij sektori.

Për sektorin e shëndetësisë: Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Spitalor Universitar ndarjet buxhetore propozohen të rriten me 21% në nivel qendror.

Veç kësaj, rritjet edhe granti komunal për shëndetësinë primare prej 9%.

Në të njëjtën kohë është ndarë edhe kontigjencë shtesë për fillimin e implementimit të skemës së sigurimeve shëndetësore.

Për herë të parë Buxheti 2018 për shëndetësi ka sjellë financim mbi 200 milionë euro.

Ndarjet për barnat esenciale janë rritur me 36% krahasuar me vitin paraprak.

Ndërsa për herë të parë është siguruar financimi i plotë për pagesën e specializantëve.

Për më shumë, është siguruar mbështetje buxhetore për punësimin e 200 mjekëve specialistë dhe numër të konsiderueshëm të infermiereve dhe infermierëve të rinj.

Shpenzimet kapitale për sektor janë rritur për 126% në raport me vitin 2017.

Ndarjet buxhetore për sektorin e arsimit: Ministria e Arsimit, Universiteti Publik dhe Akademia e Shkencave janë ngritur më 22% në nivel qendror.

Duke përlllogaritur edhe rritjen prej 4% të grantit komunal për arsim, totali i shpenzimeve për arsim planifikohet të jetë 260,2 milionë euro.

Për të reflektuar prioritetet kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik, është rritur dukshëm financimi për sektorin e infrastrukturës dhe konkurrueshmërisë.

Buxheti për sektorin e bujqësisë dhe ai i mjedisit dhe planifikimit hapësinor:

Për infrastrukturë dhe konkurrueshmëri ekonomike, ndarjet buxhetore janë rritur 32,8%, krahasuar me rishikimin e buxhetit 2017, duke arritur vlerën prej 374 milionë eurosh.

Brenda këtij sektori është përfshirë financimi për zgjerim të infrastrukturës ekonomike që ul pengesat për rritje të qëndrueshme.

Në anën tjetër, me 9% është rritur edhe mbështetja për bujqësi, si mbështetës i zhvillimit ekonomik, duke arritur financimin total prej 60 milionë eurosh.

Ky sektor vazhdon të mbështetet fuqishëm edhe nga financimi i donatorëve.

Në total, në mbështetje të zhvillimit ekonomik në Buxhetin 2018 parashihen shpenzimet direkte në vlerë prej 434 milionë eurosh. Për realizimin e prioriteteve të qeverisjes së mirë ndarjet buxhetore janë rritur në sektorin e qeverisjes së përgjithshme, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe menaxhimit të financave publike. Total financimet për këta sektorë janë rritur në 10%, apo në 149 milionë euro.

Në të njëjtën kohë buxheti është rritur edhe për të mundësuar ushtrimin më efikas të funksionit të auditimit të përgjithshëm. Po ashtu, edhe për të garantuar funksionim adekuat të shërbimit shtetëror diplomatik ka pasur rritje të rëndësishme në buxhetin operativ të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në fund, për të garantuar se rritja ekonomike është e gjithmbarshme dhe forcon kohezionin dhe zhvillimin social, buxheti është rritur dukshëm për sektorin e punësimit dhe çështjeve sociale, si dhe atë të kulturës. Për këta dy sektorë gjithsej financimi i planifikuar buxhetor është rritur me 5%, nga 428 milionë euro, në 450,2 milionë euro. Përbrenda kësaj rritjeje parashihet mbështetje për rritjen e përfitimeve të asistencës sociale me 20%, duke filluar nga 1 janari i vitit 2018.

Fillimin e financimit të skemave të përkrahjes për qytetarët e paaftësuar në vendin e punës, për pensione familjare, për pagesën e mbështetjes financiare për qytetarët paraplegjikë dhe kujdestarët e tyre, si dhe mbështetjen financiare për viktimat e dhunës seksuale të luftës.

Për veteranët e luftës dhe kategoritë e dala nga lufta është paraparë mbështetje adekuate sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Në të njëjtën kohë, buxheti për kulturë, rininë dhe sportin është rritur me 36% dhe ndër të tjera parasheh edhe fillimin e ndërtimit të stadiumit nacional të Kosovës.

Deficiti buxhetor dhe borxhi publik: Deficiti i përgjithshëm buxhetor për vitin 2018 pritet të jetë 112 milionë euro, apo rreth 1,7% e bruto produktit vendor, për të vazhduar me në ritëm të zvogëluar deri në 1% në vitin 2020. Natyrisht se kur këtij deficiti i shtojmë edhe financimin nëpërmjet klauzolës për investime dhe nga mjetet e AKP-së, kemi një rritje të tij, por ekzekutimi

i projekteve të parapara nëpërmjet këtij financimi do të bëhet vetëm pas marrjes së këtyre mjeteve.

Rrjedhimisht, ne parashohim një deficit të qëndrueshëm dhe me financim adekuat. Ky nivel i deficitit pritet të financohet me një kombinim të huamarrjes së brendshme dhe të jashtme. Niveli i huamarrjes pritet të ketë një rritje modeste, por që në asnjë mënyrë nuk rrezikon qëndrueshmërinë e borxhit tonë publik. Do të ketë rritje të borxhit të brendshëm të emituar nëpërmjet letrave me vlerë, por që pjesa më e madhe do të jetë borxh i jashtëm nëpërmjet kredive koncesionare. Deri në fund të periudhës planifikuese stoku total i borxhit publik pritet të jetë përafërsisht rreth 20% e GDP-së. Unë jam i vetëdijshëm se jo të gjitha kërkesat janë plotësuar tërësisht, por brenda mundësive reale besoj se ky është buxhet i arsyeshëm.

Siç e përmenda edhe në hyrje, ne kemi zhvilluar konsultime intensive në të gjitha institucionet dhe, për aq sa është e mundur, i kemi akomoduar kërkesat e arsyeshme të të gjitha institucioneve.

Të nderuar deputetë,

Unë sot pres në Kuvend që të ketë debat, të ketë propozime profesionale dhe ju siguroj që mes dy leximeve të gjitha ato kërkesa, ato propozime, ato amendamente që kanë mundësi të akomodohen brenda mundësive reale të buxhetit, ne si Ministri e Financave do të jemi në dispozicion të komisioneve dhe të Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Tani, të nderuar deputetë, pas prezantimit të projektligjit, hap debatin për diskutim në parim. Fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, zoti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Do të jem shumë i shkurtër, Projektligji i Buxhetit të Republikës së Kosovës 2018 është proceduar në Kuvend në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Projektbuxheti përmban kornizën makrofiskale për vitin 2018-2020 që pasqyron të dhënat për rrjedhat makroekonomike aktuale, për treguesit makroekonomikë dhe trendin e të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe ndikimet ekonomike në periudhën afatmesme. Përveç pjesës tekstuale, projektligji përmban edhe pjesën tabelare, me të dhëna për të hyra dhe shpenzimet e përgjithshme sipas burimeve dhe strukturës së tyre për vitin 2018 dhe parashikimet për dy vjetët në vazhdim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar në parim Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës 2018, ka vlerësuar se i njëjti përmbush kushtet ligjore të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe me shumicë votash i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Tani është radha e përfaqësuesve ose e kryetarëve të grupeve parlamentare. Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, fjalën e ka Visar Ymeri. Kolegë deputetë, në qoftë se do të kishte mundësi grupet parlamentare t’i sjellin emrat e diskutuesve, LDK-ja dhe PDK-ja e kanë sjellë.

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Draft-buxheti 2018 fatkeqësisht po e them nuk ndryshon në asgjë në raport me buxhetin e vitit paraprak. Edhe vitin e kaluar në momentin e dërgimit të draft- buxhetit në Parlament flitej me optimizëm për projeksionet e rritjes ekonomike dhe promovojë atë botë me të madhe buxheti 2 miliardësh, si e arritur kolosale e qeverisë. Më vonë me rishikim deri diku është korrigjuar kjo papërgjegjshmëri e qeverisë së kaluar.

Natyrisht, se nuk duhet të jesh ekspert i financave për ta kuptuar që edhe ky buxhet do ta ketë pak a shumë fatin e njëjtë me atë paraprak. Njësoj sikurse me buxhetin e vitit të kaluar, të hyrat e parashikuara janë të fryra dhe joreale, kurse shpenzimet priten të mbulohen nga borxhi. Deficiti buxhetor në buxhetin e kaluar ishte 300 milionë euro, ndërkohë që në këtë buxhet është 277 milionë euro. Ajo që vërehet në Buxhetin 2018 është një matematikë e thjeshtë e numrave, duke thjeshtësuar kështu në skajshmëri nevojën për analizë makroekonomike. Me një thjeshtësi të frikshme shifrat ekzistuese janë rritur me një përqindje të caktuar dhe atë në kategori të caktuara, por pa humbur kohë në krahasimin e këtyre modifikimeve me synimet afatgjata të vendit.

Kështu, për shembull, nëse e shohim projeksionin e të hyrave buxhetore vërejmë se gati e gjithë rritja e projektuar është në Tatimin në Vlerë të Shtuar, të grumbulluar nga Doganat dhe në detyrime doganore, me çka rritet edhe më tej varësia buxhetore nga importi i mallrave. Kjo përkundër synimit të stërdeklaruar për të përmirësuar këtë projeksion në favor të të hyrave të grumbulluara brenda shtetit. Për më tepër se kaq, edhe kjo qeveri, sikur secila në mandatet paraprake, nuk parasheh fare rritje të prodhimit vendor për t’i zëvendësuar importet. Kështu natyrisht se do të shtohet qarkullimi ekonomik i brendshëm që do t’i shtonte vendet e punës, e që do ta rriste mirëqenien e fuqinë agregate blerëse të qytetarëve tanë. Kështu do të mbanim më shumë para brenda ekonomisë sonë dhe do të rrisnim efektin zhvillimor të remitencave që vijnë nga jashtë, por jo me këtë qeveri dhe, fatkeqësisht as me këtë qeveri. Edhe me këtë, sikur me të tjerat, do të vazhdojmë të eksportojmë para të gatshme që na i sjell mërgata dhe kështu të kontribuojmë në rritjen e prodhimit industrial të vendeve të tjera, kryesisht të Serbisë dhe Maqedonisë, duke e vazhduar ankthin ekonomik dhe social që mbretëron në vendin tonë tash e sa dekada.

Në këtë buxhet po ashtu vërehet edhe një kthim i pashmangshëm të famshme Klauzolë e investimeve dhe të ideja e futjes së duarve në mjetet e privatizimit. Ajo që po harrohet sërish është se ideja e Klauzolës së investimeve dhe shfrytëzimit të mjeteve nga procesi i privatizimit ka qenë arsyeshmëria e mosrespektimit të rregullës fiskale në këmbim të projekteve në ndikim të

shprehur në rritjen ekonomike. Krejt çka kjo qeveri, e ngjashëm edhe me qeverinë e kaluar, kanë nxjerr nga kreativiteti është prapë asfalti. Në fakt, mendojmë se në vetë dokumentin për Klauzolën e investimeve mbase në mënyrë eksplicite do të duhej të ishte ndaluar përdorimi i kësaj klauzole për investime rrugore apo mirëmbajta të tyre. Se sa real janë këto lloj buxhetesh, mjafton të shikohet zëri i shpenzimeve të financuara nga Klauzola e investimeve.

Qeveria e kaluar kishte buxhetuar 192 milionë euro si investime kapitale, e në realitet, realizimi ishte vetëm 2 milionë euro. Kësaj radhe qeveria qenka treguar pak më e kujdesshme, sepse ka buxhetuar pak më pak, pra 148 milionë euro, e qëllojani se sa do të jetë realizimi, mbase me këtë kujdes arrin në 3 milionë. Ajo që po vërehet është edhe mosharmonizimi komplet i orientimeve të politikave shpenzuese buxhetore me synimet afatmesme të qeverisë, defekt ky që më shumë mund t'i atribuohet kaosit të përgjithshëm qeveritar në ndërtimin e në konsensusi eventual mbi prioritetizimin e këtyre synimeve. Më shumë se kaq, ky buxhet mund të kuptohet si tendencë për akomodimin e kërkesave klienteliste të gjithë partnerëve të koalicionit qeverisës, numri i saktë i të cilëve është vështirë të përcaktohet.

Në këtë kontekst, duhet parë edhe trefishimin e menjëhershëm të deficitit buxhetor, nga 86 në 253 milionë euro. Nuk do mend që fatura që do ta paguajnë qytetarët për këtë megaqeveri dhe megakoalicion do të jetë shumë e kushtueshme. Megjithatë, ky buxhet i ka disa ndryshime: ta zëmë, numri i stafit në institucionet qendrore, pra pa përfshirë komunat, është rritur për 1 mijë e 070 veta. Nuk do mend se gjithë ata ministra e zëvendësministra kanë nevojë edhe për staf shtesë, pra prej shoferëve, te asistentet e te zyrtarët për fotokopje.

Tjetër, ky është buxheti i parë, në fakt, që nuk parasheh asnjë cent të hyrë nga dividendat për një kohë të gjatë. Ky vit duhet të shënohet si viti kur ky sistem i korruptuar i rrënoi përtokë kompanitë publike. Në fund, duhet ta them që në variantin më optimist për këtë qeveri, e më pesimistin për qytetarët që nënkupton mbijetesën e këtij koalicioni edhe përtej pranverës së vitit 2018, atëherë do të hasim sërish në një detyrim që shifrat e tanishme të korrigjohen në kufi të poshtëm nga mesi i korrikut të vitit të ardhshëm, siç ka ndodhur edhe me rishikimin e buxhetit vitit 2017.

Lëvizja “Vetëvendosje” është kundër këtij lloj buxhetimi, është kundër këtyre projeksioneve mashtruese për sa u përket zhvillimeve ekonomike në vend dhe mendojmë që përfundimisht duhet të ndalet kjo logjikë qeverisëse, e cila po e dëmton rëndë potencialin ekonomik, e qe besa, rrjedhimisht edhe mirëqenien për qytetarët e Republikës së Kosovës. Prandaj, ne do të votojmë kundër këtij buxheti, sepse nuk mendojmë që ky buxhet i sjell kurrfarë të mire Republikës së Kosovës, ndërkohë që dëmet nga ky tashmë i kemi parë të përsëritura nëpër vite, siç i pamë në 2017, 2016 dhe në vitet e kaluara dhe në qeveritë e kaluara. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të qeverisë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka analizuar Projektligjin e Buxhetit 2018, është për keqardhje që pas tre vjetëve të përmirësimit të strukturës së buxhetit, me shumë më tepër investime kapitale, me program të qartë të kursimeve, me planifikim buxhetor në funksion të objektivave zhvillimore, që është vlerësuar nga Fondi Monetar dhe nga Komisioni Evropian, Buxheti 2018 degradon dhe e kthen situatën para vitit 2015, kur ka pasur një planifikim të dobët buxhetor, një strukturë joadekuate të buxhetit, një planifikim buxhetor i udhëhequr krejtësisht me motive provinciale e politike.

Më lejoni të jap arsyet për këtë konstatim: e para, ky buxhet që na prezantohet sot nuk buron dhe nuk ka lidhje me programin qeverisës 2017-2021. Ne e kemi dëgjuar në fushatë premtim për rritje ekonomike 8%. Në faqen 4 të programit qeverisës, rritja ekonomike thuhet se do të arrijë 7% në fund të mandatit qeverisës. Ndërkaq, në buxhet rritja ekonomike parashihet 4,6% në vitin 2018, 4,9% në vitin 2019 dhe 5,3% në vitin 2020. Kur do të arrihet 7% apo 8%, siç është premtuar? Unë ju garantoj që jo me këtë qeveri. Prandaj, deklarimi në programin qeverisës 2017-2021 se buxheti do të adresojë prioritetet strategjike është frazë boshe dhe është mashtrim.

E dyta, kur është aprovuar buxheti i vitit 2017 në dhjetor të vitit të kaluar, deputetët të PDK-së dhe të opozitës së atëhershme e kanë kritikuar buxhetin 2 miliardë euro se bazohet në financim nga huamarrja dhe nga mjetet e AKP-së. Ai buxhet atëherë kishte mbështetjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar, tash Kuvendit të Kosovës i prezantohet një buxhet që përfshin këto burime të financimit. Kjo qasje e këtyre deputetëve e bën të qartë se kundërshtimi i atëhershëm ka qenë i rrejshëm dhe për motive politike.

E treta, ky është buxheti me rritje më të vogël të të hyrave që kemi pasur për shumë vjet me radhë. Ju përkujtoj që buxhetet e Qeverisë Mustafa kanë pasur rritje të të hyrave mesatarisht 10% në baza vjetore. Ndërkaq, me këtë buxhet për vitin 2018 rritja e të hyrave është vetëm 6%. Më lejoni të jap një fakt tjetër për të hyrat buxhetore. Gjatë mandatit të Qeverisë Mustafa të hyrat tatimore janë rritur afër 400 milionë euro, krahasuar me gjendjen e trashëguar në vitin 2014 që është një rritje prej 30%, ndërkaq kjo qeveri në tre vjetët e ardhshme do të rrisë të hyrat tek në vitin 2020 vetëm me 17% krahasuar me gjendjen që po e trashëgon. Në Qeverinë Mustafa të hyrat nga tentimat u patën rritur 22% për shkak të menaxhimit më të mirë, në këtë qeveri kemi 0% rritje të të hyrave nga ky burim.

Dhe, kjo është e natyrshme me qasjen për falje të borxheve pa asnjë bazë ligjore që po aplikon kjo qeveri. Ky nuk është planifikim dhe menaxhim i duhur buxhetor, për të cilin ka nevojë Kosova.

Arsyeja e katërt, ky buxhet dëmton bizneset dhe investimet që do të ndodhin në ekonomi. Ju informoj se norma reale e investimeve në ekonomi deri në vitin 2014 ka qenë negative me -5%, gjatë Qeverisë Mustafa e kemi rritur në 11% në vitin 2015, 10% në vitin 2016, dhe 13,9% në vitin 2017. Ndërkaq, kjo qeveri me këtë buxhet bën që trendi i rritjes së investimeve të përgjysmohet vetëm në 5.6% më 2018. Edhe në vitin 2020 nuk arrihet norma e rritjes së investimeve që kemi pasur sivjet. Me këtë lloj buxheti është e natyrshme që norma e rritjes së eksporteve të përgjysmohet gjithashtu, nga 5,4% sa është sivjet, në 2,5% në vitin e ardhshëm, edhe në vitin 2020 norma e rritjes së eksporteve nuk e tejkalon normën e rritjes së eksporteve që është sivjet. Kështu maten, në fakt, efektet e këtij buxheti.

Te shpenzimet, këtu shpërfaqen të gjitha dobësitë e këtij buxheti, shpërfaqet mungesa e guximit profesional për të planifikuar objektiva ambicioze, por që janë të realizueshme. Por, mbi të gjitha, shpërfaqet mungesa e vizionit se kah do ta orientojmë ekonominë dhe shoqërinë kosovare në vitet që vijnë. Për informim të deputetëve dhe të qytetarëve, qeveria e kaluar i ka rritur kryesisht shpenzimet kapitale për 521 milionë euro krahasuar me gjendjen e trashëguar në vitin 2014, që është një rritje prej 35%. Dhe, kjo është arritur duke përmirësuar strukturën e buxhetit më shumë investime kapitale, duke mos e rritur ngarkesën tatimore për qytetarë dhe për biznese. Kjo qeveri vitin e ardhshëm i rrit shpenzimet vetëm për 4%, më 2020 shpenzimet rriten me 14% krahasuar me vitin 2017.

Tek investimet kapitale, më 2018 këto do të jenë më të vogla se sa që janë sivjet dhe kështu do të përkeqësohet struktura e buxhetit. Pjesëmarrja e investimeve kapitale në shpenzime totale buxhetore do të bie nga 36, sa është sivjet në 32%. Plot projekte kapitale nuk janë kapitale për nga natyra e tyre. Për shembull, projekti i inventarizimit të tokave bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë në kuadër të Institutit Bujqësor me kod 15522.

Te shpenzimet për paga, ju informoj se në Qeverinë Mustafa e kemi krijuar bazën ligjore për rritje vjetore të pagave nga janari i vitit 2018, nëpërmjet rregullës në përputhje me normën e rritjes ekonomike. Në vitin 2017 rritja ekonomike pritet të jetë 4,3%, në vitin 2018 sipas qeverisë 4,6%, por kjo qeveri po shkel këtë ligj, sepse në këtë buxhet pagat nuk mund të rriten as me 4%. Rritja e buxhetit për paga nga 572 milionë me 589 milionë është 17 milionë, apo 2,9%. Për më tepër, në Buxhetin 2018 është paraparë rritje e punësimit në sektorin publik për 1 mijë e 050 të punësuar, me një pagë mesatare duke përfshirë tatimet, kontributet pensionale e tjera, e tjera, rreth 550 euro, janë 7 milionë euro që do të shkojnë vetëm për punësim të ri. Pra, mbesin 10 milionë euro për rritje të pagave, prandaj nuk ka mundësi të ketë rritje të pagave ashtu siç kërkohet me ligj, prandaj po shkelet ligji në këtë rast.

Të nderuar deputetë,

Duhet ta dinë taksapaguesit kosovarë se vetëm punësimi i rreth 70 zëvendësministrave do të kushtojë rreth 3,5 milionë euro. Llogaritini vetë këtë, 70 zëvendësministra me nga 3 veta staf përcjellës secili, me veturë dhe shpenzime të reprezentacionit. Për ilustrim, për sigurime shëndetësore Qeveria ka ndarë një kontigjencë prej 3 milionë euro që është më pak se kostoja e zëvendësministrave.

Tek shpenzimet për mallra dhe shërbime, kjo qeveri tash e kthen praktikën e qeverive deri në vitin 2014. Nuk ka në buxhet asnjë plan të kursimeve dhe kjo fjalë as që zihet në gojë në gjithë dokumentin e buxhetit. Buxheti për mallra dhe shërbime është rritur me 17% dhe askund nuk arsyetohet kjo çështje. Në Qeverinë Mustafa ne kemi pasur një plan të qartë të kursimeve për mallra dhe shërbime. Tek subvencionet, ato rriten ndjeshëm, por jo për bujqësi, që ka qenë premtim elektoral, duke u thënë në veçanti vreshtarëve, kryetari i PDK-së se do t'u rriten me 1 500 euro, kryetari i AAK-së se do t'u rriten me 1 250 dhe njerëzit ishin në dilema se a do të jetë rritja 1 500 apo 1 250 euro për hektar, ndërkaq me këto subvencione që janë planifikuar, nuk do të ketë rritje të subvencioneve në bujqësi.

Do të rriten skemat e veteranëve të luftës në 73 milionë euro. Edhe pse në buxhet ministri ka paraparë vetëm 58 milionë, por me këtë numër ekzistues të veteranëve të luftës kjo skemë do të shkojë në 58 milionë, dhe kjo skemë në fakt i absorbon edhe mjetet që i patën ndarë për pensionimin e parakohshëm të policisë, që tash nuk figurojnë fare në buxhet.

Premtimet për pagesë të pensioneve të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës mbesin vetëm mashtrim. Janë vetëm 1 milion euro të parapara në këtë kategori, me një llogaritje të thjeshtë del që jo më shumë se 300 persona mund të paguhen nga kjo kategori.

Të nderuar deputetë, ekziston një problem shumë i madh në këtë buxhet që mund të prodhojë pasoja ligjore dhe ta dëmtojë buxhetin edhe në të ardhmen nëpërmjet vendimeve gjyqësore. Duhet të jetë e qartë për të gjithë se buxheti ka historik, nuk mund të bëhen prerje siç është bërë në këtë buxhet. Nuk mund të përdoret buxheti i Kosovës për të financuar interesa të ngushta elektorale të partive në pushtet. Është shqetësuese tendenca për të orientuar buxhetin në komuna të caktuara që qeverisen nga partitë në pushtet. Me këtë buxhet janë hequr projektet ose është shkurtuar buxheti për projektet e nisura në dy vjetët e fundit nga komunat nëpërmjet mjeteve të ministrive të linjës bazuar në memorandumet e bashkëpunimit.

Për shembull, në rastin e Pejës janë hequr komplet projektet me memorandumet e bashkëpunimit. Një kontratë e nënshkruar 1 milion euro, është buxhetuar vetëm 100 mijë euro tashmë në buxhet. E njëjta situatë është edhe në plot komuna të tjera, si në Viti, Podujevë dhe në komuna të tjera anekënd Kosovës. Ata që po fusin duart në buxhet në këtë mënyrë, ta dinë se po bëjnë shkelje të ligjit dhe mund ta dëmtojnë buxhetin në të ardhmen nëpërmjet vendimeve

gjyqësore, duke qenë se janë krijuar obligime ligjore nga kontratat e nënshkruara. Ne kërkojmë që të gjitha ato memorandume të nënshkruara bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin 2017 të reflektohen plotësisht në Buxhetin 2018.

Për më tepër...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Unë mund t'i jap edhe dy minuta kështu, por Rregullorja, shiko, ti po i sheh të tjerët. Ju po i shihni qysh flasin të tjerët, ka shumë të tjerë këtu që kërkojnë ashtu si ky t'u vazhdohet. Ju jeni 20 e sa deputetë, secili mund t'i ndani detyrat.

Dy minuta, Avdullah, vazhdo nëse ke diçka që të ka mbetur pa thënë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Ne do t'i bëjmë të gjitha ato amendamente për të siguruar që memorandumet e bashkëpunimit me komunat të reflektohen në buxhet.

Në fushën e drejtësisë më lejoni të theksoj, në Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial punësimi i ri është vetëm 260 persona, jo 600 persona, siç është specifikuar në faqen 16 në dokumentin përcjellës. Në shëndetësi projekti i sigurimeve shëndetësore është hequr tërësisht, nuk mund të pretendojmë që të ofrojmë shërbime shëndetësore kualitative pa filluar këtë projekt. Në arsim po kthehet praktika e njëjtë, janë planifikuar 9 shkolla të reja që nuk përfundojnë as në vitin 2020. Për shpronësime është zvogëluar buxheti nga 30 në 18 milionë euro, do të mbesin plot obligime të qytetarëve për shpronësime në autostradë dhe në projekte të tjera të pamundshme që t'u kryhen obligimet atyre qytetarëve.

Janë dy ministri të reja që po krijojnë obligime për buxhetin e Kosovës, Ministria për Inovacion dhe Ndërmarrësi, që do t'ju kushtojë qytetarëve të Kosovës 10 milionë euro, me 52 zyrtarë, me 7 milionë euro vetëm subvencione që do të ndahen në bazë të vendimit të ministrit në diskrecionin e tij. Ministria e Zhvillimit Rajonal që është duke u krijuar një precedent i rrezikshëm me 4.1 milionë euro, me 54 të punësuar, me 2 milionë euro për program të zhvillimit rajonal që nuk është e qartë se si do të shpenzohet, askush nuk e di se çfarë do të punojë ky ministër dhe zyrtarët e tij, ashtu sikur edhe ministri paraparak për Inovacion dhe Ndërmarrësi. Ne kemi evituar çfarëdo rajonalizimi të Kosovës në të kaluarën, ndërkaq tash kjo qeveri po na kthen mbrapa.

Rezerva buxhetore është planifikuar 4.8 milionë euro, ju informoj që vetëm 2 muajt e fundit kryeministri dhe Qeveria ka ndarë 2.5 milionë euro për vendime që nuk janë në përputhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Të nderuar deputetë,
Grupi ynë Parlamentar e kryeson komisionin dhe do të kujdesemi që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

I nderuar ministër i Financave,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky është një rregull, që opozita kur del në foltore e ka si qëllim të vetin të kundërshtojë, me apo pa argumente politike, me apo pa argumente të shifrave, vetëm sa për të kundërshtuar.

Kjo që e dëgjova kryetarin Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës është më shumë sesa naivitet. Sikur të donte të largohej nga llogaridhënia, pasi deri para dy-tre muajsh ka vendosur se ku do t'i shpenzojnë mjetet, si do t'i shpenzojnë, çfarë mjetesh të ndajnë, si t'i planifikojnë, si t'i shpenzojnë... Vetë kanë menaxhuar me Buxhetin e Republikës së Kosovës. Edhe kryetari i Grupit Parlamentar e di se ka bërë një planifikim, jo të mbështetur në realitetin, ka pasur shifra fiktive në Buxhet, sepse po shkon viti 2017 dhe asnjë euro nuk është investuar në emër të AKP-së, që kanë qenë të planifikuara në buxhet, por njëkohësisht nuk janë realizuar as mjetet për klauzolën e investimeve, që, për fat të keq, projektligjet kanë qenë të pamiratuara, marrëveshjet të paratifikuara në Kuvend.

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar Buxhetin dhe ka ardhur në përfundim që ky është një buxhet i ndërtuar mbi shifra reale të të ardhurave dhe shpenzimeve. Është bazë për realizimin e objektivave që Qeveria ia ka vënë vetes për forcimin e shtetit dhe për integrimin evropian.

Ky projektbuxhet hap mundësi shumë më të mëdha për të bërë shumë më tepër për zhvillimin ekonomik dhe hapjen e mundësive për një jetë më të mirë të qytetarëve tanë.

Projektbuxheti e ruan nivelin e ulët të deficitit prej 1,7% të bruto-produktit vendor, e ruan balancën bankare prej 4,5%, siguron rritjen ekonomike prej 4,6%. Por, njëkohësisht është i planifikuar edhe një borxh publik prej 14%, që është i pranueshëm, rrit rrogat e të punësuarve, trajton kategoritë e ndjeshme të shoqërisë sonë dhe e ruan nivelin e lartë të investimeve kapitale. Janë këto shifra reale të Buxhetit, të cilat sigurojnë stabilitet makro-fiskal dhe një bazë të mirë për zhvillimin ekonomik dhe realizimin e objektivave programore të Qeverisë.

Është pozitiv fakti se Buxheti 2018 është buxhet i rritjes ekonomike dhe se burim kryesor që gjeneron rritje parashikohet të jetë rritja e konsumit, investimet dhe eksporti. Po ashtu, niveli i lartë i investimeve publike prej 10,2% të bruto-produktit vendor pritet të jetë një faktor i rëndësishëm, i cili do t'i japë efektet e veta në rritjen ekonomike.

Shifrat në brendinë e Buxhetit adresojnë objektivat, që Qeveria ia ka vënë vetes me platformën qeverisëse për qeverisje të mirë, sundim të ligjit, zhvillim ekonomik, punësim dhe integrim evropian. Treguesit makro-ekonomikë verifikojnë se Buxheti është i planifikuar me realizëm, por edhe me përgjegjësi. Të hyrat e përgjithshme të buxhetit janë planifikuar të jenë 6,3% më shumë se në vitin 2017, me vlerë 1 829 000 000 euro, që kapin nivelin 27,6% të bruto-produktit vendor. Është për t'u vlerësuar që rritja e të hyrave parashihet të bëhet nga nxitja e formalizimit të ekonomisë, lehtësimeve për sektorin e prodhimit, rritjen e efikasitetit në mbledhjen e të hyrave, jo duke e rënduar biznesin, por duke krijuar mundësi për një lehtësim sistematik nëpërmjet politikës efektive tatimore.

Të hyrat tatimore direkte dhe indirekte përbëjnë 89% të të hyrave të përgjithshme që marrin pjesë me 24,2% të bruto-produktit vendor, kurse të hyrat tatimore dhe të hyrat vetjake marrin pjesë me 3% të bruto-produktit vendor. Pjesa më e madhe e të hyrave buxhetore planifikohet të sigurohet nga Dogana, 1 175 000 000 euro, që janë 6% më shumë se në këtë vit, 17,6% si pjesëmarrje e bruto-produktit vendor. Të hyrat që sigurohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar janë 616 000 000 euro, apo 9% më shumë se në këtë vit. Nga akciza janë planifikuar mjetet prej 446 000 000, ose 5,7% më shumë se këtë vit, kurse të hyrat nga detyrimet doganore kanë rënie për 4,3% krahasuar me vitin 2017.

Buxheti bazohet edhe në të hyrat e brendshme, që kanë vlerë 446 000 000 euro, që janë planifikuar 4,5% më shumë se në vitin 2017, pjesëmarrja e të cilave në të ardhurat e gjithmbarshme është 24,3%

Të hyrat e brendshme janë baza themelore, ku duhet të bazohet dhe të fokusohet Qeveria, që nëpërmjet reformave dhe politikave të mirëfillta t'i rrisë edhe më tutje këto të hyra, që janë baza kryesore për buxhet të qëndrueshëm, në mënyrë që t'u ikim të hyrave nga Dogana dhe të largohemi nga praktika e së kaluarës për fryrje artificiale të shifrave buxhetore. Edhe pse këto shifra janë optimiste, ne kërkojmë edhe më shumë nga Qeveria, sepse kemi nevojë edhe për më shumë rritje ekonomike, që do të ketë impakt në rritjen e punësimit dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës në vendin tonë.

Të nderuar deputetë,

Në projektbuxhetin e vitit 2018 janë paraparë 2 082 000 000 euro, apo 31,1% si pjesëmarrje e bruto-produktit vendor për t'i adresuar prioritetet qeveritare. Mjetet e parapara për shpenzimet

buxhetore janë planifikuar në shifra reale, përkundër planifikimit të vitit të kaluar, kur buxheti ishte i bazuar në shifra të perealizueshme.

Tani e kemi në miratim projektligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili mundëson realizimin e mjeteve të parapara në buxhet prej 86 milionë eurove dhe janë miratuar marrëveshjet për projektet që do të realizohen nëpërmjet klauzolës së investimeve që janë paraparë 62 000 000 euro, projekte këto që kanë të bëjnë me rehabilitimin e rrugëve rajonale, me ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza në Prishtinë, rehabilitimin e linjës hekurudhore Prishtinë - Hani i Elezit, sigurimin e ujërave dhe mbrojtja e kanaleve, projekti për konkurrueshmëri dhe gatishmëri për eksport, nëpërmjet të cilit projekti po fillon të mbështetet sektori privat, si dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që do të japë efekte në zhvillimin ekonomik të vendit. 33% e shpenzimeve të përgjithshme, nga 687, milionë euro janë paraparë për investime kapitale për t'i mbështetur sektorët kyç të ekonomisë.

Nga shpenzimet e parapara për investime kapitale në infrastrukturën rrugore janë planifikuar 34,6% të mjeteve, me të cilat do të ndërtohen rrugët që konsiderohen me prioritet nacional, siç janë ato në drejtim të Shkupit, në drejtim të Mitrovicës, Drenasit, Skenderajt, në drejtim të Gjilanit, të Pejës, rruga Deçan - Plavë, që ka filluar të ndërtohet vite më parë, mjetet e para janë planifikuar që në vitin 2013, por që nuk vazhdoi më tutje në mungesë fondesh dhe tani po fillon investimi edhe në këtë rrugë, që besoj se do të ketë efekte shumë pozitive për Kosovën.

Në përmirësimin e infrastrukturës në arsim, në shëndetësi, në ujësjellës dhe në përpunimin e ujërave të zeza, në projektin e rëndësishëm në kulturë dhe sport, për bujqësi, për përmirësimin e infrastrukturës në të gjitha komunat tona, janë paraparë mjete kapitale prej 449 000 000, apo 65,4% të mjeteve të parapara për investime kapitale.

66% e shpenzimeve buxhetore, apo 1 383 000 000 euro janë planifikuar për shpenzime rrjedhëse, ku për herë të parë pas katër vjetësh është planifikuar rritja e pagave, me ç'rast do të përfitojnë të gjithë të punësuarit, që janë të planifikuar në Buxhetin 2018. Për herë të parë, 19 vjet pas luftës, fillon të paguhet një kategori e ndjeshme e shoqërisë sonë, gratë viktime të dhunës seksuale gjatë luftës, që ishte paraparë me ligjin e miratuar në mars të vitit 2014, por që është shumë e pakuptueshme pse nuk implementohej një ligj i tillë, si dhe do të përfitojnë të gjitha familjet që marrin ndihmë sociale nga shteti me rritje prej 20%.

Në Buxhetin 2018 është arritur që të rritet edhe granti i përgjithshëm për komunat, granti për arsim, granti për shëndetësi dhe nisur nga ajo që rritja e buxhetit në sektorin e bujqësisë është për 13%, në sektorin e shëndetësisë për 30% në nivelin qendror dhe në nivelin lokal, në sektorin e arsimit për 26% në nivelin qendror dhe lokal, rritja e buxhetit për infrastrukturë dhe konkurrueshmëri për 32,8%, me ç'rast do të përfitojnë bizneset e vogla dhe të mesme, investimi me prioritet në bujqësi, ku rritja është bërë për 9%, duke e vlerësuar si një sektor me ndikim të

fuqishëm në rritjen ekonomike, si dhe rritja e mjeteve për qeverisjen e mirë për 10% është një mesazh i besueshëm se Buxheti 2018 ka filluar të planifikohet për prioritetet që ndikojnë në zhvillimin dhe në mirëqenien e qytetarëve që ka qenë...

KRYESUESI: Vetëm dy minuta edhe ty po t'i jap...

SAFETE HADËRGJONAJ: Pra, një buxhet i tillë është buxhet i besueshëm dhe Buxheti 2018 ka filluar të planifikohet për prioritete të cilat ne faktikisht e kemi ngrëhur si çështje për t'u planifikuar në këta sektorë kryesorë, që kanë efekte në zhvillimin ekonomik.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do ta përkrahim projektbuxhetin për vitin 2018 duke votuar për, me kërkesën drejtuar Qeverisë që të ketë një përdorim efikas dhe eficient të mjeteve të taksapaguesve, në mënyrë që të arrihen objektivat që Kosova ia ka vënë vetes në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian. Kontributin tonë të mëtutjeshëm do ta japim gjatë punës sonë në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ku do të kemi mundësi të bëjmë edhe ndonjë përmirësim eventual, në rast se ka nevojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, kush e ka fjalën? Zoti Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Grupi ynë Parlamentar, duke e ditur se procesi i përgatitjes së Buxhetit të Kosovës ka filluar qysh në fillim të vitit 2017 nëpërmjet qarkoreve buxhetore, pastaj propozimet për prioritetet e shpenzimeve dhe tavanëve buxhetore deri në qershor të këtij viti, si dhe propozimet e shpenzimeve nga organizatat buxhetore deri më 31 tetor 2017, të vetëdijshëm që përgatitja e Buxhetit 2018 është një zinxhir i aktiviteteve që përfshin periudhën shkurt - 31 tetor 2017. Ministria aktuale dhe ministri Hamza është dashur pothuajse në të njëjtën kohë ta përgatisin edhe buxhetin e rishikuar 2017, një rishikim i vonuar.

Ne do ta votojmë Projektligjin për Buxhetin 2018 në lexim të parë, duke lënë hapësirë që deputetët tanë ta japin kontributin e vet me propozimet e tyre deri në leximin e dytë. Po ashtu, ne i jemi mirënjohës ministrit Hamza dhe stafit të tij për punën e tyre në këtë ambient të cekur më lart dhe besojmë që Buxheti 2019 të jetë edhe më shumë në harmoni dhe në funksion të Programit qeverisës të kryeministrit. Njëkohësisht, vlerësimi ynë është se Buxheti i Kosovës për vitin 2018 është në vazhden e buxheteve konservative, por që ndjek praktikën e matura në planifikimin e të hyrave të përgjithshme.

Këtë buxhet e veçojnë parametrat e parashikuar makro-ekonomikë me bazë të fortë të planifikimit, si rritje reale e bruto-produktit vendor prej 4,6%, në krahasim me vitin 2017, dhe

rritja nominale e ekonomisë mbi 6%. Po ashtu, krijimi i 20 000 vendeve të reja të punës vetëm për vitin 2018.

Sa u përket të hyrave të planifikuara, ato janë të planifikuara me shkallë të rritjes prej 6,3% krahasuar me vitin paraprak dhe atë jo duke i rritur taksat dhe bazën tatimore, por duke i zvogëluar ato. Shpenzimet e planifikuara rezultojnë më shumë në funksion të marrëveshjeve paraprake si projekte dy apo trevjeçare, veç të kontraktuara, është fjala tek investimet kapitale. Po ashtu, ato janë brenda kornizës afatmesme, 2017, 2018, 2019.

Edhe një herë, ne do ta votojmë në lexim të parë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bontiq e ka fjalën.

JELENA BONTIĆ: Zahvaljujem predsedavajući!

Zakon o nacrtu Budžeta za 2018-u godinu najzad je tehnički dobro pripremljen. Planiranje Budžeta bazirano je na realnim ciframa, bazirajući se na prihode i rashode.

Poslanička grupa Srpska lista ima neke primedbe na predloženi Budžet, a te primedbe se odnose na ministarstva koja u svojim planovima i raspodeli budžeta nisu uvrstili u svoje kapitalne troškove nijednu opštinu sa srpskom većinom. Tako na primer, jasno se vidi u tabeli 3, tačka 2, kapitalni projekti za centralni nivo, na primer, da Ministarstvo zdravstva u svojim planovima za 2018-u godinu nema nijedan projekat koji je usmeren na pomenute opštine, takođe ni Ministarstvo kulture omladine i sporta.

Poslanička grupa Srpska lista daće svoje primedbe do drugog čitanja, a danas dajemo podršku Nacrtu zakona o Budžetu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! “Nisma”, kush e do fjalën?

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektbuxheti i paraqitur për vitin 2018 nga ministri Hamza paraqet një strukturë të mirë brenda kuadrit ligjor. Është brenda shifrave reale, si në fazën e planifikimit të të hyrave, po ashtu edhe në fazën e shpenzimeve dhe garanton një ecje dhe një zhvillim stabil, si dhe një gjendje fiskale të stabilizuar.

Mbështetja të cilën, për të mos u lëshuar në ato që i thanë parafolësit, sepse është krejtësisht reale dhe e natyrshme që ky projektbuxhet të parashihet nga pozicionet dhe të vlerësohet në bazë të pozicioneve ku gjendemi dhe është krejtësisht normale që opozita ta mbajë një qëndrim çfarë e deklaroi deri më tani, por ne bëjmë thirrje që ajo të bëhet pjesë konstruktive, që brenda dy leximeve t'i ofrojë të gjitha ato vërejtje që i ka dhe sigurisht që Qeveria do t'i marrë për bazë dhe do të jetë në funksion të një interesi të përgjithshëm.

Ajo që do të vlerësoja tani është mbështetja, e cila ofrohet në rritjen e granteve për komuna në fushën e Shëndetësisë, në fushën e Arsimit, dhe në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë Publike, e në Ministrinë e Drejtësisë, e cila mendoj se duke shtuar kapacitetet shtesë në sistemin e Drejtësisë neve do të na hapë një mundësi që të shkojmë drejt stabilizimit dhe funksionimit të shtetit të së drejtës.

Mundësia e 690 pozitave të reja brenda kuadrit të Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial, mendoj se do të rrisë kapacitetet operacionale dhe efikasitetin e punës në sistemin e Drejtësisë, i cili do t'i garantojë të gjitha mundësitë e largimit të pengesave deri në luftimin e informalitetit, i cili është i konstatuar në masë 30% dhe do të hapen perspektiva të reja.

Po ashtu, e vlerësoj shumë këtë projektbuxhet në ruajtjen e realizimit të kontratave të bartura nga qeveritë e kaluara. Mendoj se këto janë kontrata të kontraktuara dhe duhet të realizohen. Sigurisht se kjo ka penguar në hartimin e prioriteteve të reja, që do të garantonin një zhvillim më dinamik dhe një dinamikë të shtuar. Por, urojmë që brenda vitit 2018 disa kontrata, disa projekte, të cilat kanë mbetur të zvarritura me vite të tëra, të realizohen dhe për vitin 2018 kjo Qeveri të hartojë prioritete të reja, që do të garantojnë një zhvillim dhe rritje të punësimit.

Është për t'u përshëndetur edhe mbështetja e garantuar e skemave sociale dhe kategorive të dala nga lufta, sipas ligjeve në fuqi. Gjatë dy leximeve, Grupi Parlamentar "Nisma" do të kontribuojë në amendamentimin të përmirësimit të disa projekteve dhe do ta mbështet plotësisht në lexim të parë këtë projektbuxhet të paraqitur nga Qeveria. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! "6+"-i, cili e doni fjalën? Zoti Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

2018 yili kosova butcesi yasa tasarisini "6+" paralemento gubu olarak inceledigimizi kosovanin onumuzde ki yil da buyume hizini istenilen seviyede yakalayacagini gosterilen verilerden gormekteyiz.

2018 yili icin planlanan butce yaklasik olarak 2 milyar euro oldugu ve bunun buyuk bir kisminin malesef yine vergilerden aslinda gumurk vergilerinden karsilanmasi ve Kosova ekonomi yapisi

ticerete dayali bir sekilde devam etiginin, bu da gelecekte ciddi sorunlar ortaya koymasi endisesi tasidigini uzulerek ifade etmek isterim.

2018 yili butce planlamasinda kosova nin 3 en onemli sektoru olan egitim, saglik ve adalete ciddi artirlarin saglandigi ve bu oranlari yakalsik olarak %27 civarinda olmasi bizleri sevindirmektedir, cunku halkimiz ozellikle saglikta ciddi sorunlar yasarken ilac konusunda gerekli duzenlemelerin olmasi bizleri sevindirir. Hukümetin programinda dogru bir sekilde ilerledigini gormekteyiz.

Bu yil yatirimlari istenilen duzeye cekilmesi ekonomide bir canlanmanin yasanilacaginin sinyallerini vermektedir, uskup otobanini altyapi konusunda ciddi bir proje teskil etigi ve bu yil sona ermesi bizleri sevindirirken ayni zamanda diger bolgelere gilan ve mitrovica isitkamesinde otoban planlamalari da ongorulmesi, bizlerin kosovanin kalkinmasina onemli olan yatirimlari planli bir sekilde butce dengesini bozmadan devam etigini gormekteyiz.

Bu yil buyume oraninda yani yaklasik olarak %4 oraninda kamu calisanlari maaşlarında bir artirlarin saglanacagi da mujedesini verilmektedir. Bu planlama her yil bu seviyede olmasi da ongorulmektedir yani hukümetin normal 4 yilic sure zarfi icinde %20 lik bir maaş zaami planlanlamis olmasi bizleri memnun etmektedir.

Beledie butcelerine baktigimizda secimlerinin bu yil sonunda yapilmasi ve butcelerin bir oncesi beledie baskanlari tarafından planlanmis olmasi yeni secilen beledie baskanlari tarafından eli mahkum bir sekilde sadece uygulama

ile kalacak olmalari, istenilen verimlerin bu yil icinde almali zor olacaktir. Umud ederim ki ekslikleri tespit edip 6 ay sonrasi gerekli duzenlemeleri yapma sansini yakalama olanagina sahibiz.

Topluluklar acisinden Butce tasarisini inceledigimizde her yil oldugu gibi bu yilda genel butce cercevesinde planlama yapildiği daha dogrusu topluluklar bakanliginda ve topluluklar ofisinde sadece tek butce seklinde ongoruldugu ve bizlerin her seferinde itiraz etigimiz ama degismeyen madde okarak kaldigini, topluluklara ayrilan butcenin sadece tek bir topluluk sirplari tarafından kullanilacaginin endisesini tasimaktayiz..

2 yildir butce de ongordugumuz 12. Madde ile kisiltama getirdigimizi ama bu maddeninde pek bir ise yaramadigini ve son bu butce tasarisinde de bu maddenin kaldirilimis olmasi bizleri topluluklari derinden uzmustur.

Basbakan ve finans bakanindan bu konuda herkesin hak etigi kadar haki olan butceden faydalanmasi konusunda adimlari atilmasini bekledigimizi ifade etmek isteriz. Aksi halde butce tasarısına cekimser kalacagimizi uzulerek ifade etmek isterim.

Finans bakani ile yapmış olduğumuz istisarelerde toplulukların kulanımı açısından özellikle yatırımlar açısından sosyal bakanlığında 1 milyon euro bir butcenin ayrıldığını ifade etmişlerdir, her ne kadar bu ihtiyaçlarımızı gidermese de bir adım atıldığını bizlerin taleplerin karşılanacağı umudunun doğmaktadır. Ama beklentimiz al kod olarak her topluluğun butcesinin belli olmasıdır.

Bu yıl butçede eğitim bakanlığında ve topluluklar bakanlığında her topluluğa ait birimlerin kurulması onergesini sunacağımız ifade etmek isteriz çünkü bizlerin sorunlarına etkili çözüm üretmek her yıl butçe ye katkı sağlayan topluluklar olarak hakimizin olduğunu bildirmek isterimden. Projelerimiz yerinden takip edilmesi en doğru çözüm olacağına inanmaktayız.

Kosova Türk toplumu olarak her yıl butçede öğördüğümüz kültür evi projelerine devam edeceğimizi ve hedefimizde mamusa belediyesi olduğunu da ifade ederken özellikle prizren ve mamusada su projelerin takipçisi olacağımızı bu projelerin butçede yer alması için cabamızın devam edeceğini bildirirken grup olarak 2018 yılı butçe tasarısını desteklediğimizi birdaha ifade ederken gerekli değişiklik onergelerini de komisyona sunacağımız bildirmek isterim.

Dhe, në fund, Grupi “6+” nuk do ta votojë këtë Buxhet derisa në Ministrinë e Komuniteteve dhe në Zyrën e Kryeministrit për Komunitete nuk ndahet sipas nënkategorive për secilin komunitet të veçantë. Edhe në tekstin e Buxhetit duhet të specifikohet sipas nenit i cili ka figuruar deri në vitin 2016 dhe 2017, ku ndahet dhe specifikohet riprogramimi sipas kategorive për secilin komunitet në veçanti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari, projektbuxheti është ndër ligjet, është ligji më i rëndësishëm i një vendi dhe sigurisht që zoti Haradinaj, si kryeministër i vendit, do të duhej të ishte këtu për t'i dëgjuar shqetësimet dhe diskutimet e deputetëve të Kuvendit. Mirëpo, sigurisht edhe kjo qasje tregon sa janë të përgjegjshëm karshi deputetëve, por edhe karshi qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Sa i përket Projektbuxhetit 2018, tashmë është bërë praktikë që edhe komisionet parlamentare të shqyrtojnë buxhetin, pra nuk i përket vetëm Komisionit për Buxhet, por edhe komisioneve të tjera, varësisht prej fushave që mbulojnë dhe në këtë drejtim edhe Komisioni për Legjislacion para tri javësh ka organizuar dëgjim publik me institucionet e drejtësisë dhe ato institucione që bien në fushëveprimtarinë e Komisionit për Legjislacion dhe, thënë të drejtën, janë të shumta kërkesat që këto institucione i kanë adresuar në Komisionin për Legjislacion, kërkesa këto që Qeveria i ka injoruar.

Sigurisht që Komisioni për Legjislacion duhet ta bëjë punën në këtë drejtim, pra që në bashkëpunim edhe me Komisionin për Buxhet dhe Financa t'i adresojë kërkesat e institucioneve të drejtësisë. Tashmë i kemi gati kërkesat tona dhe nesër në mbledhjen e komisionit të gjitha këto do të adresohen.

Jo rrallë, madje më duhet të them që në vazhdimësi ne kemi dëgjuar kryeministra, përfshirë edhe kryeministrin aktual, por edhe ministrat e drejtësisë, përfshirë po ashtu edhe ministrin aktual, Abelard Tahiri, teksa flasin për sundimin e ligjit, për fuqizimin e institucioneve të drejtësisë, luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe sigurisht që për të kuptuar se sa është serioze një Qeveri për ta forcuar sistemin e drejtësisë sigurisht që duhet parë edhe buxhetin që i është ndarë sistemit të drejtësisë.

Mendoj që Qeveria Haradinaj, pavarësisht deklaratave publike, nuk do të ketë qasje ndryshe nga qeveritë e kaluara në raport me sistemin e drejtësisë, sepse për çështje dhe për fusha të tjera do të flasin deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje”, unë po ndalem vetëm te sistemi i drejtësisë.

Pra, edhe në buxhet, sikurse edhe në program qeverisës që do ta diskutojmë në një seancë tjetër, shihet që është një vazhdimësi e qeverisjeve të kaluara, domethënë një farë lloj lejimi i degradimit të institucioneve të drejtësisë dhe nuk e di se a po u përshtatet qeverive që qëllimisht ta degradojnë sistemin e drejtësisë, në mënyrë që ta kenë më të kontrollueshëm, sepse kështu është faktuar realisht, sa më i dobët financiarisht, aq më i kontrollueshëm dhe, në fakt, i anshëm bëhet sistemi i drejtësisë kur nuk ka edhe buxhet.

E kam thënë pra, edhe më parë në seancat e kaluara, po e përsëris prapë, në qoftë se një qeveri është e interesuar ta forcojë sistemin e drejtësisë, atëherë kjo së pari duhet reflektuar në buxhet.

Këtu thuhet që buxheti është dy miliardë, u tha edhe nga zoti Haradinaj, ndërsa për sistemin e drejtësisë janë ndarë pak më shumë se 30 milionë euro, pak më shumë se 30 milionë euro, kjo është tepër pak, as 2% e totalit buxhetor. Vetëm vendet e rajonit ndajnë buxhet për sistemin e drejtësisë diku 4 apo 5% të totalit buxhetor dhe këtu hyjnë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Agjencia Kundër Korrupsionit, Akademia e Drejtësisë dhe një sërë institucionesh dhe agjencish të tjera që e mbulojnë këtë fushë.

Të gjithë sot jemi dëshmitarë të asaj se sa shumë kemi probleme me sistemin e drejtësisë. Jo vetëm pse e thotë “Vetëvendosje”, shoqëria civile, por kjo evidentohet edhe në raportet vendore dhe ndërkombëtare.

Dhe unë sot këtu nuk po dua të flas për kapjen e sistemit të drejtësisë, sepse do të kemi mundësi të diskutojmë në një seancë tjetër. Si pasojë e kapjes së këtij sistemi sot Albini është në paraburgim, Donika është në paraburgim për veprime politike, Frashëri është po ashtu deputet në

paraburgim, i cili u dënua me 8 vjet pa asnjë fakt, pa asnjë provë, Egzoni, Atdheu, Adeja, pra kjo e vërteton se sa shumë i kapur është sistemi i drejtësisë, por shumë shpejt do të kemi mundësi për të diskutuar dhe veçanërisht vetëm për këtë çështje.

Sot po ndalem te kushtet e rënda me të cilat ballafaqohet ky sistem dhe varësia financiare nga Qeveria, siç thashë edhe më përpara, e bën shumë më të dëgjueshëm.

Për shembull, mungesa e numrit të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Siç po shkon puna me këtë Qeveri, shumë më i madh do të jetë numri i zëvendësministrave se sa numri i prokurorëve dhe shumë më i madh do të jetë numri i këshilltarëve të tyre se sa numri i gjyqtarëve. Tash është dashur që atë buxhet që i keni ndarë për apetitet e kësaj Qeverie, individëve përbrenda kësaj Qeverie, t'ia leni sistemit të drejtësisë, le ta luftojë sistemi i drejtësisë korrupsionin, krimin e organizuar, sepse është e pamundshme me këtë numër të prokurorëve dhe gjyqtarëve të luftohet krimi i organizuar dhe korrupsioni, pastaj bashkëpunëtorëve profesionalë.

Unë i kam 16 faqe kërkesa të Këshillit Prokurorial të Kosovës që nuk janë aprovuar në Qeveri, po njësoj ka edhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës që i ka adresuar në Komision që s'janë përkrahur në Qeveri dhe numri i bashkëpunëtorëve profesionalë është 10 deri tani për prokurorët. Ata kërkojnë që së paku një bashkëpunëtor ta kenë për dy prokurorë, njësoj edhe për gjyqtarë, sepse është dashur një bashkëpunëtor të jetë për një prokuror, mirëpo me që nuk janë kushtet atëherë një bashkëpunëtor për dy prokurorë dhe për gjyqtarë njësojë.

Pra, po ashtu nuk është paraparë rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe e bashkëpunëtorëve profesionalë.

Madje, buxheti i ndarë për paga dhe mëditje nuk korrespondon me numrin e punëtorëve, si për shembull, në Këshillin Gjyqësor, 2 271 të punësuar, ku Këshilli Gjyqësor i Kosovës kërkon edhe 380 mijë euro për t'i mbuluar të paktën këto pozita që i ka të lejuara, domethënë i është ndarë buxhet më pak se sa që ka nevojë sa u përket pagave dhe mëditjeve.

Më tej, në programin qeverisës thuhet që Qeveria do të ndërmarrë veprime për të zvogëluar numrin e lëndëve, të cilat kanë mbetur për vite radhazi në sirtarët e prokurorive.

Unë s'besoj ndonjëherë që do të mund të zbritet ky numër për sa kohë, domethënë kemi kaq pak prokurorë dhe gjyqtarë, por edhe zyrtarë ligjorë e bashkëpunëtorë profesionalë.

Po ashtu sa i përket buxhetit për Këshillin Gjyqësor askund nuk janë përfshirë obligimet që KGJK-ja i ka ndaj qytetarëve, të cilët janë dënuar pa bazë, d.m.th. kanë qenë në paraburgim për vite me radhë, që zakonisht ka njerëz që rrinë pesë vjet në paraburgim, pa të drejtë, në shpërputhje me Kodin e procedurës penale dhe me konventa ndërkombëtare, pastaj ata shpallen

të pafajshëm, kërkojnë buxhet ose dëmshpërblim nga institucionet e drejtësisë, kështu Këshillit Gjyqësor të Kosovës i duhen edhe 150 mijë euro për t'i kryer këto obligime që i ka ndaj qytetarëve, të cilët kanë dalë të pafajshëm.

Më tej, edhe për vitin 2018 qytetarëve do t'u pamundësohet ndihma juridike në rastet penale, të keni parasysh Kosova ka 40%, të mos themi më shumë, se unë jam e bindur që ka më shumë qytetarë që janë të papunë, më shumë se 40% e popullsisë dhe për shkak të kushteve të rënda ekonomike atyre do të duhej që shteti t'ua siguronte ndihmën në rastet penale.

Ka vjet që Agjencia për Ndihmë Juridike Falas nuk ua ofron ndihmë qytetarëve për faktin se nuk ka buxhet, domethënë ju po ua shkelni edhe të drejtat qytetarëve, që i kanë këto të drejta me Kushtetutën e Republikës, sepse aty specifikohet që këta qytetarë, domethënë shpenzimet për ta i mbulon shteti dhe ka kohë, ka vite, madje, që agjencia nuk e jep këtë ndihmë, jo pse nuk do, jo pse s'mundet, po pse nuk ka buxhet.

Madje, madje, ua ka edhe 40 mijë euro borxh avokatëve që kanë përfaqësuar dikur palët dhe as në këtë buxhet nuk u është ndarë.

Po ashtu edhe për funksionalizimin e Klinikës mobile, që i duhen 16 mijë e 580 euro.

Sa i përket Akademisë së Drejtësisë është bërë njëfarë pompoziteti në atë kohë, kur Instituti Gjyqësor i Kosovës është shndërruar në Akademi të Drejtësisë.

Tani me këtë buxhet që i është ndarë Akademisë së Drejtësisë, afro 800 mijë euro, është e pamundshme që ajo, tash kur i janë shtuar edhe kompetenca të reja me ligjin e ri, t'i kryejë obligimet që ia njej ligji. Pra, është e pamundshme që t'i ofrojë të gjitha ato trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë, trajnime të vazhdueshme, fillestare, për gjyqtarë dhe prokurorë, por edhe për kategori të tjera në qoftë se mbetet ky buxhet siç është aktualisht.

Po ashtu unë i kam shkruar edhe Ministrisë së Administratës Publike sa i përket Agjencisë për Ndihmë Juridike, gjegjësisht objektit me qira, ku vepron Agjencia për Ndihmë Juridike. Pra është dashur që njëra prej institucioneve publike ku është t'i lihet Agjencisë për Ndihmë Juridike falas, jo të paguajë qira për çdo vit, njësoj është edhe Akademia e Drejtësisë, mendoj që duhet ta adresoni këtë çështje, që të ndërtojmë objekte të reja në qoftë se nuk ka për t'ua lëshuar këtyre dy institucioneve.

Pastaj, në program qeverisës, për shembull, është përmendur vetingu, në buxhet nuk e shoh si do ta bëjë Qeveria vetingun, sepse për ta bërë vetingun, duhet pasur buxhet apo jo dhe si e keni menduar, a po vetëm është kështu deklarata...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Kabinet qeveritar,

Në maj të këtij viti, jo shumë larg prej sot, dyshja kandiduese Veseli - Haradinaj gjatë shpalesjes së programit të tyre ekonomik po premtinin rritje ekonomike prej 8% në viti, për një “fillim të ri”, siç e quanin ata.

Në 100 ditët e para të qeverisjes sonë thoshin të dytë, po i citoj, “do të ulim tatimin e të ardhurave të korporatave, do të dyfishojmë buxhetin për bujqësi, do të trefishojmë eksportet e do të kemi rritje ekonomike prej 8% në vit”.

Në shtator të këtij viti Qeveria e sapoformuar PAN, AKR, Sërpska prezantoi para qytetarëve programin e tyre qeverisës.

Në këtë program rritja ekonomike nuk ishte më 8%, rritja ekonomike ishte tkurrur 5 deri në 7%.

Sot, në dhjetor 2017, në Buxhetin e Republikës së Kosovës rritja ekonomike nuk është as 8, as 7, as 6, as 5% është 4%, saktësisht 4,6%. Normë e njëjtë rritje planifikohet edhe për tre vjetët e ardhshme qeverisëse.

Pra, me kalimin e kohës, jo me vite, po me javë e muaj, rritja e paraparë ekonomike po ulet, po përgjysmohet, po bie drastikisht.

E që ta përkthej më saktësisht, me një rritje të tillë të paraparë për tre vjetët e ardhshme Kosovës do t'i duhen 30 vjet për të arritur Kroacinë, mbi 60 vjet për të arritur një mesatare të Bashkimit Evropian. Kosova nuk mund të presë kaq gjatë.

Më 2 qershor të vitit 2017 dyshja e njëjtë në fushatën e njëjtë kishin premtuar rritje të pagave për mësimdhënësit kosovar, punëtorët shëndetësorë, administratën publike, për punëtorët e KEK-ut.

Sot, në Buxhetin e Republikës së Kosovës rritja e pagave nuk është paraparë të jetë 30%, siç kishin premtuar, është dhjetëfish më pakë, do të jetë 3,5%. Në fakt, rritja prej 3,5%, aq sa është rritja ekonomike e Kosovës, ishte paraparë nga Qeveria e kaluar dhe ishte rregulluar me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe është mirë që nuk rritet më shumë, por gjithashtu është mirë t'i kujtojnë premtimet e dhëna elektorale vetëm katër muaj më parë, t'i kujtojmë se këto

premtime ishin veç fjalë të thata, mashtrime, ashtu siç edhe i kishim paralajmëruar ne qytetarët gjatë fushatës, s' do të ketë as rritje të pagave për 30%, as dyfishim të buxhetit për bujqësi, as përmirësim të shëndetësisë e arsimit, nuk do të ketë as rritje ekonomike prej 8%.

Me kalimin e kohës po bien të gjitha, e vetmja gjë që po rritet në këtë kohë është natyrisht Kabineti qeveritar, numri i zëvendësministrave, i cili po rritet vazhdimisht, sot ka arritur 70 sosh dhe ky është problemi thelbësor i qeverisjes së sotme.

Pra, unë besoj që buxheti i shkon për shtati i një qeverie të madhe mishmashe. Nëse do të kesh një kabinet të gjerë me 22 ministri, 70 zëvendësministra, me qindra këshilltarë, asistentë, një makineri të tërë luksi, ky është buxheti. Por unë besoj se buxheti do të duhej të trajtohej ndryshe.

Kosovës si hap i parë do të duhej t'i vinte një program kursimi, një program që parandalon shpenzimin e pakontrolluar të parasë publike, një program që nis regrutimin e madhësisë së Qeverisë nga zhbërja e ministrive të panevojshme, nga heqja e zëvendësministrave pa punë, nga shkurtimi i mëditjeve, nga reduktimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime.

Një program i tillë punësimi e kursimi nuk është në Buxhetin e Republikës dhe s' do të jetë në tre vjetët e ardhshme.

Tash më lejoni të jap disa komente mbi strukturën e këtij buxheti, disa anomali.

E para, sipas projektligjit në fjalë, të hyrat buxhetore këtë vit do të rriten vetëm 6%. Ju kujtoj se mesatarja e tre vjetëve të kaluara ishte 9% në vit.

Pra, rritja më e ulët e buxhetit tregon për nënperformansë të potencialit tonë. Tregon gjithashtu për mungesë të plotë të luftimit të informalitetit dhe evazionit fiskal. Në të kundërtën, të hyrat do të rriteshin së paku 9% sa janë rritur tre vjetët e fundit.

E dyta, buxheti nuk i merr parasysh prioritetet e qytetarëve, për qytetarët ta kuptojmë, asfalti nuk është brenga e parë, në fakt, nuk është as e dyta, s' është as e treta. Po pavarësisht kësaj, ky buxhet ndan 41% të parave të investimeve kapitale në asfalt.

Unë nuk them që rrugët nuk janë të nevojshme, janë të domosdoshme për të bërë infrastrukturën bazë për zhvillim ekonomik, por si një Qeveri më ekspeditive do të shihte forma alternative të financimit të rrugëve, qoftë me kredi, qoftë me asistencë të donatorëve.

Pra, ky buxhet nuk e bën kthesën e madhe të domosdoshme në Kosovë, sepse sektorët kryesorë në vend, shëndetësia dhe të arsimit, vazhdon të trajtohen si të rendit të dytë.

Buxheti 2018 ia jep goditjen më të madhe shëndetësisë. Fondi i përfulur i Sigurimeve Shëndetësore është hequr, është reduktuar në tre milionë euro. Kujtojmë se në buxhetin e kaluar ishin paraparë 35 milionë euro për këtë fond. Pra, kjo Qeveri e pranon se edhe këtë vit, gjatë gjithë 2018-ës, nuk do të ketë Fond të Sigurimeve Shëndetësore, rrjedhimisht nuk do të ketë përmirësim në sistemin shëndetësor, sepse pa një fond të tillë nuk mund të kemi përmirësim të shëndetësisë.

Ndryshime nuk do të ketë as në arsim, pavarësisht rezultateve tmerruese të PISA-s, buxheti këtë vit nuk ndryshon.

Sot Kosova shpenzon 10 herë më pak se sa shpenzojnë vendet e rajonit për një nxënës. Ne sot japim vetëm 3,9% të GDP-së për edukim dhe ky proporcion po bie secilën vit dhe, për të mos mjaftuar kjo, e që bën një çudi të madhe, programet për zhvillimin e mësimdhënësve dhe programet për zhvillimin e kurrikulës reduktohen për 40%. Unë sinqerisht nuk e di se si mund të përmirësojmë arsimin në qoftë se i reduktojmë programet zhvillimore të mësimdhënësve dhe të programeve.

Dhe, për t'iu kthyer sërish investimeve kapitale, janë dy defekte thelbësore që unë i konsideroj.

E para, ato bien për 39 milionë euro krahasuar me planifikimet e një viti më parë dhe kanë një shpërndarje të çuditshme nëpër vite. Paramendoni, ndër të tjera, në nëntë raste një shkollë është paraparë të ndërtohet për katër vjet. Pra, katër vjet do t'i duhet sipas këtij buxheti të ndërtohet një shkollë e vetme.

E dyta, ky buxhet karakterizohet me një regjionalizim të paparë. Shpërndarjet buxhetore sipas rajonit të partive në pushtet është sinqerisht shqetësuese dhe kjo bëhet në dëm të kryeqytetit. Për shembull, kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, që kontribuon me 1/3 e të hyrave buxhetore në vend, me 600 milionë euro, do t'i marrë vetëm 5 milionë euro investime kapitale qendrore. Emri Prishtinë gjendet vetëm pesë herë në këtë kategori. Besoni se fshatrat e zyrtarëve tanë politikë përmenden më shpesh.

Për në fund, fare s'kam se si të mos ngre edhe shqetësimin për pensionet e veteranëve. Sërish edhe në vitin në vijim janë ndarë 58 milionë euro për veteranë dhe nuk do të mjaftojnë, do të duhet t'i ndajmë edhe 20 milionë euro të tjera në mes të vitit, duke bërë kështu shumë për veteranët 80 milionë euro në vit. Është e pakuptimit, është e paqëndrueshme.

Unë edhe një herë i bëj thirrje Qeverisë që të zbatojë ligjin e ri që të kategorizojë veteranët nëpër kategori, të pastrojë listat dhe të ndajë 0,7% të GDP-së për veteranët siç e parasheh ligji. Me një proces të tillë veteranëve të vërtetë do të dyfishohet, së paku, kontributi e buxheti do të ketë një kufij të arsyeshëm. Përderisa ne ndajmë para për mallra, shërbime, pensione, lista false, në luks

publik e në Qeveri të madhe, ne s'kemi gjetur vend për fonde të FSK-së. Në tre vjetët e ardhshme nuk është paraparë me këtë buxhet që FSK-ja të transformohet në ushtri, në të kundërtën ne do të dyfishonim fondet për mbrojtje dhe do të arrinim në 2% të GDP-së, siç kërkohet me standardet minimale për pasjen e secilës ushtri.

Pra, ky është buxhet i luksit, i mirëmbajtjes së skemave të kapjes, të zëvendësministrave dhe nuk është buxhet i shëndetësisë, i arsimit, drejtësisë e zhvillimi, nuk është buxhet i qytetarëve dhe si i tillë meriton refuzim.

Prandaj LDK-ja do të kundërshtojë këtë buxhet dhe do të votojë kundër një buxheti të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryesues!

Megjithatë, e shoh të arsyeshme të bëj përpjekje të jap disa sqarime shtesë.

Buxheti 2018 ka ndryshim të madh me buxhetin e viti 2017. Nëse dikush thotë që nuk ka, kur e shikojmë se ka rritje të pagave, janë tri skema të reja sociale, ka rritje 20% për përfituesit e familjeve të asistencës sociale, ka rritje të buxhetit për shëndetësi mbi 20%, ka rritje të buxhetit për arsimin mbi 26%, ka rritje dhe përmirësim të strukturës së buxhetit, ku pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e buxhetit është 33%, ku projektet e Klauzolës të investimeve e kanë kodin, e kanë emrin, e kanë koston, e kanë burimin e financimit, ku mjetet e AKP-së të planifikuara të vijë në buxhet, Ligji për plotësim ndryshimin e Ligjit për AKP-në është në Kuvendin e Kosovës, është dallim bukur i madh.

Sa i përket deficitit buxhetor, nëse i referohem deficitit primar, është brenda rregullës fiskale, është 1,7% dhe unë pres që do të jenë në fund të vitit edhe më i vogël.

Sa u përket analizave makroekonomike, është një departament i njerëzve shumë kompetentë, shumë profesionalë, me shkollim të mirë, po përveç shkollimit, ata i kanë më së paku secili prej tyre diku 10 vjet e më tepër përvojë në Ministrinë e Financave dhe kanë marrë pjesë aktivisht në draftimin dhe përpilimin e buxhetit për më shumë se 10 vjet.

Sa i përket çështjes së asfaltit, po e them që një numër i madh janë projekte në vazhdim, janë kontrata të lidhura. Është përqindja e madhe, ne mund të diskutojmë a janë të mira, a janë të këqija, a kanë mundur të orientohen ndryshe, mirëpo janë kontrata të lidhura dhe janë obligime kontraktuale, të cilat duhet të vazhdojnë edhe këtë vit.

Sa i përket strukturës së investimeve kapitale, për mua ishte pak e befasueshme ajo se është prishur struktura e investimeve kapitale, këtu pas vete kam një grafikun, ku paraqet ecurinë e ekzekutimit të kapitaleve dhe nëse i referohemi vitit 2015 dhe 2016 del që ekzekutimi i kapitaleve, i dëgjova do shifra që realisht nuk janë zyrtare, ka qenë 404 milionë dhe 444 në vitin 2016, ndërsa si pjesëmarrje në totalin e buxhetit nuk është më shumë se 25%.

Sa i përket lidhjes me programin e Qeverisë, po bash buxheti i ka reflektuar prioritetet e programit të Qeverisë.

Nëse e shikojmë sektorin e rendit dhe të ligjit, ka rritje, nëse e shikojmë shëndetësinë, ka rritje, nëse e shikojmë arsimin, ka rritje, nëse i shikojmë investimet kapitale ka rritje, dhe unë pres një ekzekutim të mirë të investimeve kapitale.

Sa i përket rritjes ekonomike, unë besoj që, deputetë të nderuar, e keni lexuar me kujdes pjesën makroekonomike, ku ky është skenari bazë. Ndërsa thuhet shumë mirë, po qe se fillojmë investimet në projekte të mëdha kapitale, duke përfshirë projektet e reja, kapacitete të reja gjeneruese, rritja ekonomike do të shkojë në nivel tjetër dhe do të jenë në përputhje edhe me planifikimet, edhe me programin e Qeverisë.

Sa i përket klauzolës të investimeve, ka dallim, janë vetëm projektet, të cilat kanë kosto dhe kanë burim të financimit. I vetmi një projekt që pritet të vijë marrëveshja që do të nënshkruhet, bordi do ta aprovon sipas të gjitha gjasave më 13 dhjetor, është financimi i rrugës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaç. Në të kaluarën ka ndodhur rritja e të hyrave pak më shumë se si është planifikuar tash, po duhet shpjeguar korrekt. Rritja e TVSH-së prej 16 në 18% i ka sjellë buxhetit të Kosovës nja 58 milionë euro, po kjo është ngarkesë për qytetarët e Kosovës, kjo është ngarkesë për standardin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Akciza, ngritja e akcizës në cigare dhe rritja e TVSH-së i ka sjellë nja 42 milionë euro shtesë dhe Ligji për faljen e borxheve, ose të hyrat e njëhershme për buxhetin e Kosovës i kanë sjellë edhe nja 21 milionë shtesë. Nëse i heqim të gjitha këto, del që rritja e të hyrave në të kaluarën nuk ka qenë në proporcion me rritjen ekonomike të vendit.

Prandaj, nuk mund të flasim për ndonjë performansë në të kaluarën, po nëse e shikojmë kornizën afatmesme të shpenzimeve, e cila është diskutuar dhe është aprovuar nga ky Kuvend në fillim të këtij viti, është për t'u çuditur, është më shumë se për t'u çuditur, nëse e shikojmë vitin 2017 me vitin 2018 të hyra te Administrata Tatimore janë planifikuar të ngritën mbi 33%, ok-ej rritja ekonomike dhe po e zvogëlonim informalitetin, qenkemi shumë të zotë, brenda një viti po e sillnim në zero. Po vazhdon vitet vijuese 2019 dhe 2020 rritja te ky institucion dhe pavarësisht që ne e zhdukëm informalitetin, vazhdon planifikimi me nga 21% dhe kjo pastaj Ministrisë së Financave ia ka vështirësuar shumë punën, për shkak se qarkorja buxhetore është lëshuar me

kufij irealistikë, organizatat buxhetore kanë marrë kufij shumë më të gjerë se sa ka mundësi të financohen.

Kur jemi te korniza dhe te niveli komunal, unë nuk jam kundër, mirë, janë shkuar paratë në nivel lokal, kanë nevojë për më shumë investime, po komunat i kanë marrë grantet në bazë të planifikimit të kornizës afatmesme të shpenzimeve.

Një çështje tjetër që gjithashtu është diskutuar. Rritja e pagave do të ndodhë prej 1 janarit dhe të gjithë të punësuarit që realizojnë paga nëpërmjet Buxhetit të Kosovës do të kenë paga të ngritura.

Për të hyra do të jenë për 4%. Te numri i vendeve të punës në sektorin e Drejtësisë, unë me shumë korrektësi e thashë edhe në paraqitjen time të parë, fola në raport me numrin aktual të të punësuarve, se ka dallim numri aktual i të punësuarve, numri i aprovuar dhe numri i buxhetuar. Kemi pasur tri dallime, tjetër ka qenë numri i të punësuarve, ka pasur numër të aprovuar të pozitive pa buxhet, që s'kanë pasur buxhet dhe s'i kanë lënë të punësohen, dhe tash nëse flasim në raport me numrin aktual të të punësuarve për Sektorin e Drejtësisë, për dy organizata buxhetore, për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës, numri ka mundësi të rritet për 690 pozita. Unë uroj që këto dy organizata buxhetore t'i fillojnë përgatitjet në kohë, t'i zhvillojnë procedurat e punësimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ta shfrytëzojnë këtë të drejtë të tyre që ua njeh ligji.

Kur jemi te Shëndetësia, është krijuar hapësirë, përveç rritjes të pozicionit për barnat esenciale prej 36%, rritjes së pozicionit për investimet kapitale për 126%, edhe punësimi dhe pagesa e specializantëve, por edhe 200 pozita të reja për mjekët specialistë dhe qindra pozita për infermiere dhe infermierë të rinj. E di, jam i vetëdijshëm dhe kam kërkuar, dhe vazhdoj të kërkoj mirëkuptimin e organizatave buxhetore që nuk ka pasur dhe nuk ka mundësi të financohen të gjitha nevojat e tyre. Mirëpo, ne kemi qenë të kujdesshëm t'i trajtojmë me prioritet edhe sipas prioriteteve që janë edhe pjesë e Programit të Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Ju përshëndes të gjithëve, në veçanti ju nënkryetar i Kuvendit dhe ministrin e Financave për këto shpjegime që na dha dhe në lëmin e Shëndetësisë, sidomos.

E përshëndes Qeverinë që kësaj here me Buxhetin 2018 i kushtoi një rëndësi të veçantë dy fushave, sidomos dy fushave që unë i kam në interes, e që janë shumë të ndjeshme për popullatën, sepse ato drejtpërdrejt e atakojnë qytetarin.

Janë të sëmurët dhe rastet sociale të shumta për një vend të dalë nga lufta dhe në tranzicion. Megjithatë, unë do të përqendrohem pikërisht në disa vërejtje që i kam në këta dy sektorë. Folët

për listat esenciale, për furnizimin me barna, e që gjithsesi lista jonë esenciale që siguron barnat është më e varfra në regjion. Prandaj, kujtoj që duhet të kemi kujdes edhe në rritjen e numrit të barnave në listën esenciale që bëhet çdo vit. Nuk e kemi të saktë sa do të jetë, domethënë nuk e kemi këtë listë që ta dimë përpara se sa do të shtohen këto barna në listën esenciale. Tjetër, numri i shtuar i mjekëve, specializantëve, specialistëve, është në rregull të shtohet, por vërejtja ime është në politikat kuadrore të punëtorëve shëndetësorë, sepse prej vitit në vit ne kemi punëtorë shëndetësorë, të cilët nuk parashihen në bazë të nevojave tona. Kemi reparte, ose thënë më mirë klinika, me dy dhoma, ose me 2-3 shtretër, e që kanë dyfish më shumë mjekë, specialistë dhe specializantë, dhe, në anën tjetër, kemi qytete ku nuk ka asnjë specialist, për shembull pediatër ose gjinekolog, ta zëmë në Komunën e Dragashit, që është një komunë e largët dhe shumë e vështirë që banorët të arrijnë deri në Prizren ose në Gjakovë për t'i marrë këto shërbime. Sepse, nuk ekziston pra një disiplinë e ndarjes së specializimeve dhe detyrimit të kuadrove që të shërbejnë në ato komuna prej nga vijnë, ose të detyrohen, të kenë beneficione, nëse dërgohen me një marrëveshje detyruese nga Ministria. Kujtoj që kjo duhet të kihet parasysh.

Ajo që më brengos sigurisht, vërejtja ime është edhe për përkujdesjen e fëmijëve. E tha dikush këtu se fëmijët janë pasuria jonë dhe ne të gjithë e kemi gojën plot se përkujdesja ndaj fëmijëve duhet të jetë e veçantë, megjithatë sa i përket kësaj kujtoj që nuk jemi treguar të kujdesshëm, sepse sot e asaj dite ne kemi shumë pak, ndajmë pak buxhet për kokë fëmije, dhe e kemi një rënie drastike të natalitetit në Kosovë në këtë periudhë të pasluftës. Dhe, kësaj çështjeje nuk i kemi kushtuar rëndësi, jo vetëm për shkak të dashurisë që kemi për familjen dhe për fëmijët, por kjo është edhe çështje ekonomike, besoj ju edhe më mirë se unë e kuptoni sesa e rëndësishme është përtëritja e gjeneratave për çështje edhe ekonomike.

Ne nuk kemi asnjë beneficion për lindjet e reja, ta zëmë në repartet e gjinekologjisë askush s'i pret me një dhuratë, me një pako këta fëmijë, e të mos flasim për shtesat e fëmijëve qofshin, edhe simbolike, për të treguar rëndësinë e gjeneratave që do të vijnë.

Megjithatë, do të përqendrohemi në një çështje të veçantë për Shëndetësinë, e që është Ligji i emergjencave. Një ligj bazik, një ligj shumë i rëndësishëm, i votuar në Kuvendin e Kosovës, e që nuk e gjeta në Buxhet dhe nuk e pashë se ai do të zbatohet, edhe pse parashihet që zbatimi i tij do të fillojë prej vitit 2018. Ky ligj është njëri ndër ligjet themelore në Shëndetësi, sepse me zbatimin e tij do të kemi ofrimin e shërbimeve të cilat i kontrollon vetë Qeveria, së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe e siguron një shërbim të domosdoshëm në rastet urgjente, të cilat gjithnjë e më shumë janë problematike, sidomos gjatë muajve të verës, por edhe dimrit, tani kur është koha e keqe.

Këto shërbime i kanë të gjitha shtetet dhe natyrisht u kushtojnë rëndësi. Për t'u bërë kjo, duhet buxhet dhe ky Buxhet nuk e kishte paraparë. Për fillimin dhe startimin e këtij ligji të domosdoshëm, për të cilin ka kontribuar së pari vetë Komisioni për Shëndetësinë në mandatin e

kaluar, duke i dhënë amandamentet themelore dhe ndryshimin e këtij ligji në bazë të ligjit që kishte ardhur nga Qeveria, parashihet sidomos që disa marrëveshje esenciale, e që janë në mes të pushtetit lokal dhe Ministrisë së Shëndetësisë, ndërtimi i qendrave emergjente në gjashtë qendra në Kosovë dhe parashihet marrëveshja ndërmjet FSK-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Zjarrfikësve, ndërtimi i qendrave të thirrjes, sepse do të jetë një qendër e thirrjes, dhe për të gjitha këto përgatitje komisioni i ka bërë bisedimet, por nuk është startuar, e për këto kërkohen mjete.

Për ndërtimin e këtyre qendrave të thirrjes kërkohen mjete, kërkohen përgatitje profesionale, pra investime në përgatitjen profesionale, trajnimet e mjekëve, të motrave medicinale, madje edhe shoferëve, përpos pajisjeve që duhen, domosdo. Këso ligjesh kanë të gjitha shtetet që vetes i thonë shtete. Është një shërbim i domosdoshëm dhe pa të cilin nuk mund të paramendohet startimi i mirëfilltë i Shëndetësisë, ashtu çfarë duhet të jetë.

Unë në fund desha ta përcjell edhe shqetësimin që e kam dëgjuar në terren nga qytetarët e Kosovës dhe vërejtjet e tyre sa i përket një kategorie të veçantë që për ne ka qenë shumë e panjohur, e kjo është kategoria e të moshuarve, për të cilët gjithashtu nuk ndahen fare mjete, ose ndahen fare pak. Për qendrat rekreative të tyre, dhe për shtëpi të pleqve, madje dhe në qytetet që ju as nuk mund ta paramendoni, dhe do ta them qytetin, për shembull në Rahovec, dhe atë gratë e Rahovecit kanë kërkuar shtëpi pleqsh, sepse qytetet tona po vjetrohen dhe shumë të moshuar mbeten pa përkujdesje, e ndoshta neve na duket tani e çuditshme, por edhe në pikëpamje shëndetësore, edhe në pikëpamje sociale, nesër do të jetë një çështje që ne duhet t'i përkushtojmë kujdes, edhe në bazë të Buxhetit. Kaq kisha unë sa për vërejtjen timen, e duke u përqendruar vazhdimisht në Ligjin e emergjencave, të cilat do t'i bëj si amendament dhe do të kërkoj që të fillohet me këtë buxhet të fillohet përgatitja për zbatimin e ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Teutë Haxhiu. S'është këtu. Timja, s'është. Shkumbin, a po e merr ti fjalën? Vazhdojmë, Bekë Berisha e ka fjalën.

BEKË BERISHA: I nderuar kryesues i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Unë si deputet nga Komuna e Istogut e analizova në detaje Buxhetin e kësaj komune dhe realisht ajo që më brengosi ishin mungesat e projekteve që do të mundësonin angazhimin e të rinjve të kësaj komune. Është për të të ardhur keq fakti që rinia e Istogut largohet drejt komunave tjera dhe jashtë kufijve të vendit tonë në mungesë të perspektivës dhe vendeve të punës.

Gjithçka çka ishte paraparë për zhvillimin ekonomik në Istog ishte asfaltimi i rrugëve dhe ne jemi dëshmitarë që me asfaltimin e rrugëve nuk shkojmë nga zhvillimi ekonomik dhe kjo nuk hap vende të punës. Investimet në bujqësi nuk janë të mjaftueshme dhe nuk reflektojnë nevojat e banorëve të Istogut. Mungon investimi në pendat e ujitjes, që është kërkesë kryesore e bujqve të

kësaj ane, e sidomos e atyre të Lugut të Drinit. Po ashtu, te buxheti i sportit dhe i rekreacionit mungojnë investimet dhe nuk përmbushen kërkesat e qytetarëve. Mosplanifikimi i investimeve në palestrën sportive në Istog, e cila ka dhjetë vjet që është filluar dhe kurrë nuk është përfunduar, tanimë është i patolerueshëm.

Megjithatë, buxheti i Istogut, edhe pse në vlerë jo i vogël, duket të jetë premtues, mirëpo përvoja nga e kaluara na ka mundësuar që më së shumti mbetet një vizatim i bukur në letër, e jo një realitet. Duhet të kërkojmë nga secila komunë përgjegjësi për mos zbatueshmërinë e buxhetit. Për më tepër, ajo që më tërhoqi vëmendjen ishte se të hyrat e parapara nga dividenda nga kompanitë publike janë zero. Kjo është mjaftë shqetësuese, nëse e analizojmë faktin që kompanitë publike tash e 17 vjet nuk arrijnë të sigurojnë përfitime për aksionarin. Unë bëj thirrje që të bëhet një rishikim në detaje i performansës së të gjitha kompanive publike dhe të gjenden shkaqet se pse këto nuk arrijnë të operojnë me fitime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Milaim Zeka, e keni fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Nuk po ia bëj kështu, të flas si 'bardh e zi', edhe ne kemi vërejtje në Buxhet, por, në radhë të parë, për mua është një gëzim shumë i madh si deputet i Parlamentit të Kosovës që Qeveria këto 100 ditë e ka bërë një veprim jashtëzakonisht të mirë me përcaktimin e stadiumit, që për mua është lajm i mirë, për çdo shqiptar që flet dhe mendon shqip, që është bërë në zonën e Drenicës, afër aeroportit.

Pak keq se këta, kur do të luanim me Partizanin e Zvezdën, këta simpatizuesit serbë s'mund të vijnë deri atje, por sidoqoftë... E kam vetëm një vërejtje në Buxhet, te çështja e memorialëve, e kam shikuar Buxhetin që është bërë një kërkesë për rreth 12 milionë për mirëmbajtjen e memorialëve, të varrezave të dëshmorëve, por në konsultim me shumë deputetë të Parlamentit, sidomos të zonës së Drenicës, edhe me doktor Avdylin, doktor Fadil Bekën, Ganimeten, kërkojmë që në rishikimin e Buxhetit nga Qeveria ta ndajë një fond prej 100 mijë eurove për Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Likoc, sepse është nga vendet më historike të kombit shqiptar, ku kanë shkuar dhjetëra diplomatë dhe kurrë ky vend s'e ka pasur asnjë përkujdesje. Domethënë, vetëm këtë sugjerim e kam. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Balje e keni fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Stav parlamentarne grupe "6+" već imali prilike da čujete od našeg člana u Komisije za budžet i finansije, ono što hoću da podvučem, žao mi što sad ministar nije tu, a ni premijer nije tu, ta finansijska diskriminacija koja se iz godine u godinu vuče po pitanju ostalih zajednica - "të tjerat", imali smo tačku 12 u tekstualnom delu Budžeta koja nije poštovana ni u Budžetu 2016. ni

u Budžetu 2017. godine, sada koliko smo mogli da primetimo, uopšte nema u tekstualnom delu Budžeta, odnosila se na proporcionalnom podelu sredstava, koja su se ticala Ministarstva za zajednice, povratak i kancelarije za zajednice.

Moja parlamentarna grupa "6+" je određenom dozom rezerve po pitanju glasanja ovog Budžeta, upravo zbog toga za to što se ta finansijska diskriminacija vuče uz godinu u godinu, i zahtevaćemo da se između ova dva čitanja, prvog i drugog, imamo sastanak i sa premijerom i sa ministrom za Finansije po pitanju podelu ovih sredstava proporcionalno onako kako svakoj zajednici pripada.

Mislim da je to nešto što je normalno, i mislim da ne bi trebali po nikakvim kriterijumima da delimo zajednice na one koje su veće i one koje su manje. Svi smo mi stanovnici Kosova, i političku udvaranje u finansijskoj smislu jedno od zajednica, ovo nikada neće dovesti do nekih pozitivnih rezultata. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Unë nuk do të merrem tash me madhësinë e vetë Qeverisë, domethënë me numrin e ministrave, zëvendësministrave, sepse për këtë është shkruar dhe është folur mjaft, veç mund të konstatojmë se e kemi Qeverinë më të madhe në Evropë.

Unë e dëgjova me shumë kujdes ekspozitën e ministrit edhe kam bërë përpjekje që të bëjë disa krahasime me tabelat e ofruara për këtë Buxhet, edhe pse është relativisht i komplikuar, sidomos për ne laikët që s'jemi bash ekonomistë të mëdhenj, siç janë këtu, mirëpo kam shumë paqartësi, të cilat do t'i shpreh dhe do t'i them këtu. Unë do të filloj me tabelën numër 2, domethënë te përmbledhja e ndarjeve buxhetore, apo si e parapëlqejnë ta thonë - projeksionet makro-ekonomike. Faktet që bie në sy menjëherë, nëse bëhet krahasimi i Buxhetit 2017 me këtë Buxhet, që është ofruar për shqyrtim, ajo që bie në sy është rritja e numrit të të punësuarve në Administratën shtetërore për 1 070 veta dhe një zvogëlim i të të punësuarve në nivelin lokal, për 26 veta. Sigurisht ministri thotë "jo këto janë projeksione, të parapara, ose janë të futura". Këto janë shifra në Buxhetin që i ka ofruar për diskutim zoti ministër.

Ne e shohim se për paga në Buxhetin 2018 do të paguhet më shumë 17 milionë euro, për mallra dhe shërbime nja 37 milionë, pak më shumë, dhe ajo që bie në sy është se për shpenzime kapitale janë përfundimisht 39 milionë më pak, nëse është kjo tabela që e kanë edhe ata. Unë këta numra i shoh kështu, domethënë në fund totalin sigurisht ata e shpjegojnë në forma të ndryshme.

Domethënë, në përgjithësi, e kemi një shtim të ndarjeve të mjeteve në formë rrogash, pagash, mallra, shërbimesh dhe zbritje të investimeve kapitale qysh i përmenda, 54 me 39 milionë. Mua më shqetëson më shumë një dukuri shumë e rrezikshme, që me intensitet të ndryshëm po vazhdon në disa legjislacione dhe qeveri, e kjo ka të bëjë me fryrjen e Administratës shtetërore apo numrit të personave, që paguhen nga Buxheti shtetëror. Kjo rritje është në kundërshtim të hapur me tendencën e përgjithshme në vendet demokratike, që ne i synojmë si qëllim që ta arrijmë atë stadin e tyre zhvillimor.

Në të gjitha këto vende vazhdimisht synohet që të ofrohet një shërbim sa më i mirë ndaj qytetarëve, duke e bërë një decentralizim demokratik e të vazhdueshëm të ofrimit të këtyre shërbimeve. Raporti ndërmjet të punësuarve në nivelin qendror dhe at lokal në të gjitha këto vende demokratike sillet diku prej 1 me 4, një në nivelin qendror 4 në nivelin lokal, deri në 1 në nivelin qendror, gjashtë në nivelin lokal. Tendenca e zhvillimeve në Kosovë, përkundrazi është jashtëzakonisht shqetësuese. Tani ne e kemi një raport të tillë, sivjet me Buxhetin 2018 është 1,09 me 1, kurse në Buxhetin 2017 ishte 1,12 me 1. Domethënë, kjo tendencë është duke shkuar në një drejtim negativ, apo në një kah negativ, dhe kjo do të thotë në dëm të ofrimit të shërbimeve të qytetarëve në nivelin lokal, ashtu siç është e paraparë.

Në të vërtetë, Administrata shtetërore në Kosovë është edhe ashtu jashtëzakonisht e fryrë. Nëse i krahasojmë shifrat me këto vendet që ne i synojmë për ta arritur zhvillimin e tyre, qoftë demokratik, apo ekonomik, kemi shifra alarmante. Në këto vende, raporti ndërmjet qytetarit dhe administratorit shtetëror të paguar është diku prej 1 me 40 qytetarë, një administrator me 40 qytetarë, në rastin më të keq është 1 me 30. Në Kosovë, e kemi raportin 1 me 20. Kjo është ajo gjendja që do të ishte mirë që kryeministri ta angazhonte një ekspert, nuk duhet të jetë shumë i madh, t'i bëjë këto krahasime dhe ta shohë se në cilin drejtim është duke shkuar fryrja e Administratës shtetërore, që nuk është vetëm fryrje e Administratës shtetërore, por në të vërtetë është një ndarje e mjeteve shoqërore që bëhet baza partiake dhe klanore, dhe nuk i shihet fundi askund.

Kjo mënyrë e ndarjes së mjeteve publike, i pasurisë publike, domethënë rrënim i parimeve të barazisë, mosdiskriminimit, qetësisë dhe kohezionit social. E edhe më shumë, domethënë është rrënim i një zhvillimi shoqëror të balancuar gjithëpërfshirës, duke e zbutur varfërinë selektive të popullsisë.

Tash po kaloj në fushat e caktuara, ashtu siç i kam parë unë. Për sundimin e ligjit, unë kam bërë përpjekje që ta bëj analizën e Programit qeveritar me Buxhetin e ofruar në bazë të tabelave këtu që i kemi. Dhe e kemi një zotim të kësaj qeverie që domethënë të luftohet korrupsioni, krimi i organizuar, të rregullohet e të avancohet korniza ligjore, dhe të bëhet vetingu. Mirëpo, në këtë drejtim nuk kemi asnjë sqarim si do të bëhet, në të vërtetë për ta parë saktësisht çka është në pyetje, që ka një mospërputhje të madhe ndërmjet synimeve, Programit qeveritar dhe këtij

Buxheti që e kemi këtu, unë po e them kështu: Te Këshilli Prokurorial kemi gjithsej 148 vende shtesë të punësimeve, mirëpo këta janë krejt administratorë dhe prokurorë, kurse në njësinë kryesore që synon luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit kemi 0 të punësuar, ose 0 të paraparë. Këtë mund ta shihini në faqen 48, tabela 3.1, kodi 250, dhe përveç kësaj nuk kemi asnjë operacionalizim, asnjë specifikim, asnjë konkretizim se si do të bëhet luftimi i krimit dhe korrupsionit.

Dalim te Këshilli Gjyqësor, në faqet 52-55 tabela 3.1, kodi 3.28. Ka planifikuar më shumë 120 gjyqtarë për dy vjetët e ardhshme, janë planifikuar plus 4 milionë euro shtesë, mirëpo vetëm në Sekretariat dhe në Administratë shkojnë 35 njerëz, kurse 77 nëpër gjykatat e ndryshme. Edhe me këtë synohet luftimi i lëndëve të mbetura në gjyqësinë e Kosovës, që sillet diku prej 350-400 mijë lëndë të pazgjidhura dhe me këtë rritje sigurisht është e garantuar se nuk do të ketë zvogëlim, por përkundrazi ndoshta edhe rritje, sepse ata kanë nevojë për trajnime e gjëra të ndryshme.

Mirëpo, është një pyetje edhe më shqetësuese, që nuk shihet as në Programin qeveritar, as në këtë Buxhet. Çka bëhet me lëndët që kanë filluar, ose rrezikojnë të parashkruhen? Kjo ka të bëjë drejtpërdrejt me besimin e qytetarëve në sistemin e Drejtësisë, domethënë parashkrimi në gjuhën normale shoqërore faktikisht domethënë dështim total i drejtësisë institucionale, që do të thotë dështim i shtetit, dhe në këtë drejtim nuk ka asnjë fjalë.

Çfarë do të bëhet me mijëra raste të moszbatimit të vendimeve gjyqësore me vite të tëra nga organet e zbatimit të ligjit dhe të vendimeve gjyqësore, sidomos nga Policia e Kosovës, apo sigurisht do të vazhdojë avazi i njëjtë, kur janë në pyetje kundërshtarët politikë, sidomos të opozitës, zbatimi i vendimeve gjyqësore bëhet për më pak se 24 orë dhe burgosen deputetët pa kurrfarë vendimi, ose me vendime të kundërligjshme. Kurse, në anën tjetër, kemi vendime gjyqësore që nuk zbatohen me dhjetëra vite, ose parashkruhen fare. Kjo do të kishte qenë një pyetje shumë interesante për zotin kryeministër.

Tash po kalojmë te parandalimi dhe luftimi i korrupsionit. Është paraparë zhvillimi i mekanizmave, i normave ligjore, andej-kënde... Mirëpo, nëse duhet besuar këtij ligji këtu që e kemi, Ligjit për Buxhetin, atëherë fjalët në Programin qeveritar duken goxha të kota. Për çfarë arsye? Nëse, bazohemi në nenin 18 të Ligjit për Buxhetin, paragrafi 4, aty shprehimisht thuhet kështu: “Çdo iniciativë e re për shpenzime, përfshirë këtu edhe legjislacionin e ri të propozuar, që nuk ka ndarje buxhetore të përfshirë në tabelat e bashkëngjitura, nuk do të marrë ndarje buxhetore, përveç nëse zbatohen shkurtime përkatëse në ndarjet tjera buxhetore në vlerë të njëjtë”. Atëherë, pyetja ime është: Si është e mundur që të luftohen krimi i organizuar dhe korrupsioni, kur në njësinë për luftimin e krimeve ekonomike brenda Prokurorisë së Kosovës shihen zero shtesa të të punësuarve dhe nuk ka mjete më shumë, apo ka një kundërshtim shumë të madh këtu...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e ka fjalën për sqarime.

MINISTRI BEDRI HAMZA: E para, dëshiroj ta falënderoj deputetin Kurteshi për kontributin e tij dhe do të bëj përpjekje t'i jap disa sqarime të nevojshme.

Sa i përket rritjes së numrit të të punësuarve në nivelin qendror, vetëm po i përmend organizatat buxhetore, ku përfshihet numër më i madh. Ky është Shërbimi Spitalor dhe Klinikës Universitare të Kosovës, që në raport me Buxhetin e shikuar i ka 495 pozita më tepër, Ministria e Punëve të Brendshme 171 pozita më tepër, Agjencia Kosovare e Inteligjencës 15 pozita më tepër, Këshilli Prokurorial i Kosovës 148 pozita më tepër, dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës 112 pozita më tepër. Po flas për numrin në krahasim me Buxhetin e rishikuar të vitit 2017.

Sa u përket mallrave dhe shërbimeve, ka një rritje. Rritja kryesisht shkon për dy arsye, 18 milionë euro më tepër shkojnë te mallrat dhe shërbimet në nivel komunal, në krahasim me Buxhetin e vitit 2017, dhe kemi të bëjmë me një rikategorizim, sepse i kemi pasur vërejtjet e raportit të auditorëve, ku disa shpenzime kapitale kanë qenë të keqklasifikuara dhe Auditori ka pasur vërejtje. Tash është dashur të kthehemi prej kapitaleve në mallra dhe shërbime.

Sa u përket investimeve kapitale, nëse e shikojmë ekzekutimin e Buxhetit të kapitalet për vitin 2016 i kemi 444 milionë euro, të planifikuara për vitin 2017 janë 498 milionë euro, ndërsa për vitin 2018 investimet kapitale janë në vlerë 687 milionë euro, ndërsa vetëm prej Buxhetit të rregullt janë 538 milionë. Domethënë, nuk kemi zvogëlim, por një rritje sinjifikante në raport me vitet dhe periudhat paraprake. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër i Financave,

Deputetë,

Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 është një draft pothuajse i ngjashëm me Buxhetin 2017.

Ndryshimet që kanë ndodhur me disa projekte të reja kapitale tregojnë për një shpërndarje joproportionale dhe jo të drejtë të financimit nga bashkëfinancimi i projekteve nga niveli qendror në atë lokal, duke i favorizuar disa komuna në raport me komunat tjera.

Projektbuxheti 2018 nuk pasqyron qartë as prioritetet e Programit të Qeverisë. Rritja ekonomike është paraparë 4,5% e jo 8%, siç është shënuar në Programin e Qeverisë. Pagat nuk do të rriten

25 apo 30%, aq sa janë premtuar në fushatën elektorale, por do të jenë më pak se 4%. Ky buxhet është një buxhet shpenzues dhe jozhvillimor, ku 1,3 miliard euro janë ndarë për shpenzimet rrjedhëse dhe e ka një fond të pagave kryesisht për paga, mëditje dhe transfere, por ajo që është më brengosëse është kryesisht për ndarjen e pjesës pasive.

Ajo që është kthim prapa është rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, që janë rritur për 7,9%, apo 39 milionë euro më shumë, krahasuar me këtë vit, për të cilin në vitin e fundit ka pasur projekte dhe rezultate të shkurtimit të tyre, duke mos ndikuar në përmbushjen e nevojave. Mungon vullneti i Qeverisë për zbatimin e Ligjit për sigurime shëndetësore, gjë që tregon se për këtë qëllim janë ndarë vetëm 3 milionë euro.

Të hyrat janë paraparë në shumën prej 1 829 000 000 euro, që paraqet një shumë prej 104 milionë eurosh më shumë se në vitin 2017. Kjo rritje është si rezultat i performansës së mirë të të hyrave të rregullta, që janë edhe si pasojë e ndryshimit të politikave fiskale nëpërmjet miratimit të legjislacionit përkatës. Efikasiteti i punës së agjencive kryesore të të hyrave buxhetore, siç janë Doganat dhe ATK-ja, si rezultat i kontrollit dhe performansës më të mirë dhe menaxhimit më të mirë të financave publike. Megjithatë, nëse e analizojmë trendin e të hyrave të rregullta, përderisa në vitin 2015 rritja ishte 9,3%, në vitin 2016 kjo rritje ishte 9,4%, në vitin 2017 ishte 7,3%, në vitin 2018 janë planifikuar 6,3%, gjë që paraqet një rënie.

Në këtë buxhet nuk është trajtuar fare zbatimi i Ligjit për investime strategjike, ashtu siç nuk është marrë për bazë as zhvillimi i kapaciteteve të reja, sidomos ato në prodhimin e energjisë elektrike, Ligji për “Trepçën” dhe ligjet tjera, që pritet të jenë gjenerues më të mëdhenj të të hyrave në Kosovë.

Sa i përket strukturës së të hyrave, dominojnë të hyrat nga tatimet indirekte, konkretisht të hyrat që mbahen, mblihen në kufi apo nga Doganat, nga TVSH-ja dhe akciza si të hyra kryesore, ndërkaq të hyrat nga tatimet direkte pothuajse mbeten të pandryshuara me një rritje prej 11 milionë euro me të hyrat nga tatimet në të ardhura personale, që mund të jenë parashikuar si rezultat i rritjes së pagave, gjë që do të ndikojë në shtimin e konsumit. Ndërkaq, të hyrat nga korporatat planifikohen të njëjta, që tregon mungesën e qasjes dhe planifikimit të zhvillimit të sektorit privat dhe tërheqjen e investimeve të mëdha.

Të hyrat tjera jotatimore nga taksa koncesionare dhe tantiema janë të ngjashme si në këtë vit, ndërkaq të hyrat nga dividendat e PTK-së janë zero. Kjo tregon se kjo Qeveri nuk ka ndonjë strategji apo plan për zgjedhjen e problemit financiar të PTK-së si ndërmarrje publike. Kjo ndërmarrje dhe ndërmarrjet tjera publike do të vazhdojnë të subvencionohen nga Buxheti, në vend se të financohen nga gjenerimi i të hyrave vetjake dhe të jenë profitabile edhe për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Shpenzimet janë planifikuar 2 082 000 000 euro, një rritje prej 81 milionë euro, krahasuar me këtë vit. Shpenzimet, veçanërisht ato kapitale, janë të lidhura me huadhëniet që parashihet të merren nëpërmjet klauzolës së investimeve prej 62,1 milionë euro dhe 85 milionë prej të hyrave nga fondi i likuidimit të Agjencisë së Privatizimit, dhe 31 milionë euro nga kreditë për financimin e projekteve të caktuara. Kjo rritje e shpenzimeve është e lidhur direkt me rritjen e deficitit buxhetor, i cili nga 1,5%, sa është në këtë vit, është i planifikuar të jetë diku 1,7, apo 112 milionë euro, shumë e cila mund të jetë edhe më e lartë, kur kihen parasysh efektet e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe lirimeve doganore për produktet dhe prodhimet e lëndës së parë.

Sa i përket strukturës së shpenzimeve, shohim se dominojnë shpenzimet rrjedhëse, që përbëjnë shumën prej 1 383 000 000 euro, pagat dhe mëditjet 589 milionë euro, apo një rritje prej 23 milionë eurosh, përfshirë rritjen e pagave për të punësuarit publikë që paguhen nga Buxheti i Kosovës, e që në fakt është një rritje që është paraparë edhe me Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Subvencionet dhe transfere që vazhdojnë të rriten, që për vitin 2018 janë paraparë në shumën prej 525 milionë eurove, apo 52 milionë më shumë se buxheti aktual, që detyrimisht e kufizon mundësinë e alokimit të buxhetit në investime më të mëdha kapitale. Pensionet për veteranët e luftës vazhdimisht rriten, dikush para meje tha 80 milionë, nëse i marrim për bazë edhe shpenzimet për invalidët e luftës, nëse marrim për bazë edhe 2 milionë që i marrin ata që janë pensionuar para kohe në ish-TMK-në, domethënë shuma veç ka kaluar 100 milionë euro.

Ajo që e konsideroj kthim prapa në këtë Buxhet, krahasuar me Buxhetin aktual është edhe rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për 39 milionë euro, që është kategoria që ka hapësirë më të madhe për shkurtime. Sa u përket shpenzimeve kapitale janë rreth 61 milionë euro për projektet e reja, që shpërndahen në formë joproportionale nga niveli qendror në atë lokal. Sa i përket strukturës së ndarjes së shpenzimeve sipas sektorëve ekonomikë, është rritur buxheti në shifra në disa organizata, por nuk ka projekte të matshme që do të ndikonin në përmirësimin e sektorëve të caktuar. Janë disa projekte të reja në shuma të vogla (10 000 deri në 20 000 euro), që tregojnë mungesën e qasjes serioze në hartimin dhe financimin e projekteve të qëndrueshme kapitale.

Buxheti për Arsim nuk premtonte se do të ketë përmirësim në cilësinë e kësaj fushe. Me buxhetin e ndarë në Ministrinë e Shëndetësisë nuk zgjidhet problemi shëndetësor, gjë që tregon për mungesën e implementimit të Strategjisë Kombëtare Zhvillimore.

Administrata shtetërore dhe publike vazhdojnë të rriten, gjë që përveçse tregon se punëdhënësi kryesor është shteti, e jo sektori privat, tregon edhe për mungesën e seriozitetit të Qeverisë në përmbushjen e kritereve të MSA-së për reformë në Administratën publike.

Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2018 është një buxhet shpenzues, si për nga shifrat, por edhe për nga përmbajtja e financimit programor, është buxhet i shpenzimeve rrjedhëse, i financimit të luksit qeveritar, i pagave dhe mëditjeve të zëvendësministrave, ministrave, sidomos këshilltarëve dhe kabinetëve të tyre.

Të gjitha këto që u thanë, e që shihet nga Buxheti, tregojnë se Qeveria nuk ka vizion, as nuk ka vullnet institucional që t'i konsolidojë institucionet e Kosovës në masë të zhvillimit më të mirë ekonomik, nuk do të ketë përmirësim të mirëqenies sociale dhe do ta kemi një situatë edhe më të keqe seç e kishim.

Nga aspekti profesional konsideroj që struktura e Buxhetit është ruajtur në vazhdimësi, që është një gjë e mirë, por që konsideroj te prioritetet si duket çdo qeveri i ka të vetat, por kjo Qeveri me të vërtetë pak ia ka huq, sepse prioritetet duhet të jenë ato që ne themi vazhdimisht, arsimit, shëndetësia - të jemi më të shëndetshëm. Sipas kontigjencës së barnave, po dalim që jemi populli më i sëmurë, sipas mjeteve që derdhen jashtë Kosove për shërim, duket që jemi popull shumë i sëmurë. Konsideroj që këtu duhet të përqendrohemi, të përmirësohemi, të paktën në aspektin e arsimimit dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar Haliti!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht dua ta falënderoj ministrin e Financave, Bedri Hamza, për përgatitjen e këtij Buxheti, i cili po vazhdon ta dëshmojë profesionalizmin e tij në adresimin e çështjeve prioritare për nevojat e qytetarëve të Kosovës, duke e rritur buxhetin për Shëndetësi, për Drejtësi, për Arsim dhe për projektet në infrastrukturë.

Më vjen mirë që një kërkesë e imja dhe e shumë kolegëve nga sfera e Shëndetësisë për sistemimin e specializantëve ka gjetur adresim dhe zgjidhje përfundimtare me këtë Projektbuxhet, dhe ky adresim është pa dallime politike, për herë të parë, por i orientuar në shërbim të profesionistëve mjekësorë dhe në shërbim të pacientëve, meqë kjo rritje e Buxhetit për këtë kategori e përfshin edhe stafin e mesëm, që është pasqyra e shëndetësisë dhe ky investim do të jetë në shërbim të ofrimit të shërbimeve më shëndetësore. Shpresoj kështu. Kjo do të ndikonte, gjithsesi do të duhej të planifikohej edhe me një politikë kuadrone, që këta profesionistë të mos ikin nga Kosova, një trend në rritje në vitet e fundit.

Gjithashtu, i përgëzoj edhe për rritjen e buxhetit për Shëndetësi dhe atë për barnat nga lista esenciale dhe kjo duhet të pasojë edhe me një fakt tjetër, me faktin më kryesor, monitorimin dhe kontrollimin e shpërndarjes së barnave nga lista esenciale, sepse deri më tani ka pasur abuzime në këtë sektor dhe kjo mund të parandalohet vetëm me një sistem efikas të monitorimit dhe kontrollit të shpërndarjes së barnave në sektorin publik. Dhe, kjo mund të bëhet me një sistem të digjitalizimit të këtij sektori, gjë që do të pamundësonte që të ndalohej, së fundmi, të abuzohet me këto barna dhe të mos kemi dukuri që kanë qenë vitet e kaluara, që barnat që janë blerë nga institucionet publike pastaj janë gjetur në treg, në barnatoret private, e kjo mund të ndalohej me një sistem efikas.

Rritja e buxhetit do të thotë edhe kontrollim të shpërndarjes së tyre, sepse në vazhdimësi ka pasur rritje të buxhetit për barna nga lista esenciale, por edhe mungesat kanë qenë të vazhdueshme. Po e marr shembull, vetëm vitin 2015, kjo rritje ka qenë për 14 milionë euro, por që nuk ka reflektuar në rritjen e sasisë së barnave nga lista esenciale, por ka ndodhur e kundërta. Edhe është rritur buxheti për barnat nga lista esenciale, edhe është rritur mungesa prapë e këtyre barnave në sektorin publik dhe kjo duhet të adresohet saktë me politika afatgjate dhe me një monitorim të këtij sistemi, duke e ndryshuar edhe mënyrën e blerjes dhe qasjes së këtyre barnave, duke e hequr nga sistemi, ose duke i mënjeluar anash dilerët e barnave nëpërmjet të cilëve Ministria e Shëndetësisë shpeshherë ndodh të blejë barna shumëfish më të shtrenjta sesa janë ato në treg. Kjo mund të realizohet nëse ka një qasje progresive, afatgjate, kur barnat blihen drejtpërdrejt nga prodhuesi dhe Ministria e Shëndetësisë duhet ta bëjë këtë dhe të mos i blejë nga kontrabanduesit dhe nga dilerët e barnave, që janë përreth Ministrisë së Shëndetësisë.

Gjithashtu, adresimet që janë të rëndësishme e që do të kishin ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore, është rritja e menaxhimit. Kjo rritje e menaxhimit nuk duhet të përfshijë atë që kemi parë në disa komuna dhe institucione publike, ndoshta përmirësimin e hyrjeve, qoftë në Qendrën Klinike Universitare, apo në mjekësitë familjare, ku konsiderohet e arritur blerja e disa aparateve për të hyrë në parkingun e një qendre klinike universitare, apo blerja e një aparati për pritje në mjekësinë familjare, por kjo duhet të ndryshojë në thelb në përmirësimin e kualitetit të shërbimeve shëndetësore, e jo në kualitetin e aparateve të pritjes, ose mburrjet e institucioneve publike shëndetësore, ku është bërë një garë në të kaluarën nga institucionet publike shëndetësore se kush e ka pasur numrin më të madh të vizitave. Pra, është bërë garë se cili institucion apo në cilën komunë ka qenë sëmundshmëria më e madhe.

Në të gjitha shtetet bëjnë planifikime për zvogëlimin e sëmundshmërisë, vetëm te ne ka ndodhur që edhe në fushata elektorale janë mburrur se “ne kemi pasur një milion vizita mjekësore brenda vitit”, e në fakt do të duhej të mburrëshin me zvogëlimin e numrit të vizitave dhe me zvogëlimin e sëmundshmërisë.

Kur jemi te Arsimi, dua t'i theksoj disa elemente, të cilat kemi provuar që bashkërisht në komisionet paraprake, ku kam qenë për Arsim, t'i aprovojmë disa ligje që do të kishin ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë në Arsim dhe i kemi miratuar dy ligje, që nuk kanë gjetur apo nuk po e gjejnë zbatueshmërinë e duhur: Ligji për profesionet e rregulluara, që nuk po zbatohet, dhe kërkoj nga ministri që këtë vërtet ta planifikojë në Buxhetin 2018 dhe, gjithashtu, e kemi miratuar Ligjin për provimin shtetëror të maturës, një ligj i cili kontrollon cilësinë në Arsim, apo monitorues i jashtëm i cilësisë në arsim. Është planifikuar kur e kemi miratuar dy vjet më parë këtë ligj, që të planifikohet edhe digjitalizimi brenda dy vjetësh i provimit shtetëror të maturës për t'i ndaluar abuzimet apo kopjimet, që tani janë bërë të famshme dhe pothuaj të përvitshme në provimin shtetëror të maturës. Prandaj, planifikimi me Buxhetin e vitit 2018 i digjitalizimit të provimit shtetëror të maturës do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë në Arsim.

Gjithashtu, edhe me Ligjin për profesionet e rregulluara, nga profesioni i mjekut deri te ai i juristit janë planifikuar apo listuar lista e profesioneve të rregulluara, gjë që do të ndikonte gjithashtu edhe në rritjen e cilësisë edhe në Arsimin publik, po edhe në atë privat, dhe mendoj se kjo duhet të planifikohet bashkë me ministrin e Arsimit.

Dua t'i theksoj edhe disa investime, për të cilat fillimisht e falënderoj ministrin e Financave dhe Komisionin për Buxhet që i ka adresuar disa prej propozim-amendamenteve të mia në plotësim-ndryshimin e Buxhetit, por kërkoj që ajo shumë, e cila është ndarë për stadiumin e futbollit në Runik të rritet edhe për 100 mijë euro dhe, gjithashtu, kërkoj që pjesë e këtij Buxheti të jetë edhe pastrimi dhe rregullimi i shtratit të Lumit Klina nga fshati Kuçicë deri në Skenderaj, sepse ai lumë është degraduar për shkak të hedhjeve në të dhe problemeve tjera mjedisore. Mendoj që është një nga projektet që duhet të adresohet.

Kur jemi te Sporti, gjithashtu duhet të planifikohet që të përfundojnë investimet në Stadiumin e Prishtinës dhe atë të Mitrovicës, që të jenë të gatshëm për gara ndërkombëtare, duke e falënderuar ministrin dhe kryeministrin për vendimin që stadiumi nacional të ndërtohet në Drenas dhe që hapat të mos jenë të ngadalshëm si të ministrit paraprak, por të jenë efikas që ky stadium të ndërtohet dhe të përfundojë brenda periudhës së caktuar kohore, që ky stadium të jetë në shërbim të sportdashësve të Kosovës.

Gjithashtu, edhe dy ligjet që i kemi miratuar, atë të sponsorizimit dhe për luftimin e huliganizmit dhe dukurive negative në sport, duhet të adresohen me këtë buxhet, sepse ato dy ligje janë miratuar dhe janë në fuqi nga 19 janari 2017, por që nuk po zbatohen nga institucionet përkatëse, apo nuk janë nxjerrë udhëzimet e duhura administrative dhe kjo do të ndikonte drejtpërdrejt në zhvillimin e sportit.

Fat të njëjtë për moszbatimin e disa projekteve, që kanë qenë me Buxhet, kanë pasur edhe Projekti për restaurimin dhe konservimin e shtëpive-muze në Lagjen Jasharaj, për të cilat kemi

ndarë buxhet, por ministria nuk e kryer punën e vet. Kërkoj që ato të implementohen, bashkë me projektin për restaurimin apo ndërtimin e Akademisë së Parë Ushtarake të UÇK-së në Açarevë, që gjithashtu ka qenë i planifikuar, por që nuk është i implementuar nga ministria paraprahe e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, apo nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, bashkë me Kullën e Shaban Manxhollit, të cilat kanë qenë të planifikuara, por nuk janë adresuar nga ministria paraprahe.

Gjithashtu dua ta falënderoj ministrin e Financave për fillimin e projektit, planifikimin e projektit të zgjerimit të rrugës Mitrovicë - Prishtinë, një projekt shumë i rëndësishëm, i domosdoshëm. Kjo e tregon efikasitetin e Partisë Demokratike në realizimin e projekteve, sepse për këtë projekt Qeveria e Kosovës ka filluar të paguajë kredi, ndërsa projekti nuk ka filluar të implementohet. Ky është një projekt që do të realizohet me Partinë Demokratike, me njerëz kompetentë dhe profesionistë.

Mendoj se ky Buxhet e adreson një pjesë të madhe të problemeve që janë, por gjithsesi ka nevojë që edhe të përmirësohet me anë të amendamenteve dhe kontributi i çdo deputeti do të jetë më se i mirëseardhur në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, unë besoj se është mirë ta marrim një pauzë për drekë. Vazhdojmë në orën 15:15. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Ne po e vazhdojmë seancën, ndërkohë na bashkëngjiten kolegët e tjerë deputetë. Fjalën e ka Xhevahire Izmaqu, pastaj le të bëhet gati Teuta Haxhiu, në qoftë se është këtu, ose Rasim Selmanaj, nga Grupi Parlamentar i AAK-së.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar, për fjalën!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë që na përcillni në këtë seancë,

Fillimisht më lejoni të përshëndes punën e ministrit të Financave, njëkohësisht e falënderoj për durimin që e ka pasur gjatë pyetjeve tona të vazhdueshme, e veçanërisht disa nga ne që nuk jemi profesionistë në këtë drejtim.

Fjala ime do të jetë e ndarë në tri pjesë, pra pjesa e parë projektet e komunës sime të Vushtrrisë që janë në bashkëfinancim me Qeverinë.

Pjesa e dytë do të kem në diskutim mbi kategoritë që kanë nevojë për mbështetje dhe lobim nga ne si deputetë.

Dhe, pjesa e tretë, institucionet që janë nën kupolën e komisionit ku unë bëj pjesë.

Duke qenë pjesë e shumë vendimeve për një periudhë dhjetëvjeçare sa PDK ishte në pushtet në Komunën e Vushtrrisë, si deputete dhe qytetare e atij rajoni ju falënderoj, i nderuar ministër, për mbështetjen pa rezervë që i dhatë kryetarit të komunës, profesor Bajram Mulaku, për tri mandate radhazi, me qindra projekte kapitale të realizuara dhe dhjetëra të tjera që janë në rrugë për t'u realizuar.

PDK, duke e udhëhequr për tri mandate Komunën e Vushtrrisë, këtë vit buxhetor ka pjesëmarrje me bashkëfinancim me Qeverinë në disa projekte, të cilat i ka në nisje e disa në përfundim, ku kryetari Mulaku, i cili për pak ditë do të lërë detyrën e të parit të Vushtrrisë, ka për t'u mbajtur mend gjatë për revolucionin zhvillimor në atë rajon.

Të nderuar kolegë,

I nderuar ministër,

Të nderuar ministra,

Dëshiroj të përshëndes angazhimin e Qeverisë për të financuar projektet si në vijim: Palestrën sportive në Samadrexhë, e cila u iniciua nga pushteti i PDK-së në Vushtri dhe u mundësua falë

angazhimit të kryetarit të partisë sime, zotit Kadri Veseli dhe në këtë rast, po ashtu dua të bart një falënderim të veçantë për një njeri fisnik që bëri shumë të jetësohet kjo palestër në fshatin Samaderxhë dhe ky është një veteran, një mësues i nderuar nga kjo ulëse e Kuvendit, falënderime dhe respekt të pafund për zotin Ferat Basholli. Pra, një njeri, i cili e kishte shqetësim jetësor të ketë një palestër, meqenëse njihen të rinj dhe të reja në atë fshat që kanë afinitet shumë në sport.

Meqenëse jam duke folur për projektet me bashkëfinancim, po ashtu do të ndaj admirimin për një punë të shkëlqyeshme të një zonjushë të re, e cila ishte drejtoreshë deri më tani e Kulturës në Komunën e Vushtrrisë, kjo është Shpresa Rama, e cila ka punuar me zemër që Vushtrria të ketë një qendër rinore, ku edhe në këtë projekt ka pjesëmarrje Komuna e Vushtrrisë me mjete financiare, andaj Qeveria ka ndarë përsëri mjete për të finalizuar këtë projekt, i nisur nga Komuna nën udhëheqjen e PDK-së.

Shtatorja e të madhit Hasan Prishtina, e cila u soll në vendlindjen e tij para disa ditësh, do të vendoset në sheshin e ri, për të cilin përsëri u kujdes zoti Mulaku dhe partia ime në Vushtri, duke vazhduar me shtëpinë e Mahmut Agë Gjinollit, e cila do të kthehet në muze, po ashtu do të renovohet Qendra e Kulturës dhe për të gjitha këto projekte do të vazhdojë të qëndrojë kujdestare fanatike deri në realizim! Po ashtu, pra, duke falënderuar edhe ministrin e Kulturës, i cili ka vendosur të kujdeset që në vazhdimësi të ketë financa deri në fund të projektit.

Rruga magjistrale Prishtinë-Mitrovicë është nisur, ministër, në kohën kur ishit në mandatin e parë në ekzekutiv dhe, si duket, do ta përfundoni përsëri me mandatin tuaj, sepse pati mbetur e stopuar. Ka qenë periudha me plot probleme e ngarkesa, e më së shumti vështirësohej qarkullimi në periudhën e verës, kur bashkatdhetarët tanë ia mësynë vendlindjes, por vështirësi kanë pasur edhe bizneset që operojnë përkaj rrugës, bujqit dhe të gjithë banorët që çdo dite bëjnë rrugë në relacionin Prishtinë-Vushtri-Mitrovicë!

Po ashtu, të nderuar kolegë deputetë,

Së bashku me ministrin e Infrastrukturës, zotin Pal Lekaj dhe me kryetarin Mulaku u kemi dhënë fjalën banoreve të Artakollit, gjatë vizitës së bërë para disa javësh që rruga në aksin Bukosh-Gllavotin do të përfundojë në vitin 2018. Dhe, unë jam e lumtur kur pashë që Qeveria ka ndarë mjetet për këtë investim. Kërkoj, pra, që edhe infrastruktura e re të jetë shumë efektive në këtë proces që duhet të fillojë sa më parë.

Të gjitha këto projekte janë të nisura dhe buxhetet për to, me pjesëmarrje i ka vendosur në kornizë afatmesme qeverisja e PDK-së në Vushtri dhe, për këtë arsye deri në fund do t'i përcjell edhe punët e Qeverisë, edhe në Kuvend, për të kurorëzuar me sukses, sepse qytetarët këtë e presin nga unë.

I nderuar ministër,

Unë kam kërkesa që gjatë pjesës së dytë të miratimit të buxhetit të keni parasysh në kodin e buxhetit të punëve dhe mirëqenies sociale të ndihmohet Shtëpia e Pleqve në Prishtinë, sepse aty është një objekt në gjendje të mjerë! Për moshën e shtyrë, është një vend aspak i dinjitetshëm, ku ata e kalojnë periudhën e fundit të jetës së tyre, sigurisht aspak me dëshirë që të qëndrojnë në ato ambiente!

Kërkoj, po ashtu, urgjentisht, të shtohet numri i inspektorëve të punës, veçanërisht në kontroll të sektorit privat, ku kemi të dhëna se shkelen në vazhdimësi të drejtat e punëtorëve, duke u nisur nga kompensimi material dhe në çdo drejtim tjetër. Gjithmonë ka pasur justifikim se ka mungesë të burimeve njerëzore dhe mungesë të inspektorëve.

Në kodin buxhetor të Ministria për Kthim dhe Minorite do të shikoj mundësinë për një investim të një ndërtese të karakterit social, fjalën e kam për banorët romë të fshatit Prilluzhë, të cilët nëse i sheh ku banojnë, normalisht që nuk na bënë krenarë fakti i të qenit shumicë.

Pra, pa banesë dhe pa rrugë, në baltë dhe në shtëpi të ftohta, derisa ne edhe bashkësia ndërkombëtare prej pasluftës fokusin e kemi pasur vetëm tek një komunitet tjetër pakicë.

Unë po i diskutoj në parim dhe menjëherë pas kësaj seance do të shikoj mundësinë e amendamentimit për realizim.

Në pjesën e fundit kërkoj që nga Komisioni për Buxhet të kihen parasysh Këshilli i Pavarur dhe Komisioni i Mediave për Buxhetin, të cilin e kanë arsyetuar në kërkesat e tyre në mënyrë që të shtojnë efikasitetin për punën e këtyre agjencive me kredibilitet.

Duke përshëndetur për angazhimin edhe kolegët e mi deputetë në Komisionin për Buxhet e Financa, shpresoj që në lexim të dytë të kemi një sukses për një prurje pozitive të këtij ligji më vital në këtë Kuvend! Sigurisht që vota ime është pro kalimit në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Rasim Selmanaj e ka fjalën.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryesues,

Pa dashur të mos përsëris, unë këtë buxhet e vlerësoj si buxhet të mundësive ekonomike të Kosovës, një buxhet që po ashtu është me detyrime ndaj vazhdimit të projekteve që kanë nisur këtë vit e duhet vazhduar vitin e ardhshëm dhe po ashtu edhe projekte të reja.

Nga fjala e ministrit u tha, po ashtu është edhe në buxhet, se parashihen rritje të investime në arsim, shëndetësi, pastaj në rend e ligj dhe në projekte të tjera komunale.

Por, unë do të ndalem në tabelën 3.2 te projektet kapitale. Më konkretisht, te rruga Deçan-Plavë. Nuk është ministri Lekaj këtu, por ministri i Financave është këtu, unë po e lexoj tabelën që është paraparë vlera e investimeve për të përfunduar ky projekt.

Në vitin 2018 janë paraparë 2 milionë e 400 mijë, më 2019, 3 milionë dhe 2020, 4 milionë e gjysmë.

Dëshiroj të kthehem pak mbrapa, kur ka nisur ky projekt para katër vjetëve në Qeverinë e zotit Thaçi janë ndarë një milion e 100 mijë, ndërsa për tre vjetët e qeverisjes së zotit Mustafa janë ndarë 50 mijë euro. Kemi qenë kritikë dhe kemi pasur të drejtë.

Po ashtu dëshiroj të them se ky projekt, në qoftë se, ministër, vazhdohet me këto dinamika të ndarjeve të mjeteve buxhetore, do të kryhet për 10 vjet.

Prandaj, unë kërkoj që në leximin e dytë të ndahen jo më pak se 10 milionë dhe të parashihet që ky projekt të përfundojë në vitin 2019, pra në fund të vitit.

Nuk është projekt i Deçanit, është projekt nacional që i lidh tri shtete, Shqipërinë, Kosovën e Malin e Zi dhe që krijon mundësi të mëdha të zhvillimit të turizmit, po edhe aspekte të tjera.

Prandaj, te Ministria e Infrastrukturës ekzistojnë këto mundësi të lëvizjes së mjeteve dhe duhet ta trajtojmë këtë projekt seriozisht, e që unë nuk mendoj se ky trajtim i këtij projekti është në atë stadin që e meriton për t'u trajtuar.

Për ministrin e Kulturës e kam një kërkesë, për shembull, palestra sportive e cila u nisur në Deçan qe tetë vjet janë ndarë 50 mijë euro, për katër vjet, ndërsa për t'u përmbyllur projekti duhen 600 mijë. Është një trajtim joserioz i këtij projekti, kështu që unë besoj që ministri i Financave, bashkë me ministrin e Kulturës do ta gjejnë mundësinë që në leximin e dytë të ndahen mjetet buxhetore dhe të përmbyllet.

Më herët u dëgjuan disa kolegë të LDK-së se ky buxhet shkon më shumë nga ana rajonale. Unë mendoj se kjo nuk ekziston. Në qoftë se donë ta shohin në këtë prizëm, atëherë në rajonin e Dukagjinit tash e sa vjet asnjë projekt i madh kapital nuk ka ndodhur. Ka ndodhur një projekt që ka nisur në kohën e Hashim Thaçit, rruga Deçan-Plavë, por që nuk është trajtuar dhe nuk është përkrahur seriozisht.

Prandaj, disa nisja e disa projekteve në këtë regjion mendoj se është kthim i borxhit ndaj asaj pjese, e cila ka kontribuar jashtëzakonisht shumë.

Edhe një herë po përsëris, një buxhet i mundësive reale që ka Kosova, po që deri në leximin e dytë, i nderuar ministër, duhet bërë disa lexime të brendshme dhe disa projekte të trajtohen seriozisht, sepse është e palogjikshme një palestër sportive të kryhet për 15 vjet, ose një rrugë nacionale që ka nisur para pesë vjetëve të zgjatë, ku ta di unë, 10-15 vjet.

Prandaj, unë besoj që Qeveria e zotit Hardinaj do ta trajtojë këtë kërkesë seriozisht. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi e ka fjalën. Ka dalë. Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryetar i Parlamentit!

Po sigurisht që fjala ime thotë më shumë se ato që bëhen në grup. Faleminderit!

Ju përsërisht, kolegë të nderuar,

Ministra,

Media,

Kërkesë për Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Në bazë të nenit 57.3 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, unë si deputet, Islam Pacolli, Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa paraqes këtë propozim:

Amendamentimin e projektit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, me numër 06/L-020 për vitin 2018, amendamentimin në Ligjin e propozuar nga Qeveria e Kosovës për Buxhetin 2018 në tabelën e buxhetit të Ministrisë së Infrastrukturës kam vërejtur se ekziston projekti me kodin 15298 me emrin “Zgjerimi i rrugës nga ura e Veterrikut deri te udhëkryqi Fshati Amerikan”.

Komisioni për Buxhet dhe Financa të bëjë shpërndarjen adekuate sipas organizimit buxhetor, duke pasur parasysh vëllimin e madh të veturave që e shfrytëzojnë këtë rrugë si hyrje të Prishtinës, duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj rruge, ju lus që Ligji i Buxhetit 2018 të amendamentojë edhe projektin me kodin 15298 që quhet “Zgjerimi i rrugës nga ura deri në Graçanicë”.

Kisha lutur komisionin që pa hezitim ta përkrahë këtë, shpresoj që po.

Unë kam folur edhe më herët për çështjen e Gollakut, por ende nuk kam parë projekte serioze që janë adresuar në atë drejtim, po më duket që ministrat nuk kanë qenë ose nuk kanë pasur kohë t’i trajtojnë mirë. Kisha pasur dëshirë ta marrin parasysh këtë.

Edhe një kërkesë për ministrin e Punëve të brendshme, që ta shqyrtojë çështjen dhe ta paraqesë kërkesën në Qeveri për rritjen e pagave të policisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Driton Çausi e ka fjalën.

DRITON ÇAUSHI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të pranishëm,
Dua që sot të ngre dy çështje që lidhen me Projektbuxhetin 2018.

Në radhë të parë, një sektor tepër të rëndësishëm, për të cilën besoj ka unanimitet për rëndësinë e tij në zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, pra është fjala për sektorin e bujqësisë.

Ajo që kemi dëgjuar në kohën kur është themeluar kjo Qeveri, kanë qenë disa parime programore, ku thuhej që bujqësia do të trajtohet si sektor strategjik dhe do të ketë politika nxitëse dhe stimuluese, por edhe rritje të fondeve zhvillimore dhe gjenerimin e vendeve të punës.

Ajo që pamë në fillim ishte një neglizhim ose një kundërshti me këtë që u tha në këto parime, për vetë faktin që një sektor kaq vital dhe kaq i rëndësishëm iu dha në përgjegjësi një subjekti politik, i cili i shërben një qeveri tjetër, pra Qeverisë serbe, është fjala për Listën serbe dhe cili mund të jetë e motivi që një subjekt i tillë të zhvillojë një sektor, i cili dëmtohet në masën më të madhe nga importet nga Serbia.

Përveç kësaj, në këto prime u tha që do të ketë rritje të fondeve, kur e shohim buxhetin, një gjë e tillë është e padukshme, pra nuk ka një ndryshim esencial në ndarjen e buxhetit për bujqësi. Bile unë dëgjova nga ministri që rritja është 9%, një gjë e tillë nuk qëndron, për shkak se rritja e buxhetit për Ministrinë e Bujqësisë është vetëm 2 milionë euro.

Nëse i shohim subvencionet, pra është një dallim i papërfillshëm dhe nuk e kuptoj si mund të jetë kjo një qasje e re, qasje serioze ndaj këtij sektori.

Gjithashtu dua të rikujtoj, e kemi përmendur edhe më parë, që kjo ministri funksionon me një ligj, i cili nuk e ka kaluar miratimin e Parlamentit. Pra, një program kombëtar të bujqësisë dhe zhvillimit rural, i cili faktikisht vazhdon të jetë ilegal për katër vjet me radhë, për shkak se nuk e ka marrë mbështetjen e këtij Kuvendi.

Tepër shqetësuese është që ende në kuadër të këtyre investimeve në Ministrinë e Bujqësisë, në buxhetin për Ministrinë e Bujqësisë nuk kemi një fond për fatkeqësi natyrore dhe tanimë kemi disa shembuj, ku ekonomi të tëra, familje të tëra janë shkatërruar nga viti 2015 me humbje të mëdha që kemi pasur nga sëmundja e Bllutangut, kanë qenë mbi 1 200 krerë nga këto, që ende mbesin të pakompensuara.

Në vitin 2016 ngjashëm, mbi 1 500 krerë nga një epidemi tjetër që vazhdojnë të mbesin të pambuluara dhe e shohim në këtë buxhet nuk ka një trajtim për një fond të tillë, i cili po e them është një domosdoshmëri e pashmangshme.

Çështja tjetër që dua të ngre, pa dashur në asnjë moment ta trajtoj në formën e një rajonalizimi, mirëpo që është evidente që të gjitha qeveritë e kaluara kanë pasur një qasje jo të drejtë në investime në komunën e Gjakovës. Ajo që mua më bie në sy dhe që është edhe një shqetësim për qytetarët e komunës së Gjakovës, e arsyeja pse e them, po e përsëris, nuk ka të bëjë me trajtim të veçantë, po ka të bëjë me nevojën për të mos diskriminuar rajone të caktuara, e që është mungesa e investimeve në infrastrukturën e sportit, e cila nga ajo që prezantohet në buxhet është tepër e dukshme, e që unë nuk besoj që është e drejtë për një qytet që ka një traditë të tillë të sportit, e që më e keqja dhe që është një arsye tjetër për ta ngritur këtë çështje, është edhe ajo që është proklamuar gjatë fushatës nga subjekti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në qytetin e Gjakovës, me premtime të shumta për investime në stadione, në infrastrukturë sportive dhe të ngjashme.

Pra, kjo është prapë për zhgënjim edhe prapë po dëshmon që të qenit në pushtet vazhdon të manipulohet, vazhdon të keqpërdoret si pjesë e fushatave elektorale, e që në fund përfundojnë prapë me diskriminim dhe mospërgjegje ndaj nevojave esenciale që qytetarët i kanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po shkojmë në bazë të një radhitje, të cilën grupet parlamentare e kanë dhënë. Mimoza Kusari-Lila e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Së pari më lejoni që të gjithëve t'ju uroj "Javën e luftës kundër korrupsionit", me shpresën që kemi filluar ndonjëherë ta kuptojmë rëndësinë dhe peshën e kësaj jave.

Së dyti, ministër Hamza, adresimet e mia kanë të bëjnë me politikën e Qeverisë, andaj nuk kanë të bëjnë me përgatitjen teknike të buxhetit, por me politikën të cilat i vendos kryeministri dhe ministrat e tjerë të linjës.

Buxheti i Kosovës, i cili është sjellë para deputetëve, shpërfaq në mënyrë më të qartë të mundshme:

Së pari, konfuzionin e Qeverisë për politikën zhvillimore.

Së dyti, mungesën e piramidës vendimmarrëse në këtë kabinet qeveritar, zbulon mashtrimet që janë bërë me qëllim elektoratit në mbarë Kosovën në zgjedhjet parlamentare dhe këto të fundit lokale.

Edhe pse prezantohen shumë parti në koalicion, dëshmojnë se bashkë të gjitha nuk janë në gjendje të bëjnë një koordinim të thjeshtë të përgjithësisë institucionale për atë se çfarë i takon secilit dikaster.

Buxheti sot flet shumë më tepër për mungesën e kapacitetit qeverisës dhe menaxhues në Zyrën e Kryeministrit dhe të Qeverisë së Kosovës, se sa që ne do të donim të dinim për të.

Për t'ju argumentuar këtë, po i përmend vetëm disa fakte.

Buxheti si dokument ligjor vjen duke qenë i paraprirë nga programi katërvjeçar i Qeverisë Haradinaj. Ky program u është sjellë deputetëve të Kuvendit para gati tre muajsh dhe në rrethanat normale, dikush do të mendonte se një armatë e tërë ministrash, më konkretisht 22 prej tyre, një armatë e tërë zëvendësministrash, diku 67 sa janë deri sot dhe këshilltarësh, tash më do të nxjerrin koston aktuale të programit zhvillimor të Qeverisë Haradinaj. Por jo, në të kundërtën, buxheti dhe programi kanë shpërputhje serioze mes tyre.

Këtë kosto nuk kemi si ta dimë as ne tani, edhe pse sot duhet të kishim numrat e parë të buxhetit të qeverisë Haradinaj, i cili do të tregonte orientimin e Qeverisë.

Buxheti i Qeverisë Haradinaj është sikurse pasuria e një numri zyrtarësh shtetërorë. E dinë se u është rritur në mënyrë enorme ajo pasuri, por nuk ka teori ekonomike që mund ta shpjegojë një rritje të tillë të pasurisë. Fatkeqësisht, për popullin e Kosovës nuk po ndodh e njëjta.

Katër shtylla kryesore janë në programin qeverisës të Qeverisë Haradinaj: sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe punësimi, integrimet euro-atlantike dhe zhvillimi sektorial.

Në asnjërën prej këtyre shtyllave nuk ka politika zhvillimore, ose fokusim buxheti në to.

Përderisa një qeveri, e cila e quan veten Qeveri e djathtë, prezanton buxhet super të majtë. Nga 22 ministri që i ka kjo megaqeveri, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies i merr $\frac{1}{4}$ e buxhetit, apo 407 milionë e 662 mijë e 214 euro. Prej të cilave investimet nuk janë në politikat e punësimit, por në ato të mirëqenies dhe skemat sociale.

Rritja e skemave sociale paraqet një tendencë të kthimit të tërë popullit të Kosovës në kategori sociale. Dhe, krijimin e perceptimit se dikush është duke prodhuar para, të cilat do të shpërndahen në këmbim të votës.

Me këtë program qeverisës dhe këtë buxhet nuk po nxitet punësimi dhe ndërmarrësia, me këtë program dhe këtë buxhet po nxitet paralizimi i shoqërisë aktive, ikja nga vendi i atyre që kanë energji dhe nuk shohin se si mund ta gjejnë veten aktiv në këtë shtet pasiv.

Sundimi i ligjit, si shtylla e parë, vërehet zbehtë në Buxhetin 2018. Nëse Qeverisë Haradinaj i intereson sundimi i ligjit dhe lufta ndaj korrupsionit, do të kishim një buxhet më të madh për mekanizmat e drejtësisë.

Marrim shembull një element tepër të ndjeshëm të jetës sonë, luftën e fundit në Kosovë.

Instituti për Krimet e Luftës në Kosovë ka buxhet vetëm 111 mijë euro e 499, çka mund të flasim për këtë. Dikush është apo nuk është fare i interesuar të zbardhen krimet e luftës në Kosovës, përderisa ne sot ende ballafaqohemi me probleme tepër të thella e serioze dhe me skema sociale që burojnë nga kjo periudhë e kohës sonë.

Ndërsa të gjithë prokurorët specialë buxhet vjetor kanë një milion e 293 mijë euro, Njësia e Krimeve Ekonomike në kuadër të prokurorisë ka buxhet 58 mijë euro. Sa do të ketë forcë dhe sa do të ketë mundësi me një luftim serioz të krimit dhe korrupsionit.

Si shtyllë e dytë e Qeverisë Haradinaj zhvillimi ekonomik dhe punësi paraqitet në buxhet dhe mund të shihet se buxheti i ministrive të linjës: Ministrisë së Tregtisë, Industrisë, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve, Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe Ministrisë së Inovacionit, së bashku të gjitha është 48 milionë euro. Nëse shtohet këtu, kërkoj ndjesë, edhe Ministria e Bujqësisë, plus 57 milionë euro, të gjitha bashkë afrohen në 100 milionë euro, që është 5% e buxhetit. Po flasim për dikastere të zhvillimit ekonomik, po flasim për atë çfarë është esenciale sot, punësimi dhe zhvillimi. Se ekziston shpërputhje e vërtetë e programit qeverisës krahasuar me buxhetin shihet se asnjë prej fondeve të agjencive, të cilat janë paraparë në programin katërvjeçar të themelohen, nuk janë pjesë e Buxhetit 2018.

Nuk paraqitet agjencia e participimeve që është planifikuar në kuadër të MZHE-së, nuk paraqitet fondi i TIK-ut në kuadër të MZHE-së, nuk paraqitet Agjencia e zhvillimit të aftësive nga Ministria e Inovacionit. Buxhetet e ministrive nuk janë në përputhje me njëra-tjetrën, të kundërtën, ka dualizma dhe mungesa të qartësisë se kush për çfarë është përgjegjës, çka në vete shpjegon se Qeveria ka shumë shefa dhe asnjë vendimmarrës. Se buxheti i Republikës së Kosovës dhe ministrive përkatëse në kuadër të subvencioneve tregon se nuk kemi një vizion zhvillimor edhe vetë fakti se subvencionet përdoren ndërmarrje publike, siç është Trepça, 4 milionë e 817 mijë euro nga buxheti i MZHE-së, përderisa ne flemë në miniera dhe minerale, të cilat kanë një pasuri enorme.

E njëjta është edhe me njësinë e ndërmarrjeve publike, me 4 milionë e 200 mijë, ne sot subvencionojmë ngrohjen, ujin, Trainkosin, Infrakosin, të gjitha këto tregojnë se, në fakt, nuk kemi ndërmarrje në kuadër të sektorit publik profitabile, por kemi ndërmarrje, të cilat marrin nga buxheti i shtetit. Skema e veteranëve paraqet një vlerë prej 58 milionë eurosh. Sa për një krahasim, tërë buxheti i arsimit në Republikën e Kosovës, buxheti vjetor për arsimin parafillor,

fillor, të mesëm dhe universitar është në vlerën 54 milionë euro, përfshirë mirëmbajtjen dhe ndërtimin e gjashtë universiteteve, katër instituteve. Përderisa, vetëm skema e veteranëve është 58 milionë euro, në programin e Qeverisë paraqitet që janë 28 mijë e 562 përfitues, ndërsa thuhet se ky numër ka tendencë të rritjes deri në 40 mijë. Me këtë numër dhe këto shifra, ky është mashtrimi më i madh që i bëhet një kategorie që meriton të trajtohet shumë më mirë dhe përfitimi më i madh politik nga dikush që luan me numra për përfitim të vetin.

Sikur të kishit pak dinjitet, ky numër nuk do të kishte nevojë të fryhej dhe as të manipulohej. Veteranët dhe luftëtarët e mirëfilltë do të kishin jetë të dinjitetshme dhe status të rregulluar që moti, ndërsa qeverisja do të prezantonte një program si duhet dhe jo një program, prej së cilës 100 milionë euro sot janë pjesë e skemës, e cila ende nuk e ka arritur kufirin e sipërm. Me këtë shohim se a kemi qeveri të së ardhmes apo të kaluarës, me këtë program dhe këtë qeverisje ne jemi 20 vjet prapa, shtu këtu 10 vjet që vendet e rajonit janë para nesh, 30 vjet prapa. Ky buxhet ka çdo gjë, përveç projekteve strategjike në të. Buxhetit i mungon konsistenca, buxhetit i mungon vizioni. Ka shtrirje të projekteve dhe shkurtim.

Tash diçka për Komunën e Gjakovës. Si një ndër rajonet me buxhetin më të vogël pas Mitrovicës, prapa është dhe është ende fatkeqësisht prezente në këtë buxhet. Hyrje-daljet e qyteteve, të cilat janë paraparë nga vlera prej 25 milionë eurove që ishin të parapara, 18 milionë nga Ministria e Infrastrukturës dhe 7 milionë nga Komuna, janë zbërthyer dhe reduktuar në vetëm 7 milionë, kjo është për qarkoren buxhetore për tre vjetët e ardhshme. Nga 1,2 milion memorandumit të nënshkruar midis meje si ish-kryetare dhe ministrit të Kulturës, Shtëpia e Kulturës në Rogovë të Hasit me këtë buxhet kap vlerën ose kap shumë vetëm prej 500 mijë eurove, reduktim prej 700 mijë eurosh.

Fushat e tenisit në Gjakovë, një projekt i filluar vitin e kaluar, nënshkruar marrëveshja dhe nënshkruar kontrata në vlerën 488 mijë euro, është reduktuar në 100 mijë euro. Këtu kemi probleme serioze me ligjin, për shkak se si pasojë e humbjes së buxhetit kompanitë edhe mund të padisin ministrinë dhe t'i marrin të gjitha mjetet prapa. Shkolla fillore në Ponoshec që realisht është duke u ndërtuar në Korenicë, nga 313 mijë euro e 589 sa është kontrata e nënshkruar, me buxhetin e Qeverisë Haradinaj ka rënë në 230 mijë euro. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, projekt i nënshkruar mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Komunës së Gjakovës vitin e kaluar, nga 813 mijë euro, ka rënë në 713 mijë euro, kush i ka bërë shkurtimet duhet të japë përgjegjësi për to.

Në total, në trevjeçar projektet e nisura që kanë pasur vlerën 27 milionë e 815 mijë 567 euro, kanë rënë në 8 milionë e 543 mijë euro. Minusi për Komunën e Gjakovës nga Qeveria Haradinaj është 19 milionë e 272 mijë e 567 euro. Të gjitha këto dhe të tjera argumente, të cilat i prezantova, na bëjnë ne që absolutisht të mos e mbështesim buxhetin që është para nesh, por në

mes të dy leximeve, nëse arrin të shkojë në leximin e dytë, të amendamentohen dhe të gjitha mjetet që janë marrë nga projektet e të kthehen ashtu siç kanë qenë të destinuara. Faleminderit!

KRYETARI: Mexhide Mjaku-Topalli e ka fjalën, ndërsa bëhet gati Teuta Haxhiu.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Në fillim të diskutimeve dëgjova në fjalimin e tij ish-ministrin e Financave, Avdullah Hoti, se në Qeverinë Mustafa ka pasur ngritje të të hyrave, si dhe përmirësime në strukturën buxhetore. Unë i parashtraj pyetje ish-ministrit pse atëherë nuk e filluar zbatimin e Ligjit për tetraplegjikë dhe paraplegjikë?

Ndërsa, sot lirisht mund të them se ky buxhet që u paraqit para nesh është dëshmia më e mirë se Qeveria e Republikës së Kosovës është në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Këtë na e prezantoi sot ministri aktual i Financave, zoti Bedri Hamza. Për prioritetet në Ministrinë e Shëndetësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, për skemat pensionale, për ndarjen e buxhetit për personat tetraplegjikë dhe paraplegjikë, për ngritjen e pagave, për shtimin e numrit të gjyqtarëve e për shumë prioritete të tjera.

Në fund të fjalës së tij ministri ishte i gatshëm që të pranojë vërejtjet e dala nga ne deputetët. Unë kam dy kërkesa për ministrin e Infrastrukturës: duke e ditur se prioritetet duhet të jenë interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, unë kërkoj që të bëhet një planifikim buxhetor nga Departamenti i Infrastrukturës Rrugore për realizimin e kyçjes në autostradë tek fshati Gurëz, komuna e Ferizajt. Ndërsa, çështja tjetër, është fjala për një fshat në komunë të Vitisë, fshatin Mjak. Që nga përfundimi i luftës banorët e këtij fshati nuk mund të kthehen për të banuar për shkak të mungesës së instalimit elektrik. Kërkesa e tretë ka të bëjë me ndarjen e mjeteve shtesë për kompletimin e bazamentit të shtatores së Hyrë Emini Mira. Pra, duhen edhe 3 mijë euro mjete shtesë për ta kompletuar si duhet projektin e shtatores së Hyrë Emini, me kodin e projektit “Hyrë Emini”.

Dhe, në fund, kërkesa tjetër është ndërtimi i një palestere sportive në fshatin Greme, sepse kështu, ky fshat do të mund të bëhet me infrastrukturë moderne në të gjitha aspektet, ky do të ishte një lajm i mirë për të rinjtë e fshatit Greme, komuna e Ferizajt. Kjo kërkesë i drejtohet ministrit të Kulturës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Teutë Haxhiu, ndërkohë kolegë deputetë, nga “Nisma” nuk paska të deklaruar, as pa grup parlamentar, vazhdojmë me radhitjen sipas partive.

TEUTË HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Para vetes sot kemi Projektbuxhetin 2018, që mbi të gjitha, buxheti të cilin ne sot e kemi në shqyrtim në parim është buxheti i qytetarëve të Republikës së Kosovës në radhë të parë, e jo i partive politike.

Megjithatë, domethënë çdoherë ka nevojë të japim sugjerime, por edhe kritika aty ku vërtet ka nevojë. Por, sot, edhe pse si deputete kam shumë sugjerime rreth shumë amendamenteve, shumë kërkesave që vijnë në radhë të parë nga Komuna e Gjakovës, por më lejoni të përsëndes së pari ministrin e Financave pikërisht për shkak që nuk lejoi që të vetmit qytetarë në Republikën e Kosovës, qytetarët e komunës së Gjakovës, të jenë të diskriminuar duke paguar kredi që vërtet po të lejohej, ishte diskriminimi më i madh që do t'u bëhej qytetarëve të komunës së Gjakovës si të vetmit në Republikën e Kosovës, ngase kjo kredi ishte marrë pikërisht nga parafolësja sa ishte si kryetare. Por, për fat, kjo nuk po ndodh dhe ata qytetarë nuk do të paguajnë kredi, sepse janë qytetarë dhe janë taksapagues të buxhetit të Kosovës dhe gjitha hyrje-daljet, pra do të kryhen nga buxheti i Republikës së Kosovës, sepse kjo është edhe e drejtë.

Por, unë kam edhe shumë kërkesa të tjera, edhe pse para vetes kam një listë, të cilën e kam nxjerrë në këtë projektbuxhet, e që i kam para vetes. Vetëm në komunën e Gjakovës janë 31 projekte, por sinqerisht jam shumë e pakënaqur, ngase shuma e cila alokohet prej vitit në vit nuk është shumë e cila tregon, pra që ato projekte do të realizohen për një periudhë të shkurtër kohore. Kur thamë “periudhë të shkurtë kohore”, më shumë flas për shkak se një projekt që fillohet të ndërtohet për një kohë të gjatë, shumë shpejt po ndihet nevoja që ai të rinovohet, në fakt, po kemi humbje të taksave të qytetarëve.

Mbi të gjitha është edhe një kërkesë imja dhe e 39 deputetëve që e kemi miratuar në mandatin e kaluar, çka unë gjithëherë i falënderoj, për Kompleksin memorial Meja që prapë ministri, përkatësisht Ministria, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë prapë mjete për Kompleksin memorial Meja dhe uroj që sa më parë të përmbyllet, sepse është një projekt, duke e ditur secili prej neve që 27 prilli është Dita e të pagjeturve në Republikën e Kosovës i shpallur me vendim të Kuvendit të Kosovës.

Megjithatë, një kërkesë imja është edhe uji i pijes për 24 fshatra të Rekës së Keqe që nuk figuron, dhe kërkoj, ministër, që vërtet 24 fshatra të Rekës së Keqe pas 18 vjetësh edhe atyre t'u kryhet pra ky projekt dhe ata të kenë ujë të pijes, ngase vërtet 18 vjet pas luftës ende nuk kemi ujë të pijes në 24 fshatra të Rekës së Keqe, të komunës së Gjakovës. Me arsytim, që unë nuk e kam hasur, se sinqerisht në projektbuxhet ndoshta shifrat janë shumë të vogla për t'i studiuar edhe ne që nuk jemi krejt ekspertë, por më ka interesuar shumë çështja e Vëllaznimit, pra e

klubit futbollistik Vllaznimi në Gjakovë, nuk e kam hasur, por pak më parë bisedova me ministrin e Kulturës dhe ashtu siç ma tha ministri i Kulturës, te mbështetja e komunave janë ndarë 200 mijë euro, është fjala e ministrit. Unë do të jem çdoherë në vëzhgim se a janë ndarë 200 mijë euro dhe kërkoj ndarje jo 200 mijë euro për stadiumin e Gjakovës, pra të Vllaznimit të Gjakovës, por një mbështetje të vazhdueshme në mënyrë që klubi futbollistik Vllaznimi pra ta ketë stadiumin ashtu siç e meriton.

Nuk kam çka të flas më tepër për këtë klub, por ka qenë dikur krenaria e Kosovës, prandaj kërkon edhe trajtim të mëtutjeshëm edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Megjithatë, është prapë një shifër prej 130 mijë eurosh që është paraparë për ndërtimin e shkollës në Ponošec, por ndarja prej vitit në vit, e thashë edhe më parë, do të ishte mirë që kjo ndarje të bëhej brenda vitit 2018 dhe ata nxënës ta kenë një objekt shkollor ku do t'i mbanin mësimet, sepse mbi të gjitha, nëse objekti nuk është në nivelin e duhur, atëherë shumë pak mund të presim edhe cilësi. Megjithatë, kam edhe shumë kërkesa të tjera, por prapë një kërkesë e propozuar nga ana ime rreth asfaltimit të rrugës Smolicë-Stubëll-Berjan-Nivokaz, e që lidhet me Junikun, është ndarë një shumë prej Junikut, mirëpo prej Smolicës kjo lidhet pikërisht me Junik, ish-ministri nuk e ka ditur se ku i bien këto fshatra, por sinqerisht kjo rrugë ka një histori në vete, edhe në kohën kur është dashur, ndoshta kur dikush nuk ka menduar që kjo rrugë ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm edhe në kohën e luftës dhe sinqerisht kjo kohëzgjatje për të mos filluar ndërtimi i kësaj rruge tregon që nuk kanë qenë këta banorë dhe këto fshatra, ose krejt kjo rrugë, pra nuk ka qenë në agjendën e qeverisë së kaluar, prandaj ju lus që këtë, edhe pse do të bëj amendament gjithsesi, sikurse për ujë të pijes, por edhe për këtë rrugë që të hyjë në Buxhetin 2018.

Unë para vetes gjithashtu kam një numër kërkesash nga Komuna e Junikut, të cilat nuk i kam parë në buxhetin e këtij viti, pra që po flasim për vitin 2018, siç është rregullimi i shtratit të lumit Erenik, pastaj furnizimi me ujë të pijes për banorët e lagjes “Agim Ramadani”, ndërtimi i stadiumit dhe rrjetit elektrik, ndërtimi i objektit të shkollës fillore dhe të mesme “Edmond Hoxha” që ka qenë kërkesë e vazhdueshme dhe nuk do të ndalem, pra do të bëj edhe amendament dhe nuk do të ndalem derisa të realizohet kërkesa e Komunës së Junikut për ndërtimin e kësaj shkolle. Ndërtimi i Qendrës Kulturore po ashtu në komunën e Junikut, ndërtimi i palestrave sportive, themelimi i Degës së Gjykatës Themelore, asfaltimi i rrugës Junik-Jasiq-Gjocaj-Livadhi i Madh, janë edhe një numër kërkesash, e që qytetarët na kanë votuar për të qenë këtu, janë që kërkojnë nga ne që t'i realizojmë edhe synimet, kërkesat e tyre.

Gjithashtu, është edhe një shkollë fillore në fshatin Lumbardhë, komuna e Deçanit, e cila është në një gjendje të mjerueshme dhe më së paku i përngjan një objekti shkollor për të mbajtur mësim. Prandaj, duke përshëndetur edhe rritjen e buxhetit për rininë, unë kërkoj që të kemi një rritje të vazhdueshme në sektorin e rinisë, sepse mbi të gjitha është një propozim që ka dalë nga ana jonë në Komisionin për Rini, që do të duhej të punojë Qeveria, përkatësisht Ministria e

Kulturës në Ligjin për vullnetarizmin, e që normal do të duhej të ndahej buxhet edhe sa i përket nesër zbatimit të ligjit, sepse mbi të gjitha ne kemi shumë nevojë dhe paraprakisht përderisa hartojmë ligje, të cilat kanë probleme financiare, është më mirë të mos bëjmë ligje fare, se sa të kemi problem në zbatim.

Prandaj, me kërkesat tona, edhe të kolegut tim, besoj, edhe të shumë kolegëve të tjerë ashtu siç ka ndodhur që më kanë përkrahur në amendamente, sepse mbi të gjitha janë amendamente dhe kërkesa të qytetarëve, unë do t'i bëj amendamentet për ujin e pijes, për rrugën Smolicë-Stubëll-Berjan-Nivokaz, por edhe disa amendamente të tjera dhe normalisht që kërkoj çdoherë mbështetjen edhe të kolegëve të opozitës, sepse Aleanca ka ditur të tregojë që e ka votuar buxhetin sa herë e ka vlerësuar që ai buxhet është në interes të qytetarëve dhe unë jam shumë i bindur që ka deputetë edhe nga opozita që do ta votojnë buxhetin, sepse qytetarët kërkojnë llogari nga ne. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete, por ndërkohë kur e ke diskutuar, ke ngjallur një replikë. Ke të drejtë për kundër replikë paraprakisht, urdhëro zonja Mimoza, fjala për ju, replikë e ke, 2 minuta.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Emrin e kam Mimoza Kusari-Lila, kryesuese e Alternatives, emrin dhe mbiemrin komplet. Mua po më vjen mirë që po ndihemi si në kohë fushate që do të thotë zgjedhjet shpejt po vijnë, përgatitur jemi të gjithë se jemi mësuar zgjedhje pas zgjedhjeve. Vetëm i rikujtoj disa gjëra, nëse duam t'i prezantojmë në projektet në këtë Parlament, të paktën ta marrim mundin dhe të shikojmë saktë dhe korrekt se çka kanë ato.

Rruga qarkore e Gjakovës që është e prezantuar në Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitet 2018, 2019 dhe 2020 përfshin vlerën 7 milionë euro. Këto 7 milionë euro janë vetëm për pjesën e hyrjes në qytetet, nuk i përfshin unazat, të cilat janë iniciuar dhe analizuar e studiuar me plan fizibiliteti me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Rrjedhimisht, Ministria e Infrastrukturës i ik obligimit të vet prej 18 milionë eurosh që ka pasur t'i fusë në projekte strategjike për komunën e Gjakovës. Shkolla në Ponoshec që figuron në buxhet nuk është për shkollën në Ponoshec, ka filluar ndërtimi i po të njëjtit projekt në fshatin Korenicë, për shkak se është refuzuar nga banorët e fshatit Ponoshec dhe si e tillë paraqitet, por edhe si e tillë rrjedh që edhe për shkollën në Korenicë 100 mijë euro janë hequr për finalizim.

Totali apo shuma e krejt asaj çfarë e thashë, po e ri përsëris, besoj që të gjithë e kanë buxhetin është transparent, Komuna e Gjakovës në Qeverinë Haradinaj ka minus në 2018-2020 19 milionë e 272 mijë e 567 euro. Këto janë reduktime që i janë bërë secilit projekt që ka qenë në vazhdimësi dhe gjithashtu heqje të projekteve strategjike që kanë qenë në planifikim, në proces, në Qeverinë Mustafa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E përshëndes zonjën Melihate Tërmkollin, se shpesh ia kam ngatërruar emrin, zonja Mimoza Kusari-Lila, Faleminderit. Ka kundër-replikë një minutë.

TEUTË HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Nuk e di, dy deputetë, kryetare e një subjekti që nuk e di a është subjekt ende, megjithatë duhet t'u kërkohet falje banorëve të fshatit Ponoshec, po na dëgjojnë, sepse kërkesa nuk është refuzuar nga ata, por përkundrazi këtu ka shumë më shumë, e unë do ta shpalos në një të ardhme, sepse është bërë një kërkesë pikërisht nga Drejtoria e Arsimit, atëherë e udhëhequr nga një drejtoreshë që ka qenë kryetare zonja Kusari-Lila, e cila e ka dorëzuar një projekt krejt kundër kërkesës së banorëve të fshatit. Megjithatë, edhe një herë po e them, për herë të parë banorët, qytetarët e komunës së Gjakovës nga kjo qeveri nuk janë lejuar të diskriminohen ashtu siç ka kërkuar zonja Kusari-Lila të paguajnë nga taksat e tyre. Për herë të parë në një komunë, e vetmja komunë që ka marrë kredi për hyrje-daljet, është pak një vlerë prej 7 milionë, normal që do të duhej ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Po i vazhdojmë diskutimet, Besa Baftiu e ka fjalën, ndërkohë le të bëhet gati Naser Rugova.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Gjendja në sektorin e shëndetësisë vazhdon të mbetet e rëndë, kredibiliteti i sistemit shëndetësor publik është në rënie të vazhdueshme. Pacientët janë të pakënaqur me shërbimet shëndetësore në sektorin publik, kështu që një pjesë e tyre që kanë mundësi po trajtohen në institucionet private apo edhe jashtë shtetit, e ata që nuk kanë mundësi, pajtohen me fatin që i pret.

Me këtë gjendje nuk janë të kënaqur as stafi mjekësor, sepse nuk po u krijohen kushtet e nevojshme për punë, e disave nuk po u jepet mundësia as të fillojnë punën profesionale, për të cilën janë avancuar. Për këtë arsye sot kemi një numër të madh të mjekëve, të stafit të mesëm që po e lëshojnë Kosovën dhe po shkojnë në vendet e BE-së, ku po e gjejnë veten ashtu siç edhe e meritojnë. E gjithë kjo po ndodh në mungesë të një strategjie të mirëfilltë dhe në mungesë të një vullneti politik për të ndryshuar këtë situatë. Sistemi shëndetësor për 18 vjet pas luftës ka qenë një ndër pjesët më të neglizhuara nga të gjitha qeveritë. E gjithë kjo gjendje është si pasojë e shumë faktorëve, por besoj janë dy më të rëndësishëm që kanë ndikuar të jetë kjo gjendje kaq e rëndë: menaxhimi i dobët i sistemit shëndetësor, siç janë emërimet dhe punësimet në baza partiake nepotike, jomeritore, mungesa e llogaridhënies dhe mbikëqyrjes, si dhe faktori tjetër, që është shumë me rëndësi, që është financimi apo buxheti i pamjaftueshëm.

Po ashtu, një faktor shumë i rëndësishëm është edhe mungesa e sigurimeve shëndetësore. Kur është fjala te buxheti, ne sot kemi një diskutim projektligjin më të rëndësishëm të Qeverisë që është Projektligji për buxhetin. Fatmirësisht e kemi marrë me kohë dhe besoj se do të trajtohet në bazë të afateve të parapara jo si shumë herë me procedura të përshpejtuara. Buxheti për shëndetësi për vitin 2018 ka rritje dhe këtë rritje normalisht se e përshëndesim. Rritja është për 20 milionë euro, që do të thotë se ka qenë 180 milionë euro dhe tani është 200 milionë euro. Por, sa do të ketë përmirësime në këtë sektor, varet se si do të menaxhohet ky buxhet.

Qytetarëve pak u interesojnë shifrat në këtë buxhet, atyre u intereson nëse do të trajtohen ashtu siç e meritojnë dhe do të marrin shërbime në kohë dhe cilësore. Edhe pse kemi një rritje për buxhetin e shëndetësisë, ndarja e tij nuk është bërë në mënyrë proporcionale në bazë të nevojave. Për shembull, për Fondin për trajtim jashtë vendit janë ndarë 6 milionë euro për këtë vit, që domethënë kemi një rritje prej 200 mijë eurosh më shumë se sa vitin e kaluar, por kërkesat dhe nevojat janë shumë më të mëdha dhe çdo ditë e më shumë po rriten. Buxheti për barna është rritur, por jo mjaftueshëm që t'i mbulojë të gjitha grupet të të sëmurëve, për shembull në Kosovë numri i të prekurve nga skleroza multiple është përafërsisht 1 mijë pacientë, e Ministria e Shëndetësisë në listën e saj siguron barna vetëm për 100 pacientë, barna, të cilat janë shumë të shtrenjta dhe të papërballueshme për secilin qytetar të Republikës së Kosovës.

Prandaj, është dashur të mendohej në këtë drejtim, sepse vetëm sigurimet shëndetësore do të mund të mbulonin këto shuma, e siç kemi dëgjuar prej ministrit të Shëndetësisë, sigurime shëndetësore nuk do të kemi as për vitin 2018, derisa po ndahen 3.5 milionë euro për zëvendësministra dhe këshilltarë të tyre, për kontingjentin për sigurime shëndetësore janë ndarë vetëm 3 milionë euro. Nëse sigurimet shëndetësore nuk do të bëhen këtë vit, atëherë Qeveria është dashur të heqë dorë nga luksi, siç është luksi i blerjes së veturave të reja, sepse shuma për blerjen e veturave zyrtare arrin gati gjysmë milionë euro, vetëm shuma për blerjen e veturave të Kuvendit të Republikës së Kosovës është 130 mijë euro, për Komisionin e Pavarur të Medieve, 60 mijë euro, Zyra e Auditimit 25 mijë euro, blerja e veturave zyrtare 40 mijë euro, blerja e veturave për Ministrinë e Inovacionit, 150 mijë euro. E çka m'u duk absurde, te Kabineti i presidentit, blerja e një aparati fotografik me vlerë 10 mijë euro. Nuk di se për çfarë aparati bëhet fjalë! Në anën tjetër, ne kemi spitale apo qendra të mjekësisë familjare, në të cilat në mungesë të veturave për ndihmë të shpejtë pacientët mund të pësojnë edhe me jetë. Po ashtu, kemi edhe, qoftë spitale, apo qendra të mjekësisë familjare, që kanë mungesë të aparateve të rëntgenit, e në anën tjetër kryetarit të shtetit i dedikohen mjete prej 10 mijë eurosh për blerjen e një aparati fotografik.

Në buxhetin për SHSKUK-në, kemi zvogëlim për mallra dhe shërbime, që në përqindje i bie për 1% më pak. Kemi një rritje për buxhetin për paga dhe mëditje për 9,87%, ku do të punësohen 200 mjekë dhe 100 mjekë, infermierë apo infermiere. Siç e dimë, vetëm kërkesat në QKUK-në, numri për staf të mesëm është shumë më i madh sesa ky numër prej njëqind.

Shpenzimet komunale janë rritur për 12 mijë euro, që në përqindje i bie 1%. Shpenzimet kapitale janë rritur për 5 277 mijë euro, në përqindje është 101%. Kemi shuma të mëdha që janë ndarë për SHSKUK-në, për mirëmbajtje të infrastrukturës spitalore, e që në fakt nuk di se për çfarë mirëmbajtjeje bëhet fjalë. Në Buxhet nuk pashë se janë ndarë mjete për implementimin e Ligjit për emergjenca, për të cilin ligj foli kolegja ime e komisionit, doktoresha Flora Brovina, e është dashur qysh prej janarit të këtij viti që po hyjmë të jetë ndarë në tërësi buxheti për të.

Sa i përket buxhetit për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ministri Hamza këtu para nesh paraqiti si të arritura, se janë ndarë mjete për kategoritë, siç për pensionin familjar dhe për pensionin invalidor. Është mirë që janë ndarë, mirëpo ministër, dihet se ligji faktikisht për pensionet e financuara nga shteti, e dini që ka kaluar qysh në vitin 2014, dhe ky ligj që moti është dashur të implementohet në tërësi. Prandaj, kjo është një kategori që është dashur të implementohet shumë më herët, e mos u krenohuni me këtë se tani këto dy kategori po mbulohen me buxhet.

Thashë në fillim se ky buxhet nuk është i mjaftueshëm, por nëse menaxhohet mirë, atëherë besoj se një buxhet prej 200 milionë eurove do të jetë një buxhet solid për Ministrinë e Shëndetësisë, apo për sistemin shëndetësor në tërësi në Kosovë. Mirëpo, nëse menaxhohet mirë, e shembull të menaxhimit të buxhetit e kemi edhe Komunën e Prishtinës, ku edhe këtu tha disa nga kolegë, apo një koleg që kritikoi, ndonëse me buxhet jo të mjaftueshëm për shëndetësi, e dini se si është punuar në Komunën e Prishtinës, si janë qendrat e mjekësisë familjare.

Ndonëse janë rritur faktikisht shërbimet shëndetësore, nuk është që janë rritur për arsye se sëmundshmëria është rritur, mirëpo janë rritur për arsye se është rritur edhe besueshmëria në institucionet publike. Kjo besueshmëri, që është rritur në institucionet publike, përkatësisht në qendrat e mjekësisë familjare në Prishtinë, unë kërkoj që të rritet edhe në institucionet publike të tjera, siç janë spitalet e përgjithshme në nivel të komunave, apo edhe në Qendrën Klinike Universitare. Tek e fundit, nëse përmirësohen këto kushte, nëse kemi shërbime të mira, janë shërbime që i marrin qytetarët e Republikës së Kosovës dhe janë shërbime që janë në të mirë të shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Krejt në fund, dua të flas edhe për buxhetin, faktikisht për projektet kapitale që janë për komunën e Gjilanit. Meqë vij prej asaj ane, me sa pashë unë, nuk ka projekte të reja për komunën tonë. Janë të gjitha ato projekte që janë vazhdim i projekteve të viteve të kaluara. Pashë këtu që janë ndarë mjete, tha edhe ministri Hamza, për trajtimin e ujërave të zeza për Prishtinë, Fushë-Kosovë dhe Obiliq. Është mirë që janë ndarë këto mjete për trajtimin e ujërave të zeza në këto komuna, por fatkeqësisht, ministër, apo Qeveria nëse e di, Gjilani është shumë keq në këtë drejtim dhe siç e kam parë, për rregullimin e shtratit Mirusha dhe lumit Stanishorka janë ndarë vetëm 300 mijë euro, mjete të cilat janë të pamjaftueshme, e dihet se Gjilani urgjentisht ka nevojë që të ndërtohen impiante për ujërat e zeza.

Po ashtu pashë se nuk ka projekte, sa i përket ndërtimit të shkollave, është vetëm shkolla e Haxhajve. Po besoj që duhet ta dijë, Qeveria e kaluar e ka ditur, ministri i kaluar i Arsimit e ka ditur, që nxënësit e shkollës së Haxhajve janë duke mësuar në një xhami, në një objekt që faktikisht është në kuadër të xhamisë, janë në gjendje shumë të keqe. Me sa pashë, janë ndarë vetëm 130 mijë euro. Po ashtu, është e mirë që janë ndarë mjete për rrugën nacionale Prishtinë - Gjilan - Konçul. Dhe, siç e dini, është bërë bujë e madhe sa i përket kësaj rruge, ndonëse është e vonuar, po mirë që është në buxhet.

Ndërtimi i qendrës, ndërtesës së Institutit të Shëndetësisë Publike në Gjilan...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.)

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Bedri Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, e nderuar nënkryetare, zonja Dërguti!

Deputete Baftiu, faleminderit për diskutimin tuaj!

E thashë që për herë të parë kemi filluar me buxhetimin e tri skemave të reja, nuk e thashë për mburrje, është e vërtetë. Ju thatë që prej vitit 2014 ka qenë kjo, por unë pyes, pse vëlla më keni pritur mua? Pse s'e keni bërë më herët? U desh të bëhet më herët, nëse është dashur, është dashur të bëhet më herët.

E dyta, e lavdërove pak si shumë menaxhimin e Komunës së Prishtinës, por nëse u referohemi të dhënave zyrtare nuk del bash ashtu. Këtu është buxheti i Komunës së Prishtinës, ky është ekzekutimi i projekteve kapitale në Komunën e Prishtinës.

Deputete e nderuar,

Më 2013, ekzekutimi i shpenzimeve kapitale ka qenë 68,5 milionë euro, më 2016 është 58,4 milionë euro, është 10 milionë më pak. Nëse do kishte qenë trend pozitiv, ishte dashur të paktën të jetë nja 20 milionë më shumë se 68 milionë. Nëse e shikojmë raportin e Auditorit, ai thotë se veç nja 58% e shpenzimeve kapitale janë investuar. Ky nuk është kursim. Te shpenzimet kapitale, sot po jua them, sot po jua them edhe kolegëve të mi ministra, çdo mosekzekutim i Buxhetit të kapitalet është mospunë, është mosplanifikim. Prandaj, këtu vjen ajo pjesa kur taksat kthehen më së miri te taksapaguesit. Dhe, këtu e kemi ngecjen më të madhe.

Sa u përket projekteve për ujëra të zeza, dëshiroj të sqaroj se janë edhe disa regjione, është regjioni i Gjilanit, regjioni i Ferizajt, regjioni i Mitrovicës, të cilat ende nuk e kanë të zgjidhur këtë problem. Është kryer studimi i fizibilitetit, jemi në negociata dhe unë jam i bindur që gjatë këtij mandati qeverisës do të sigurohen mjete nëpërmjet financimit prej institucioneve financiare

ndërkombëtare për trajtimin e ujërave të zeza në komunën e Gjilanit dhe në regjionet që i përmenda. Faleminderit!

KRYESUESJA: Replikë, fjalën e ka deputetja Besa Baftiu.

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetare Aida Dërguti!

Zoti ministër,

Ju thatë: “Pse më keni pritur mua?”. Ju e dini shumë mirë se kush ka qeverisur tash e tetëmbëdhjetë vjet pas luftës. Lëvizja “Vetëvendosje” asnjëherë nuk ka qeverisur në nivelin qendror. Ju keni qenë në qeverisje. Nëse ju personalisht jo, atëherë kanë qenë kolegët tuaj që kanë qeverisur dhe menaxhuar me buxhetin tash e tetëmbëdhjetë vjet.

Kur është fjala për Prishtinën, unë e ceka, ministër, për “shërbimet shëndetësore”. Shërbimet shëndetësore dallojnë shumë në komunën e Prishtinës në krahasim me shërbimet që jepen edhe në nivelin terciar, e që nuk do të duhej të ishin në këtë mënyrë, sepse dihet për çfarë është niveli terciar e çfarë është niveli primar. Prandaj, një gjë e tillë ekziston, një gjë e tillë e dinë qytetarët e Republikës së Kosovës, përkatësisht qytetarët e komunës së Prishtinës, për këtë arsye ia dhanë besimin edhe për katër vjet kryetarit Shpend Ahmetit dhe Lëvizjes “Vetëvendosje” që të qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Kundër-replikë, ministri!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, deputete!

Unë veç iu referova të dhënave zyrtare. Do të thotë, nëse flasim për sukses të një qeverie, të një qeverisjeje në nivel qendror a lokal, të një ministrie, më së miri tregojnë të dhënat zyrtare, statistikat, grafikonët dhe kur jemi te ekzekutimi i Buxhetit, këto janë të dhëna zyrtare. Faleminderit!

KRYESUESJA: Fjalën e ka kërkuar deputeti Bekim Haxhiu. Pra, replikë!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar nënkryetare!

E nderuar kolege deputete,

Mendoj që për shëndetësinë më së paku duhet të bëhet politikë. E përgëzova qasjen e Qeverisë së Kosovës për realizimin e kërkesave për specializantë dhe për specialistë të mjekësisë pa dallime politike për nivelin e Kosovës, që është qasje pozitive.

Të thuash që numri i vizitave është rritur për shkak të besimit, e jo për shkak të sëmundshmërisë, atëherë do të thotë është një shkarje profesionale që nuk kisha pasur qejf për qëllime politike, ju e nderuar Besa, të ju shoh të dilni në atë pozicion, sepse njerëzit shkojnë te mjeku kur sëmuren,

sepse për të shkuar për besim shkojnë nëpër xhami e kisha dhe në institucione të tjera. Faleminderit!

KRYESUESJA: Kundër-replikë, Besa Baftiu!

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetare!

Nëse e dini, deputetë, parafolës, e dini që ekziston edhe mjekësia preventive. Besoj se e dini shumë mirë. Unë punoj edhe në sektorin ku na vijnë jo vetëm të sëmurë, por na vijnë edhe fëmijë të shëndoshë, në Neonatologji, kështu që nuk shkojnë te mjeku faktikisht apo të marrin shërbime shëndetësore qytetarët vetëm kur janë të sëmurë, por mund të shkojnë edhe të bëjnë kontrollime sistematike. Prandaj, shërbimet që janë bërë në komunën e Prishtinës është më se evidente që janë shërbime shumë të mira. Për këtë arsye është kthyer besimi i shërbimeve publike shëndetësore te qytetarët. Kjo është esenca e gjithë asaj që e thashë deri më tani. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Abelard Tahiri.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: E nderuar kryesuese,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht dua ta falënderoj ministrin e Financave, zotin Hamza, për konsideratën e treguar në lidhje me kërkesat buxhetore për vitin 2018, për Ministrinë e Drejtësisë dhe për kërkesat e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Spektori i Drejtësisë në Kosovë, pavarësisht përkrahjes së vazhdueshme politike dhe të arriturave që ka shënuar, ka nevojë për rikthim të fuqishëm në vëmendjen tonë, për t'i ofruar mbështetje në mënyrë që të arrijë progres të matshëm.

Në vitin 2017, i gjithë sektori i drejtësisë ka pasur buxhet kumulativ prej 52 milionë eurosh. Këto mjete financiare kanë mundësuar menaxhimin e ndarjeve sektoriale, si të Ministrisë së Drejtësisë, ashtu edhe të Këshillit Gjyqësor dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Kjo shumë e cekur si më lart nuk ka rezultuar të jetë e mjaftueshme për t'i adresuar sfidat e sistemit tonë të drejtësisë dhe përgjegjësitë e shtuara.

Të nderuar deputetë,

Jam shumë i lumtur që në kuadër të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 është paraparë rritja më e madhe buxhetore, që ka pasur ndonjëherë Spektori i Drejtësisë, sipas të cilit projektligj parashihet vlera e përgjithshme nga 52 milionë, sa kemi pasur në vitin 2017, të jetë në 61 milionë për vitin 2018. Pra, Ministria e Drejtësisë si institucion politikëbërës për sistemin e Drejtësisë, si dhe ministria që harton numrin më të madh të ligjeve dhe koncept-

dokumenteve, do të ketë rritje prej 7% ,nga 20,8 milionë të vitit 2017, në 22,2 milionë për vitin 2018.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të ketë rritje për 8,3%, nga 21,7 milionë sa ka qenë, në 23,5 milionë për vitin 2018. Këshilli Prokurorial i Kosovës ka pësuar rritjen më të lartë, pra prej 17%, nga 9,5 milionë euro, sa ka pasur në këtë vit, do t'i ketë 11,1 milionë për vitin që po hyjmë, pra për vitin 2018. Po ashtu, edhe sektorët tjerë, si Akademia e Drejtësisë, Ndihma Juridike Falas, marrin mbështetje të shtuar financiare prej 13%.

Të nderuar deputetë,

Rritja e buxhetit të Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës nuk ka qenë negociim i Buxhetit me ta, mirëpo ka qenë plotësim i nevojave të tyre. Pra, aq sa janë kërkuar mjete financiare nga këta dy këshilla, aq është ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Kjo i bie që për vitin 2018, ju kërkoj falje se paraprakisht e kisha një takim me deputetët e Komisionit për Legjislacion dhe u thashë që numri i shtesë i bashkëpunëtorëve profesionalë do të jetë 960, e kam bërë një gabim, do të jetë 690, e jo 960, kështu që ju kërkoj ndjesë, prandaj kjo është rritja më e ndjeshme që ka ndodhur në sistemin e Drejtësisë deri më tani.

Me këto mjete do të ketë pra rritje të numrit të gjyqtarëve dhe stafit profesional, do të ketë numër më të madh të prokurorëve dhe po ashtu numër më të madh të stafit mbështetës për prokurorë. Pastaj, do të kemi numër më të madh të zyrtarëve korrektues, që mundëson funksionalizimin e plotë të Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Të nderuar deputetë, të pozitës dhe të opozitës, ju ftoj që ta miratoni këtë projektligj, sepse vërtet ka ndodhur një rritje sinjifikante për sektorin e sundimit të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zonja kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Me një analizë të thjeshtë të këtij Projektligji për Buxhetin e Kosovës për vitin 2018 vërehen mjaft të meta, që po e shoqërojnë mendësinë e spektrit politik në këto dhjetë vjetët e fundit. Logjikë lokaliste, provincializma klasikë, ndarje buxhetore pa objektiva të qarta, ndarje buxhetore me logjikë partiake për dikastere të rëndësishme dhe institucione të rëndësishme të dorës së parë, mospërputhje me financim adekuat të fushave të rëndësishme, që janë edhe prioritete të Qeverisë aktuale, si arsimi, shkenca dhe sektori i shëndetësisë. Mbizotëron ende logjika e asfaltit me mbi 41% të Buxhetit që investohet në autostrada, e jo e një mendësie të një koncepti zhvillimor të projektuar dhe analizuar saktë për zhvillimin ekonomik dhe për një perspektivë më të mirë për vendin.

Zaten, kur e analizojmë përbërjen e brishtë dhe tejet heterogjene të këtij koalicioni qeverisës, me një shumicë parlamentare minimale, me appetite ballkanase të partnerëve të koalicionit, me një përbërje glamuroze dhe kundër logjikës reformuese të një diete të nevojshme financiare për rrethanat që aktualisht po kalon vendi, me numrin më të madh të ministrive nga të gjitha vendet e kontinentit, me numrin më të madh të zëvendësministrave sesa keni numër të deputetëve të koalicionit qeverisës, që vërtet është për rekord të Ginisit. Emëruesi i përbashkët i këtij projektligji me pritjet e qytetarëve, shpresës për një jetë më të mirë dhe për hapjen e perspektivës është baras me dëshpërim dhe vazhdim i klimës depresive për shtetin më të ri në Evropë dhe popullsinë më të re në kontinent.

Ky projektbuxhet do të duhej të fokusohet së pari në kryeqytetin e vendit tonë, në Prishtinë, si qendra me koncentrimin më të madh të popullsisë, si qendër diplomatike, akademike, kulturore dhe universitare, e në veçanti në konceptin zhvillimor dhe të investimeve kapitale, që do të ishte fillimi i financimit nga grantet qeveritare i unazës së jashtme dhe të brendshme të kryeqytetit dhe pastaj të shikoheshin mundësitë e kreditimit të këtyre projekteve në vazhdimësi, të një rëndësie shumëdimensionale për kryeqytetin, që do të pasohej edhe me planifikimet tjera të zhvillimit ekonomik, që do të hapnin rrugë nga këto dy projekte të mëdha e, në veçanti, koncentrimin e zonave industriale për investitorët potencialë dhe inkubatorët e rinj për zhvillimin e bizneseve.

Duhet ta instalojmë një standard qeverisës normal, një kulturë institucionale, pa marrë parasysh kush qeveris me kryeqytetin. Thjesht, kryeqyteti ta ketë vendin meritator, sepse aty edhe është koncentrimi më i madh i banorëve të Republikës.

Ky projektbuxhet do të vazhdojë të financojë edhe më tej projekte të filluara nga qeveritë e kaluara për autostradat në drejtim të Shkupit dhe të Luginës dhe rrugëve tjera regjionale. Në këtë kontekst, kërkoj që edhe në projeksionet buxhetore të ndara për Rrafshin e Dukagjinit të bëhet një lidhje e komunave edhe më të vogla me autostradat nacionale, e në veçanti transiti Klinë - Gurrakoc të ndërtohet në një trase jashtë vendbanimeve dhe ta lidhë Istogun me akset rrugore nacionale.

Unë tani e kam një apel për kryeministrin. Rruga e filluar tashmë nga komuna e Pejës, Pejë - Majë e Zezë - Shtupeq, që lidhet me pjesën tjetër të Bjeshkëve të Rugovës, është projekt me rëndësi të madhe për atë zonë dhe që vazhdon në projeksionet buxhetore për vitin 2018, por që keni e zvogëluar dukshëm buxhetin për këtë projekt. Dhe, jo vetëm për Pejë dhe Istog, apo Viti dhe Podujevë, por edhe për komunat e tjera keni bërë shkurtime dhe reduktime buxhetore joracionale dhe mbase të kundërligjshme.

Si mund të hiqen ose të përgjysmohen mjetet për vitin që pason, kur ka filluar një shkollë në këtë vit, është planifikuar të mbarojë në vitin 2018, apo fillim të vitit 2019, dhe kjo kontratë, tani e autorizuar nga komuna me operatorin ekonomik, zgjatet deri në vitin 2020, apo 2021. Kërkoj me

urgjencë që këto projekte që kanë qenë në linjë buxhetore dhe ka pasur nënshkrim të memorandumit të ministrave dhe ministrive të linjës me komunat, të rikthehet në pozicionet financiare, ashtu siç kanë qenë.

Këtë po e ilustruj me fakte. E kam këtu përpara projektin Palestra e Sportit Istog, për të cilin në memorandum janë paraparë 300 mijë euro, pra kanë qenë të parapara komplet 600 mijë euro, dhe janë ndarë në rishikim të Buxhetit vetëm 210 mijë euro dhe për vitin 2018 vetëm 100 mijë euro. Kësaj palestere, që u bë histori, do t'i zgjatet jeta edhe për gati dy vjet. Kjo është thjesht e pakuptimtë dhe kërkoj me urgjencë që ky projekt të kthehet në alokimet themelore, që në njëfarë forme janë zyrtarizuar ndërmjet ministrisë së linjës atëherë, dhe kryetarit të Komunës.

Po ashtu, me rishikim nga 20 mijë euro për sallën e edukatës fizike në fshatin Vrellë janë alokuar vetëm 4 mijë euro, kurse total projekti financohet për këtë vit vetëm në 100 mijë euro, e kanë qenë të parapara 250 mijë euro. Thjesht, kërkoj që kjo vazhdimësi e projekteve në mënyrë ligjore dhe institucionale të vazhdojë edhe më tutje. Po ashtu, duhet ta kenë parasysh se aksi më i rëndësishëm rrugor, që do të gjeneronte zhvillim ekonomik, turizëm, agroturizëm, zhvillim të industrisë ushqimore, mbetet rruga Pejë - Kuqishtë - Çakorr, që e përshkon rrjedhën e Lumit Lumbardhë dhe kanionin me bukuri të rralla të Bjeshkëve të Rugovës, që është rrugë e karakterit ndërshtetëror, që, për mendimin tim, por edhe të shumë ekspertëve të këtyre fushave, është arteria kryesore me inpute zhvillimore, jo vetëm për Pejë me rrethinë, por për komplet Rrafshin e Dukagjinit.

Rikonstruimi i kësaj rruge me parametra modernë nuk kushton më tepër se 10-12 milionë euro, sipas ekspertëve të fushës, e që do të hapte perspektivë të madhe zhvillimore për Rugovën, Pejë dhe komplet për atë zonë. Po ashtu, edhe rruga për Bjeshkët e Mognës si projekt ndërkomunal ndërmjet Istogut dhe Zubin-Potokut, me financim të pjesshëm nga BE-ja, do të duhej ta kishte përkujdesjen dhe mbështetjen buxhetore të Qeverisë dhe me këto dy projekte nga Mognë deri në Rugovë do të ndryshonte shumë pozitivisht klima investive dhe zhvillimore për komplet atë regjion.

Arsimi vazhdon të mbetet brengë dhe shqetësim i madh për vendin tonë. Në një vend ku ka më shumë universitete publike se shkolla profesionale, perspektiva e asaj rinie është e zyrtë. Buxheti i ndarë për sferën e Arsimit nuk është premtues dhe nuk jep fare shpresë. Është zvogëluar për 40% financimi i zhvillimit të kurrikulave, që është hap konkret drejt reformës dhe ngritjes së cilësisë në arsim.

Kërkoj që me urgjencë të sillet Ligji për arsimin e lartë në procedurat e plotësim-ndryshimit, në mënyrë që t'u hapet rrugë zhvillimeve dhe reformës substanciale të këtij sektori vital për vendin. Duhet ndarë mjete shtesë për një projekt nacional, ku do të merrnin pjesë të gjithë, përfshirë prej presidentit të vendit e deri te zyrtari më i thjesht i Arsimit, sepse në qoftë se vazhdojmë duke

prodhuar njerëz me diploma, që është vetëm letër dhe jo konform kërkesave të trendeve moderne të tregut të punës, atëherë vërtet nuk mund të dalim nga pozita zero dhe nga një degradim enorm që politika ia ka bërë sistemit të Arsimit në vend.

Shëndetësia, me gjithë një rritje të vogël buxhetore, është vetëm 3% e GDP-së, ndërsa rajoni i ka 6% të GDP-së, andaj me gjithë rritjen simbolike për listën esenciale të barnave, do të vazhdojë prapë avazi i vjetër.

Fondi i Sigurimeve Shëndetësore pa shpresë se do të mund të fillojë pothuajse deri në vitin 2020. Janë ndarë vetëm 3 milionë euro për këtë fond, që do t'i shpenzojë administrata dhe logjistika e tij, sepse për cilësinë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore as që bisedohet, me këto mjete buxhetore.

Sistemi informativ shëndetësor duhet të realizohet dhe të implementohet në tërësi, të koordinohet edhe me SIFI-n, sepse këto janë dy shtyllat kryesore që mundësojnë që një sistem bashkëkohor shëndetësor të vazhdojë trendet normale.

I propozoj Komisionit për Buxhet dhe Financa t'i marrë në konsideratë këto propozime dhe të analizojë segmente të tjera të këtij projektligji që kanë mjaft mangësi.

Tek e fundit, buxheti është i qytetarëve, as i pozitës, as i opozitës dhe si të zgjedhur të popullit kemi obligim ta ndajmë në mënyrë proporcionale dhe në interes të publikut të gjerë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nezir Çoçaj, ndërkohë le të përgatitet deputetja Time Kadrijaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të paraqes disa çështje lidhur me buxhetin, edhe pse në parim do ta përkrah dhe do ta mbështes këtë buxhet, por kam disa vërejtje që mendoj se duhet t'i kenë parasysh si ministri për Financa, gjegjësisht ministrat e linjës si dhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Ndër çështjet e para që do të paraqes është rruga që lidh fshatrat e komunës së Prizrenit, gjegjësisht të Hasit të Prizrenit me atë të Gjakovës, e cila është një rrugë që ka deformime të shumta, ndërsa për vitin buxhetor 2018 janë të ndara rreth 50 mijë euro, për të cilat unë mendoj se nuk do të mjaftojnë, për arsye se kjo rrugë është rreth 43 kilometra, ndërlihd pra dy komuna, të cilat duhet të riparohen edhe tri ura të vogla, gjegjësisht ato duhet të zgjerohen.

Duke pasur parasysh takimin e dy qeverive që është mbajtur në Korçë ditëve të fundit, me marrëveshjen parashihet të ketë edhe një pikë të re kufitare në mes të fshatit Mariq, gjegjësisht të fshatit Gorozhub të komunës së Prizrenit.

Po ashtu lidhur me rrugët, unë mendoj se është shumë e nevojshme zgjerimi me korsi të reja të rrugëve Arbanë-Xërxë, gjegjësisht Zhur-Dragash, sepse qarkullimi në këto rrugë është i ngarkuar, gjegjësisht rruga në drejtim të Dragashit sidomos në zezonën e dimrit është vështirë e kalueshme.

Ajo që më duhet të potencoj sot është, edhe pse kohë më parë kam parashtruar pyetje parlamentare për kryeministrin, gjegjësisht ministrin përkatës, ka të bëjë me eksplorimin e egër të rërës dhe zhavorrit që ka deformuar shtratin e lumit Drini i Bardhë, si dhe ka përmblytur shumë hektarë tokë bujqësore dhe shumë pjellore.

Unë shpresoj shumë që Qeveria Haradinaj gjatë këtij mandati do të gjejë buxhet, edhe pse jam shumë i vetëdijshëm se kërkohet një shumë e konsiderueshme për rregullimin e shtratit, mirëpo duhet ta kemi parasysh që Drini i Bardhë ndërlidh shumë komuna, shumë fshatra dhe toka është shumë bujqësore.

Në aspektin e atraksionit turistik kemi të bëjmë me Pashtrikun dhe unë mendoj se banorët që jetojnë përreth Pashtrikut duhet ta shfrytëzojnë edhe pasurinë natyrore dhe këtë bukuri të rrallë natyrore që e kemi ne.

Unë mendoj se Qeveria duhet të fokusohet dhe të investojë në Kalanë e Fregnit, besoj se ministri i Kulturës në parim e ka mbështetur dhe e përkrah, por do ta shohim sa do të ketë realizim buxhetor për këtë projekt.

Po ashtu shpresoj shumë që edhe të rritet mundësia të qasjes në Pashtrik, në malin e Pashtrikut nëpërmjet asfaltimit të rrugëve. Besoj që shumica e kolegëve e dinë, sidomos ata që kanë qenë pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare që një numër apo mund të them rreth 80% të ushtarëve të UÇK-së kanë kaluar nëpër këto pika kufitare dhe e dinë rëndësinë e malit të Pashtrikut.

Unë shpresoj shumë që do të ketë qasje nga fshati Planej dhe fshati Kuzhnin, rruga përfaqësisht nga fshati Kuzhnin është 10 kilometra dhe po aq është edhe nga fshati Planej.

Dua ta përmend edhe një gjë, që është e nevojshme në fshatrat e Hasit të Prizrenit, është investimi në stadiumin e shkollës së futbollit “Drini i Bardhë”, e cila si shkollë futbollit ka katër grupmosha, të cilat garojnë në gara të ndryshme, por që fatkeqësisht në mungesë të stadiumit apo të fushës së futbollit shumë ndeshje i zhvillojnë nëpër stadione relevante në Prizren, Arbanë, apo diku tjetër.

Unë dua t'i jap mbështetje Ministrisë së Arsimit, gjegjësisht të asaj që Qeveria, edhe pse ka bërë një rritje simbolike të buxhetit për arsim, i cili për fat të keq nuk mund të ketë ndonjë rezultat në këtë mandat qeveritar, gjegjësisht në vitin 2018, sepse situata në arsim mendoj se të gjithë e dimë çfarë është.

Unë shpresoj shumë, duke pasur parasysh edhe ministrin dhe interesimin e ministrit që të kemi një sistem apo një mësim tërëditor, unë besoj që duhet një numër i konsiderueshëm i godinave shkollore, gjegjësisht parashkollore dhe çerdheve të investohen anekënd Kosovës me qëllim të përmirësimit të cilësisë në arsim, pra të mësimin gjithëditor.

Po ashtu e dimë përafërsisht edhe përgatitjen profesionale të arsimtarëve, e cila bëhet në fakultete, e sidomos nevojat për trajtimin permanent të tyre që mund të bëhen nga organizatat e ndryshme buxhetore, gjegjësisht nga buxheti që Ministria e Arsimit mund dhe duhet të ndajë.

Në anën tjetër, ne e dimë rëndësinë që hulumtimet dhe kërkimet shkencore në arsim luajnë rol të rëndësishëm dhe politikëbërësi nuk mund të marrë asnjë vendim pa u bazuar në këto hulumtime dhe kërkime shkencore, por që fatkeqësisht janë të mangëta dhe po ashtu në buxhet u pa që nuk do të kenë mbështetje as universitetet publike, as institucionet, siç e dimë rastin kur Instituti Pedagogjik i Kosovës ka bërë një kërkesë të rritjes së buxhetit për rreth 60 mijë euro që ta paguajë stafin, një staf profesional që mund t'i ndihmojë shumë edhe ministrinë, gjegjësisht drejtoritë komunale dhe shkollat përkatëse.

Unë po ashtu dua të shtoj çështjen e Ministrisë së Inovacionit, po mendoj që është diçka shumë e mirë që Kosova e ka themeluar apo e ka ngritur një ministri të tillë, por nuk shpresoj shumë nga buxheti që është i përcaktuar për këtë ministri. Dua t'u them të gjithë kolegëve, duhet t'i them edhe ministrit, sepse qenke i vetmi ministër që po më dëgjon, se të tjerët ndoshta kanë edhe punë më të madhe.

Me kërkimet që i kanë bërë në internet shumë qeveri bazohen te Ministria e Inovacionit dhe kjo ministri do të luajë rol kryesor.

Ne e dimë të gjithë, ne kemi një rini të mrekullueshme, ne kemi një rini që ka shumë ide të mira, të mrekullueshme, por për fat të keq nuk kanë buxhet se si t'i realizojnë këto ide që janë shumë praktike, shumë kreative.

Unë shpresoj shumë që kjo ministri do të luajë një rol të rëndësishëm dhe do ta ketë mbështetjen edhe të deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj, ndërkohë le të përgatitet deputeti Bilall Sherifi.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Për herë të parë buxheti këtë vit do të jetë mbi 2 miliardë, për të cilën edhe përgëzoj Qeverinë për këto të arritura, dhe e falënderoj ministrin në një takim paraprak që e kemi pasur bashkë me grupin parlamentar dhe në mënyrë të detajuar na ka shpjeguar rritjet që i ka buxheti qoftë në nivelin qendror, apo në nivelin lokal edhe rritjen në bazë të prioriteteve dhe programit të Qeverisë.

Buxheti reflekton kërkesat e agjencive buxhetore, ashtu si janë paraparë, është i hartuar në bashkëpunim me FMN-në, shpërndarje e drejtë me shumë projekte reformuese, rritje ekonomike stabile dhe ka lehtësi të reja për prodhuesit dhe përpunuesit vendorë, rritje të pagave, financim për ndihma sociale dhe kategorive të dala nga lufta.

Po më duket që këtë vit vërtet shëndetësia do të jetë prioritet i kësaj Qeverie dhe kjo po shihet me ndihmën në vazhdim të sektorit shëndetësor për barna nga lista esenciale dhe vija të tjera.

Është punë e mirë se me këtë buxhet do të bëhet pagesa e specialistëve dhe e shumë specialistëve, si një breng e vazhdueshme, sepse specialistët në ndërkohë është dashur të paguajnë nga xhepi i vet për të vazhduar specializimin, sepse për një periudhë kohore u është paguar specializimi, por për një periudhë tjetër jo.

Po më vjen mirë që ka rritje të vendeve të reja të punës edhe për shumë specialistë, sepse ju e dini që e kemi një hall me specialistë të shumtë të cilët janë të papunë dhe kjo ka qenë një padrejtësi që u është bërë specialistëve, sepse Kosova, shteti më i varfër në rajon, ka prodhuar kuadro të larta arsimore dhe këto kuadro në pamundësi për t'u përfshirë në punë në vendin edhe ku edhe janë specializuar, janë detyruar të migrojnë në vende të tjera të Bashkimit Evropian dhe për një jetë më të mirë e më të dinjitetshme, për shkak se Kosova së paku është dashur t'u afrojë një vend pune.

Në vitin 2018 kemi rritje 22% në nivelin qendror, ndërsa për barna esenciale kemi 36%, që është një lajm i mirë edhe për institucione shëndetësore, edhe për punëtorët shëndetësorë, edhe për popullatën, sepse tash furnizimi me barna dhe citostatikë do të jetë dukshëm më i mirë dhe qytetarët nuk do të detyrohen që këto barna t'i blejnë nga xhepi i cekët, sepse është e papërbalueshme për një qytetar të Kosovës të blejë një citostatik, për shkak se ka një kosto të lartë buxhetore dhe është e pamundshme të përballohet ajo kosto.

Rritje të buxhetit ka edhe në arsim, në bujqësi dhe po mendoj që subvencionet këtë vit do të shkojnë aty ku ka nevojë dhe nuk do të ndahen aty ku nuk ka nevojë.

Kemi rritje për çështje sociale 20% dhe i kemi 3 skema të reja sociale: janë personat e paaftësuar për vende të punës, persona paraplegjikë dhe i kemi personat e dhunuara gjatë luftës, një milion euro, e paga mujore për atë kategori do të jetë 230 euro.

Sigurimet shëndetësore: është ndarë një buxhet, por shpresojmë se ministri i Shëndetësisë dhe Qeveria vërtet do të punojnë me përkushtim që këtë vit të fillojë implementimi i ligjit të sigurimeve shëndetësore, sepse ka shumë vjet që ligji është miratuar, po nuk po implementohet.

Janë 48 milionë grante për shëndetësi në nivel qendror, grante për shëndetësinë komunale, pagesat e specializantëve dhe buxhet për punësim të 200 specialistëve.

Pastaj, buxheti në nivel qendror, prioritet është rendi dhe ligji. Iniciativë e mirë, sepse në çdo Raport Progresi e kemi kërkesë të luftohet krimi dhe korrupsioni. Një fenomen i cili është në rritje, kjo rritje do të shkojë për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial dhe për Ministrinë e Drejtësisë dhe Policinë. Do të ketë rritje të punëtorëve, 700 punëtorë, dhe në këtë rast këto dikastere nuk mund të ankohen kur grumbullohen lëndët e patrajtuara, për shkak se e kanë mundësinë e punësimit të punëtorëve dhe ato lëndë që kanë qenë afro gjysmë milioni, duhen të pakohen dhe në mënyrë rekord të trajtohen.

Buxheti është shpërndarë në mënyrë proporcionale nëpër komunat e Kosovës.

Dhe, në fund, lajm i mirë që tash e tutje veteranët janë në vijë të rregullt buxhetore dhe më nuk do të ketë ndalje dhe as vonesa në pagesat e tyre.

Sa i përket komunës së Deçanit, Deçani ka aplikuar me shumë projekte, po në fakt, ato projekte nuk janë përfshirë në këtë projektbuxhet dhe ne gjatë dy leximeve do të amendamentojmë plot çështje, të cilat besoj që në Komisionin Parlamentar për Buxhet do të merren parasysh.

Është zgjerimi i qendrës së qytetit nga ura e Demës në Carabreg.

Asfaltimi i rrugëve Strelle i Epërm - Drenoc - Gramaçel - Rastavicë. E kemi edhe asfaltimin e rrugës nacionale Manastir-hidrocetrali Lumbardh-Deçan dhe e kemi ndërtimin e një shkolle në Llukë të Epërme, që është shkolla fillore "Verrat e Llukës", sepse ajo është një shkollë shumë e vjetër dhe vërtet nxënësit që mësojnë në atë shkollë punojnë në kushte mjaft të vështira dhe nëse nuk intervenohet aty, nxënësit mund të goditen, sepse shkolla është në një gjendje mjaft të keqe.

Andaj, ne do e përkrahim buxhetin dhe mendoj që ndërmjet dy leximeve këto amendamente të përkrahen. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bilall Sherifi, ndërkohë le të përgatitet deputeti Rexhep Selimi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesuese!

Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

E mora fjalën që t'ï them disa fjalë në funksion të një takimi që e kam pasur, besoj që edhe disa kryetarë të tjerë të grupeve parlamentare e kanë pasur me një delegacion të Komitetit Olimpik të Kosovës, të cilët na kanë lutur që grupet parlamentare të japin një mbështetje më të madhe në Projektligjin për buxhetin në avancimin dhe mbështetjen e sporteve në përgjithësi në Kosovë.

Shqetësimet që ata i ngritën në takim ishin serioze dhe unë u premtova se në emër të Grupit Parlamentar të "Nismës" do të angazhohemi që të bëjmë ç'është e mundur e të kërkojmë edhe nga ministri i Financave, edhe nga kryeministri, edhe nga Qeveria në përgjithësi që në mes të dy leximeve çështjes së sporteve t'ï kushtohet më shumë rëndësi. Shqetësimet që ata i ngritën vërtet ishin serioze, siç thanë, në mungesë të mbështetjes financiare kemi edhe shuarje të tërësishme të klubeve, madje edhe me traditë dekadash dhe mendoj që derisa të rregullohen disa çështje, ku sporti do të mund të jetonte nga mbështetja e bizneseve, nga sponsorizimet apo nga forma të tjera, është mirë që më shumë kujdes t'ï kushtohet edhe në Buxhetin 2018, po edhe për vitet e tjera vijuese, derisa të krijohen, si thashë, burime të tjera alternative më të mëdha që do ta mundësoni financimin e sportit.

Meqë kur po ka suksese, siç janë rasti i Majlindës dhe Norës, politikanët po vrapojnë të bëjnë 'selfi' dhe të reklamojnë më shumë veten se sa sportistët që i kanë realizuar ato suksese. Është mirë që edhe këtu ku kemi pushtet, ku kemi mundësi të marrim vendime, të cilat do të shkonim në ndihmë të arritjes së sukseseve, të rritjes së sukseseve të tyre, është mirë që të bëjmë diçka më shumë për ta, sepse fundja, sportit të gjithë e dimë që e mban rininë larg rrugëve të gabuara, mundëson që të kemi edhe një shëndet më të mirë, por është edhe një investim afatgjatë, i cili edhe në aspektin financiar në të ardhmen mund të kthehet, t'u kthehet edhe klubeve, por edhe vendit në përgjithësi.

Unë e ndjeva si obligim që atë që e kemi biseduar në takimin me ta, ta them këtu në seancë dhe të jap publikisht zotimin e "Nismës" se do të angazhohemi për aq sa kemi mundësi që sporti në përgjithësi në Kosovë të mbështetet më shumë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi, ndërkohë të përgatitet deputeti Armend Zemaj.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk mund të mos e përmend se shpeshherë po më bie që çdo trajtim buxhetor gati të njëjtat probleme t' i kemi dhe nuk e kam ndërmend të heq dorë sa herë të vijnë të njëjtat probleme t' i identifikoj si të tilla.

Kemi dëgjuar që qeverisja është ndryshe, qeveria me ta është ndryshe, por po duket që qasjen e ka goxha të njëjtë me qeveritë paraprake, e sidomos sa u përket disa çështjeve që unë kam pritur që do të ketë qasje ndryshe.

Por, duhet të fokusohet në disa aspekte. Nëse Kuvendit i ka ardhur një plan legjislativ, një agjendë legjislative, një strategji legjislative, ku do të kemi ligje të caktuara në të ardhmen të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës, do të duhej që këto të përcilleshin edhe me parashikime buxhetore.

Unë e di që nuk keni mundur, edhe pse nuk jam i fushës së financave dhe planifikimit të buxhetit, por edhe e di që ndoshta s'keni mundur t' i parashihni saktësisht implikimet buxhetore për ato ligje, por ma merr mendja, është dashur të konsideroni që nëse nuk është paraparë që, ta zëmë, për Ligjin për pensionim të parakohshëm të policëve të Kosovës, atëherë ne presim që së shpejti ky ligj të miratohet në Kuvend dhe, po e zëmë, mund të dalim me një procedurë të shpejtë po e them një shifër gjithsesi jo të saktë, po të përafërt, rreth 2 000 policë.

Nëse 2 000 policë dalin në pension përnjëherë, kjo është barrë buxhetore, 2 000 pensione më shumë do t' i kesh.

Përveç kësaj, aty ku dua të fokusohem tash, është që këta 2 000 policë që dalin në pension do të duhej të zëvendësoheshin me policë të rinj dhe do të ketë implikime buxhetore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike menjëherë.

Pra, nuk e pashë që është paraparë një buxhet shtesë ose i caktuar për këtë në Akademinë e Sigurisë Publike, pra, e cili do të merrte përsipër me një infrastrukturë krejt më të madhe dhe më të përgatitur regrutimin e policëve, të cilët duhet të zëvendësohen. Zëvendësimi i policëve nuk pret shumë, për shkak se ky ka të bëjë drejtpërdrejt me sigurinë publike në Kosovës, sepse policia nuk mund të presin që të mos zëvendësohen në Policinë e Kosovës.

Dhe, njëkohësisht po ashtu implikimi i tretë është që edhe këta policë nuk do të punojnë pa para me Policinë e Kosovës.

Pra, do të doja që ta kishit planifikuar dhe ta kishit përshkruar, nëse s' e keni përshkruar, atëherë besoj që në ndryshimet, ose plotësim-ndryshimet ose në rishikimin e buxhetit në qershor, nuk e di se si do të menaxhohej kjo punë, po unë e pashë që nuk është paraparë kjo.

Edhe jo vetëm për këtë projektligj, i cili shpejt do të bëhet ligj, po ka edhe projektligje të tjera, të cilat do të kenë implikime buxhetore dhe nuk i pashë.

Por, ajo që më duhet ta përsëris prapë sa i përket FSK-së. Sa i përket FSK-së edhe unë kam pritur jo qasje të njëjtë me qeveritë paraprake dhe kam mbështetur besimin tim që nuk do të kemi qasje të njëjtë edhe në aspektin financiar.

Ta zëmë, nesër piqen kushtet që FSK-ja të shndërrohet në Forcë të Armatosur dhe seriozisht nuk e di se si me të njëjtën planifikim buxhetor mund të planifikohet edhe të ketë rritje të kapaciteteve as të FSK-së, nëse ka ndryshime ligjore, e as të Forcave të Armatosura të Kosovës, nëse ka ndryshime kushtetuese.

Prandaj, do të donim që thjesht të kishim trajtim më serioz dhe parashikim të buxhetit. Unë e di që edhe mund të ketë zëvendësime nga një linjë buxhetore në tjetrën, po të ketë kaq shumë, mendoj që do të duhej të ishin planifikuar më herët.

Pra, ajo çka unë e pres që të ketë qeverisje ndryshe, nuk e pashë në planifikimin e buxhetit, sepse njëjtë po trajtohen edhe çështjet e sigurisë, njëjtë asfalt, shpresoj që buxheti të mos e ketë fatin e buxheteve të kaluara në aspektin e grabitjes së buxhetit, por po ashtu shpresoj që Qeveria të mos ketë fatin e qeverive të kaluara.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj, të përgatitet deputeti Memli Krasniqi.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Kolegë deputetë,

Kryeministër,

Ministra të pranishëm,

Buxheti i shtetit në vendet demokratike pretendon të avancojë politikat zhvillimore, thënë më mirë, të synojë avancimin e shoqërisë duke iu përshtatur rrethanave dhe kërkesave të kohës, me qëllim që jeta e qytetarëve të bëhet më e mirë, që infrastruktura të përafrohet me modernizmin, apo që vendi të bëhet i dashur për qytetarët, duke u rikthyer taksat e tyre në përmbushjen e kushteve elementare nga shteti në të cilin jetojnë.

Projektligji për buxhetin, të cilin po e shqyrtojmë sot, edhe pse shumë pak kohë nga trajtimi i rishikimit të buxhetit të vitit 2017, i cili u kundërshtua me tendencën formale të ndryshimeve të dobëta, tregon qartë se edhe ky projektbuxhet është vazhdim i nisur apo pasqyra e vërtetë e mashtrimeve numerike pa politika esenciale, pa përmbajtje të avancimit kolektiv të shoqërisë dhe, ajo që është njolla më e keqe, e papërgjegjshisë së këtij koalicioni është mungesa

programore, mbi bazën e së cilës do të kishim projeksione të qarta për një zhvillim ekonomik të vendit tonë.

Këtu, në këtë buxhet, na flet koalicioni qeverisës, jo vetëm ministri apo kryeministri. Këtu na flet logjika qeverisëse, na flet luksi qeveritar, komoditeti, bajraktarizmi në ndarjen e të hyrave buxhetore, parcializimi i synimeve individuale në dikastere me interes tenderomanie, joshja elektorale, na flet logjika e shantazhit ndaj kategorive sociale, invalidëve dhe veteranëve të luftës, viktimave të dhunës seksuale, pensionistëve të moshës, personave me aftësi të kufizuara, familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, pensionistëve të Trepçës, pensionistëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, sepse me Projektbuxhet 2018 këta do të përfitojnë më pak se 4 euro në ditë, sepse kjo qeveri me këtë buxhet është kujdesur që të sigurojë rritje në kategorinë e mallrave të shërbimeve, duke bërë akomodimin e qeverisë më të madhe në rajon e më gjerë. Sidomos numrin e të ashtuquajturve ‘legjenda të gjalla’ që tash quhen ‘zëvendësministra’ dhe kuptohet, stafin e tyre të stërzgjeruar.

Prandaj, ata që ushqejnë shpresë se kjo qeveri mund të bëjë ndryshime është e gabuar, sepse ligji më i rëndësishëm vjetor, siç është Buxheti i Republikës së Kosovës, i cili do të duhej të siguronte zhvillim ekonomik, të ulë shpenzimet e luksit qeveritar, e jo t’i rritë, të zvogëlojë informalitetin dhe të rritet buxhetin, ku qartë shihet nga projeksionet se kemi ulje në planifikimin e të hyrave, ku shpëlarja e parave do të parandalohej, e jo të vazhdohej. Me një fjalë, ky buxhet do të përkufizohet si buxhet shpenzues dhe konsumues për luksin qeveritar, i paperspektivë dhe i pashpresë për një jetë më të mirë të qytetarëve.

Të nderuar kolegë deputetë, mund të tingëllojmë si zëra opozitar, por ky dokument i paraqitur nuk na lejon që së paku të shohim diçka pozitive nga zotimet e proklamuar nga koalicioni qeverisës. Do të isha shumë i kënaqur që të ofroj përkrahjen tonë, që aty ku mundemi të bëjmë përmirësimin e nevojshëm në avancimin e ideve progresive, por me kaq dobësi në zotimet e marra për ndryshime të politikave zhvillimore është shndërruar në jozhvillimore, që prodhon vetëm afëra korruptive, diskrepancë në llogaridhënie, me një fjalë, ofruet i keqpërdorimit të taksave publike.

Do të theksoja dy arsye përmbajtjesore pse nuk duhet përkrahur këtë projektbuxhet. Janë dy dikastere të rëndësishme që tregojnë logjikën se sa përkrahet një shtet ligjor dhe konkurrent në fushën e sigurisë me vendet e rajonit.

Si mund të kemi stabilitet financiar, zhvillim të vendit, ku me këtë buxhet nuk krijohen kushte që nëpërmjet ngritjes së infrastrukturës dhe kapaciteteve të organeve të sigurisë, të luftohet informaliteti financiar, shpëlarja e parave, luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe, ajo çka është synim primar, transformimi i Forcave të Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Republikës së Kosovës.

Kërkesat e vazhdueshme dhe të arsyeshme të Policisë së Kosovës, nga ajo çka është ndarë me këtë buxhet janë minimale, me të cilat nuk krijohen kushte pune dhe siguri në kryerjen e detyrave policore. Nga ajo që shihet, tregohet mospërkrahje në plotësimin e kushteve të domosdoshme, minimale, për siguri në punë, sipas ligjeve dhe praktikave të avancuara, është tregues i qartë se kjo qeveri nuk dëshiron një polici të pavarur dhe të zhvilluar, por të varur financiarisht dhe të kontrolluar politikisht.

Mendoj se duhet të gjenden patjetër format e financimit të qëndrueshëm, si dhe të sigurohen kushtet e punës sipas standardeve më të mira ndërkombëtare. Kjo është më shumë se nevojë njerëzore, se sa ruajtje e një logjike të shëndoshë të një policie profesionale dhe të pavarur.

Më shumë se 8 mijë policë sot nuk gëzojnë sigurime shëndetësore, nuk sigurojnë pension të dinjitetshëm apo pension të parakohshëm, nuk gëzojnë asnjë beneficion nga i cili kjo Qeveri do t'i bënte krenarë në punën që bëjnë për ruajtjen e sigurisë publike dhe të luftimit të krimit dhe të korrupsionit në vendin tonë.

Deputetë të nderuar, pozitë dhe opozitë, qytetarë të Republikës së Kosovës, a ju kujtohen deklaratat e këtyre krerëve të koalicionit të këtij vendi se po i mungojnë njerëz që marrin vendime të mëdha, apo ndodh që kanë menduar që vendim i madh nënkupton vetëm rritja e madhe e numrit qeveritar, apo vendim i madh është rritja e luksit qeveritar, a ju kujtohet që këta theksonin se do të sigurojnë krijimin e ushtrisë së ardhshme të Kosovës, a ju kujtohen se këta prematuan se në vitin 2017 do të lëvizni të lirë, pa viza.

Andaj, të respektuar, kjo qeveri me këtë projektbuxhet, jo që nuk siguron krijimin e ushtrisë së Kosovës, jo nga arsyeja e mungesës së vullnetit, por me këtë buxhet nuk është paraparë asnjë metelik i vetëm shtesë për vitin 2018. Kjo tregon se vendimit të madh të themelimit tash i mungon edhe zhvillimi i saj. Kjo shihet qartë, sepse largimi nga agjenda e transformimit të FSK-së tregon qartë se tani vendimet e mëdha të tyre janë shndërruar në politika klienteliste, vendimet e mëdha janë bërë minore në krahasim me logjikën institucionale të zhvillimit dhe të integritetit të shtetit të Kosovës në strukturat evropiane dhe euroatlantike.

Andaj, ky projektbuxhet paraqitet si problem serioz i funksionimit institucional të vendit tonë, mbi tendencën se jo çdo gjë është vetëm synimi sikurse i këtij koalicioni se vetëm të qenit në pushtet ka çmim. Si përfaqësues i interesave të qytetarëve të vendit, më takon që në mes të dy leximeve të paraqes amendamente, me të cilat pretendoj se do të përmirësoj së paku disa pika të caktuara që kanë të bëjnë me shpërndarjen buxhetore. Orientimet e qarta në përkrahje të dikastereve që merren me sundimin e rendit dhe ligjit, për të ruajtur parandë publike dhe për ta ridestinuuar apo për të parandaluar shpërndarjen e milionave të destinuara për luksin qeveritar.

Amendamentet e mia janë:

Rritja e buxhetit për institucionet e drejtësisë, me fokus të veçantë, prokurorë dhe gjyqtarë, si dhe bashkëpunëtorë profesionalë;

Rritja e buxhetit për Policinë e Kosovës, kushtet e punës dhe sigurinë personale;

Rritja e buxhetit të Forcës së Sigurisë, avancimi strukturor dhe ngritja në nivel të ushtrive profesionale me standarde të NATO-s.

Dhe, pa dashur që të bëj dallim rajonal, sepse nevojat primare janë të mëdha në gjithë Kosovën, ka të bëjë me sigurimin e ujit të pijes për dy fshatra të komunës së Deçanit si urgjencë e domosdoshme për banorët fshatrave të Strellcit të Epërm dhe të Strellcit të Ulët.

Dhe nga një bisedë me ministrin e Financave e falënderoj personalisht, i cili ka gjetur gatishmërinë që 360 000 mijë eurove t'i fusë në Projektbuxhetin 2018. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Memli Krasniqi, ndërkohë të përgatitet deputeti Shkumbin Demaliaj.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, e nderuar kryesuese e seancës,

I nderuar kryeministër,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht dëshiroj ta përgëzoj ministrin e Financave dhe Kabinetin qeverisës për punën në projektimin e hartimin e një buxheti të qëndrueshëm, i cili sipas të gjithë parametrave garanton një stabilitet makrofiskal dhe një zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet projekteve konkrete dhe i cili, pas një periudhe të gjatë disavjeçare, mes tjerash, mundëson edhe ngritjen e pagave për të gjithë punëtorët në sektorin publik, ashtu siç është e paraparë me legjislacionin në fuqi, sipas rritjes ekonomike të këtij viti.

U adresuan këtu dhe u thanë shumë diskutime për disa fusha dhe me të drejtë besoj që duhet të vlerësohen adresimi i sfidave dhe prioritetëve të rëndësishme të Qeverisë në fushat kryesore, siç janë shëndetësia, arsimiti, drejtësia, ngritja e mirëqenies sociale e kështu me radhë, po unë do të fokusohem te disa fusha për të cilat u diskutua ndoshta pak më pak.

Kryesisht do të flas për sportin, për kulturën dhe për bujqësinë.

Përkundër zhvillimeve pozitive të viteve të fundit në sport dhe rezultateve të jashtëzakonshme për një vend që konsiderohet i vogël në arenën ndërkombëtare, megjithatë sporti në Kosovë përballet me sfida të mëdha.

Këtu nuk po flas për të arriturat në sportet kulmore, por kryesisht po flas për problemet e mëdha, me të cilat ballafaqohen sportistët dhe sportistet në nivelin lokal, e veçanërisht klubet, të cilat janë në rrezik të shuarjes apo sfidohen nga mbijetesa për shkak të mospërkrahjes nga ana e komunave.

Përveç ndonjë rasti të disa komunave, të cilat kanë treguar gatishmëri dhe seriozitet në mbështetjen e zhvillimit të klubeve të tyre komunale, shqetësim i madh vazhdon të mbetet mostrajtimi me seriozitet i këtyre klubeve nga ana e qeverisjeve komunale, një shqetësim të cilën edhe Komiteti Olimpik i Kosovës e ka shfaqur publikisht, për çka e ka mbështetur edhe ministri i Sportit dhe kryeministri, e për çka i kemi takuar dhe ne të gjithë si kryetarë të grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës delegacionin e KOK-ut gjatë ditës së djeshme edhe sot.

Unë shpresoj se në fazën e amendamentimit do të gjendet mundësia, i nderuar ministër, që të gjitha komunave t'u rritet buxheti për sportin, me qëllimin e drejtpërdrejtë të mbështetjes së klubeve të cilat funksionojnë në të gjitha komunat e Kosovës dhe pa dallim sportet. Veçanërisht sportet individuale kanë probleme dhe kanë një mbështetje minimale, ku për fatin e keq të tyre dhe tonin, si shoqëri, ata mbështeten me nga 300, 500, 700, 800 euro në vit, gjë që e pamundëson funksionimin e tyre normal edhe për disa javë, e le më për një vit të tërë.

Kur e dimë që kemi një potencial të hatashëm të dëshmuar tashmë në nivelin më të lartë ndërkombëtar, unë besoj që nuk mjafton që vetëm kur të kenë suksese sportistët e Kosovës, ne t'i përshëndesim ata me postime në Facebook edhe në rrjete sociale e të ngarendim e të fotografohemi e dalim në televizione me ta, por duhet që t'u ndihmojmë që ta trasojnë rrugën e suksesit, sepse potenciali është evident.

Për sa i përket sportit, unë e pashë që në buxhet me të vërtetë ka një numër goxha të madh të projekteve kapitale dhe kjo është e mirëseardhur, por unë e shpreh shqetësimin për mundësinë e realizimit në kohë dhe me efikasitet të këtyre projekteve.

Kur e dimë se ka projekte që kanë filluar para 10 vjetësh dhe kanë filluar mbrapsht dhe nuk janë realizuar sot e gjithë ditën, atëherë konsideroj që Ministria e Sportit të ketë kujdes që sa më parë të fillojmë realizimin e këtyre projekteve.

Me të vërtetë befasohem se disa projekte të cilat kanë qenë të buxhetuara qysh në vitin 2015, sot ose ende nuk kanë filluar, ose po ripërsëriten nga viti në vit te lista e projekteve kapitale dhe ende nuk kanë ndonjë perspektivë të realizimit.

Andaj besoj që shumë e rëndësishme që ndoshta të racionalizohet numri i tyre dhe të mundësohet buxhetimi më i qëndrueshëm për finalizimin e projekteve, veçanërisht të atyre të cilat janë në proces.

Sa i përket kulturës, ajo që dua ta vlerësoj është rritja e buxhetit sa i përket ngritjes së pagave të kërkuara me të drejtë nga ana e krijuesve dhe performuesve, gjë që nuk ka ndryshuar në statusin e tyre prej rregullimit që ua kemi bërë në vitin 2011.

Unë konsideroj që të gjithë krijuesit dhe performuesit, të cilët janë pjesë e sistemit publik dhe që ndërlidhen me institucionet e kulturës dhe trashëgimisë kulturore në varësi të Ministrisë së Kulturës, duhet të kenë një ngritje të pagave që e tejkalon këtë përqindje që do ta kenë të gjithë punonjësit e administratës publike gjatë këtij viti dhe mendoj që kjo do të ishte një trajtim shumë më i dinjitetshëm sesa që u është bërë atyre deri më tash, përkundër premtimeve që i kanë pasur 3-4 vjetët e fundit, e asnjëherë nuk u është rritur as për një metelik paga qoftë aktorëve, qoftë valltarëve, qoftë atyre në Galerinë Kombëtare, apo të tjerëve.

Unë e përshëndes rritjen e buxhetit për bujqësi, është një ngritje në pjesën e subvencioneve dhe granteve, që është tepër e rëndësishme për vazhdimin e zhvillimit dhe trendit të zhvillimit pozitiv në bujqësi, edhe pse pajtohem besoj të gjithë që nevoja është që të ketë një rritje edhe më të madhe. Sido qoftë, kjo rritje shpresoj se i mundëson Ministrisë së Bujqësisë për të përfshirë skema të reja të mbështetjes në programin e zhvillimit rural, siç është skema e sigurimeve bujqësore, e cilat tashmë është filluar dhe sipas planifikimit do të duhej të fillonte me implementim gjatë vitit të ardhshëm, në mënyrë që fermerët e Kosovës, të cilët preken nga fatkeqësitë natyre, të kenë me të vërtetë një siguri se puna e tyre nuk do të shkojë dëm dhe do të kenë mundësi të kompensimit.

Kur jemi të kompensimi dua ta thërras vëmendjen e ministrit të Financave të një vendim i Qeverisë së kaluar, i cili për fat të keq s'është zbatuar asnjëherë dhe që është obligim ligjor, e që përkundër kërkesave dhe zyrtare që e kemi bërë në mandatin e kaluar, ende nuk është kryer. Ka të bëjë me kompensimin e fermerëve të prekur nga sëmundja e lëkurës gungore, që është shfaqur për herë të parë vitin e kaluar dhe që zyrtarisht nga Agjencia e Ushqimeve dhe Veterinës janë konfirmuar 1500 krerë të lopëve, të cilat kanë ngordhur nga kjo sëmundje.

Vendimi i Qeverisë, i pazbatuar, po e përsëris, ka qenë që këtyre fermerëve t'u kompensohen krerët dhe besoj që Agjencia e Ushqimeve dhe Veterinës duhet ta ketë një fond për ta bërë këtë kompensim, sepse shumë prej tyre me të vërtetë kanë pësuar dëme të mëdha. Besoj që në total, me një llogari prej rreth 1 000 euro për krerë, fondi i nevojshëm për zbatimin e vendimit në fuqi është rreth një milion e 500 mijë euro.

Në fund, e përshëndes konsolidimin e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe mendoj se përkundër që buxheti është i vogël në këtë fazë fillestare, subvencionimi i kompanive dhe iniciativave inovative në sektorin e teknologjisë informative dhe komunikimin në ekonominë digjitale, në përgjithësi është tepër i rëndësishëm, por edhe pse nuk qenka ministri këtu, unë dua ta theksoj që do të shpresoj që subvencionimi dhe mbështetja do të shkojë edhe për teknologjinë

e “Blockchain”, e cila është një nga teknologjitë më inovative në këtë fazë dhe e cila tashmë anëmbanë botës është duke shënuar një përdorim në rritje që përdoret në fusha të ndryshme.

Andaj, shpresoj shumë që në bashkëpunim me palët e interesit, me qendra e inovative në Kosovë, edhe kjo teknologji do të marrë mbështetje nëpërmjet subvencionimeve, të cilat parashihen me këtë projektbuxhet për Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shumbin Demaliaj, ndërkohë le të përgatitet deputeti Ismajl Kurteshi.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zonja kryesuese!

I nderuar kryeministër Haradinaj,

Ministër i Financave,

Të nderuar deputetë,

Dua që t’i ik sa më shumë, të mos përmend shumë aspekte që kolegët i folën më herët, por dua të ndalem në diçka shkurt, retroaktive, lidhur me hartimin e buxhetit.

Për t’u hartuar një buxhet, në këtë rast për t’u hartuar Projektbuxheti i Republikës së Kosovës, ma merr mendja se kryeministri Haradinaj dhe ministri i Financave nuk e kanë bërë vetëm këta të dy këtë buxhet, po janë kërkesat e dikastereve, të agjencive buxhetore, duke filluar që nga dikasteret komunale e deri te dikasteret e agjencitë buxhetore në tërë Qeverinë e Kosovës. E flas këtë se dëgjoj shumë kolegë të mi që me dhembshuri kërkojnë të dinë pse një dikaster ka kaq pak mjete të ndara. Askush nuk mund të shtojë më shumë mjete se sa ata kanë kërkuar. Kur një agjenci buxhetore ka kërkuar kaq mjete për të shpenzuar brenda një viti, në komisione parlamentare i kemi pasur të gjithë ato kërkesa, edhe vetë në komision të gjitha këto kërkesa buxhetore i kemi kërkuar nga këto agjenci buxhetore, me dhembshuri tani dalim e flasim se s’keni ndarë më shumë mjete për këtë, për këtë, përderisa të gjitha këto kërkesa vijnë nga vetë agjencitë buxhetore që i janë drejtuar Ministrisë së Financave, gjegjësisht Qeverisë për të ardhur ky buxhet këtu. Por, lidhur me këtë aspekt, në radhë të parë po më pëlqen diçka, sepse procedurat ligjore, Ligji për Buxhet nuk po bazohen në aspektin demagogjik.

U tha se buxheti është politik më herët, sepse partitë në pushtet i kanë dhënë orientim buxhetit në zona të ndryshme, bile u tha edhe një fjalë që u karakterizua si ‘provinciale’. Po, është shumë e vërtetë se buxheti është politik, edhe për çudi ende ka personalitete që janë bartës të proceseve të mëdha në parti të ndryshme dhe mendojnë se në Kuvend s’duhet të bëjmë politikë. Kësaj s’di çfarë t’i them! Është ndoshta në dukje ky buxhet edhe me karakter rajonal, se s’mund t’i them provincial, sepse termi “provincë” në aspektin historik na ka ngufatur edhe në kokë edhe është ngulitur si element negativ. Por, për shkak se në Kosovë deri më tani ekziston një rajon që nuk është shtruar asnjë metër autostradë, edhe pikërisht nga ai rajon, rajoni i Dukagjinit, e që nuk

është provincë, të hyrat për buxhetin e Republikës së Kosovës nga ai rajon janë mbi 35%, edhe sot mund të quhet provincë!

Kemi edhe ne vërejtjet tona për këtë çështje, po në shumë kode buxhetore që kemi menduar se janë në këtë buxhet që do t'i përmendim prej tyre, nuk i pashë, por mendoj se në mes të dy leximeve të Projektligjit për buxhet do të jenë brenda ligjeve të amendamentuara, brenda këtij ligji. Është projekti i asfaltimit të një rruge në Grykën e Strelcit, siç e quajmë ne atje, e deri te Guri i Nuses që projekti ka përfunduar, po nuk e pashë në asnjë kod buxhetor, por besoj gjatë mes dy leximeve do të kryhet dhe vitin e ardhshëm do të asfaltohet kjo rrugë.

Çështja e ujësjellësit, edhe unë dua ta falënderoj ministrin, por ajo ka filluar, sepse përgatitjet atje edhe grumbullimi i atyre pikave të ujit veç ka filluar të ndodhë, por nuk është për buxhetin e vitit të ardhshëm, por ka ndodhur që me rebalancin e buxhetit të vitit 2017 ka filluar puna. Është interesante se ajo pjesë duhet të përmyllet, sepse e bën atraktiv at pjesë të parkut nacional në Bjeshkët e Strelcit për vetë banorët, por mund të jetë një atraksion vërtet turistik edhe për qytetarët e Kosovës dhe për turistë të huaj. Ka edhe kode të tjera që nuk i pashë, nuk janë të përfshirë shumë rrugë e rrugica të tjera edhe në komunën e Deçanit, por edhe në rajone të tjera të Kosovës.

Pashë se po ekziston një kod buxhetor, u përmend më herët, për rregullimin, do të thotë mirëmbajtjen e rrugës magjistrale që përkolon nëpër Gjakovë deri Rekës së Keqe dhe Junik që për shkak të mosmirëmbajtjes ajo rrugë është bërë shumë e pakalueshme. Pastaj është edhe një fakt tjetër që në kuadër të investimeve të memorialit kemi edhe disa lokacione që ende nuk janë rregulluar, shumë varreza të dëshmorëve, si në fshatin Sllub të Deçanit, edhe në Morinë të Gjakovës, po i veçoj, por ka edhe në shumë vende të tjera, ku varrezat e dëshmorëve atje janë ende në gjendje të mjerueshme.

Ka shkuar kohë e gjatë dhe këto nuk janë rehabilituar. Buxhetin do ta mbështes dhe i jam mirënjohës Qeverisë aktuale për hartimin profesional të këtij buxheti dhe dua të specifikoj një gjë, për të gjithë ata që po flasin, që kjo mënyrë retroaktive për buxhetin e Qeverisë së kaluar, dua të them se është vetëm Qeveria e kaluar që nuk ka pasur rritje të pagave në asnjë sektor dhe tani me këtë buxhet e kemi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi dhe le të përgatitet deputetja Besa Gaxherri.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesuese!

Përsëritje, kolegë deputetë,

Buxheti i Kosovës 2018 për arsim nuk dallon shumë nga buxheti i vitit 2017, edhe pse më 19 janar të këtij viti ky Kuvend me nismën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe

përkrahjen e grupeve parlamentare të PDK-së, LDK-së, AAK-së dhe “Nismës” kanë aprovuar Rezolutën mbi arsimin, në të cilën, përveç të tjerash, në pikën e parë të kësaj rezolute thuhet: “Arsimi të shpallet interes nacional, ndërsa në funksion të kësaj të rritet buxheti për këtë sektor”.

Edhe pse rezoluta është aprovuar në fillim të vitit dhe Qeveria e kaluar ka pasur obligim të fillojë jetësimin e saj, nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim. Nëse kjo mund të arsyetohej me faktin se buxheti për vitin 2017 ka qenë i miratuar para aprovimit të rezolutës, nuk mund të arsyetohet planifikimi i buxhetit për vitin 2018, i cili nuk është në harmoni me rezolutën, e që nuk mundëson avancim të arsimit në Kosovë dhe trajtim të arsimit si prioritet kombëtar.

Ministritë së Arsimit për vitin 2018 i janë ndarë gjithsej rreth 55 milionë euro, nga të cilat vetëm 21 milionë e 571 mijë euro u dedikohen investimeve kapitale. Me këtë buxhet për arsimin, problemi i arsimit në Kosovë vetëm sa do të thellohet, me mësim në tri ndërrime, me orë mësimi 30 minuta, klasat me nga 40 nxënës, shkollat pa laboratorë, kabinete, nuk mund të flitet për avancim të arsimit dhe as për arsim si prioritet kombëtar. Se si është trajtuar arsimi gjatë ndarjes së buxhetit po e ilustrim me këta shembuj:

Në komunën e Gjilanit për planifikim e riplanifikim urbanistik janë ndarë mbi 2 milionë e 400 mijë euro, kurse për pajisje shkollore vetëm 300 mijë euro, ose tetë fish më pak se planifikimi urban që në këtë komunë ndodh çdo vit për interesa të bizneseve të caktuara dhe jo për qytetarët. Në këtë buxhet të arsimit nuk janë paraparë mjete për përmbushjen e obligimeve që dalin nga nënshkrimi i Kontratës kolektive me sindikatat e arsimit, e që për një vit për pagat jubilarë dhe tri pagat përcjellëse Ministritë së Arsimit duhet t’i ndahen 908 mijë euro, do të thotë pak mbi 900 mijë euro. Në këtë buxhet nuk është ndarë asnjë euro për mësimdhënësit që kanë punuar gjatë viteve ‘90-ta dhe pritet që edhe një ligj gjatë vitit të ardhshëm të aprovohet për këtë kategori të mësimdhënësve, por buxhet për këtë kategori nuk është ndarë.

MASHT-i nuk ka paraparë mjete as për ndërtimin e një objekti, ku do të vendosej Instituti Pedagogjik i Kosovës, i cili po punon në disa kontejnerë afër Pallatit të Shtypit dhe se punëtorët e këtij instituti shumë të rëndësishëm padrejtsisht po trajtohen si shërbyes civilë, edhe pse ata e kanë fituar statusin e punëtorëve profesionalë.

Qeveria ka për obligim të angazhohet për jetësimin e Rezolutës së Kuvendit për arsim, një gjë e tillë nuk mund të ndodhë me buxhetin e planifikuar. Ne kërkojmë nga Qeveria që t’i evidentojë të gjitha shkollat, ku mësimi zhvillohet në tri ndërrime dhe të ndajë mjete për ndërtimin e shkollave të reja, me qëllim të eliminimit të këtij problemi, por jo vetëm kaq, duhet të investohet shumë në sigurimin e laboratorëve dhe mjeteve të tjera të nevojshme, sidomos për shkollat e mesme profesionale që aktualisht nuk kanë kushte për punë praktike, që për këto shkolla janë të domosdoshme. Edhe sa i përket sektorit të kulturës për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve janë ndarë mjete prej rreth 34 milionë eurosh, që për këto tri kategori, këto tri fusha të

rëndësishme shoqërore, as përafërsisht nuk janë të mjaftueshme. Me këtë buxhet vështirë është të parashihet punë normale, qoftë në kulturë, qoftë në përkrahjen e aktiviteteve të rinisë, qoftë në plotësimin e kërkesave emergjente në fushën e sportit.

Sa i përket komunës së Gjilanit dhe arsimit në këtë komunë, janë ndarë 13 milionë euro, prej të cilave 11 milionë euro shkojnë për të ardhurat personale, kurse 1 milion e 400 mijë euro për mallra dhe shërbime, derisa për investime kapitale në këtë komunë janë ndarë vetëm 600 mijë euro, e që vërtet janë jashtëzakonisht pak. Sa i përket kulturës në këtë komunë janë gjithsej 427 mijë euro, rreth gjysma e tyre shkojnë për paga, 200 mijë euro, 160 mijë janë për subvencione dhe është interesant se sa u përket investimeve kapitale në këtë fushë, në fushën e kulturës, nuk është ndarë asnjë euro.

Në Gjilan katër shkolla punojnë me tri ndërrime, me këtë buxhet nuk është paraparë ndërtimi i ndonjë shkolle që ndikon në zvogëlimin e ndërrimeve nga tri sa aktualisht janë, në dy ndërrime. Atje është paraparë dhe ka filluar ndërtimi i shkollës në Haxhaj, në Livoç të Ulët dhe ndërtimi i Shkollës së mesme të muzikës, por këto nuk e zvogëlojnë numrin e shkollave, të cilat po punojnë aktualisht në tri ndërrime. Sa i përket autostradës, e cila ishte temë edhe gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet lokale, derisa në programin qeverisës kishte vetëm një fjali në lidhje me autostradën, ku thuhej; “Përfundimi i procesit administrativ të prokurimit për autostradën Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë, ka filluar” që është në faqen 31, në Projektligjin për buxhet, asnjë fjalë më shumë. Madje, as nuk ka sqarime si duket kjo tani apo nuk ka autostradë në vitin që po hyjmë Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë, kjo është për të diskutuar dhe sigurisht ministri do të japë ndonjë sqarim në lidhje me këtë.

Sa i përket Diasporës, për të cilën përherë në fushata ngrihet shumë pluhur, premtohet shumë, e në buxhetin që po planifikohet për vitin e ardhshëm parashihet vetëm rritja e numrit për 16 punëtorë të rinj dhe rritja e buxhetit për 400 mijë euro, pa specifikuar asgjë se për çka konkretisht do të shfrytëzohen këto mjete, që do të jenë në dispozicion të Ministrisë së Diasporës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri, ndërkohë përgatitet deputetja Sala Berisha-Shala.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Kolegë deputetë,

Zoti ministër,

Duke u bazuar në ish-qeverisjen e mirë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zhvillimi ekonomik, rritja ekonomike, rritja e bruto produktit vendor dhe strukturimi i mirë i buxhetit të Republikës së Kosovës ka dhënë rezultate tashmë të prekshme.

Ish-qeveria me performansën e saj profesionale të shkëlqyer dhe me qeverisjen me duar të pastra ka arritur që të zërë hapin e rritjes ekonomike globale dhe ta tejkalojë atë. Bazuar, pra, sipas azhurnimit të parashikimit ekonomik të Fondit Monetar Ndërkombëtar të tetorit të vitit 2017, thotë: “Bruto produkti vendor në nivel global pritet të rritet nga 3.2% më 2016, në 3.6% dhe në 3.7% në 2017 dhe 2018, duke vazhduar me një mesatare prej 3.8% në periudhën afatmesme 2019-2022”.

Pra, bazuar në këtë ish-Qeveria mori hapa të guximshëm e profesionalë duke i falur borxhet e ndërmarrjeve private deri në vitin 2009 dhe duke hartuar politika fiskale tejet të favorshme për biznesin vendor, e që sipas të dhënave të vitit 2017, sipas të dhënave zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës aktiviteti ekonomik i matur nëpërmjet bruto produktit vendor ka pas një rritje reale prej 3.9% në tre mujorin e parë të vitit dhe 4.6% në të dytin, pra flitet për vitin 2017. Kjo përfaqëson një rritje të peshuar prej 4.3% krahasuar me gjashtëmujorin e njëjtë të vitit paraprak. Po ashtu, parashikimi i prillit të vitit 2017 parashihte një shtytje të fortë të rritjes nëpërmjet investimeve publike të financuara nga klauzola e investimeve dhe mjetet e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore, përkundër pra mungesës së kësaj shtytje, siç e dimë, që patëm zgjedhjet, të dhënat aktuale tregojnë se rritja ka buruar nga zgjerimi i investimeve private dhe eksportit, të mbështetur nga uljet e vazhdueshme e kostos së kreditimit dhe rritja e komponentëve të bilancit të pagesave që ndikohet nga remitencat, eksportet e shërbimeve dhe investimet e huaja direkte.

Bazuar në këtë çka thashë më lart, mund të konstatojmë se në të hyrat buxhetore për vitin 2018 pa mëdyshje do të ketë rritje, sepse tashmë të hyrat buxhetore në Republikën e Kosovës janë strukturuar dhe duhet të vazhdohet në rrugën e njëjtë. Por, a do të ndodhë kjo me një qeveri çfarë e kemi aktualisht? Qeveri, e cila çdo hap apo vendim që e ka marrë për këta tre muaj në lidhje me ekonominë dhe buxhetin e vendit ose janë të dëmshme për vendin, ose janë shkelje ligjore, siç është shembulli apo rastet konkrete, rasti i faljes së borxhit ndaj ambalazhuesve të ujit, shpronësimi i Hades, e plot vendime të tjera.

Nga Projektbuxheti 2018 parashihen të jenë 1 miliard e 829 milionë euro të hyra buxhetore, e që krahasuar me vitin 2016-2017, pra buxheti ka pasur rritje 8%, ndërsa për vitin 2018 kjo qeveri parasheh rritje vetëm 6%, fatkeqësisht edhe në këtë aspekt ka rënie. Në bazë të planifikimit tuaj ju thonë se do të keni rritje ekonomike mbi 4%, ndërsa në programin e qeverisë ju po e përmendni një rritje ekonomike mbi 7%, Atëherë lind pyetja cila është e vërteta? E vërteta është që vërtetë me këtë qeveri nuk do të ketë as 4 as 7% rritje, por do të biem nën 4% të rritjes ekonomike. Por, kur shikojmë shpërndarjen apo shpenzimet e buxhetit për vitin 2018, atëherë shohim një çrregullim dhe një ndarje buxhetore të padrejtë, joprofesionale dhe të dëmshme për vendin.

Po ndalem te shpenzimet, gjithsej shpenzime ju keni parashikuar t'i keni 2 miliardë e 82 milionë dhe këto janë të dedikuara në shpenzimet rrjedhëse në 1 miliard e 383 milionë, që krahasuar me vitin 2017 janë 108 milionë më shumë dhe të shpërndara kuptohet në paga dhe mëditje për 17 milionë më shumë, që fatkeqësisht ligji apo ish-qeveria në bazë të ligjit ka planifikuar që në bazë të rritjes ekonomike do të ketë rritje të pagave, ndërsa me 17 milionë nuk do të mund të realizonin rritjen ekonomike që ka pasur ish-qeveria. Dhe, pastaj mallra dhe shërbime këtu është një shumë prej 39 milionë më shumë se vitin 2017 dhe fatkeqësisht këta 39 milionë merren nga shpenzimet kapitale, që fatkeqësisht këtë vit nga viti 2017 janë minus 39 milionë, pra në vitin 2017 kemi pasur të planifikuara 726 milionë në investimet kapitale, ndërsa për këtë vit kjo qeveri ka 39 milionë më pak shpenzime kapitale, pra janë 687 milionë.

Për të mos marrë kohë, ju keni premtuar ose keni pasur prioritet tuajin zhvillimin ekonomik, arsimin, shëndetësinë, FSK-në dhe unë shkarazi po ju them, zhvillim ekonomik duke i zvogëluar investimet kapitale për 39 milionë nuk mund të ketë. Duke zvogëluar në 40% në arsim te cilësia, pra nuk mund të ketë arsim të mirëfilltë, ju e dini se në çfarë niveli e keni sjellë arsimin. Shëndetësia gjithashtu nuk mund të ketë përmirësim, kur ju keni larguar tërësisht Fondin e Sigurimit nga skemat buxhetore, e keni lënë vetëm 3 milionë në këtë kod buxhetor.

Ndërsa, për FSK-në fatkeqësisht që keni trumbetuar që do ta bëni ushtri, nuk parashihet asnjë rritje dhe jo vetëm për këtë vit, por as për vitet paraprake.

Duke pasur parasysh kohën, pra po ndalem në disa argumente për ndarjen e padrejtë nëpër komuna. Të gjitha komunat, të cilat qeverisen nga Lidhja Demokratike e Kosovës ose nuk kanë fare projekte të reja, ka komuna, të cilat edhe janë ndërprerë marrëveshjet që kanë qenë ose memorandumet që janë lidhur për vitin 2017 e më tutje.

Ja, për shembull, po i them dy-tre shembuj konkretë: unë pashë kur fillova me i lexua komunat e radhitur ishte komuna e parë e Gllogovcit, pastaj menjëherë ishte komuna e Fushë-Kosovës dhe vetëm këto i krahasova e pashë tek infrastruktura rrugore të ndara për Gllogocin janë 2 milionë e 835 mijë euro, ndërsa për Fushë-Kosovën janë 1 milion e 260 mijë euro. Domethënë, kjo thotë gjithçka që përafërsisht njëjtë është edhe për komunën e Deçanit dhe të Vitisë, pra diskrepanca që është komunë e udhëhequr nga LDK-ja. Dhe, një shembull më konkret, po nisem nga komuna e Pejës, ku vërtet për këtë vit në infrastrukturë nuk ka asnjë projekt të ri dhe, zoti ministër, pasi qenke këtu dhe po më vjen keq që ministri i Infrastrukturës nuk është, komuna e Pejës ka bërë një kërkesë zyrtare të protokolluar më 13. 10. 2017, e që të mos marr kohë, të gjitha projektet që janë parashikuar këtu shuma është 3 milionë e gjysmë, asnjë projekt nuk është futur në këtë buxhet.

Dhe, kjo natyrisht që është e papranueshme dhe unë po e them edhe publikisht, kam biseduar me ju, zoti ministër, të falënderoj që keni pasur mirëkuptim dhe ne do të bëjmë amendamente së

paku për shumën, të cilën janë të parashikuara me memorandum nga ish-Qeveria dhe janë larguar tërësisht ato mjete dhe do t'i kthejmë, konsideroj unë bashkë me ju prapë në buxhetin aktual.

Dua të ngre vetëm edhe një çështje te Kuvendi i Kosovës, përveç vërejtjeve që kam për kushtet e deputetëve, që nuk kanë zyra edhe sot që jemi pas 15-16 vjetëve pas luftës në Kuvend të Republikës së Kosovës deputetët nuk kanë zyra, nuk kanë as teknologji për punë. Unë sot dua ta ngre çështjen e buxhetit për Grupin joformal të grave deputete. Ky grup funksionon që nga korriku i vitit 2005 e deri tani dhe asnjë cent nuk është ndarë dhe nuk ka as kod buxhetor, kemi pasur arsye të ndryshme, por unë konsideroj se më nuk ka asnjë arsye që të mos ndahen buxhet për këtë grup ose ky grup duhet të pushojë së funksionuari. Dhe, unë po jap një shembull konkret te buxheti i Kuvendit të Kosovës, tek kodi i stafit politik, stafi mbështetës politik, që ka një shumë prej 700 mijë euro, unë po propozoj të merren vetëm 100 mijë euro prej këtij kodi buxhetor dhe ky grup do të funksionojë më së miri, pasi që ky grup gjithë kohën ka qenë në funksion të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Unë ju falënderoj për vëmendjen dhe konsideroj se pas amendamentit që do t'i kemi bashkë, do ta ndryshojmë Buxhetin. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, sipas radhës, ia jap fjalën deputetes Sala Berisha-Shala. Urdhëro, zonja deputete!

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Qeveria s'qenka këtu, sigurisht ka dalë për të pushuar. Unë do të bëj përpjekje që të mos zgjatem shumë për ta kursyer kohën, sepse janë në pritje edhe shumë deputetë të tjerë. Tani e kemi në shqyrtim një projektligj shumë të rëndësishëm, siç është Projektligji i Buxhetit për vitin 2018.

Është shumë interesant se çdoherë kur diskutohen projektligjet në Kuvendin e Kosovës dikush merr në thua te ndarja e Buxhetit për Drenasin. Unë do t'i thosha edhe Qeverisë, edhe ministrit të Financave, se sikur çdoherë tjetër vazhdimisht nuk do të pajtohem me ndarjen e buxhetit bazuar në kriteret unike, siç është numri i banorëve, e të tjera, sepse një ndarje e tillë nuk garanton qasje të njëjtë me Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe nuk garanton zhvillim të barabartë për të gjithë qytetarët, sepse jo të gjitha komunat, pavarësisht nga numri i banorëve të tyre, janë të zhvilluara, disa kanë mbetur në prapambeturi ekonomike, siç është edhe Drenasi ose Glllogoci, që iu referua kolegja ime, Besa Gaxherri.

Ky projektbuxhet konsideroj se është ndërtuar në saje të një arsyeje, e jo në saje të dëshirave, pra në saje të mundësive. Adreson çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me shtylla të rëndësishme, segmente të rëndësishme, siç është zhvillimi ekonomik, arsimit, kultura, sundimi i ligjit e tjera. Mendoj se tash nuk mund t'i ik këtij diskutimi pa e përshëndetur edhe futjen e projekteve kapitale, jo vetëm për Drenasin, por prej të cilave do të përfitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës, që janë projekte që gjenden në atë vend. Bie fjala, siç është Stadiumi Kombëtar i Kosovës, nga i cili do të përfitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës, mandej më vjen mirë që vazhdon të jetë në projekt rruga Skenderaj-Komorani, e cila ka qenë vetëm në letër dhe nuk është bërë asnjë milimetër në ndërtimin e asaj rruge, shpresoj që punët do të dinamizohen dhe të kryhet në kohën e duhur.

Mandej, çështjet që lidhen me kulturën, siç është Kalaja e Vuçakut, e cila ka filluar në mandatin e kaluar dhe e përshëndes në këtë rast, rastisi që ish-ministri i Kulturës, që tani e drejton këtë sesion shkencor, e ka mbështetur këtë projekt, i cili është projekt që nuk është në përfitim vetëm të qytetarëve të asaj komune, por bën që lashtësia të flet me gjuhën e vet.

Siç thashë edhe në fillim, nuk do të zgjatem shumë, diskutimin tim do ta dorëzoj me shkrim, por do të jem kujdestare të shoh se sa po zbatohen këto projekte, jo vetëm në komunën prej së cilës vij, por projektet që lidhen me zhvillimin ekonomik, me çështjet e Arsimit e të Shëndetësisë, çështjet sociale në tërë Kosovën, në të mirën e qytetarëve të Kosovës.

Ju ftoj paraprakisht të votoni, sepse nga ky buxhet do të përfitojmë të gjithë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti)

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti i Aleancës, a është dikush? Ahmet Isufi, ndërkohë përgatitet deputetja Shqipe Pantina.

AHMET ISUFI: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë pa hyrë shumë në elaborim të përgjithshëm të Projektbuxhetit, konsideroj se është një buxhet i cili është bartur edhe më herët, prandaj vijat buxhetore të përcaktuara vetëm duhet të sistemohen, të precizohen dhe sidomos kërkesat imediate të agjencive të ndryshme dhe të niveleve të përcaktuara, të jenë ato që mundësojnë një ndryshim të gjendjes, qoftë të zhvillimit ekonomik, infrastrukturës, pastaj edhe sferave tjera.

Dy elemente, të cilat do t'i përmend janë ajo e Arsimit, sepse u përmend edhe rezoluta, e cila jep përparësi dhe shtytje Arsimit në Kosovë, duke e ditur se pa një Arsim cilësor ne nuk mund të ecim përpara në zhvillimin shoqëror, dhe kur e kam parasysh këtë e shoh se një ndarje, e cila është bërë për Universitetin "Kadri Zeka" është bërë vetëm në segmente, të cilat mund ta

përmirësojnë infrastrukturën përbrenda, por jo për kampusin, i cili ka qenë i parashikuar dhe Komuna e Gjilanit i ka ndarë 7 hektarë, për të cilën fillimisht, që më 2015 janë paraparë 50 mijë euro, duke u rritur shuma çdo vit për ta pasur një kampus vërtet universitar modern, i cili mundëson edhe zhvillimin e Arsimit cilësor.

Njëkohësisht dua ta përmend edhe një segment tjetër, i cili u theksua edhe në këtë seancë, e që është sporti ne kemi pas një takim me zotin Besim Hasani, kryetar i Komitetit Olimpik, dhe vërtet kur e shikojmë se në çfarë niveli është sporti ynë dhe cilat kanë qenë angazhimet për t'u pranuar në nivelin ndërkombëtar, është një diskrepancë shumë e madhe. Kosova është pranuar në UEFA, FIFA, në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar, por krahasuar me infrastrukturën dhe veprimet tjera të ngritjes së cilësisë së sportit, është nën çdo nivel. E kam shikuar një derbi të futbollit në Gjilan, që është luajtur pikërisht dje, e që vërtet është për keqardhje një infrastrukturë e tillë, kur edhe lojtarët nuk e njihnin më njëri-tjetrin pikërisht për shkak të mungesës së investimeve në sport.

Prandaj, është e domosdoshme që ashtu siç ka përparuar Kosova në nivele individuale dhe dhënie të sportistëve të dalluar edhe klubeve të mëdha ndërkombëtare, ta bëjë Kosovën me klube, të cilat vërtet e nderojnë atë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Shqipe Pantina, ndërkohë përgatitet deputetja Mirjeta Kalludra.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Në fakt, ministri nuk qenka këtu, sepse unë më shumë kisha komente, por edhe pyetje për ministrin dhe për mënyrën e ndarjes së buxhetit dhe do të ndalem vetëm në disa ministri, pasi shumica e vërejtjeve që kisha, veçse u thanë prej parafolësve.

E para, e kemi Ministrinë për Zhvillim Rajonal, së cilës i janë ndarë 200 mijë euro buxhet, mirëpo nuk thuhet se si do të shpenzohen këto 200 mijë euro. Në fakt, e gjithë shuma shkon për administratë, që nënkupton për të bërë asgjë, në fakt. Kjo i justifikon edhe më mirë vërejtjet që u thanë edhe këtu se kjo ministri është krejtësisht e kotë dhe nuk ka kurrfarë kuptimi as ekzistenca e saj. Gjatë fushatës për zgjedhjet lokale ne kemi dëgjuar shumë kandidatë për kryetarë të komunave, të cilët kanë përmendur se në shumë qytete dhe fshatra të Kosovës qytetarët kanë probleme elementare, duke filluar me ujin e pijshëm.

Ky që ndoshta do të ishte mirë që këto 200 mijë euro për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, pra për një ministri kot, si dhe shuma e ndarë për pagat e zëvendësministrave, që po ashtu janë për punë kot, të shkonin në projekte për ujësjellës apo ndërtimin e ndonjë çerdheje nëpër komuna të ndryshme.

Çështja tjetër është buxheti i ndarë për Ministrinë e Administratës Publike. Te tabela që tregon për investimet kapitale te Ministria e Administratës Publike, një shumë e caktuar e këtyre parave, e të hollave, shkojnë për projekte për ndërtim të shkollave. Tani unë nuk e kam të qartë se pse Ministria e Administratës Publike duhet të merret me ndërtimin e shkollave, e sidomos me ndërtimin e shkollave fillore, kur kjo çështje është kryesisht kompetencë e komunave. Pra, pse komunat nuk merren me ndërtimin e infrastrukturës së arsimit fillor, por një gjë të tillë duhet ta bëjë Ministria e Administratës Publike?

Është mirë që Ministria e Arsimit më pak po merret, edhe pse edhe ajo merret me ndërtimin e shkollave, sepse roli dhe detyra e ministrive është hartimi i politikave, e për ndërtimin e infrastrukturës ne e kemi një ministri, e cila është përgjegjëse për ndërtimin e infrastrukturës. Pra, nuk e kam të qartë dhe nuk besoj se edhe Qeveria e ka të qartë se pse Ministria e Administratës Publike të merret me ndërtim të shkollave. Po ashtu, te e njëjta ministri është një shumë e ndarë prej gjysmë milioni euro për reformën e Administratës Publike. Unë e di që prej se ekziston kjo ministri, në vazhdimësi është marrë me reformë të Administratës Publike, dhe në vazhdimësi ka pasur të holla të ndara në buxhet për reformë të Administratës Publike. Dhe, vitin e ardhshëm bëhen 10 vjet nga pavarësia dhe për dhjetë vjet me radhë, bile edhe më herët, por të paktën këto dhjetë vjetet e fundit kjo ministri në vazhdimësi është në reformë, harton strategji të ndryshme, por, në fakt, për çdo vjet Raporti i Progresit flet se si Administrata është e politizuar, është joprofesionale, e kështu me radhë, dhe as në buxhet nuk thuhet se si do të shpenzohen këto 500 mijë euro. A do të përdoren këto për punëtori, apo për vizita turistike në Shqipëri për ta hartuar dhe një strategji tjetër, apo, më në fund, Qeveria, përkatësisht Ministria e Administratës Publike, e këtu unë jam shumë skeptike, e ka ndonjë plan konkret se si do ta bëjë reformën e Administratës Publike.

Te Ministria e Infrastrukturës, e cila ka më së shumti projekte dhe ndërtim të rrugëve kryesisht, edhe pse edhe te shumë ministri tjera, janë një numër i madh i projekteve që barten nga viti 2017 për vitin 2018, por ajo që nuk shpjegohet këtu është se kjo shumë e bartur, kjo shumë që në fakt përshkruhet në tabelë, a është shuma e cila ka qenë e caktuar për projekt, apo është shuma e cila ka mbet pa u realizuar? Dhe, këtu mendoj se është një hile e madhe, në bazë të së cilës Qeveria tenton t'i fshehtë, ose moszbatimin e projekteve, apo ndonjë dallavere tjetër që fshihet pas tyre.

Së fundi, sa i përket ministrive, është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Unë edhe në buxhetin e vitit të kaluar e kam pas vërejtjen se pse Ministria e Pushtetit Lokal, pra Ministria për Administrim të Pushtetit Lokal, merret me ndërtim të rrugëve, trotuareve, e kështu me radhë.

Në këtë vit, ato nuk janë paraqitur në Buxhet, por edhe më keq, janë ndarë 3,8 milionë euro, që thuhet për investime kapitale dhe as edhe një shpjegim i vetëm se si dhe ku do të shpenzohen këto 3,8 milionë euro. Pra, për çfarë projektesh, për çfarë investimesh kapitale bën fjalë dhe si do të merret vendimi për shpenzimin dhe cilat projekte do të financohen me këto 3,8 milionë euro?

Krejt në fund, edhe sa u përket agjencive, përkatësisht institucioneve të pavarura. Përderisa buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës është diku 11 milionë, e Radiotelevizioni është siç e dimë me mal problemesh, me keqmenaxhim, keqpërdorim të parasë publike, një institucion tjetër, i cili është institucion kushtetues, është Komisioni i Pavarur i Medieve, të cilit asnjë cent nuk i është ndarë për investime kapitale. Ne para afërsisht 2-3 vjetëve e kemi miratuar Ligjin për digjitalizim dhe as vitin e ardhshëm nuk shihet se është ndarë as edhe një cent i vetëm për këtë proces. Pra, a e ka ndërmend Qeveria ta bëjë fare procesin e digjitalizimit? Nëse po, pse për vitin e ardhshëm nuk e ka planifikuar as edhe një cent të vetëm, apo ne si shtet kemi hequr dorë nga ky proces, i cili është një nga pothuajse proceset e domosdoshme nëpër të cilën duhet të kalojë vendi ynë, në qoftë se duam të sigurojmë mbulesë cilësore mediale. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Mirjeta Kalludra, ndërkohë përgatitet deputeti Hajdar Beqa.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot para nesh e kemi për shqyrtim Projektbuxhetin për vitin 2018, i dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës ashtu siç kërkohet me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

Të njëjtin e kemi analizuar me shumë kujdes, e nga kjo kam arritur t'i vërej këto çështje që do t'i ngre në vijim. Bazuar në projeksionet e dhëna në tabelën e parë të Ligjit të Buxhetit, ku niveli i shpenzimeve të projektuara për vitin 2018 është në 2 miliardë e 82 milionë euro. Prej tyre, 1 miliard e 383 milionë euro janë në shpenzime rrjedhëse, ndërsa 687 milionë euro në shpenzime kapitale. Vetëm kategoria e shpenzimeve për paga dhe mëditje do të rritet për 25 milionë euro, ndërsa kategoria e subvencioneve do të rritet për 30 milionë euro. Rritje të tjera ka pësuar edhe kategoria e mallrave dhe shërbimeve, si dhe ajo e shpenzimeve komunale.

Nëse e marrim për bazë këtë rritje vetëm në këto dy kategori ekonomike, paga dhe mëditje, si dhe kategorinë e subvencioneve, ku shuma e arritjes do të jetë për 55 milionë euro, kjo është si rezultat se e kemi një qeveri me numër të madh të ministrave, po ashtu me numër të madh të zëvendëskryeministrave dhe zëvendësministrave, ku numri aktual ka tejkaluar mbi 70 zëvendësministra.

Numri gjithnjë në rritje i zëvendësministrave, si dhe numri i madh i përfituesve në skemat përfituese të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale lë të kuptohet se në Kosovë edhe për një periudhë kohore Buxhetin do ta kemi buxhet social. Do të kemi buxhet social si rezultat, apo mungesë e një strategjia për zhvillim të mirëfilltë ekonomik, si rezultat apo mungesë e

planifikimit për nxitjen dhe promovimin apo mbështetjen e hapjes së vendeve të reja të punës për dy kategori, të cilat janë më se të nevojshme, mbështetjen e të rinjve dhe grave.

Po ashtu, është shqetësuese sesi nga Qeveria e Kosovës parashihet të shpenzohen 7,2 milionë euro për vetura luksoze, edhe pse institucionet posedojnë një numër të madh të veturave zyrtare për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive. Në këtë rast, jo vetëm që kemi një numër shumë të madh të veturave zyrtare, por kemi edhe keqpërdorim në përdorimin e tyre. Veturat zyrtare përdoren për shërbime private jashtë orarit zyrtar, vizita private jashtë vendit, si dhe pushime verore jashtë vendit.

Është e pakuptimtë sesi institucionet e Kosovës kanë ndarë një buxhet prej më shumë se 7,2 milionë eurosh për të marrë me qira 358 vetura, të cilat do t'i shfrytëzojnë për 66 muajt e ardhshëm, kurse institucionet publike shëndetësore në Kosovë i kanë në dispozicion rreth 90 autoambulanca, në mungesë të të cilave shpesh rrezikohet edhe jeta e pacientëve, kur disa qendra kryesore të Mjekësisë Familjare kanë vetëm nga një autoambulancë dhe kur kërkohet të intervenohet në dy raste përnjëherësh, atëherë rrezikohet edhe jeta e qytetarëve, përderisa institucionet e vendit vlerësohet se i kanë në dispozicion mijëra vetura për shërbyesit civilë.

Po ashtu, në këtë rast Qeveria, respektivisht Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë, duhet t'i kenë parasysh edhe disa ligje të tjera, të cilat janë miratuar në mandatin e kaluar në Kuvend dhe që do të kenë implikime financiare. Këto nuk janë parashtruar në projekte. E kam fjalën për shërbimin mjekësor emergjent, ligj i cili parasheh ta bëjë një reformë në shërbimin emergjent dhe të ketë një organizim të ri dhe ofrim të shërbimeve më të mira dhe më afër qytetarit.

Unë konsideroj se patjetër duhet të parashihet buxhet për vitin 2018, që të fillojë kjo reformë dhe shërbimet emergjente të funksionalizohen sa më parë, reformë që është e domosdoshme.

Vlen të theksohet se me gjithë rritjen e kufirit të shpenzimeve nuk kemi rritje premtuese të të hyrave të buxhetit në një bazë të qëndrueshme. Pjesa dërmuese e të hyrave është nga importi. Bilanci i të hyrave dhe të dalave nga eksporti dhe importi është 2,5 miliardë euro. Shqetësues mbetet fakti se Kosova ka rritje të buxhetit publik në shumën prej 850 milionë eurove.

Te ndarja e buxhetit për ministritë nuk do të ketë ndryshime shumë të mëdha, as në Ministrinë e Shëndetësisë. Nëse e analizojmë projektbuxhetin për Shëndetësi, edhe pse e proklamuar si prioritet, ku ka një rritje të buxhetit, kjo nuk është e mjaftueshme, sepse problemet në Shëndetësi janë jashtëzakonisht të mëdha dhe qytetarët janë ata që po pësojnë nga shërbimet jo të mira, mungesë e barnave, si dhe pritje të gjata në marrjen e shërbimeve të caktuara.

Investimet në shëndetin publik dhe shërbimet primare shëndetësore, si bazë e mirë e parandalimit të sëmundjeve, investohen shumë pak. Shërbimi primar shëndetësor është në gjendje jashtëzakonisht të keqe, pasi është lënë në mëshirën e komunave, kurse nuk përkrahet me buxhet të mjaftueshëm për përmirësimin e këtyre shërbimeve.

Sistemi i informimit shëndetësor nuk është buxhetuar mjaftueshëm për përmbylljen e këtij kapitulli dhe fillimin sa më parë të sigurimeve shëndetësore. Për një sektor të rëndësishëm të Shëndetësisë, siç është edhe Inspektorati Shëndetësor, që monitoron dhe kontrollon me mijëra institucione shëndetësore, nuk përkrahet me buxhet dhe staf të mjaftueshëm dhe as për së afërmi nuk i plotëson nevojat për funksionalizimin e këtij institucioni.

Buxheti që ndahet për pacientë që shërohen jashtë vendit është jashtëzakonisht i vogël. Në këtë rast duhet të mendohet me urgjencë, që këto shërbime të funksionalizohen në vend. Pra, këto shërbime të ofrohen brenda vendit, ku do të jetë një kosto më e lirë dhe këto shërbime do t'i marrë një numër më i madh i qytetarëve.

Tek Sektori i Shëndetësisë do të kemi një rritje të numrit të punëtorëve, në këtë rast konsideroj se duhet t'i mbështetim me kuadro profesionalë spitalet regjionale, e jo të stërngarkohet QKUK-ja, kurse spitalet regjionale të mbeten pa kuadro të nevojshme, me çka rrezikohen të mbyllen edhe disa shërbime në mungesë të kuadrove, të cilat po pensionohen.

Te Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nëse shikojmë buxhetin për Arsim, ky buxhet nuk ka investime të mjaftueshme, sidomos në atë që është prioritet strategjik i Arsimit, në ngritjen e cilësisë në arsim. Me këtë buxhet të planifikuar nuk do të ketë rritje të cilësisë në Arsim dhe përmirësim i rezultateve zhgënjyese të dala nga PISA.

Investimi në infrastrukturën fizike është i domosdoshëm, por ajo që Kosovës i duhet urgjentisht është edhe investimi në cilësinë e edukimit, që e marrin fëmijët dhe të rinjtë tanë. Te Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, po ashtu mendoj se duhet të kemi buxhet më të madh, meqë në këtë rast e kemi prioritet përkrahjen e implementimit të masave aktive të tregut të punës, nëpërmjet të cilave do ta kemi një nxitje dhe përkrahje direkte për hapjen e vendeve të reja të punës, si dhe përkrahjen e të rinjve dhe të femrave në punësim dhe vetëpunësim, fuqizimin e Inspektoratit të Punës, rritjen e numrit të inspektorëve, si dhe njëherësh edhe rritjen e mbikëqyrjes së Inspektoratit në luftimin e ekonomisë joformale dhe në mbrojtjen e punëtorëve.

Tek ndarja e buxhetit nëpër komuna, unë do të ndalem pak më konkretisht në Komunën e Klinës, për të cilën është ndarë buxhet në vlerë prej 9 684 854 euro. Po ashtu, kemi edhe disa projekte kapitale që mbështeten nga ministria apo Qeveria, dhe disa projekte të caktuara, për të cilat vlerësojmë se nuk janë të mjaftueshme për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve të komunës së Klinës.

Nëse i analizojmë me vëmendje, shumica e projekteve të komunës së Klinës janë të planifikuara që të fillojnë, apo të realizohen në vitin 2019 dhe 2020, kurse i kemi vetëm disa projekte që do të zbatohen gjatë vitit 2018. Do t'i veçoj disa projekte që konsiderohet se janë të domosdoshme të planifikohen dhe të buxhetohen për vitin 2018, e të cilat do të ndikojnë direkt, si në zhvillimin ekonomik, në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe në punësim. Është ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Klinës. Është një projekt apo investim i domosdoshëm që duhet të bëhet në këtë komunë. Një gjendje shumë shqetësuese është me ujërat e zeza dhe me ndotjen e lumit Klina dhe Lumëbardhi. Të gjitha kanalizimet fekale dhe atmosferike në komunën e Klinës derdhen në shtratin e Lumëbardhit dhe lumin Klina. Shtrati i këtyre lumenjve shfrytëzohet edhe për hedhjen e mbeturinave të ndryshme. Shtretërit e këtyre lumenjve nuk janë të mirëmbajtur.

Në projektbuxhetin e Komunës së Klinës, në kodin e programit 634660, 1832364 dhe kodin e projektit 47243 është planifikuar tek në vitin 2020 projektndërtimi i sistemit për trajtimin e ujërave të zeza. Ne konsiderojmë se gjendja është shqetësuese dhe një projekt i tillë është i domosdoshëm të planifikohet qysh në vitin 2018, qoftë nëpërmjet ndarjes së buxhetit për Komunën e Klinës, apo nëpërmjet ndarjes së buxhetit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa, le të përgatitet deputetja Emilija Rexhepi.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot jemi duke shqyrtuar dhe diskutuar për Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Është një ligj me rëndësi të veçantë. Konsideroj se të gjitha komunitetet dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës janë duke e përcjellë dhe pritur që ky buxhet të kalojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sepse është në interes të zhvillimit ekonomik të vendit, në interes të krijimit të vendeve të punës dhe të integritit të vendit.

Për këtë buxhet e bëri një prezantim shumë të mirë edhe ministri Hamza, se Buxheti 2018 i plotëson të gjitha kushtet ligjore për miratim në parim. Ky buxhet është i shpërndarë relativisht mirë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, në të gjitha komunat e Kosovës. Kemi rritje në subvencione, kemi rritje në bujqësi, kulturë, rini, sport, edhe pse te sporti konsideroj se ndoshta duhet të shikohet mundësia, se kemi shumë klube, në gati të gjitha komunat, apo edhe sportistë që po e Republikën e Kosovës prezantojnë në gara të ndryshme edhe jashtë vendit, ku po marrin

shumë edhe vende të para në nivelin e sportit që e prezantojnë, por komunat përkatëse nuk po kanë mundësi buxhetore t'i përkrahin. Të shikohet një mundësi ndoshta edhe kah Ministria e Kulturës që edhe ata sportistë të përkrahen, se për momentin janë ambasadorët më të mirë të Republikës së Kosovës.

Kemi rritje edhe në Arsim e në Shëndetësi, buxhet për barna esenciale. Është për t'u përshëndetur edhe buxheti për specializantët dhe për specialistët e rinj, gjë që është imediate që të mbështetet kërkesa e tyre. Në infrastrukturë, në përgjithësi, e kemi një rritje që vlen të theksohet. E kemi një rritje edhe krahas rritjes ekonomike të pagave në nivel të vendit për të gjithë shërbyesit në Republikën e Kosovës. E kemi edhe një rritje për kategoritë e dala nga lufta, që mendoj se janë kategoritë që kanë merituar më së shumti. Edhe për sistemin e drejtësisë, u tha edhe nga ministri, zoti Abelard Tahiri, që e kemi një rritje. Ne e dimë se për një sundim të mirëfilltë të ligjit dhe për luftimin e korrupsionit, i cili është më shumë se imediat për ta luftuar nga institucionet e vendit dhe të menaxhohet sa më mirë paraja publike, sepse qytetarët janë të interesuar që djersa e tyre të jetë sa më transparente kur të menaxhohet.

Është mirë që kemi rritje edhe te Këshilli Prokurorial, edhe te Këshilli Gjyqësor, që të mbështesim edhe me staf, edhe mbështetës, edhe profesional, që ta kemi një efikasitet më të mirë të funksionalizimit të sistemit të drejtësisë, e në të njëjtën kohë edhe të reformës ligjore, meqë është prezantuar edhe një pako e reformës ligjore nga ministri i Drejtësisë.

U tha edhe nga kolegët, ndoshta kjo jep të kuptohet këtu në Parlament që Kosova ka nevojë për një reformë zgjedhore, se të gjithë deputetët po ndalemi në regjionet apo komunat nga vijmë, edhe pse ne jemi të votuar në tërë Republikën e Kosovës. Unë do të ndalem pak edhe në komunën nga e cila vij unë, Komuna e Gjakovës. Realisht, për dallim nga viti paraprak, ka projekte më shumë, edhe në nivelin që janë paraparë, edhe nga niveli lokal, edhe nga niveli qendror. Janë të përfshira edhe në qytet, duke u nisur nga lumi Krena, edhe hyrje-daljet e qytetit, është një buxhet jo ndoshta i mjaftueshëm, që është i paraparë, e mund të them se gati secili fshat dhe të gjitha regjionet e komunës së Gjakovës kanë projekte, të cilat duhet përshëndetur, meqë janë mbështetur edhe nga niveli qendror.

Unë do t'i them edhe dy projekte të nivelit strategjik, duke e pasur edhe informatën që nga Ministria e Infrastrukturës, sidomos projektet që janë nga BERZH-i, në bazë të informatave që i kemi, janë diku rreth 10 milionë euro që teprojnë buxhet nga disa projekte dhe kisha kërkuar nga ministri i Financave, po edhe ministri i Infrastrukturës, që të paktën me rishikim të shikohet mundësia e rrugës që është me rëndësi të veçantë për zhvillim ekonomik, që e lidh Gjakovën me Prizrenin, aty lidhet edhe komuna e Rahovecit, që i bie të lidhet ajo pjesë e Kosovës me Rrugën e Kombit, që pastaj lidhet edhe me Tiranën, edhe me Prishtinën, gjë që do të ndikonte direkt në zhvillimin ekonomik dhe në krijimin e vendeve të punës.

Në të njëjtën kohë, kisha kërkuar që këto dy projekte që po i theksoj janë projekte që janë strategjike dhe mund të gjenden forma, siç kemi pasur praktika edhe në të kaluarën, në regjione të caktuara. Rruga Gjakovë - Junik është një rrugë që është bërë diku në fund të viteve të '80-ta dhe është një rrugë shumë e vjetruar. E aty në çdo të tretin fshat ka shkolla, që fëmijët shkojnë në shkollë, as nuk kanë trotuare, dhe këtë rrugë kisha kërkuar nga ministri i Transportit Infrastrukturës, në bashkëpunim me ministrin e Financave, ta gjejnë mundësinë për ta rindërtuar këtë rrugë, sepse ka nevojë me kapacitete të reja dhe me nevoja të kohës.

Nuk do të ndalemi në shumë projekte që u thanë edhe nga parafolësit, që janë për t'u mbështetur dhe për t'u përshëndetur, edhe ato kërkesa që janë përfaqësues të njëjta, se kërkesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës janë të njëjta. E kemi edhe rrugën që realisht është diskutuar gati çdo vit në buxhet, që e tha edhe deputetja Haxhiu, rruga që lidh komunën e Gjakovës me komunën e Junikut nëpërmjet fshatrave Smolicë, Stubëll, Berjah, Nivokaz edhe Junik. Nga Komuna e Junikut në këtë rast janë në projektbuxhet 231 mijë euro për ta lidhur deri në Nivokaz. Atëherë, i bie që ajo rrugë është diku 7 km, që përfaqësues gjysma e rrugës është e kryer. Andaj, kisha kërkuar nga ministri i Infrastrukturës dhe ai i Financave ta shikojnë mundësinë e buxhetore, 321 mijë eurove që janë ndarë për këtë rrugë, t'u shtohen edhe 250 mijë euro që të përfundojë kjo rrugë dhe ta lidhë komunën e Gjakovës, duke pasur parasysh që ajo rrugë, përveç që e lehtëson jetën e qytetarëve në ato regjione, e ka edhe një historik të veçantë në luftën e fundit, sepse ka ndikuar direkt në furnizimin e logjistikës për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe për banorët e atyre fshatrave.

Ta kemi edhe një rrugë që do ta kisha theksuar dhe mendoj se mund të përfshihet në këtë buxhet, e cila ka qenë edhe në Buxhetin 2017, një rrugë që lidh dy fshatra, fshatin Molliq me fshatin Potok. Ka qenë problem i projektuesit, ka mbetur një pjesë e vogël e rrugës pa u lidhur asfalti dhe është e pakuptimtë, ndoshta edhe joligjore, që të ndahet në mes të rrugës, të mos ketë asfalt dhe të vazhdojë asfalti në pjesën tjetër. Janë ndarë 50 mijë euro, kanë qenë të ndara edhe për këtë vit, por ndoshta ka qenë paaftësi e Ministrisë së Infrastrukturës për ta realizuar një miniprojekt.

Kisha kërkuar që atyre 50 mijë eurove të shikohet mundësia t'u shtohen diku edhe 150 mijë euro, në bazë të parametrave që i kanë projektuesit, që fshati Molliq të lidhet me shkollën e Molliqit dhe të lidhet fshati Botushë me shkollën e Molliqit, sepse janë dy fshatra të një regjioni që kanë dhënë për Kosovën dhe rrezikohet jeta e fëmijëve që vijnë në shkollë, sepse ajo rrugë është buzë malit dhe është e rrezikshme, sepse rrëshqet dheu, rrëshqasin gurët, dhe konsideroj që nuk ka ndonjë vlerë të papërballueshëm nga Buxheti i Republikës së Kosovës që të financohet për këtë vit.

Ne e kemi edhe një çështje që u bë gati historike për atë regjion. Flitet për ujë të pijes për 28 fshatra të regjionit të Rekës së Keqe. Kanë qenë 24 fshatra, projekti është zgjeruar, që tash e përfshin edhe pjesën kah Guska andej dhe ato pjesët Devë dhe pjesët më të larta të komunës, dhe

bëhen 28 fshatra. Ne e dimë që projekti ka filluar në vitin 2009, kur kanë qenë të parapara për atë projekt 1 655 980 euro. Janë realizuar nga mundësitë që i kanë pasur komunat ose pushtetet lokale atje kohë pas kohe diku rreth 700 000 euro. Ka mbetur për t'u investuar rreth 900 000 euro.

Ne e dimë që është një projekt që është financuar nga Zyra zvicerane dhe CDI-ja për rrjetin e atyre fshatrave, për rrjetin e ujit të pijes, rrjetin horizontal, kurse pjesa vertikale ka qenë në përgjithësi e Komunës, sepse edhe komuna i ka shpallur procedurat e prokurimit dhe kisha kërkuar që të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi. Ndërkohë, të përgatitet deputeti Liburn Aliu.

EMILIJA REDŽEPI: Poštovani ministri,
Kolege poslanici,
Poštovani građani,

Nacrt zakona o Budžetu Republike Kosovo za 2018.-u godinu treba podržati za pozitivnim akcentom na sveobuhvatne reforme u obrazovnom i zdravstvenom sistemu, koji su više nego potrebni svim našim građanima. To je vrednost ili velika mana jedne države u razvoju sa teškim posledicama, države koja ukoliko želi da se razvija i prati moderne savremene demokratske zemlje mora graditi i forsirati svoje unutrašnje kapacitete sa adekvatnim stručnim ljudskim resursima, ali i usavršavati postojeće.

Kao predstavnik Bošnjačke zajednice u ovom Parlamentu, moja je obaveza i odgovornost da podržim sve projekte svih bošnjačkih delegata sa lokalnog nivoa, pre svega mislim na opštinu Prizren i Peć, a već su ubačeni u Nacrtu budžeta za 2018.-u godinu. Radi se o kontinuitetu od 2009-e godine iz sfere infrastrukture, a to su izgradnja puteva, škola, ambulanti, sportskih terena, razne kulturne sale, ali i izgradnja bošnjačkog kulturnog centra u gradu Prizrenu i u gradu Peći, koji će se uskoro realizovati.

Naš prioritet i fokus kao Bošnjačka zajednica jeste velika problematika regionalni put Prizren - Rećane, i tu sem našeg budžeta zahtevamo i podršku međunarodnih vladinih i nevladinih organizacija, jer je do izgradnje tog projekta zahtevano veliko finansijsko ulaganje.

Takođe želim govoriti o razvojnoj strategiji naše Vlade, i damo podršku premijeru, gde mi poslanici iz redova nevećinske zajednice imamo moralnu obavezu da podržimo, zato što nikada do sada nismo imali ovoliki broj naših ljudi u izvršnoj vlasti, a uvek se borimo i tražimo da se poštuje Ustav Republike Kosova, odnosno Zakon o zaposlenosti manjinskih zajednica, sa

fokusom na određena resursna ministarstva, koja direktno utiču na položaj života običnih građana.

Govorim o Ministarstvu poljoprivrede, koja ima veći budžet ove godine, gde javno zahtevam veću podršku bošnjačkim poljoprivrednicima po svim opštinama gde oni žive, počev od opštine Leposaviće, pa sve do opštine Prizren. Od Ministarstva za zajednice i povratak zahtevam podjednaku raspodelu budžeta za sve zajednice, bez diskriminacije, ali nisam uvek bila za odvajanje posebnog finansijskog koda, jer se tako još više delimo po nacionalnoj osnovi. Ako se to uradi, onda treba svako ministarstvo odvajati posebne kodove, što smatram da je pogrešno.

S obzirom da je ministar Financija danas sa nama, želim ga informisati da ćemo nekoliko nas poslanika dati amandman do drugog čitanja Zakona o Budžetu, a odnosi se na povećanje finansijskih sredstava za kancelariju za zajednice pri Uredu premijera, zato što smatramo da mi tu jedino vidimo prostor oko traženja bilo kakvih vrsta pomoći za razne nevladine organizacije, razna udruženja, kulturna društva, medija iz redova manjinskih zajednica.

Naše su potrebe, gospodine ministre, jako veće, a fond te kancelarije je jako mali, te ćemo se u pismenoj formi obratiti i Parlamentarnoj komisiji za budžet i financije, i tražiti pozitivnu podršku.

Što se tiče Ministarstva za rad i socijalnu politiku, takođe zahtevam da deo planiranih aktivnosti pomenutog ministarstva ide za izgradnju kuća siromašnim porodicama, socijalnim slučajevima, i samohranim majkama u tri najsiromašnja bošnjačka sela u Župi, odnosno u opštini Prizren. Dostaviću njihova imena ministarstvu, pa neka komisija ustanovi pod kakvim uslovima i pod kakvom trenutnom stanju ovi građani žive.

U suštini, podržavam Budžet za 2018-u godinu, koji je u interesu svih naših građana, naravno uz amandmane koje ću dostaviti Parlamentarnoj komisiji za budžet do drugog čitanja u Parlamentu Republike Kosova. Zahvaljujem!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu, ndërkohë të përgatitet deputetja Vjosa Osmani.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Pata rastin ta shikoj këtë projektbuxhet dhe pjesa e fjalimit tim lidhet vetëm në pak pika, meqenëse pajtohem me parafolësit, sidomos nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, te çështjet e investimeve kapitale në infrastrukturë.

Sërish, edhe në këtë projektbuxhet, sikur edhe në buxhetet e viteve të kaluara, mund të vërejmë që Komuna e Prishtinës është lënë anash, pothuajse si çdoherë deri tash. Desha vetëm t'juaj përkujtoj që është një projekt i Qeverisë për Komunën e Prishtinës, i bërë, i hartuar, në vitin 2009 për unazën e Prishtinës. Kjo unazë e Prishtinës që prej atëherë nuk ka filluar ende të ndërtohet.

Për t'u ndërtuar kjo unazë kërkohen vite dhe jo pak buxhet, Komuna e Prishtinës me buxhetin e vet nuk ia del dot për ta realizuar. Sa më parë që të futet në buxhet kjo unazë, aq më shpejt dhe aq më lehtë do të kemi lehtësime edhe në qarkullim në Komunën e Prishtinës, e kjo do t'u ndihmonte edhe të gjithë qytetarëve që vijnë në Prishtinë, sidomos do të mund të fillonim me segmentin nga rruga Prishtinë - Shkup, te pjesa e kthesës për Gjilan në drejtim të Pallatit të Drejtësisë. Desha t'juaj përkujtoj që në këtë pjesë, në këtë lokacion, ka jashtëzakonisht shumë toka që janë në pronësi të Qeverisë dhe ku me planin e Prishtinës së Re Qendër, aty parashihet të ndërtohen ndërtesat e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Dua vetëm t'juaj përkujtoj që përgjatë këtyre viteve në Komunën e Prishtinës ka pasur jashtëzakonisht shumë kërkesa për ndërtime nga ministritë dhe institucioneve të ndryshme qendrore të Kosovës, që kërkojnë të ndërtojnë objekte në qendër të Prishtinës. Në qendër të Prishtinës më nuk ka lokacione. Ata kërkojnë mbindërtime, kërkojnë t'i fusin ndërtesat e veta afër ndërtesave tjera, gjë që është e pamundur të realizohen.

Në anën tjetër, i kemi hapësirat e lira dhe do të ishte jashtëzakonisht mirë që të planifikohej qysh tash dhe të futej në Projekt-buxhet fillimi i ndërtimit të qarkut të unazës së Prishtinës nga pjesa e rrugës Prishtinë - Shkup në drejtim të Pallatit të Drejtësisë, pastaj në vitet tjera mbase do të mund të vazhdohej.

Dua t'juaj përkujtoj po ashtu që në vend se të bëhet ky projekt, në vend se të realizohet ky projekt, i cili është gati dhe e ka hartuar vetë Qeveria në vitin 2009, Ministria e Infrastrukturës është duke bërë investime në zgjerimin e rrugës në Vetërnik dhe tash po e shoh që edhe në këtë projekt-buxhet parashihet të vazhdohen investimet në atë zgjerim të asaj ruge.

Unë kam pritur që në këtë seancë do të kemi pyetje, se unë i kam bërë pyetje parlamentare ministres së Planifikimit Hapësinor pikërisht lidhur me këtë rrugë, sepse unë mendoj se është rrugë e ndërtuar pa leje ndërtimi. Nga Ministria e Infrastrukturës nuk është marrë leje në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, pikërisht për faktin kur e di që kjo rrugë në një të ardhme shumë të shkurtër duhet të rrënohet. Pra, në vend se ju të parashihni këtu buxhet për zgjerimin e kësaj ruge, ju do të duhej të parashihni buxhet për rrënimin e një pjese të saj, sepse ky investim është bërë gabimisht. Për shkak të fushatave... është tepër gabim, sepse është Rruga A që i ka katër shirita dhe i ka 32 metra gjerësi, që planifikohet të kalojë nga Lagja e Spitalit në pjesën e Lagjes së Kalabrisë dhe duhet të kalojë nën këtë rrugë që momentalisht është duke u ndërtuar. Pra, ne jemi duke bërë investime dhe jemi duke ndërtuar tash në Vetërnik, e në një të ardhme të

afërt kjo rrugë, ky investim, duhet të rrënohet. Duhet të ndërpritet ky investim. Të ndërpritet dhe të planifikohet menjëherë, të merret leje në Ministrinë e Planifikimit, të shikohet me Inspektorat, e kështu me radhë... Të mos lejohet më tutje të bëhet investim, por të fillojë të ndërtohet ura, sepse nën të do të kalojë arteria kryesore e Prishtinës, që do të jetë Rruga A, e cila, në fakt, edhe në fushatën që e patëm ka qenë edhe premtim i të gjitha subjekteve politike, edhe pse në fakt është i pamundësuar si projekt, pikërisht për shkak të realizimit të zgjerimit të kësaj rruge në Vetërnik.

Po ashtu, desha ta ngre edhe një çështje tjetër. Neve sapo na ka ardhur Projektligji për ndërtesat e ndërtuara pa leje, pra Projektligji për legalizim. Ky është projektligji i dytë që vjen te ne për legalizim, sepse i pari ka skaduar, pjesërisht i suksesshëm. Sa i përket legalizimit të ndërtimeve ka qenë totalisht i pasuksesshëm dhe mund të rrezikojë që edhe ky projektligji që po vjen tash mund të jetë i pasuksesshëm pikërisht për faktin se në këtë projektligj që do të trajtojmë tash, taksat që kërkohen nga qytetarët për legalizim të ndërtesave janë jashtëzakonisht të ulëta, apo të mos them që gati nuk ka fare.

Dhe, nëse nuk do të kemi taksë që do të merret nga qytetarët, si do të financohet legalizimi i këtyre ndërtesave? Prandaj, është e domosdoshme që të kemi sukses të legalizimit, duhet që në këtë projektbuxhet të parashohim buxhet për komunat, për ta ndihmuar procesin e legalizimit, që është njëri ndër proceset më të mëdha dhe më të rëndësishme që ne do ta kemi në fushën e planifikimit hapësinor.

Nuk do të ketë planifikim të mirëfilltë pa pasur legalizim të suksesshëm. Këtu, unë jam i bindur që të gjitha grupet parlamentare do të jenë për Ligjin e legalizimit, por kot do të jenë për Ligjin e legalizimit po që se nuk do të kemi financa dhe buxhet për t'i ndihmuar komunat që ta realizojnë këtë projekt. Prandaj, duhet që jashtëzakonisht me urgjencë të shikohet edhe çështja e buxhetit të ndarë në ndihmë të legalizimit për komunat anekënd Kosovës dhe për këtë punë do të mund të konsultoheni bashkë me Ministrinë e Planifikimit, me që edhe vetë komunat e kanë bërë një kontribut gjatë kohës së këtij projektligji.

Pra, këto janë çështjet që unë desha t'i ngre dhe besoj se do t'i merrni parasysh, dhe gjatë kohës sa do të trajtohet ky projektligj, unë do të përpiqem që, përpos të jap kontribut, t'i bëj edhe amendamentet e nevojshme për ndryshim të këtij projektligji gjatë kohës sa do ta trajtojmë ne. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani, në ndërkohë të përgatitet deputeti Abdyl Salihu.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Do të provoj të flas shkurt, edhe pse me gjasë mund t'i përsëris disa prej çështjeve që kanë ngrehur shumë prej kolegëve deputetë, mirëpo gjithnjë duke shpresuar që sa më shumë të përsërisim vërejtje të caktuara, ato edhe mund të merren parasysh.

E para që dua të them është që çdo qeveri, përfshirë edhe këtë, duhet të largohet nga mentaliteti provincial në momentin kur ndahet buxheti. Pra, të mos lejohet logjika që e kemi dëgjuar nga deputetë të caktuar që, në qoftë se kandidatët e partisë sonë nuk fituan në këtë komunë, atëherë ne nuk do të investojmë në projekte, sepse pikërisht logjika e tillë pastaj mund të rikthehet si bumerang dhe t'i dëmtojë pikërisht ata që tregojnë se investimet bëhen për hir të partisë, e jo për hir të komunës, apo për hir të shtetit, në përgjithësi.

Çështja e dytë ka të bëjë me mospërputhjen ndërmjet prioriteteve qeveritare, pra ato që i shohim me shkrim, apo që janë deklaruar gjatë fushatës elektorale, me ato që sot i shohim si prioritete buxhetore. Ne kemi dëgjuar shumë për rritjen ekonomike, e cila, siç u tha edhe nga kolegët, me gjithë atë se njëherë është premtuar 8, pastaj 7, dhe pastaj tjera përqindje, sot u konfirmua këtu që do të jetë vetëm 4,6, gjë që tregon se me një trend të tillë do të duhen dhjetëra vite, do të duhen dekada të tëra për ta arritur mesataren e shteteve të tjera në Evropë.

Çështja tjetër ka të bëjë me rritjen e pagave, sepse është çështje për të cilën është trumbetuar nga dita e parë e Qeverisë. Me gjithë faktin që kemi dëgjuar për një rritje prej 30%, Buxheti nuk e reflekton këtë, e reflekton vetëm një rritje në fakt dhjetëfish më pak. Megjithatë, me gjithë shifrat që po përmenden, për mua brenga kryesore mbetet mungesa e fokusit në Arsim dhe në Shëndetësi.

Mund të thuhet që ky fokus ka munguar përgjatë viteve, megjithatë në fakt për herë të parë po e vërejmë një ulje prej 40% të buxhetit në Arsim, në fushën e zhvillimit të mësimdhënësve dhe të kurrikulave. Kjo është tepër shqetësuese, në veçanti për shkak të rezultatit tepër të keq që Kosova ka në PISA, rezultat që fatkeqësisht mund të përsëritet edhe në të ardhmen. Dhe, përderisa shtetet tjera që janë zhvilluar ekonomikisht kanë dëshmuar se pa zhvillimin e Arsimit, pa ngritjen e cilësisë në Arsim është i pamundur edhe zhvillimi ekonomik, te ne fatkeqësisht ende nuk po mbretëron një logjikë e tillë dhe po shkohet vetëm me logjikën e asfaltit, e jo me logjikën e ndërtimit të kapaciteteve nëpërmjet Arsimit cilësor, që do të mund pastaj ta ndërtonin e ta zhvillonin këtë shtet edhe ekonomikisht.

Pra, vetëm 3,9% të GDP-së shpenzohet në Arsim, që është më e ulët se në çdo vend tjetër të rajonit dhe, po ashtu, sa i përket ndërtimit të shkollave, besoj se shumë rajone, shumë fshatra, shumë lagje të qyteteve, duhet ta kenë parasysh se për shumë prej tyre janë paraparë katër vjet për ndërtimin e një shkolle. Kjo është tepër shqetësuese për ata nxënës që akoma mësojnë në situata tepër të rënda, shumë shpesh edhe duke u pikuar shiu, apo tashmë edhe bora gjatë dimrit, dhe pa kushtet elementare për mësim.

Meqenëse, jam te Arsimi, unë shpresoj se ministri i Financave mund ta sqarojë, te kategoria e pensioneve kontribut-dhënëse. Ka disa vjet me radhë që së bashku me kolegët e mi nga LDK-ja kemi paraqitur amendamente në Buxhet, në mënyrë që edhe përvoja e viteve të '90-ta të mësimdhënësve dhe të kategorive të tjera, që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës, atëherë të ndërtuar paralelisht dhe në kundërshtim të regjimit serb, do të njihet apo nuk do të njihet, kur të kalkulohet kontributi i tyre, sepse me gjithë faktin që ka pasur premtime se do të njihet, rrjedhimisht edhe kur kalkulohet për pensione do t'u kalkulohen edhe vitet '89-'99, sepse ata kanë punuar, rrjedhimisht është shumë e padrejtë të mos u njihet ajo përvojë e punës. Në praktikë shumicës dërrmuese të tyre nuk u është njohur kjo përvojë.

Në qoftë se te ajo kategori e pensioneve kontribut-dhënëse nuk është përfshirë edhe njohja e kësaj përvoje, shpresoj që mund të ulemi të bashkëpunojmë, në mënyrë që ta shohim se si mund të përfshihet edhe ajo, me qëllim që të mos e bëjmë të njëjtën padrejtësi që është bërë gjatë kohës së regjimit serb.

Sa i përket Shëndetësisë, për të mos e përsëritur, Fondi për Sigurime Shëndetësore, në seancën kur është bërë rishikimi i Buxhetit, shumica prej jush keni diskutuar për mungesën e rregulloreve dhe akteve nënligjore që do t'i ndihmonin hyrjes në fuqi të dispozitave të ligjit, i cili ende s'ka hyrë në fuqi. Pyetja ime është: Sa keni arritur deri tani të punoni që të përgatiten këto rregullore dhe po e përsëris atë që e kam thënë në atë seancë, kur ka vullnet, rregulloret e aktet nënligjore mund të përgatiten për 24 orë. Dhe, arsyetimet e tipit "s'janë bërë më herët" më nuk pranohen.

Pyetja është: Pse nuk po bëhen tash e tutje?

Po ashtu, sa i përket transformimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës, faktikisht transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura. Unë e kuptoj që kjo varet nga një vendim politik, mirëpo Qeveria juaj e ka premtuar këtë vendim politik dhe tani i kanë mbetur më pak se një muaj për ta realizuar atë, sepse është thënë se do të bëhet gjatë vitit 2017. Po, hajt ta zëmë që po u bëka gjatë vitit të ardhshëm, pra të fillojë procesi, sepse ne e dimë që do të zgjasë për vite të tëra. Në Buxhet nuk është paraparë asgjë për t'i reflektuar, qoftë trajnimet, qoftë hapa të tjerë që duhet të ndërmerren para procesit të rekrutimit.

Madje, ne kemi dëgjuar edhe ankesa nga Ministria e FSK-së që edhe për kapacitetet ekzistuese për ta përmbushur numrin e ushtarëve rezervë nuk kanë buxhet të mjaftueshëm, pra edhe për ato që tanimë i lejon Pakoja e Ahtisarit dhe Kushtetuta jonë, ende pa filluar procesi i transformimit.

Mendoj që në funksion të realizimit dhe të premtimit politik për transformim të FSK-së duhet patjetër që të rritet Buxheti, në mënyrë që njëherë të plotësohen të gjitha kapacitetet e FSK-së, të parapara brenda mandatit ekzistues, por po ashtu të parashihet edhe Buxheti për hapat e parë të transformimit në Forca të Armatosura.

Çështja e parafundit që dua ta ngre ka të bëjë me luftimin e informalitetit dhe evazionit fiskal, që ju e përmendët, sepse kjo ka të bëjë drejtpërdrejt edhe me luftimin e krimit e të korrupsionit. Gjithmonë përmendet si një nga kriteret, edhe në nivel të Bashkimit Evropian. Ndoshta ju e përmendët që janë duke u ndërmarrë masa, mirëpo fatkeqësisht kjo nuk po reflekton në Buxhet sa duhet, ndoshta mund t'i përmendni saktësisht dy ose tri veprimet konkrete, që Qeveria juaj po i ndërmerr për ta luftuar informalitetin dhe evazionin fiskal.

Dhe, e fundit që dua ta ngre ka të bëjë me investimet në vendbanimet shqiptare në veri të vendit. Unë e pashë Buxhetin për komunat e veriut në veri të Mitrovicës, në Zveçan, Zubin-Potok, të gjitha investimet lidhen vetëm me vendbanime serbe. Ju e dini, zoti ministër, që ka lagje ku akoma banojnë shqiptarë, me gjithë presionin e madh dhe faktit që e rrezikojnë jetën e tyre. E kemi Lagjen e Boshnjakëve, të Doktorëve, të Minatorëve, si dhe fshatrat e thellë në veri, të cilat janë të izoluar dhe sidomos tash gjatë dimrit kanë probleme të mëdha. Ne do të përgatitim edhe amendamente në bashkëpunim me banorët e asaj ane, në mënyrë që ata të mos harrohen, as nga Qeveria e Kosovës, por as nga ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës. Dhe, shpresoj që ju do t'i përkrahni, sepse vetëm nëpërmjet investimit ekonomik ne mund të shpresojmë që ata do të vazhdojnë të qëndrojnë atje në një situatë, kur fatkeqësisht institucionet e vendit nuk po bëjnë asgjë për ta shtrirë sovranitetin në veri. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Ahmet Isufi, kryetari Grupit Parlamentar të AAK-së.

AHMET ISUFI: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po shihet mungesa e kuorumit në seancë dhe, po ashtu, ka edhe njëzet të paraqitur për të diskutuar, prandaj unë kisha kërkuar që seancën ta vazhdojmë nesër, në mënyrë që të mund t'i votojmë edhe projektbuxhetin, edhe dy marrëveshjet ndërkombëtare që i kemi të parapara në agjendë.

KRYESUESJA: Atëherë, le të deklarohen të gjitha grupet parlamentare. Kush flet në emër të Lëvizjes "Vetëvendosje"? Deputeti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Edhe ashtu po shihet që numrat s'janë. Unë mendoj se me gjasë të gjithë janë të gatshëm të shkojnë të pushojnë pak në shtëpi, e nesër ta vazhdojmë seancën. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Edhe ne pajtohemi që seancën ta shtyjmë mundësisht për nesër në orën 10:00.

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të PDK-së, zoti Elmi Reçica.

(Ndërprerje e incizimit)

Atëherë, po e vazhdojmë. Në emër të Aleancës, foli. Në emër të “Nismës”, Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Po, kryetare!

KRYESUESJA: Faleminderit! Atëherë, seancën e vazhdojmë nesër, në orën 10:00.

* * *

E mërkurë, më 6 dhjetor

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 dhjetor 2017

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Po vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 5 dhjetor.

Jemi në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

Unë do t'u thërras në bazë të radhitjes së paraqitjes, ata që janë këtu, ndërkohë shpresojmë që vijnë deputetë të tjerë.

Po i lexoj emrat e atyre që janë prezentë: Arbërie Nagavci, nuk qenka, Saranda Bogujevci, Arbër Rexhaj, Driton Çausi.

ARBËR REXHAJ: Shikuar në përgjithësi dhe po t'i bësh analizë Projektbuxhetit për vitin 2018, lirisht mund të thuhet se është një vazhdimësi e njëjtë e buxheteve nga viti në vit, me disa ndryshime të vogla, me zërat e buxhetit dhe projeksione përafërsisht të njëjta.

Pritjet, përgjigjet që duhet t'u jepen qytetarëve të Republikës së Kosovës me këtë projektbuxhet janë të shumta, por po i përmend disa nga ato:

Një, a e zvogëlon papunësinë ky buxhet?

Dy, a garanton zhvillim të qëndrueshëm ekonomik?

Tre, a është bërë shpërndarja, rishpërndarja e mjeteve buxhetore në mënyrë adekuate ? dhe

Katër, a e zvogëlon varfërinë ky buxhet?

Përderisa pritjet se do të ketë rritje ekonomike prej 3,5% për vitin 2018, ky projektbuxhet jo vetëm që nuk do të zvogëlojë papunësinë, po do ta mbajë këtë status quo edhe në aspektin e papunësisë.

Po t'i analizojmë zërat e projektbuxhetit vërehet qartë se shpërndarja, rishpërndarja e mjeteve buxhetore është pothuajse e njëjtë vit pas viti, pra të themi se kjo shpërndarje nuk është e mirë. Them i se nuk është e mirë, ngase nuk ka sjellë rezultate të mira gjer tani.

Pra, pritjet, rezultate të ndryshme me veprime të njëjta nuk arrihen. Rrjedhimisht ky projektbuxhet nuk garanton as zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, as shpërndarje adekuate të mjeteve buxhetore.

Nga ajo që u tha më lart del se ky projektbuxhet nuk mund të zvogëlojë as varfërinë që i ka kapluar qytetarët e Republikës gjithandej.

Nëse hyjmë në analizë pak më detale del se shpenzimet kapitale marrin pjesë me rreth 37% të të hyrave të përgjithshme, e nëse hyjmë edhe më në detaje, pjesa dërmuese e këtyre shpenzimeve shkon në autostradën Kosovë-Maqedoni dhe e keqja më e madhe këtu se ky projekt strategjik bartet nga një punëkryes, i cili pas pagimit të taksave gjithë profitin e tij e bart jashtë Republikës së Kosovës, meqenëse është kompani e huaj.

Pagat dhe mëditjet, bashkë me mallrat dhe shërbimet janë dy zëra të buxhetit që kapin vlerën 847 milionë, ose thënë ndryshe, rreth 47% e të hyrave të përgjithshme.

A thua se Republika jonë ka aq shumë luks se të shpenzojë kaq shumë në këto kategori?

Thuaj se organizatat buxhetore janë strofull e punësimit, logjikë kjo e shekullit të kaluar.

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Kjo është e patolerueshme, sepse në çdo shtet normal bartës të punësimit është sektori privat.

Qeveritarët tanë e kanë gojën plot për zhvillim të sektorit privat, por ama zërat e buxhetit tregojnë të kundërtën.

Desha të ndalem pak edhe në zërin e rezervave kapitale, saktësisht Fondin e Likuidimit nga AKP-ja, i paraparë në këtë projektbuxhet me rreth 50 milionë.

Është interesant se edhe projeksioni për vitin 2019 dhe 2020 është e njëjta vlerë, edhe mund të dalë në realitet kështu, po dyshojmë se kjo mund të jetë realitet dhe ne nuk dimë se sa janë këto fonde deri më tani, apo nga vjen kjo vlerë deri në 50 milionë.

Këtu nuk ka nevojë të përmendet edhe numrin e madh të zëvendësministrave, të cilët e kanë degraduar këtë Qeveri, po ashtu të degraduar, sepse e rëndojnë shumë edhe buxhetin e Kosovës.

Në këtë buxhet do të duhej të parashiheshin më shumë çerdhe publike nëpër komuna që andej Kosovës, e në këtë rast Prizreni nuk e ka asnjë të tillë, pra asnjë çerdhe publike të vetme, edhe shpërndarja në çdo komunë do të duhej bërë sipas aspektit proporcional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lirije Kajtazi, të bëhet gati Faton Topalli. Jam duke përcjellë listën elektronike tash.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Po e filloj fjalën time me subjektin, i cili edhe e ka kryeministrin apo Qeverinë, zoti Pal Lekaj, i cili duke folur për buxhetin e vitit të kaluar, pa hyrë në shifra dhe pa pasur forcën të kontestojë strukturën dhe projeksionet buxhetore, ai ndalet në një çështje, duke e pyetur kryeministrin Mustafa se ku i ke ministrat edhe pse i ke me bollëk.

Prandaj, dua ta pyes edhe unë këtë Qeveri, ku janë ministrat, të cilët janë aq të shumtë, të cilët në mënyrë të vrazhdë e shfrytëzojnë dhe e konsumojnë këtë buxhet, pa menduar fort te ndarja buxhetore e arsyeshme. Pa llogaritur këtu krejt atë që derivon si pjesë e kabineteve të tyre që është konsumuesi më i madh i buxhetit.

Prandaj, arsyeja pse unë e përmend këtë është ndoshta për të përfunduar edhe me fjalën e këtij subjekti, duke i pyetur qytetarët se kujt i jepni besimin, cila është qeveria, të cilës ju i jepni votën? Unë dua ta pyes po ashtu këtë subjekt, kujt i dedikohet kjo qeveri? Kujt i dedikohet ky buxhet që është konsumuesi më i madh i parasë së qytetarëve?

Prandaj, dua të them edhe një herë, qytetarë të nderuar, mos u mashtroni nga demagogjitë e njerëzve, të cilët përdorin për parulla çështje të mëdha dhe harrojnë në momentin që ulen në karrige, harrojnë transformimin e Forcës në Ushtri të Kosovës, i harrojnë projektet, të cilat në formën më të ndryshme i kanë prezantuar.

Dhe, për të dal tek ajo të cilën ne e kemi sot në rend, Ligjin për buxhetin, i cili duhet të reflektojë projeksionet buxhetore të balancuara për çdo kategori, e sidomos për ata që ndoshta nuk e kanë mundësinë të ulen në këto karrige.

Po ashtu duke u përqendruar në memorien institucionale, duke parë atë që edhe disa kolegë deputetë dje edhe e thanë dhe programin e kësaj Qeverie, e shohin se disa pozicione të cilat janë kërkuar kanë edhe si burim rekomandime dhe rezoluta të shumta, të cilat edhe legjislatura e kaluar i ka ofruar, kujdesin për kategoritë në nevojë dhe kusht tjetër, pos Qeveria duhet të jetë kujdestari social i tyre.

Prandaj, mendoj se granti specifik, i cili u dedikohet komunave për çështjet sociale, është më se i nevojshëm të jetë pjesë e këtij buxheti. Është çështje që i kemi identifikuar bartësit dhe në këtë aspekt, ndoshta duhet të shohim saktë që kur projektohet buxheti të merren për bazë edhe të

gjitha kategoritë e tjera, të cilat në mënyrë të arsyeshme profesionale e kërkojnë buxhetin për sektorë të vet.

Për atë e kemi edhe një çështje, e cila lidhet edhe me komunën prej nga vij, është projeksioni për grantin për arsimin.

Ju dje e thatë, ministër, se granti për arsimin është shtuar, por duhet të shikohet në mënyrë të veçantë që t'u ndahet komunave, të cilat kanë specifikat e veta. Kur flas për këtë, Gjilani është me specifika, ngase arsimit zhvillohet në katër gjuhë dhe përpos kësaj, i kemi zonat kufitare që janë të prekura nga politika, janë të braktisura dhe ne detyrohemi të ruajmë cilësinë e arsimit dhe për me qenë më afër nxënësve, t'i mbajmë ato shkolla dhe në këtë drejtim kemi një shpenzim të buxhetit nga projeksioni i investimeve kapitale në 3 milionë e 400 mijë. Është shumë e konsiderueshme dhe e cenon me të madhe investimin kapital në këtë komunë, kur e dimë se kemi projekte apo shqetësime të mëdha të qytetarëve të bartura nga viti në vit.

E kemi impiantin e ujërave të zeza, kemi shumë gjëra të tjera, të cilat besoj se nëse nuk shpenzohet ky buxhet nga të hyrat e komunës në atë kategori, sigurisht që projektet për Gjilanin do të ishin shumë më të mëdha.

Po ashtu dua të ngre edhe interesimet e mia dhe besoj se në leximin e dytë do të kemi kujdes që të ndahet më shumë buxhet si në nivel qendror, dhe nivel lokal për sportin. U tha edhe dje nga kolegët, por vërtet duhet të kemi konsideratë më tepër për kujdesin ndaj rinisë, ngase shqetësimet për këtë kategori janë mjaft të larta, me shumë çështje devijonte, të cilat i preokupojnë apo i cenojnë ata.

Prandaj, më shumë buxhet për sportin, si në aspektin e arenave të larta ndërkombëtare, si në aspektin e masivitetit, nga se shumë klube rrezikojnë të shuhen në mungesë të buxhetit.

Kur flas për sportin, duhet të specifikoj edhe kërkesën për më shumë mbështetje për sportin femëror. Siç e dimë, ka më pak sporte nga femrat, ka më pak subvencione, buxhet për to, por dua të përmend një gjë, ka më shumë medalje që vijnë nga sporti femëror. Nëse shkojmë në përqindje, 55% e medaljeve vijnë nga femrat në Kosovë. Kjo na bënë krenarë të gjithëve, prandaj duhet të jemi të kujdesshëm që të dedikojmë më shumë buxhet edhe për sportin femëror dhe sportet në përgjithësi.

Dhe, po ashtu nga debatet e mëhershme nga Kuvendi kemi nxjerrë nevojën e mbrojtjes së punëtorëve si në sektorin publik, ashtu edhe privat dhe, në këtë aspekt është dashur të parashihet edhe shtimi i numrit të inspektorëve. Ndoshta bashkë mund ta shohim se së paku 10 apo 20 inspektorë do të ndikonin shumë që cilësia edhe e njerëzve, edhe mosdiskriminimi në punë të

jetë në nivelin çfarë kërkohet për arsye të shumë raportimeve të cenimit të së drejtës së punëtorëve në përgjithësi. Faleminderit!

Besoj se ne do të jemi bashkëpunues të gjithë edhe me ju, ministër, edhe me vetë Komisionin për Financa, në mënyrë që të gjitha këto që janë edhe preokupime, po edhe diçka që keni përfshirë në pjesën e programit qeverisës të reflektojë në buxhetin e këtij viti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Faton Topalli e ka kërkuar fjalën me urgjencë, le ta përfundojë, pastaj të bëhet gati Evgjeni Thaçi.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,

Të nderuara deputete,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

E di që gjatë ditës së djeshme është diskutuar bukur shumë për buxhetin e Kosovës dhe kjo është në rregull dhe e drejtë, për arsye se është njëri prej atyre ligjeve që përcakton më së shumti se çfarë do të ndodhë me qytetarët e Kosovës brenda 12 muajve të ardhshëm.

Jam i vetëdijshëm që përkundër vërejtjeve që i kanë dhënë kolegët e mi të Lëvizjes “Vetëvendosje”, por edhe të opozitës në përgjithësi, edhe këto vërejtje që do t’i bëj unë sot nuk do ta ndryshojnë buxhetin në formën që është prezantuar, sepse sipas praktikave, me ndonjë ndryshim dhe me ndonjë pazarllëk të vogël do të miratohet i njëjti buxhet i paraqitur nga Qeveria.

Ajo që dua të bëj sot është ta thjeshtëzoj kuptimin e materialit prej mbi 400 faqesh për qytetarin e Kosovës, një material i cili përmban shumë shifra, por asnjë ndryshim.

Nëse në vitin 2017 kemi pasur në dispozicion një miliard e 725 milionë euro, këtë viti buxheti është paraparë të jetë një miliard e 829 milionë euro.

Rritja e paraparë është gjithsej 104 milionë euro. Po kjo është rritje në tavolinë, për arsye se edhe vitin e kaluar kemi pas të paraparë një buxhet prej dy miliardë eurosh, i cili në fund rezultoi të jetë vetëm 1.7 milion euro.

Rritja prej 104 milionë eurosh, edhe pse për qytetarin e rëndomtë duket sikur është një rritje jashtëzakonisht e madhe, në fakt është një rritje jashtëzakonisht e vogël.

Nëse këtë rritje e zbërthejmë në shifra konkrete që të jetë e kuptueshme edhe për qytetarin e Kosovës, atëherë viti që vjen secili banor i Kosovës do të përfitojë në mënyrë direkte apo indirekte gjithsej 61,17 euro në vit, rreth 5 euro në muaj, apo 0,16 centë në ditë më shumë se sa një vit përpara, pra kaq është ndryshimi, 0,16 centë.

Shuma prej 0,16 centëve nuk është rritje rrogash, por një shumë e cila shpërndahet në gjithë strukturën e buxhetit, pra për shëndetësi, për arsim, për kulturë për të gjitha fushat.

Zoti ministër i Financave.

Thuaju qytetarëve të Kosovës se me 16 centë në ditë sa mund të ndryshojë mirëqenie e qytetarëve të Kosovës? Sa do të rritet cilësia në arsim? Sa do të zvogëlohet varfëri? Sa do ta ndjejnë bizneset këtë farë mbështetjeje prej 0,16 centë në ditë?

Nëse jeni shumë i sqartë do të duhej të pranoni se në Kosovë në raport me vitin 2017 nuk do të ketë asnjë ndryshim.

Kur ndërrohet Qeveria, zoti ministër i Ekonomisë, zakonisht ndryshohen politikat ekonomike.

Buxheti 2018 nuk reflekton ndryshim të politikave ekonomike.

Zoti Hamza, thonë që jeni ekonomist i zoti. Ajo që unë kuptoj nga shifrat dhe politikat ekonomike, shoh që qeveritë shkojnë e vijnë, ndërsa politikat ekonomike mbesin pa ato që kanë qenë deri tani.

Kur Hashim Thaçi e përfundoi mandatin e tij si kryeministër, Isa Mustafa vazhdoi t'i implementojë politikat e Hashim Thaçit.

Në buxhet pati rritje të shifrave pak aty, pak këtu, por asnjë ndryshim të politikave ekonomike, të cilat do të sillnin ndonjë ndryshim përmbajtjesor.

Por nëse ka ndonjë ndryshim si te Isa Mustafa, si tek ju tani, më thoni, cili është ky ndryshim? Ku mund të vërehet ky ndryshim? Ku preket ky ndryshim? Kush e përjetoi këtë ndryshim? Pse nuk po ndryshojnë pra deficitet tregtare nëse ka ndryshime, pse Serbia, kundërshtari ynë kryesor në rajon, vazhdon të mbetet partneri ynë kryesor në ekonomi?

Çka keni bërë nëpërmjet politikave ekonomike t'i mbështesni bizneset dhe t'ua lehtësoni konkurrencën me Serbinë dhe vendet e rajonit? Pse nuk po rritet mirëqenia e qytetarëve, por vetëm e politikanëve? Pse nuk kemi biznese më të forta? Pse nuk kemi fare prodhim? Pse po rritet vetëm numri i punëtorëve në administratë dhe jo në prodhim?

Nuk kemi ndryshime, sepse nuk kemi ndryshime të politikave ekonomike, zoti ministër.

Natyrisht që një eksperiment i njëjtë, i bërë në të njëjtat kushte, sipas të njëjtës metodë, me të njëjtat mjete, nuk mund të sjellë rezultate të ndryshme kur ai përsëritet, sepse rezultati do të jetë gjithmonë i njëjtë.

Prandaj, edhe buxhetin që kemi është buxhet i mbijetesës, por nuk është buxhet i zhvillimit. Ky buxhet është përsëritje e vitit 2014, përsëritje e vitit 2015, përsëritje e viteve 2016 dhe 2017, prandaj edhe gjendja ekonomike në vendin tonë është e njëjta në të gjitha këto vite që i përmenda.

U rrit tatimi, e me rritjen e tatimit u rrit buxheti, por nuk u shtua prodhimi, nuk u rrit mirëqenia, nuk u zvogëluar varfëria, ne vazhduam të mbesim vendi i cili jeton nga tregtia, remitencat dhe shumë më pak nga prodhimi.

Isa Mustafa nuk solli ndryshim të politikave ekonomike. Ai mbeti thjesht një kopjues i Hashim Thaçit, ashtu siç është edhe Bedri Hamza tani.

Sinqerisht më duhet të pyes për ta kuptuar si është e mundur që një doktor i ekonomisë, një akademik si Isa Mustafa dhe tjetri dje guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës, i vlerësuar si ekonomist i zoti, të mos dinë asgjë më shumë se për të kopjuar politikat ekonomike të një historiani?

Si është e mundur që ky vend, i cili jeton mbi energji që ka rezerva thëngjilli për një mijë vjetët të ardhshme dhe që paguan 50% më shumë për energji elektrike se sa të gjitha vendet e rajonit. Ky vend që jeton mbi plumb, mbi arë, ky vend që ka popullsinë më të re në Evropë të mos ketë gjetur për 17 vjet me radhë, as gjatë pushtetit të LDK-së, as gjatë pushtetit të PDK-së, një ministër të zotit, i cili është në gjendje ta nxjerrë këtë vend nga balta.

Shikojeni edhe një herë Buxhetin 2018, tatimi nga të ardhurat e korporatave në vitin 2017 ishte 84 milionë, në vitin 2018 është paraparë të jetë prapë 84 milionë, pra zero ngritje. Nëse kemi zhvillim ekonomik, nëse kemi prodhim, nëse kemi ecje përpara, do të kishte edhe rritje të tatimit, po tatimin nuk e rritni te ata që janë të pasur. Tatimi nga të ardhurat personale një vit më parë ishte 135 milionë, për vitin 2018 është paraparë që kjo rritje të jetë vetëm 11 milionë. Pra, shihet ku doni t'i merrni paratë, nuk doni t'i merrni aty ku i kanë nga 1 000 euro e 5 000 euro nëpër xhepa, po i merrni tek ata që i kanë nga 50 centë, e duhet menduar 3-4 herë se ku e blejnë bukën, a e blejnë të "Furra Prizreni", apo e blejnë te "Furra Pashtriku".

Tatimi në pronë një vit më parë ishte 25 milionë, këtë vit janë paraparë 8 milionë më shumë, fare pak.

Në përgjithësi, të hyrat tatimore direkt në vitin që po shkon ishin 251 milionë, ndërsa për vitin e ardhshëm planifikohen të jenë gjithsej 267 milionë, apo 16 milionë më shumë. 16 milionë mund të quhet sukses për një ndërmarrje ekonomike, po 16 milionë nuk mund të quhet sukses për një shtet, për Republikën e Kosovës.

Të hyrat nga tatimet indirekte në vitin 2017 ishin gjithsej 1.292 miliardë, në vitin 2018 janë planifikuar të jenë një miliard e 378 milionë, pra gjithsej 86 milionë më shumë. Kjo ndodh për shkak që tek ne ka vetëm ndryshim të emrave të kryeministrave, ndryshim të emrave të ministrave, ndryshim të emrave të zëvendësministrave, po asnjëherë ndryshim të politikave ekonomike.

E kam parasysh, zgjedhjet nacionale kanë përfunduar më 11 qershor, e kam gjithashtu parasysh që kjo Qeveri e pati lindjen e vështirë dhe pa ndonjë prerje cezariane ajo as që do mund të lindte.

Por dua të them që në këso rrethanash nuk është lehtë të bësh politika, dua të them që kam mirëkuptim për vështirësitë, ashtu siç nuk kam fare mirëkuptim për orientimin politik, për të cilin u përcaktuat vetë në Qeveri.

Tre muaj janë pak për të krijuar politika të mirëfillta ekonomike, nëse ato nuk i keni menduar më herët, e duket se nuk i keni menduar, ashtu siç tre muaj janë shumë për të filluar implementimin e politikave ekzistuese.

Sot jemi në opozitë. Megjithatë, duam që ky vend të ecë përpara, duam të ketë zhvillim ekonomik, duam që Qeveria të bëjë punë të mira, sepse kjo është në interes të qytetarëve, duam t'i bëjmë këto punë të mira, sepse kur të vijmë ne në pushtet do ta vazhdojmë aty ku kanë mbetur punët e mira, në qoftë se janë bërë fare, duam që të kemi mirëqenie qytetare dhe jemi të gatshëm ta mbështesim çfarëdo çështje që e çon këtë vend përpara.

Por politikat tuaja ekonomike nuk bëhen më të mira duke arrestuar deputetë të Lëvizjes “Vetëvendosje”, si Frashër Krasniqi e Donika Kadaj, duke mbajtur në burg Albin Kurtin, deputetin më të votuar në Kosovë, duke mbajtur në burg Atdhe Arifin apo Egzon Balajn e aktivistë të tjerë.

Ju e dini që ata që burgosin kundërshtarë politikë, ata që i dënojnë kundërshtarët politikë, ata që i mbajnë nëpër burgje, e dinë se çfarë emri kanë, veni gishtin kokës dhe mendoni se cila është e ardhmja e qytetarëve të Kosovës dhe çfarë i ofroni këtij vendi.

KRYETARI: Zoti Bedri Hazma, ministri e ka fjalën, le të bëhet gati Evgjenia.

MINISTRI BEDRI HAZMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Topalli, faleminderit për diskutimin,

E pati një diskutim goxha analitik, po me analiza të pasakta dhe të paqëndrueshme.

E para, buxheti është 2 miliardë e 82 milionë, nëse flet për pjesën e të hyrave, është diçka tjetër, nëse flet për pjesën e të dalave buxhetore është diçka tjetër, a buxheti është 2 miliardë e 82 milionë, pjesa e të hyrave është një miliard e 829 milionë kjo është deficit i buxhetor dhe çështje të tjera kur t'i shtohen.

Gjithashtu pati prapë analiza të tjera të pasakta, partner kryesor i Kosovës është Bashkimi Evropian, shkëmbime tregtare më të mëdha Kosova i ka me Bashkimin Evropian.

Sa u përket ndryshimeve, unë e di edhe pajtohem të gjithë që Kosova ka nevojë për një rritje ekonomike më të madhe, po rritja ekonomike prej 4,6 apo sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, 4,8, është rritja më e madhe ekonomike në regjion, është rritja më e madhe ekonomike që ka ndodhur në vitet e pasluftës, po i vetëdijshëm që ky nivel i rritjes ekonomike ka nevojë të kalojë edhe në nivel më të lartë.

Asnjë politikë fiskale nuk është paraparë të jetë barrë për biznesin. Besoj që jeni të informuar apo të paktën ishte dashur të jeni të informuar që Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë veprime që shkojnë në favor të ndërmarrjeve prodhuese. Janë vendimet që i lirojnë të gjitha lëndët e para, gjysmëproduktet dhe të gjitha imputet për prodhim prej tatimit të Dogonës. Janë vendime, të cilat i lirojnë të gjitha lëndët djegëse që përdoren në procesin e prodhimit prej akcizës. Dhe, gjatë këtij mandati nuk janë paraparë norma të reja tatimore, nuk janë paraparë tatime të reja.

Dhe, sa i përket ngarkueshmërisë apo pjesëmarrjes së të hyrave në totalin e buxhetit Kosova e ka ngarkueshmërinë më të vogël, sillet aty diku prej 25 deri 27% dhe zoti Topalli, ju e dini që në vendet e tjera kjo ngarkueshmëri është shumë e lartë. Po e përsëris, ky buxhet pjesën më të madhe ua kushton investimeve kapitale, 687 milionë, 33% e totalit të buxhetit, aty ku taksat e taksapaguesve kthehen te qytetarët. Ky buxhet në vete përmban rritjen e pagave, përfshirjen e tri skemave të reja sociale, rritjen e asistencës sociale për 20%. Unë nuk e di qysh thua se është buxhet i njëjtë, kur nëse Ministria e Tregtisë që është përkrahje e sektorit privat, ka 25 % rritje, Ministria e Infrastrukturës 35% rritje, Ministria e Shëndetësisë 28% rritje, shërbimi spitalor 15% rritje, Ministria e Arsimit 24% rritje, ne jemi duke u dhënë para qytetarëve, jemi duke ua kthyer paratë qytetarëve.

Prandaj, analizat janë më tepër të karakterit politik, joprofesional, jo të qëndrueshme. Unë i mirëpres edhe kritikën, jam i hapur edhe për kritikën, por realisht për kritikën, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së këtij dokumenti dhe po e përfundoj, sa i përket madhësisë së dokumentit varet kush çka do të shohë. Ka mundësi që dikush do të shohë vetëm një tabelë të buxhetit, ku janë të përmbledhura vetëm të hyrat dhe të dalat buxhetore, deficit i buxhetor, s'ka nevojë të hyjë në analitikë, por ligji e kërkon që në këtë formë të përgatitet buxheti dhe të

procedohet në Kuvend. Buxheti është publik dhe prej ditës së parë kur është aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës është në ueb faqen e Ministrisë së Financave.

Prandaj, konstatimet, analiza juaj, zoti Topalli, ishte puro politike, pa asnjë përmbajtje dhe pa asnjë saktësi profesionale. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë deputeti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit! Shifrat që kam nxjerrë unë janë shifra, të cilat janë të nxjerra nga buxheti, ju keni deklaruar dje dhe në media të hyrat janë 1 miliard e 829 milionë euro. Pra, dallimi është 104 milionë euro në mes të vitit të kaluar dhe këtij viti.

E dyta, nuk thashë që ka lëvizje numrash në buxhet, lëvizje numrash ka, nuk ka ndryshim politikash. Në qoftë se ju me politikat e reja do të thoni arsimit është i rëndësishëm, sepse me arsim krijojmë më shumë mundësi për vendin tonë, do t'i rrisim 50% të hyrat, do ta rrisim buxhetin për arsim, atëherë do të kishim ndryshim politikash. Ju e dini shumë mirë që lakun ua keni vënë kryesisht njerëzve të varfër të Kosovës, e keni ul tatimin për TVSH-në, jo ju tani, por qeveria e kaluar, prej 50 mijë euro në 30 mijë euro. Pra kjo i bie që bizneset e vogla të mos lejohen të mbesin gjallë. Ndërsa, sa u përket korporatave keni të njëjtat të hyra ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kundër-replikë, zonja Evgjëni Thaçi bëhet gati.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Zoti Topalli, e sheh që është rritur buxheti për Ministrinë e Arsimit, edhe nëse rritja e buxhetit nuk nënkupton përkrahje për arsimin, unë nuk e di çka. Sa i përket TVSH-së, e kam përgjigjen, të lutem, hulumto në vendet e tjera të zhvilluara, a ka prag a s'ka prag për TVSH-në? Prandaj, ligjet e Kosovës, edhe aty ku s'janë të harmonizuara, duhet të harmonizohen me direktivat e BE-së dhe me 'acquis communautaire'.

Prandaj, fokusi jonë është që të krijojmë parakushte për zhvillimin e sektorit privat dhe bartës i zhvillimit ekonomik të jetë sektori privat dhe kontribuues dhe gjenerues i rritjes ekonomike të jetë sektori privat dhe në këtë drejtim kam kënaqësinë t'ju informoj sot se e kam nënshkruar një marrëveshje me KFV-në për 7.5 milionë euro grant, që të kontribuojmë në fondin për garantimin e kredive dhe të ndihmojmë sektorin privat, sidomos ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Evgjëni Thaçi-Dragusha, fjala për ju.

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra të pranishëm,

Në radhë të parë dua ta falënderoj ministrin Hamza për ekspozenë e Buxhetit 2018 që bëri dje dhe gjithashtu për respektin që tregon ndaj këtij institucioni më të lartë të Republikës së Kosovës dhe ne deputetëve, i cili na gjendet sa herë që ne kemi nevojë të konsultohemi me të.

Ndërsa, për ministrat e tjerë, mendoj se do të duhej të ishin më të pranishëm gjatë gjithë kohës këtu, e shoh që ministrat e PDK-së janë, edhe dje edhe sot kanë qenë vazhdimisht këtu.

Duke qenë se ne jemi deputetë të zgjedhur me votat e qytetarëve nga e gjithë Kosova, për arsye se jemi një zonë zgjedhore, me të drejtë dhe kërkesat nga qytetarët nga të gjitha viset e Kosovës vijnë në drejtimin tonë. Por, ne nuk mund t'u përgjigjemi të gjithave, zgjedhim të akomodojmë vetëm ato kërkesa, të cilat i shohim si më emergjente. Unë kam zgjedhur të flas sot për një kërkesë, në mesin e shumë të tjerave, duke u bazuar në dy kritere: në nevojën bazike që kërkohet të plotësohet dhe në numrin e madh të banorëve, të cilët preken nga kjo kërkesë.

Të nderuar kolegë, ne të gjithë e dimë se kështu si popull kreativ që jemi, kemi zhvilluar një fond të madh dhe të pasur të barsoletave për Drenicën, e sidomos për Skenderajn, lidhur me infrastrukturën atje. E vërteta është ndryshe, jam e sigurt se të gjithë kemi qenë në atë rajon, qoftë sepse jemi nga ai vend, qoftë sepse kemi lidhje apo kemi shkuar për të vizituar komplekset, varrezat e dëshmorëve dhe të heronjve atje. Me gjithë përpjekjet e qeverive të njëpasnjëshme pas luftës dhe qoftë ato qendrore apo lokale, Skenderajt mbetet një prej komunave më të prapambetura në aspektin infrastrukturor, kjo për arsye se kjo komunë ka qenë e lënë pas dore dhe e harruar me dekada, kjo për arsye se kjo komunë ka qenë e shkatërruar totalisht gjatë luftës dhe gjithçka ka filluar nga zeroja. Prandaj, unë mendoj që duhet t'i jepet një vëmendje e shtuar akoma kësaj komune.

Të nderuar kolegë, një kërkesë që unë dua ta shtroj dhe kam nevojë për mbështetjen tuaj është një projekt për kyçje në ujësjellës, me të cilin preken mbi 15 mijë banorë të komunës së Skenderajt. Janë një numër i madh i fshatrave, të cilat kanë nevojë emergjente për ujë, duke filluar që nga Llausha, Rezalla e Re, Kllodernica, Tushila, Kopiliqi, Turiqefci, Buroja, Vojniku, Izbica, Runiku, Leqina, Çubrelë, e deri në Vitak. Mbi 15 mijë banorë, të cilët kanë nevojë urgjente, faktikisht këto fshatra komuna e Skenderajt ua ka shtruar rrjetin primar të ujësjellësit, është bërë instalimi dhe kompletimi i rrjetit primar të gypave, ndërsa rrjeti sekondar, apo kyçja individuale në ujësjellës ka mbetur e parealizuar për mungesë të fondeve.

Prandaj, mendoj që nuk jam e tepërt nëse kërkoj që në Buxhetin 2018, komunës së Skenderajt, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, zoti ministër Lluka s'qenka këtu, t'i ndahen fonde të mjaftueshme për kompletimin e këtij projekti mjaft të rëndësishëm. Amendamentin me

arsyetim do ta paraqes me shkrim mes dy leximeve të projektligjit. Kërkoj mbështetjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe kolegëve deputetë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Myfera Shinik.)

KRYESUESJA: Fjalën e ka Saranda Bogujevci.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot dua të ngre disa çështje rreth planifikimit të buxhetit, specifikisht rreth komunës së Podujevës.

Së pari, dua të ngre çështjen e petitionit të banorëve të Orllanit që është dorëzuar dhe prezantuar në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Peticione, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur. Qysh nga viti 2011 banorët e Orllanit kanë kërkuar që të bëhet zgjidhje e ujit të pijshëm në këtë rajon. Banorët e fshatit Orllan dhe fshatrave përreth që janë, fshati: Brain, Herticë, Turiqicë, Rakinicë, Muhazob, Bllata, Metergovc, Bervenik, Kalaticë, Brainë dhe Kushevicë, ku në përbërje janë më shumë se 3 mijë banorë dhe nuk kanë ujë të pijshëm.

Këta banorë janë të varur nga pusët e hapura, ku uji në është i kontaminuar. Për shkak të mungesës së ujit të pijshëm, është edhe njëra ndër arsyet që shumë banorë nga këto fshatra janë edhe duke u larguar, por ka edhe prej banorëve domethënë që janë sëmurë për shkak të ujit të kontaminuar. Është absurde që këto fshatra rrethohen me Liqenin e Batllavës, ku një pjesë e Kosovës furnizohet me ujë të pijshëm dhe këta nuk kanë qasje në ujë të pijshëm. Komuna e Podujevës ka ndarë një buxhet minimal prej 50 mijë eurosh për vitin 2018, afër 130 mijë euro për vitin 2019, që nuk është i mjaftueshëm për të rregulluar këtë problem dhe për t'ua mundësuar banorëve kyçje në ujësjellës.

Ujësjellësi Rajonal "Prishtina" ka dorëzuar projektin në Komunën e Podujevës dhe unë propozoj që në nivelin qendror të planifikohet buxheti që u mundëson këtyre banorëve kyçje në ujë të pijshëm që është e drejtë e tyre njerëzore.

Çështja tjetër ka të bëjë rreth ndërtimit të shkollave. E pashë në buxhet që është planifikuar ndërtimi i disa shkollave në komunën e Podujevës, por unë dua ta di se çka do të ndërmerret për objektet ekzistuese. Një pjesë e madhe e shkollave në fshatrat e komunës së Podujevës janë në gjendje të keqe, pjesa më e madhe e tyre kanë tualete jo të shfrytëzueshme, disa i kanë edhe jashtë shkollave, domethënë po flasim për shkollat fillore, ku fëmijët janë të vegjël dhe sidomos gjatë kohës së dimrit duhet të largohen jashtë objektit të shkollës për këto nevoja.

Çështja tjetër ka të bëjë me ndërtimin e rrugës Prishtinë - Podujevë, nuk ka asnjë informacion për qytetarët se kush është mbikëqyrës i këtij projekti, sa janë shpenzuar deri më tani, cila është kompania kontraktuese, sa do të zgjasë projekti, si duket ky projekt, si dhe deri ku do të bëhet zgjerimi i këtij projekti. Gjithashtu, është parë se një pjesë e asfaltit që është shtruar është dashur të prishet dhe të shtrohet prapë, domethënë që nuk është bërë punë e mirë, prandaj lind pyetja kush është duke mbikëqyrur këtë punë?

Çështja tjetër ka të bëjë me planifikimin e Kompleksit Memorial të Demë Ahmetajt. Në maj të këtij viti është dorëzuar një kërkesë nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prishtinë për të parë gjendjen ekzistuese e kullës së Demë Ahmetaj në fshatin Reçicë të Podujevës. Si proces, domethënë ka zgjatur deri në shtator të këtij viti, ku është bërë projekti ideor, është shqyrtuar në Komision për shqyrtim dhe vlerësim në IKMM, është lëshuar një aktvendim gabim nga Komuna e Podujevës, domethënë projekti është dorëzuar në Drejtorinë e Urbanizmit në Komunën e Podujevës dhe ky aktvendim ka qenë i gabueshëm, për shkak se është bazuar vetëm në projektin ideor. Dhe, nga komisioni është kërkuar që në bazë të projektit ideor të përgatitet projekti kryesor, ku paraqitet paramasa dhe paralogaria, si dhe të prezantohen detajet e çdo investimi të restaurimit dhe konservimit të objektit për Demë Ahmetajn.

Pra, pa miratim dhe në kundërshtim me vendimin e lëshuar nga IKMM-ja dhe në kundërshtim me Ligjin për trashëgiminë kulturore është rrënuar komplet objekti i Demë Ahmetajt, domethënë nga vetë Komuna e Podujevës. Më intereson ta di se çfarë do të ndërmarrë Ministria e Kulturës rreth kësaj çështjeje dhe tjetra, çfarë do të ndërmarrë Ministria e Kulturës për të mbrojtur trashëgiminë kulturore në komunën e Podujevës, domethënë në Llap dhe Gollak, për shkak se janë shumë objekte që janë rrënuar dhe trashëgimia kulturore po dëmtohet në këtë rajon.

Domethënë, nuk mund të ndërtojmë të ardhmen nëse e shkatërrojmë atë që ka mbetur si trashëgimi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Përshëndetje për të gjithë!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Ne sot po vazhdojmë të trajtojmë projektligjin më të rëndësishëm me të cilin përcaktohen zhvillimet e të gjitha segmenteve institucionale dhe shoqërore në vendin tonë. Unë nuk dua të lëshohem në detaje të planifikimeve në projektbuxhet apo analizën e projekteve konkrete për investime kapitale, por do të insistoj në kërkesën për sqarim përse, në fakt, ka një disharmoni kaq të madhe mes programit qeverisës dhe projektbuxhetit.

Gjatë përgjigjeve që i dha dje qeveria, përkatësisht ministri Hamza, vetëm sa konfirmohet kjo shpërputhje e madhe. Në fakt, dje na ofroheshin dy të vërteta: një nga deputetët opozitarë dhe një nga Qeveria apo ministri Hamza. Por, ajo çka unë kërkoj është që zoti Hamza të na flasë për dallimin e madh në mes të këtyre dy të vërtetave. Dje na u tha një e vërtetë që në Kosovë do të ketë rritje ekonomike 4,6% në vlera nominale, kurse 4,8% apo 5% në vlera reale. Dhe, kjo përafërsisht do të jetë e njëjta për tre vjetët e ardhshme, kjo është e vërteta e parë. I nderuar ministër, e vërteta po ashtu është që në programin qeverisës është parashikuar një rritje diku rreth 7% apo 8%.

Po lëshohem në të vërtetën tjetër, ju na thatë që rritja e pagave në sektorin publik në Kosovë në vitin 2018 do të jetë 3,5% apo deri në 4%, mirëpo e vërteta tjetër është që në program keni thënë që rritje do të ketë deri në 30%. Në programin qeverisës parashiheshin si prioritete dy segmente të rëndësishme, arsimit dhe shëndetësia. Dhe, ju dje na thatë që do të ketë rritje të buxhetit në këta dy sektorë, pajtohem edhe këtu, por i nderuar ministër, me reflektimin në këtë projektbuxhet është krejt i kundërt. Ju keni mundur të rrisni buxhetin në kategoritë e tjera buxhetore brenda sektorit të shëndetësisë, por Fondin për Sigurime Shëndetësore, tek të cilët njerëzit presin përmirësim të shërbimeve shëndetësore, ju e keni ulur në vlera minimale, nga 30 milionë sa ishin paraparë në vitin 2017, e keni zbritur në 3 milionë në vitin 2018.

Kurse, në fushën e arsimit krahasuar me vitin 2017 e keni reduktuar buxhetin në shifrën prej 40% dhe atë në dy temat më të rëndësishme që prekin gjendjen e arsimit në Kosovë: atë për zhvillimin e kurrikulave dhe zhvillimin e programeve për përmirësimin e mësimdhënies. Paradoksi i radhës vjen te FSK-ja. Në programin qeverisës thuhet qartazi se “FSK-ja do të transformohet në ushtri të rregullt”. Nga ana tjetër, për këtë çështje nuk ndahet asnjë cent shtesë, përveç shumë prej 58 milionëve, të cilat janë në fakt para për shpenzimet e rregullta që i bën FSK-ja sot. Nga ana tjetër, edhe pse po më vjen keq që sa herë diskutohet për buxhetin, jemi të detyruar në njëfarë forme të flasim edhe për veteranët e luftës dhe kjo bëhet pikërisht për vetë fajin e Qeverisë, e cila nuk po shpreh gatishmërinë që të merret me zbatimin e plotë të ligjit, i cili do të bënte kategorizimin dhe do të ndihmonte pastrimin e listave të tyre, ku përfundimisht mashtruesit dhe manipuluesit do të hiqeshin nga aty, kurse për veteranët e vërtetë do të kërkonim të gjejmë mundësi të tjera që pensioni i tyre të rritet.

Me këto lista fiktive, të nderuar deputetë, ne kemi paraparë shumë prej 58 milionë eurove, kurse për invalidët 38 milionë euro, që në total kap shifrën diku 96 milionë euro. Këto mjete nuk do të mjaftojnë deri në fund të vitit 2018 dhe për këto kategori do të duhen edhe rreth 30 milionë shtesë. Me sigurinë më të madhe, të nderuar deputetë, po them që jemi i vetmi vend në botë pothuajse që ndajmë më shumë para për njerëzit që kanë luftuar para 17 vjetësh se sa për ushtrinë e sotme, ose ushtrinë, të cilën ne po mendojmë ta krijojmë dhe që varet siguria jonë individuale apo kolektive. Domethënë, ndajmë diku 100 milionë për veteranë, ndërkohë ndajmë 56 milionë për FSK-në.

Definitivisht, paradoksale!

Do të lëshohem edhe në një element tjetër që për mua nuk ka të bëjë shumë me projektbuxhetin e sotshëm, por ka të bëjë me një kulturë të keqe që është instaluar në mënyrën se si po shpenzohet paraja publike në këtë vend, dhe cili është ky? Po e marr rastin e parë, e di që kjo është një temë, e cila nuk dëshiron të flasë thujse askush, e di që është një temë që ngjall pak ndjeshmëri, cila është kjo? Ndarja e 300 mijë euro për familjarët e Kumanovës. Tash dikush do të thoshte, po, mirë është bërë sepse ata kanë nevojë për një mëshirë materiale. Unë mendoj krejtësisht tjetër, ata nuk kanë nevojë për mëshirë materiale, të nderuar deputetë, ata kanë nevojë që Qeveria bashkë me institucionet e saj vartëse, AKI-në, Policinë, të na dhënë përgjigje kush janë ata që i organizuan bijtë tanë, djemtë tanë nëpër gjithë Kosovën, i mblodhën dhe i dërguan për t'i vrarë diku ose i dërguan që një pjesë e tyre të vuajnë sot dënimin atje, duke u torturuar çnjerëzisht.

Dhe, kjo është përgjigjja që, në fakt, kërkojnë ata familjarë. Kjo është përgjigjja në fakt që kërkojmë edhe ne si shoqëri këtu dhe jo për të provuar me forma abuzive, ndoshta të vendimmarrjes politike, për të provuar me nja 300 mijë euro të pastrohemi me këtë çështje. Qeveria ka për obligim që institucionet tona, po them AKI-ja dhe Policia e Kosovës, unë nuk e di cila është përgjigjja e tyre se si mundet që në Kosovë dikush të organizojë ekspedita të njerëzve për t'i çuar dhe për t'i vrarë ata. Besomëni, ma kujtojnë një kohë masakrën e Tivarit, kur mblidheshin njerëz nëpër Kosovë dhe dërgoheshin e vriteshin diku. Kjo është përgjigjja që duhet kërkuar dhe jo me 300 mijë euro ose 400 mijë euro.

Çështja tjetër që nuk lidhet me këtë ka të bëjë me faljen e tantimës për ambalazhuesit e ujit. Merret vendim që diku 58 milionë euro t'i falen dikujt, dhe kush janë ata? Disa nga ta janë kompani private në Kosovë, të cilat ka vendim gjykate që janë dënuar për mashtrim ose janë në proces të trajtimit nëpër gjykata. Dhe ne çka bëjmë si qeveri, u falim 58 milionë euro atyre. Prandaj, kjo formë e abuzimit të vendimmarrjes politike për shpenzimin e parasë në Kosovë mendoj që duhet të marrë fund dhe krejt në fund, duke e parë që ky projektbuxhet si i tillë, po them është në kontekst të asaj që unë e thashë që ka një disharmoni të madhe me programin e Qeverisë, është mirë që t'i kthehet Qeverisë edhe një herë, të provojë që të bëjë një lidhje ose të vendosë frekuenca mes projektbuxhetit dhe programit të Qeverisë dhe më pas të na e sjellë edhe një herë këtu për votim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Ministri Bedri Hamza e ka fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Zoti Selmanaj, faleminderit për diskutimin. Dua të besoj që i ke lexuar me kujdes edhe programin e Qeverisë, edhe buxhetin. Ka një ndërlidhshmëri edhe nëse e shikojmë se cilat janë prioritetet në programin e Qeverisë që janë reflektuar edhe në buxhet. Nëse e kemi dhënë prioritet rendin dhe ligjin, kemi rritje të buxhetit për sektorin e rendit dhe ligjit.

Nëse kemi thënë që është prioritet, shëndetësia ka rritje, i vetëdijshëm që rritja ka nevojë të jetë edhe më e madhe edhe për arsimin, prandaj ka një ndërlidhshmëri.

E përmende çështjen e rritjes ekonomike, besoj që më tepër ka qenë çështje teknike e numrave, mirëpo nëse e shikojmë me kujdes, në projektbuxhet thotë se rritja ekonomike reale do të jetë 4.6%, ndërsa rritja nominale 6%. Mirëpo, pak më poshtë thotë se rritja mund të kalojë mbi këto nivele dhe unë besoj që duhet të fillojnë se është koha e fundit kur duhet të fillojnë investimet në projektet e mëdha, si janë projektet e reja gjeneruese në energji dhe këto investime që priten të ndodhin në një periudhë të ardhshme 4-5 vjeçare në nivelin e rritjes ekonomike, edhe reale po flas, e çojnë atje ku është e planifikuar me programin e Qeverisë.

Sa i përket rritjes së pagave, ne kemi thënë që do të ketë rritje të pagave brenda mandatit, se kemi qenë të vetëdijshëm për legjislacionin aktual që është në fuqi që rritjen e pagave e lidh me rritjen ekonomike. Nëse trendet e rritjes ekonomike janë të tilla sipas planifikimeve, brenda mandatit, do të thotë se rritja e pagave do të jetë rritje sinjifikante. U përmend rritja e buxhetit për shëndetësi dhe arsim, që ka ndodhur. Ka ndodhur në pozicione të caktuara dhe prioritetet besoj që ministrat e ministrive të linjës i kanë caktuar drejt.

Sa i përket çështjes së shndërrimit të FSK-së në ushtri, unë ju siguroj se aspekti financiar, buxheti, nuk do të jetë problem për transferimin e FSK-së në ushtri. Të kryhet pjesa tjetër, ka mundur të kryhet më herët po të ishim ne të vendosur dhe pak më vizionarë, ka mundur të jetë punë e kryer. E di ti Driton pse s'është kryer, jam i sigurt që e di, nëse s'e di ta tregoj herën tjetër, por ka mundur të jetë sot e kryer dhe ne të flasim se si ta rritim Buxhetin dhe ta përkrahim këtë organizatë buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër! Replikë, Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Po, i nderuar ministër!

Në fakt, po e konfirmon atë që tashmë e thashë unë. Nuk po e kontestoj atë që po e thoni ju, domethënë po, është e vërtetë. Rritjen ju po e parashihni 4,8 eventualisht 5, por në program e keni thënë deri në 7-8 dhe në projektbuxhet, madje keni folur për tre vjetët e ardhshme. Tash, nëse flasim për rritje të pagave, tash po thoni 3,5- 4, pajtohem kjo është e vërtetë, shumë e saktë, por në program keni thënë 30%, dhe nëse shkon për tre vjet nga 3,5%, sepse me ligj kemi thënë që rritja e pagave do të jetë konform rritjes ekonomike të vendit, atëherë nuk mund të kalojë më tepër se 14%, por jo 30%.

Dhe si i tillë, po veç një sekondë, unë po flas, vetëm të ketë një lidhje, një konvergjim ndërmjet programit dhe mos u hidhni hi syve njerëzve në Kosovë, për të thënë që... Edhe në Shëndetësi, është e vërtetë që ka rritje, po ka në linja buxhetore, të cilat nuk lidhen me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, për të cilin ne po vlerësojmë dhe njerëzit presin që me Fondin për Sigurime

Shëndetësore mund të rritet ose të përmirësohet ofrimi i shërbimeve. Fol për atë që unë po flas, jo për atë që ti po dëshiron të flasësh. Po e thua të vërtetën, shumë e saktë çka po thua, por nuk është ajo çfarë unë po them. Ka një mospërputhje.

KRYESUESJA: Kundër-replikë, ministri Hamza!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Kurrkund në program nuk shkruan që rritja ekonomike do të jetë 8%. Është 5 deri në 7%. Dhe, kurrkund në program nuk shkruan që rritja ekonomike qysh vitin e parë të qeverisjes do të jetë 7%.

Nëse flasim për rritjen e pagave, ajo nuk do të jetë 3,5, por do të jetë më e madhe se 3,5, dhe nëse e marrim në periudhën 4-vjeçare me një mesatare prej 4% dhe themi e mbështetim në kumulativ, del se do të jetë ndoshta diku deri 20%. Unë nuk e kam parë në program, nuk e di ku e ke parë 30%? Prandaj, në këtë drejtim jemi shumë në rregull unë, jo ju me shifra, se po i ngatërron. Nuk e di a po i harron, apo vetë po i ngatërron.

Edhe te çështja e sigurimeve shëndetësore, duhet bërë një dallim. Sigurimet shëndetësore paguhën 3,5% prej punëdhënësit, 3,5% prej punëtorit. Futja e sigurimeve shëndetësore nënkupton që e rrit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër! Fjalën e ka Mërgim Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Jemi duke e trajtuar një çështje shumë të rëndësishme për qytetarët dhe jam i vetëdijshëm se interesi për të diskutuar për këtë pikë është shumë i madh. Prandaj, do të mundohem të mos e zgjas dhe të jem konkret në diskutimin tim.

Më lejoni që ta përgëzoj Qeverinë, e në veçanti ministri Hamza për punën e tyre dhe njëkohësisht edhe ministrat tjerë, që për harmonizimin e projekteve për vitin vijues një proces ky jo i lehtë karshi nevojave dhe kërkesave për realizimin e projekteve në dobi të zhvillimit dhe ngritjes së mirëqenies së përgjithshme të vendit. Pasi e kaluam vitin zgjedhor të zgjedhjeve nacionale dhe lokale, është me rëndësi të veçantë t'u japim qytetarëve zgjidhje të shumë problemeve dhe sfidave që kanë në jetën e tyre.

Jam jashtëzakonisht i kënaqur që ky projektbuxhet ka vendosur në fokus për t'i përmbushur objektivat dhe për të mundësuar zhvillimin në disa sfera, që për vite kanë qenë në qendër të diskutimeve të fjalimeve boshe, mirëpo tani po e marrin formën e vet të realizimit. Në këtë kontekst veçoj, si vijon:

1. Adresimi i duhur i nevojës për avancimin e mëtejshëm të sistemit të drejtësisë, duke mundësuar kështu rritjen e numrit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në këtë sektor dhe njëkohësisht edhe rritjen e investimeve kapitale, që do të kontribuojnë në efikasitetin e përgjithshëm të këtij sektori;

2. Veprimin konkret me Sektorin e Shëndetësisë, që rezulton në rritjen e buxhetit për këtë sektor të rëndësishëm jetike për qytetarët e vendit tonë, duke mundësuar fillimin e implementimit të skemës së sigurimeve shëndetësore dhe rritjen në ndarjet nga barnat esenciale, si dhe duke ofruar financim të plotë për pagesën e specializantëve, të cilët për shumë kohë kishin mbetur në mëshirën e fatit dhe orvateshin nga një zyrë në tjetrën për ta fituar të drejtën e tyre;

Një element shumë i rëndësishëm është edhe ofrimi i mbështetjes buxhetore për punësimin e mjekëve specializantë dhe infermierëve të rinj, që përmbush zotimin tonë si Parti Demokratike të Kosovës për përmirësimin e shërbimit shëndetësor në vend, duke rritur gjithashtu edhe shpenzimet kapitale për mbi 130%.

3. Gjithashtu, nëpërmjet këtij buxheti po e merr formën edhe përfundimi i rrugës M-2 për Mitrovicë, projekt i cili krahasuar me vitin e kaluar ka shënuar rritje të ndjeshme, duke e mbyllur kështu neglizhimin dhe pengesën disavjeçare që e kanë tejzgjatur këtë proces, me të cilën janë përballë e dëmtuar qytetarët e këtij rajoni;

4. Rritjen e përfitimeve të asistencës sociale për 20% brenda vitit 2018. Fillimin e financimit të skemave të përkrahjes për qytetarët e paafëtësuar në vendin e punës, për pensionin familjar, për pagesën e mbështetjes financiare për qytetarët paraplegjikë dhe kujdestarët e tyre, si dhe për mbështetjen familjare për viktimat e dhunës seksuale në luftë.

Për veteranët e luftës është paraparë mbështetja adekuate sipas dispozitave ligjore në fuqi. Në të njëjtën kohë, buxheti për kulturën, rininë dhe sportin është rritur 36% dhe, ndër të tjera, parashih edhe fillimin e ndërtimit të Stadiumit Nacional të Kosovës në Drenas, vendim të cilin e përshëndes.

Vlen të përsëritet gjithashtu mbështetja me mbi 7 milionë euro për subvencionimin e ndërmarrësve privatë, në veçanti për ndërmarrjet që udhëhiqen nga të rinjtë dhe gratë, qëllim ky që do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve të konkurrueshmërisë të ndërmarrësve privatë, si dhe përkrahja e inovacioneve në fuqizimin e ndërmarrjeve dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Natyrisht, nevoja për zhvillim është shumë më e madhe në raport me burimet ekzistuese të financimit, mirëpo ndryshimet dhe avancimet e bëra, sidomos në Sektorin e Drejtësisë dhe Shëndetësisë, japin sinjale për zhvillimin pozitiv për qytetarët e vendit në vitin që vjen. Unë besoj, megjithatë, se tani po lëvizim kah fundi i një periudhe të vështirë, kur qytetarët i kemi lodhur me fjalime dhe me veprime konkrete për ta përmirësuar jetesën e tyre.

Nga analiza që i kemi bërë këtij projektbuxheti, kam parë se nuk pretendon të bëjë gjëra me paratë të cilat nuk i posedojmë, sikur nuk ka ndodhur në të kaluarën, e që ka qenë një përvojë e keqe, kur mjetet financiare të parapara shpenzoheshin pa arsyetim përkatës dhe për mundësinë e shfrytëzimit të tyre. Megjithatë, në çdo projektim të mirë kemi nevojë për përmirësime. Duke qenë i informuar për një rast në shkollën e mesme të Gjimnazit “Hamzë Jashari” në Skenderaj, shkollë që është dashur të përfundojë qysh moti, por fatkeqësisht është larguar fare nga Buxheti 2017, ndërsa nuk është planifikuar as në këtë projektbuxhet të vitit 2018. Andaj, për këtë çështje do të kërkoj një amendament në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duke mos i dëmtuar projektet tjera, por konsideroj se kemi obligim ndaj projekteve që kanë filluar në vitin 2015.

Gjithashtu, në këtë projektbuxhet kemi nevojë të reflektojmë edhe për çështjen e trajnimeve, pasi ne e dimë shumë mirë se secila organizatë buxhetore i ka të planifikuara trajnimet në institucionet e tyre, por besoj që ka nevojë të centralizohet dhe e kemi institucionin përgjegjës që merret me trajnimet e shërbyesve civilë. Është IKAP-i që i realizon dhe është nën ombrellën e Ministrisë së Administratës Publike, besoj që e ka edhe përgjegjësinë ligjore që ta bëjë një gjë të tillë.

Mirëpo, nuk duhet harruar që ky projektbuxhet nuk sjell sukses vetvetiu dhe pa angazhim konkret. Mund të bëhet vetëm një plan i mirë në letër, gjë për të cilën jam i vendosur që në asnjë rrethanë të mos ndodhë, dhe në asnjë rrethanë të cenohet e drejta e qytetarëve për mirëqenien e tyre.

Të nderuar kolegë,

Nuk mund ta nënvlerësojmë faktin se sa i rëndësishëm është përmirësimi në sektorin e lartcekur për qytetarët e vendit, sidomos në atë të Shëndetësisë. Nuk mund të përfundojmë vetëm në kundërshtim për agjendë të politikës ditore, të llojit “ky”, “ju”, “këtë gjë”, “jo atë gjë”, që Qeveria nuk mund ta bëjë, ose mund ta bëjë. Nuk duhet të zgjedhim për të siguruar që Qeveria të marrë përgjegjësinë për të cilën është thirrur dhe kësaj të japë dritë të gjelbër për fillimin e realizimit të projekteve të shumta për t’i përmirësuar shërbimet për qytetarët dhe për të mundësuar zhvillimin e vendit tonë.

Duke marrë parasysh këto gjëra që i thashë më sipër, ju ftoj ta votoni në lexim të parë Projektligjin e Buxhetit për vitin 2018, pastaj ndërmjet dy leximeve, nëse ka ndonjë gjë për t’u

shtuar, ose nëse ka nevojë për harmonizime të mëtejme, mund ta bëjmë atë duke propozuar amendamente në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Drita Millaku. Pas zonjës Drita, Hykmete Bajrami, Abdyl Salihu. Urdhëroni!

DRITA MILLAKU: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Projektligji për Buxhetin ka mangësi të mëdha, duke filluar nga shpërndarja jo e barabartë e granteve për komuna dhe mosndarja e buxhetit për shumë institucione të rëndësishme për shtetin.

Për shembull, buxheti për RTK-në është 11 200 000 euro, ku nuk mund të gjejmë asnjë të dhënë se sa persona janë të punësuar aty. E në anën tjetër, e kemi sistemin prokurorial, për të cilin janë ndarë 9 423 350 euro dhe aty ka të punësuar një numër të konsiderueshëm të punëtorëve. Te sistemi gjyqësor, ku ka të punësuar 2 271 të punësuar, buxheti është 23 495 000 euro. Buxheti për Policinë e Kosovës është 58 milionë euro dhe nga kjo shumë vetëm 11 800 000 janë të dedikuara për investimet që kanë të bëjnë me forcimin e kapaciteteve të Policisë, e të tjerat janë për paga dhe për luksin e njerëzve të kapur të Policisë, që janë të kapur nga politika, sidomos të atyre me yje të plotë, që e kanë privatizuar Policinë dhe bëjnë shpenzime marramendëse, duke filluar nga pagat e deri te shfrytëzimi i automjeteve zyrtare për qëllime private. E në anën tjetër, patrullat që intervenojnë të parat në vendin e krimit i kanë automjetet e shkatërruara dhe janë njerëz që nuk arrijnë t'i kryejnë shërbimet adekuate, policë pra që nuk mund të arrijnë t'i kryejnë shërbimet adekuate.

Pra, njëra ndër arsyet kryesore, edhe pse nuk po bëhet Ligji për pensionimin e Policisë, është pikërisht se kjo pjesë shumë e madhe e majorëve, nënkolonelëve e kolonelëve, duhet të dalin në pension. E, kjo nuk i konvenon politikës mafioze. Pyetja për Qeverinë është: A janë më të rëndësishëm ata policë të patrullës, të cilët e kanë shumë më të vogël pagesën për rrezikshmërinë se sa ata policë që rrinë nëpër kolltukë dhe japin urdhra antiligjorë dhe bashkëpunojnë me krimin.

Buxheti për Forcën e Sigurisë, u tha edhe nga parafolësit e mi, është një shumë prej 18 491 800 euro. Pra, prej kësaj shume vetëm 4 300 000 euro kanë të bëjnë me rritjen e kapaciteteve të automjeteve taktike. Pyetja për Qeverinë është: Ku ka në botë që ushtria të bëhet me katër milionë euro? Dhe, pyetja tjetër është: A doni ta bën ushtri FSK-në apo RTK-në, sepse po shihet që një shifër shumë më e madhe është ndarë për RTK-në sesa për Forcën e Sigurisë.

Buxheti për Presidentin e kemi vërejtur se e ka një rritje prej 20%, pra gjysmë milion më tepër seç ka qenë. Çka po i duhet kjo rritje buxhetit të Presidentit, kur nuk i ka mbetur asgjë tjetër, veç

të kërkojë të takohet me Vuçiqin dhe të bëjë shpërndarje të dekoratave, edhe atë pa kriter. E në anën tjetër kërkesa për dekorimin e komandant “Drinit” rri në sirtarë tash e 4 vjet. Pra, nuk e dekoron për shkak se me urdhër të tij dhe me dijeninë e tij dhe të Kadri Veselit ai është vvarë.

Qeveria e Kosovës deri dje i ka pasur 67 zëvendësministra, ndoshta sot është rritur ky numër, nuk dihet, por do ta kuptojmë më vonë, dhe sipas një përlllogaritjeje të shpenzimeve të tyre, për 4 vjet kjo arrin 10 milionë euro, shumë me të cilën do të ndërtoheshin së paku 500 shtëpi për të pastrehët, apo 28 571 paga mesatare. Pra, për shkak të luksit të madh qeveritar jeni duke ua marrë bukën e gojës mbi 28 mijë familjeve.

Dua të ndalem te grantet nëpër komuna. Janë ndarë pa kurrfarë kriteri, për shembull, për Prizrenin me 186 000 banorë janë ndarë vetëm 36 400 000 euro. Po të bazohemi në bazë të popullsisë, atëherë vërejmë se, për shembull, për Graçanicën me 10 500 banorë janë ndarë 6 milionë, e nëse bazohemi në bazë të popullsisë del se Graçanica i ka 6 milionë investime, e Prizreni është dashur t’i ketë mbi 90 milionë, ose Leposaviqi, i cili i ka 15 mijë banorë, dhe janë ndarë 4 milionë e gjysmë euro, e Prishtinës me 200 mijë banorë i janë ndarë 42 milionë euro. Të mos flasim për Fondin e Mirëbesimit, që po keqbesohet e keqmenaxhohet, prej 13 milionë eurosh.

Po dal te buxheti për Prizrenin. E vërejta me kujdes të madh se qenka ndarë një buxhet për rregullimin e stadiumit në Zhur, 300 000 euro. Në fushatën e vitit 2010, zoti Thaçi u pati premtuar zhurjanëve një stadium olimpik, pastaj në vitin 2014 i harroi zhurjanët e i premtonte Korishës për një stadium të tillë. Në vitin e kaluar filloi ta premtojë një stadium të tillë në Bërnice, tani e pamë që është marrë një vendim për një stadium në Drenas. I kuptojmë plotësisht, sepse PDK-së tani i ka mbetur e vetmja komunë dhe aty duhet investuar, mirëpo problemi është që tani e 8 vjet nuk ka stadium.

Në Buxhet vërejtëm edhe 880 000 euro që janë ndarë për teleferikun në Prizren. Në vitin e kaluar, në një debat me ministrin e tanishëm të Kulturës, ai premtonte se ky teleferik do të fillojë në shkurt të këtij viti dhe do të përfundojë në tetor të këtij viti. I pata thënë atëherë që as nuk do ta filloni e as nuk do të mund ta përfundoni. Po i them edhe tash se nuk do të mund ta përfundoni, se e vetmja arsye është që duhet nja tri herë ta shkelni ligjin për ta ndërtuar këtë teleferik. Të njëjtën gjë po ia them edhe ministrit, edhe pse nuk qenka këtu, nuk do të mund ta përfundojë as stadiumin në Drenas, sepse ka qenë i dështuar në Prizren, e tani ka ardhur për të dështuar edhe në Qeveri.

Gjithashtu, e pashë edhe një shifër prej 100 000 eurove për blerjen e automjeteve për zjarrfikës. Tani e katër vjet kjo shifër po ndahet në Buxhet, por e keqja e kësaj është se automjeti asnjëherë nuk është blerë, e kurrkush nuk është marrë me këtë dhe Prizreni e ka problemin më të madh, sepse kurrkush nuk është duke u kujdesur për zjarrfikësit. Ata kanë mbetur si jetimë dhe nuk

përkujdeset as ministria, e as Komuna. Pra, janë 24 zjarrfikës e, në anën tjetër, një qytet me 200 000 banorë i ka 24 zjarrfikës, e Gjakova me 100 000 banorë i ka 60 zjarrfikës. Pra, ja çfarë ka bërë PDK-ja në Prizren tani e dhjetë vjet.

Në Buxhet ishin ndarë edhe 100 000 euro për ndërtimin e bibliotekës në Prizren, që po ashtu përsëritet plot katër vjet e njëjta shumë, e në anën tjetër objekti ka filluar dhe ka mbetur si gërmadhë për shkak se Komuna nuk guxon të investojë, sepse e ka shkelur ligjin.

Në Buxhet janë parashikuar edhe 150 000 euro për ndërtimin e sallës së edukatës fizike në Nashec, dhe atë tek në vitin 2019. Para se të bëhet ky investim, Qeveria e Hashim Thaçit duhet të japë llogari për vitet e kaluara, se ku i kanë lënë 4 milionë euro që janë dedikuar një herë, kanë qenë të ndara dhe të alokuara për investimet në pushimoren e Nashecit, kurse aty janë investuar vetëm 80 000 euro, ndërsa të tjerat janë zhdukur. Njëkohësisht, kërkoj nga organet e hetuesisë që të hetohet ky rast.

Në Prizren është ndarë buxheti për çerdhe, kurse nuk është paraparë vendi se ku do të ndërtohen këto çerdhe. Çerdhen e vetme që e kishim në Prizren, çerdhja “Yllka”, është privatizuar ose thënë më thjesht, është falur, sepse 30 euro në muaj marrin qira dhe, në anën tjetër, kërkohet ndërtimi i një çerdheje të re dhe nuk dihet lokacioni se ku duhet të ndërtohet. Por, e mira e gjithë kësaj është se me qeverisjen e Lëvizjes “Vetëvendosje” tani do t’i rregullojmë të gjitha ato katrahura që i ka bërë PDK-ja për dhjetë vjet në Prizren.

Në fund, dua të them se dje e dëgjova me vëmendje deputetin Çoçaj që vjen nga komuna e Prizrenit. Kërkesa e tij ishte për realizimin e një sërë projektesh në këtë vit për rajonin e Hasit. Unë dua t’i them zotit Çoçaj se për dhjetë vjet sa ka qenë në qeverisje PDK-ja nuk janë realizuar ato projekte, mirë është të realizohen. Mirëpo, një herë mirë është të na tregojë para katër vjetësh ky bashkë me Hashim Thaçin i patën premtuar rajonit të Hasit komunë dhe pas një periudhe shumë të shkurtë tetëmuajshe, për inat të tij, Kadri Veseli i premtoi dy komuna në Has. Ku janë realizuar ato komuna e pastaj të investohen projektet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Replikë, deputetja e PDK-së, Luljeta Veseli-Gutaj, ose ju, urdhëroni!

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, kryesuese!

E nderuar ministre,

Unë po dua ta replikoj me kolegen deputete, se po e shoh që i ka marrë gjërat shumë me ngut. Nuk desha në seancën paraprake të replikoj për ato që i tha rreth hekurudhës. Unë e di që babai i kandidatit të “Vetëvendosjes”, se nuk e di a është përcaktuar përfundimisht a do të jetë kryetar i komunës së Prizrenit, i ka të privatizuar përreth shtrumpave dhe hekurudhës në Prizren nja 2-3 arë që i ka blerë atje dhe besoj se do t’i dalin ato shumë shpejt.

Në anën tjetër, me këtë që nuk dua të pajtohem me kolegen deputete... Profesor, unë e di që zakonisht profesorët duhet të dëgjojnë, të jenë pak më të kulturuar e të dëgjojnë njëherë, e po besoj që...

Tjetra? Drita Millaku, si reja e Sylë Millakut, unë e di që Sylë Millaku, ka fakte, ka punuar në organet e UDB-së dhe të Jugosllavisë, duhet të jetë më profesionale. Është mirë që të ketë kur të thotë për Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin që kanë dorë në vrasjen e komandant “Drinit”, një ushtarak i respektuar edhe nga Thaçi, edhe nga Veseli, edhe nga të gjithë ushtarët e UÇK-së që kanë qenë në zonën e Pashtrikut, ku ka qenë komandant “Drini”. Kështu që, nëse ka fakte, është mirë që edhe Sylë t’i ndihmojë nga pak, se Sylë është vjehërr i komandant “Drinit” dhe ka pasur mundësi. Nëse s’u beson organeve të Kosovës, t’u besojë atyre të Serbisë dhe nëpërmjet organeve të Serbisë t’i ndjekë këta persona.

Sa i përket çështjes për policët, unë e di që burri i deputetes është me gradë i vogël, por këto janë procedura që i bën ministria. Nuk i bën as Hashim Thaçi, e askush tjetër. Sa i përket komunës së Hasit, deputetët mund ta përcaktojnë, mund të shfaqin ide, unë kam bërë edhe pyetje parlamentare, edhe unë kam qenë si deputet dhe jam i interesuar që Komuna e Hasit, e di që kanë pasur shumë hulumtime dhe në bazë të atyre hulumtimeve të gjithë ata që kanë kërkuar, dhe e di që janë në proces të pritjes nja dhjetë komuna përafërsisht, nuk i kanë plotësuar kriteret.

Kjo është çështje që varet prej...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit! Kundër-replikë, Drita Millaku.

DRITA MILLAKU: Kundër-replika ime i drejtohet zotit Çoçaj se paska informacione të rrejshme, sepse vjehërrin im nuk ka punuar asnjëherë në UDB dhe gjithmonë ka qenë kundër tyre. Është fakt që ka punuar në shërbimin e Policisë, mirëpo jo në ato gradat, se më mirë se që i dinë këta, se gjatë gjithë kohës kanë qenë dhe janë këlyshë të SHIK-ut, mirëpo janë këlyshë të nivelit pak më të ulët.

Dhe tjetra, sa u përket uzurpimeve, janë të parët të cilët kanë uzurpuar dhe për të gjitha tash do të japin llogari. Jo rastësisht është duke u djegur shumë dhe janë duke kërkuar nëpër gjykata, por e kanë humbur Prizrenin, e tash secili do ta shohë ku e ka vendin, tash me qeverisjen e Lëvizjes “Vetëvendosje”.

KRYEUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Hykmete Bajrami. Edhe ju e dini që sipas Rregullores nuk e keni të drejtë, të lutem! Urdhëro, Hykmete Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

E nderuar kryesuese,

Të nderuar ministra,

Buxheti është më shumë i kryeministrit sesa i ministrit të Financave.

Unë i bëj thirrje zotit Ramush Haradinaj që të vijë dhe të jetë i pranishëm në seancë kur diskutohet Ligji më i rëndësishëm i Republikës së Kosovës, sepse ka edhe raste kur disa deputetë po mendojnë që ende kryeministri i Kosovës është ish-kryeministri Isa Mustafa dhe po harrojnë që Buxheti është i Qeverisë Haradinaj.

Për zotin Topalli, që nuk e di a është këtu, i cili gjatë gjithë kohës kur po fliste për Buxhetin i referohej Buxhetit dhe politikave ekonomike të ish-kryeministrit Isa Mustafa, unë i tregoj atij që Qeveria Mustafa e ka marrë mandatin me rritje ekonomike 1,1% dhe ka arritur ta dorëzojë me 4,3%.

Në vitin 2017, kemi rritur të hyra tatimore 400 milionë, apo 10% në mesatare për tre vjetët e fundit. E kemi përmirësuar në masë të madhe ambientin e biznesit në ranglistat e raporteve dhe institucioneve kredibile botërore.

Kemi arritur që t'i bëjmë dy pako fiskale, njëra e aprovuar në Kuvend; i kemi falur borxhet, por i kemi falur me ligj të Kuvendit si institucioni më i lartë dhe nuk i kemi falur me vendim të kryeministrit, siç po ndodh falja e taniemës për 58 milionë euro; e kemi bërë pakon e dytë fiskale, e cila ka kaluar më 17 korrik të vitit 2017, e kemi rregulluar Ligjin për menaxhim të financave publike dhe përgjegjësitë, i cili e obligon Qeverinë që t'i rrisë pagat konform rritjes ekonomike prej janarit 2018.

Këto janë vetëm disa nga të arriturat, por ju rikujtoj edhe një herë - kryeministër është aktual Ramush Haradinaj.

Shumëçka është thënë nga kolegët deputetë, unë i respektoj të gjitha që janë thënë, por më duhet të ngre edhe unë shqetësimet e mia rreth këtij projektligji, një pjesë e këtyre shqetësimeve tani janë shpërfaqur nga kolegët, por besoj që kjo nuk më bën përeritëse, kjo vetëm sa i forcon shqetësimet, sepse ato nuk janë më individuale, ato janë të një grupi më të madh të deputetëve, të cilët mund t'u përkasin një ose disa partive, të cilët në këtë Kuvend flasin dhe duhet të flasin në emër të qytetarëve.

Buxheti duhet t'i adresojë nevojat elementare të qytetarëve. Buxheti që e kemi përpara jo vetëm që nuk i adreson këto nevoja, por nuk është në harmoni as me Programin e Qeverisë 2017-2021 dhe u elaborua këtu disa herë për rritjen ekonomike.

Ky buxhet parasheh rritje të të hyrave për 6%, e kemi thënë në tre vjetët e fundit rritja e të hyrave ka qenë për 10%. Është e vërtetë që janë rritur disa taksa, por me pakon fiskale një është zbritur një numër i madh i taksave.

Kur jemi te të hyrat, Buxheti i vitit 2017 është kundërshtuar shumë nga deputetët e PDK-së dhe deputetët e opozitës së atëhershme pikërisht pse në këtë buxhet kanë qenë të parapara fondet e AKP-së dhe huamarrja.

Buxheti i vitit 2018 vjen po me këto të hyra dhe për çudi tani është shumë i pranueshëm.

Kur jemi te shpenzimet, një buxhet që rrit mallrat dhe shërbimet dhe zvogëlon investimet kapitale nuk është buxhet në funksion të qytetarëve. Është buxhet në funksion të Qeverisë dhe vetë qeveritarëve.

Mallrat dhe shërbimet, duke përfshirë edhe luksin e qeveritarëve, janë rritur për 17,3%, ose 39 milionë euro.

Rritja e mallrave dhe shërbimeve ka të bëjë me rritjen e numrit të ministrive, rritjen enorme të numrit të zëvendësministrave, që nëse për asgjë tjetër Qeveria Haradinaj do të mbahet në mend një kohë të gjatë për këtë numër.

Por, kur flasim për koston buxhetore të zëvendësministrave, besoni që ky do të jetë dëmi më i vogël që i bëhet Kosovës.

Ajo çka është shqetësuese është që ministrat që i kanë nga katër dhe gjashtë zëvendës nuk do të kenë kohë të merren me punët e ministrive të tyre, sepse do t'u duhet që t'i ruajnë zëvendësit që u vijnë nga partitë tjera për të mos prodhuar skandale.

Kur jemi te investimet kapitale, me të vërtetë ka shumë për t'u thënë për shpërndarjen politike të këtyre investimeve. Është i papranueshëm fakti i shkurtimit të projekteve, të cilat janë bërë nëpërmjet memorandumeve të mirëkuptimit, nëpërmjet komunave dhe ministrive të linjës.

Komunat tani janë lajmëruar dhe kanë treguar që ato kanë lidh kontrata për ekzekutim të projekteve me operatorët ekonomikë, ndërkohë që fondet në vitin 2018 nuk i kanë. Këto projekte janë zgjatë edhe për 2-3 vjet të tjera, e në rast se operatorët ekonomikë i kryejnë punët kanë shumë shanse që nëpërmjet përmbaruesve privatë të dënohen komunat, këto para të merren, por të paguhen edhe kamata ligjore.

Unë si anëtare e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti Industri dhe Zhvillim Rajonal, po provoj t'i bëj disa komente për ministri të cilat kanë përgjegjësi dhe

kanë fusha dhe i raportojnë këtij komisioni, ministritë që janë përgjegjëse për zhvillimin ekonomik.

Është një numër i madh i ministrive që sot në Qeverinë Haradinaj merret me zhvillimin ekonomik.

Në fakt, numri ishte i madh edhe më herët, por si për çudi pa kurrfarë arsytimi këtyre dikastereve iu shtuan edhe dy të reja, që janë Ministria e Inovacionit dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Buxheti për Zhvillim ekonomik në përgjithësi është shumë i vogël, edhe pse në programit qeveritarë thuhet që sektori privat dhe zhvillimi i tij është prioritet për Qeverinë Haradinaj dhe ky është bartësi kryesor i zhvillimit.

Në fakt, nëse e analizojmë buxhetin që u është ndarë këtyre dikastereve është shumë i vogël, është 5% e buxhetit total. Nëse e analizojmë shpërndarjen e buxhetit ndërmjet këtyre dikastereve, atëherë kjo shpërndarje lë për të dëshiruar.

Më lejoni të ju bëj me dije që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me 240 punëtorë në buxhet, e ka një buxhet prej 8,6 milionë eurove. Brenda ministrisë janë 7 agjenci të pavarura dhe 8 departamente.

Ministria në kuadër të vetin e ka Agjencinë KIESA, e cila u shërben edhe me departamentet dhe agjencitë tjera 154 mijë ndërmarrjeve, të cilat janë të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

103 ndërmarrje janë aktive, derisa 60 mijë këtyre deklarojnë tatim, që domethënë janë ndërmarrje profitabile.

KIESA e ka një buxhet prej 2 milionëve për subvencione, derisa Ministria e Inovacionit, një ministri e sapokrijuar ka buxhet 7 milionë për subvencione.

Tash nuk e di, nuk jemi kundër inovacionit, definitivisht duhet t'i japim mbështetje këtij sektori sepse ka potencial, ka njerëz të rinj, të cilët janë kreativë dhe u duhet mbështetje.

Mirëpo, shpërndarja e buxhetit nuk është proporcionale. 60 mijë kontribuues në Buxhetin e Kosovës, ndërmarrje profitabile duhet të mbështeten dhe të tjera, të cilat nuk realizojnë fitim, kanë 2 milionë subvencione në kuadër të KIES-ës, ndërsa për "star tape" janë ndarë 7 milionë.

Ministria e Inovacionit parasheh në buxhet t'i ketë 52 punëtorë, gjë që nënkupton që për vitin 2018, në fakt kjo ministri është në formim e sipër dhe nuk do të ketë kapacitete, vetëm në qoftë se këto fonde shpërndahen fare pa kritere, apo për testim të ideve, siç është deklaruar vetë ministri.

Kur flasim për inovacionin, është tepër interesant të shihet që te Ministria e Arsimit, si për habi, është zvogëluar buxheti për zhvillim të kurikulave dhe është zvogëluar buxheti për zhvillim të programeve për mësimdhënës. Këto të dyja duhej të shkonin bashkërisht.

Te Ministria për Zhvillim Ekonomik i kemi 10 milion subvencione. Kanë subvencion Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e në fakt Ministria e Zhvillimit Ekonomik më së paku merret me zhvillim. Janë subvencione për ndërmarrje publike, të cilat historikisht punojnë me humbje.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik tash e dy vjet nuk ka raportuar as në Qeveri dhe as në Parlament për performansën e ndërmarrjeve publike, për performansën e bordeve të tyre, të cilat fare nuk janë përgjegjëse, sepse nuk kanë marrë asnjëherë ndonjë vendim kundrejt Ekzekutivit të këtyre ndërmarrjeve për performansë negative.

Tjetër çfarë kemi? E kemi Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, e cila e ka një buxhet 2 milionë, e ka një projekt për zhvillimin e programit për zhvillim rajonal, por as në program dhe as në buxhet nuk dihet se çfarë është ky program. Këto janë investime kapitale 2 milionë, e nuk dihet se çfarë do të bëhet, 1,5 milionë janë subvencione.

Në fakt, kryeministri Haradinaj i cili po hiqet si gardiani kryesor i kufijve të shtetit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit! Ministri e ka kërkuar fjalën, urdhëroni zoti ministër Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Jemi duke diskutuar për punën e ardhshme që do të ndodhë brenda një viti, në vitin 2018, dhe për një buxhet i cili akomodon të gjitha kërkesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës me synim për zhvillim, me synim për rritje të mirëqenies dhe me synim që të krijojë vende të reja të punës. Ky është synimi i Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Dhe, për të reflektuar në atë çka u tha edhe nga deputetja, se i përmendi disa prej ligjeve, disa gjëra të kaluara, unë në atë kohë kam qenë deputetë dhe kam qenë goxha i zëshëm rreth

funksionimit të Buxhetit të Qeverisë së kaluar, edhe pse ishim pjesë e drejtpërdrejtë edhe e koalicionit, por i kem ndarë mendimet në këtë drejtim.

Një, në buxhetet e kaluara e kemi pasur klauzolën e investimeve, e cila as edhe një projekt të identifikuar nuk e ka pasur. Pra, kemi folur për një klauzolë të investimeve e cila vetëm ka qenë e buxhetuar, por që nuk e ka pasur as edhe një projekt të identifikuar.

Kemi folur për marrjen e mjeteve nga AKP-ja, gjë që duhet të bëhet me ligj, dhe për një vit Qeveria as nuk e ka marrë mundin që ta sjellë ligjin e AKKKP-së në Kuvend dhe tani Ministria e Financave Ligjin e ka sjellë në Kuvend dhe e kemi një ligj i cili do të mundësojë marrjen e këtyre mjeteve.

Duhet të kuptohemi që ky ligj mundëson marrjen e mjeteve, të cilat kryhen pas procedurave gjyqësore, të cilat bëhen në Gjykatën Supreme në Dhomën e Veçantë.

Pra, është dashur të merren masa ligjore për të ardhur deri te shfrytëzimi i atyre mjeteve, por e kemi parë që nuk ka pasur mundësi.

U përmend rritja e Buxhetit dhe për hir të qytetarëve dua ta shpjegoj çka është rritja e buxhetit, nga ku ka ardhur rritja e Buxhetit, sepse besoj që ajo çka e ka identifikuar, puna më e madhe, Qeverinë Mustafa, ka qenë që të kemi rritje të taksave, ky ka qenë identifikimi më i madh.

Rritja e Buxhetit është bërë kështu: 42 milionë euro shtesë për buxhetin e kaluar janë shtuar nga rritja e akcizës.

58 milionë janë shtuar nga rritja e TVSH-së, dhe 21 milionë janë si pjesë e programit për faljen e borxheve.

Pra, gjithsej 120 milionë euro kanë qenë të hyra të njëhershme, të cilat, nëse flasim tani për TVSH-në, e kanë varfëruar buxhetin e secilit qytetar, në secilën xhep, te secili qytetar, sepse duhet të kuptohet që TVSH-ja paguhet nga qytetari i fundit, nga i cili e shfrytëzon atë.

U fol shumë edhe për sigurimet shëndetësore dhe për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Unë kam folur në Kuvend edhe para disa ditëve. Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, kur unë kam qenë ministër i Financave, e kam lënë për vitin vijues, të garantuar për pjesën të cilën është dashur ta përcaktojmë nëpërmjet rregullave dhe akteve nënligjore, të cilat nuk janë bërë, së paku nuk janë prezantuar që kanë përfunduar dhe që duhet implementuar dhe tash po qajmë pse ne nuk e kemi funksionalizuar Fondin e Sigurimeve. Nuk e kemi funksionalizuar, sepse Qeveria paraprake nuk e ka bërë punën e vet.

Dhe, kthehem pak te Programi i Qeverisë dhe te themelimi i ministrisë.

Një, duhet ta kuptojmë që ky vendi ynë, aseti kryesor me të cilin duhet të konkurrojmë në tregjet ndërkombëtare, është rinia jonë, të rinjtë dhe të rejtat tona, të cilat kanë potencial të jashtëzakonshëm dhe që institucionet duhet t'u hapin rrugë.

Ministria është themeluar mbi bazën e përvojave të Suedisë dhe të Estonisë, për më shumë ministria në Suedi është me plot kuptimin e fjalës e njëjtë dhe që ka kompetenca shumë më të gjëra sesa ato që i kemi ne sot.

Pse është themelua kjo ministri? Sepse, ju lutem, shikojini pak raportet ekonomike në botë çfarë po ndodh.

Në takimin e fundit të OECD-së, në vitin 2016, ka dalë një konstatim interesant, të cilin nga miopia politike nganjëherë ne edhe nuk e konstatojmë.

Ky konstatim është se 65% e fëmijëve sot kur ta mbërrijnë moshën e punës prej 18 vjeç do të bëjnë punë të cilat sot nuk ekzistojnë. Nuk ka Kosova konkurrueshmëri as resurse minerare, as për gjëra të tjera, ato janë një mbijetesë ekonomike, por duhet të orientohemi drejt ekonomisë digjitale dhe ky është trendi i botës çka po ndodhë.

Në vitin 2020, në vendet e OECD-së do të jenë 14 miliardë pajisje multidimensionale të lidhura me njëra-tjetrën, të cilat do ta krijojnë vlerën ekonomike.

Shikoni sipas FORS, prej 10 ndërmarrjeve më të fuqishme në botë, 6 prej tyre janë ndërmarrje që merren me teknologjinë informative, e cila arrit kapacitetin e konkurreueshmërisë në ekonomi. Pra, jemi duke folur për një vizion, nuk jemi duke folur për gjëra të cilat na kanë mbetur truri diku në vitet e '60-ta me një ekonomi klasike, e cila nuk funksionon si e tillë. Pra, jemi duke folur për mekanizmin më funksional që shteti mund ta ketë për rritje të konkurrueshmërisë.

Lidhur me kapacitetet e ministrisë dhe të fondit, Fondi për Inovacion dhe Ndërmarrësi nëpërmjet këshillit, i cili është themeluar me vendim të Qeverisë, është themelua një këshill nacional për inovacion dhe ndërmarrësi do të krijojë kritere, të cilat nuk do të jenë të zyrave lokale të Qeverisë, apo zyrave qendrore të Qeverisë, por do të jenë kritere ndërkombëtare me ekspertë ndërkombëtarë dhe në përcaktimin e këtyre kritereve dhe metodologjisë do të jetë vetëm një zyrtar i ministrisë.

Ne nuk dëshirojmë që të themelojmë ministri, e cila merret me vlerësimin e secilës ide inovative.

Unë u bëj thirrje të gjithë të rive dhe të rejave që kanë ide inovative, të gjithë ndërmarrësve, grave që të vijnë te ministria të bashkëpunojmë dhe t'i shfrytëzojmë këto mjete, të cilat unë jam shumë i sigurt që ato gati 10 milionë që janë në buxhet të Ministrisë për Inovacion dhe Ndërmarrësi do të bëhen 20 milionë me përkrahje të donatorëve dhe kemi shumë e shumë donatorë, të cilët janë të gatshëm.

Prandaj, besoj që këtu të gjithë, deputetë, ministra, qytetarë, profesionistë njerëz që profesion të vetëm e kanë vetëm politikën, jemi të rrethuar vetëm rreth një vizioni, për të krijuar të ardhme për rininë. E ardhmja për rininë është ekonomia digjitale, e ardhmja për rininë është hapja e vendeve të punës të qëndrueshme dhe këtë mision e ka Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër! Fjalën e ka Abdyl Salihu. Replikë, urdhëro Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesuese!

Ministër e thashë edhe në fillim, nuk jam kundër që janë ndarë 7 milionë euro për inovacion, por jam kundër pse nuk u gjetën edhe disa milionë për 64 mijë biznese që janë kontribuuese të drejtpërdrejta në Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe u ndanë 10 milionë euro për ndërmarrjet publike, që 20 vjet punojnë me humbje. Deri kur kështu? Ju keni qenë edhe ministër i Zhvillimit Ekonomik një kohë dhe besoj që e dini gjendjen shumë mirë.

Unë kam qenë anëtare e Komitetit të Investimeve. Ju po thoni që nuk ka pasur projekte të identifikuar sipas klauzolës së investimeve. Ne sot i kemi dy marrëveshje ndërkombëtare që janë projekte që janë bërë në Qeverinë e kaluar dhe janë negociuar dhe janë nënshkruar me Bankën Botërore. Një prej tyre është projekti për konkurrueshmëri në vlerë prej 14,3 milionë euro. Është nënshkrua nga ish ministri Agim Krasniqi, në kohën kur ne vetëm jemi zgjedhur deputetë dhe kemi dhënë dorëheqje. Ka qenë i gatshëm. Është projekti i TIK-ut, në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, është projekti për sistemin e ujitjes, mund ta pyesësh zotën Stavileci z. Memli Krasniqi.

Ligji për AKP-në ka qenë i punuar si i tillë dhe ka ardhur, po harroni që një pako e ligjeve po vijnë me nënshkrime të ish-kryeministrit Isa Mustafa. Domethënë, ligjet kanë qenë të gatshme. Ju e dini që Qeveria ka rënë më 3 maj 2017. Nuk kemi pasur mundësi, domethënë nuk të ka lejuar koha, sepse kemi pasur vetëm 5 muaj efektivë të qeverisjes në 2017. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Kundër-replikë, ministri Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, deputete!

Ne nuk kemi problem me çfarë nënshkrimesh na vijnë draftligjet. Ne e kemi një problem dhe problemi është se ato ligje nuk kanë ardhur kurrë brenda vitit fiskal 2017. Kjo tregon punën dhe mospunën, kjo tregon angazhimin dhe mosangazhim dhe del si rezultat që sa e sa vite në punën e inovacionit dhe ndërmarrësisë, në punën e trajnimeve, në punën e përkrahjes së sportit, nuk është bërë punë aq sa duhet, normalisht e kemi ndërmarrë një hap dhe besoj që është hap dhe më vjen mirë që e ke mirëpritur dhe besoj që do të jesh një nga deputetët më të zëshëm për ta fuqizuar inovacionin dhe ndërmarrësinë në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër! Deputeti Abdyl Salihu e ka fjalën.

ABDYL SALIHU: Faleminderit, kryesuese e Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po e shqyrtojmë Projektbuxhetin për vitin 2018, i cili është i rëndësisë së veçantë për funksionimin e rregullt të institucioneve shtetërore, në përgjithësi, dhe institucioneve vitale, në veçanti, siç janë Shëndetësia dhe Arsimi.

Të nderuar kolegë deputetë,

Lidhur me Projektbuxhetin që nga momenti i miratimit në Qeveri rreth një muaj më parë e deri më sot, duke përfshirë edhe diskutimet e bëra deri në këtë çast, është shkruar dhe folur shumë për faktin se Shëndetësia është në gjendje jo të mirë, se nuk është bërë aq sa duhet se nuk është arritur niveli i duhur e të tjera, e deri te fakti se për herë të parë e kemi rritur buxhetin në nivelin më të lartë që mund të ketë pasur ndonjëherë Shëndetësia, duke shtuar edhe investimet kapitale dhe duke siguruar mjete për punësimin e mjekëve dhe infermierëve të rinj.

E njëjta situatë është edhe në Sektorin e Arsimit. Po ju sjell ndërmend të dhënat e testit PISA, apo raporte të tjera nga UNICEF-i për nivelin e nxënësve fillor dhe të mesëm, që rezultoi se niveli i dijes së nxënësve nuk është i kënaqëm.

Pastaj çështja tjetër, si politika e masivizimit të arsimit të lartë, jo gjithmonë u mbështet me reforma të plota, pa hyrë në detaje, mendoj se e ka komprometuar cilësinë e Arsimit.

Sektorin e Shëndetësisë ka nevoja të mëdha, ne jemi dëshmitarë të përditshëm se institucionet publike shëndetësore vazhdojnë të përballen me mungesë të pajisjeve të nevojshme për shërbime kualitative, mungesë të barnave, apo edhe të materialit shpenzues.

Se buxheti për Shëndetësinë ndër vite nuk ka pasur rritje të mjaftueshme dhe kjo është theksuar si arsye pse shërbimet shëndetësore nuk kanë qenë në nivelin e dëshiruar, se reformat në sistemin shëndetësor, me gjithë lëvizjet e bëra ndër vite, vlerësohet se nuk arritën që të zbatohen në masë të kënaqshme.

Se kuadri specialistik mjekësor ndër vite ka vazhduar ikje nga vendi për të kërkuar punë dhe kushte më të mira, e paga më të larta në vendet e ndryshme të botës.

Po ashtu, sfidat te Sektori i Arsimit nga niveli parashkollor, i mesëm, ai i lartë e deri te kërkimi shkencor, sfidat e përafrimit të sistemeve arsimore dhe universitare, në kuptimin e standardeve dhe të cilësisë me vendet e Bashkimit Evropian, ku synojmë të arrijmë edhe ne, janë shoqëruar dhe janë ndërlidhur ngushtë me reformat në shumë sektorë, duke përfshirë këtu mbështetjen e mjaftueshme buxhetore.

Inovacioni, teknologjia dhe dijet e konsoliduara janë vetë sfidat tona dhe janë sfida që duhen adresuar me kujdes në rrugën e integritit rajonal dhe evropian.

Ekonomia e Kosovës dhe tregu evropian pranon vetëm kuadro të përgatitura mirë me dije, duke përfshirë këtu edhe dijet nga shkollat e veçanta profesionale.

Investimi në kapitalin njerëzor si pasuria më e madhe e vendit, investimi në përgatitjen e çdo të riju në mënyrë të drejtë dhe të ndershme vjen dhe si një domosdoshmëri ndaj problematikave të zhvillimit të vendit tonë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nga Projektbuxheti për vitin 2018 shihet se këta dy sektorë gjatë ndarjeve buxhetore janë trajtuar si prioritet dhe kjo është për t'u vlerësuar.

Sigurisht në këto ndarje buxhetore, te Sektori i Shëndetësisë me rritje prej 21% në vlerë totale mbi 200 milionë nuk do të mjaftojnë për t'i mbuluar të gjitha nevojat e akumuluar me vite.

Rritja e grantit komunal për shëndetësinë primare diku rreth 9%, në total rreth 48 milionë, por gjithsesi nga këndvështrimi im mendoj se është hap i mirë për t'u fokusuar në trajtimin e nevojave të shumta që ka Sektori i Shëndetësisë.

Ky Projektbuxhet konsiderohet i një rëndësie të veçantë për disa arsye, e kam fjalën për Shëndetësinë.

Ndarja e veçantë buxhetore për fillimin e implementimit të skemës së sigurimeve shëndetësore, rritja e fondeve për investime kapitale, duke shfrytëzuar ndarjet buxhetore nga 10 në 24,6 milionë, rritja përreth 36% për fondet për barnat esenciale krahasuar me vitin paraprak, zotimi për financimin e plotë për pagesën e specialistëve, sigurimi i fondeve buxhetore për punësimin e mjekësve specialistë dhe stafit të mesëm mjekësor, ndërsa për Sektorin e Arsimit, sipas informacioneve që dje morëm nga ministri i Financave, ndarjet buxhetore janë ngritur diku 22%

në nivelin qendror, duke përlogaritur dhe rritjen prej 4% të grantit komunal për arsim, totali i shpenzimeve për arsim planifikohet diku 260.2 milionë euro.

Të nderuar kolegë deputetë,

Së fundmi e përkrah rritjen e buxhetit në shëndetësi dhe arsim, duke shpresuar që rritja do të përcjellë reforma në këta dy sektorë, prandaj nisur nga ajo që u tha deri tani dhe nga parafolësit në përgjithësi, është shumë e rëndësishme që ne të fillojmë vitin 2018 me buxhet të aprovuar. Prezantimi i këtij projektbuxheti ka mbështetjen time dhe e aprovoj që në fazën e parë të leximit, me qëllim që të kemi kohë që bashkërisht të punojmë për të plotësuar me amendamentet ato fusha ku vlerësojmë sa ka prioritete dhe lejojnë mundësitë buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë,

Ministra,

U diskutua mjaft për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 nga të gjithë kolegët dhe ajo që po rezulton nga këto diskutime, në fakt, vetëm po e vërteton atë që edhe kjo Qeveri ka mungesë të vizionit, të mirëplanifikimit, nuk synon as realizimin e prioriteteve që i ka përcaktuar vetë në programin e saj qeverisës dhe nuk garanton as për së afërmi zhvillimin dhe progresin e vendit në të gjithë sektorët e tij.

Unë sot do të fokusohem kryesisht te buxheti i planifikuar për arsim, dua të ndaj këtu me ju një deklaratë që kryeministri, zoti Haradinaj, e pati në fjalën e tij hyrëse javën e kaluar në një konferencë të organizuar për PISA-n në GIZ dhe ai filloi fjalën, duke thënë se ne sot mund të flasim për suksesin në fushën e arsimit, por rezultatet flasin krejt ndryshe dhe deklaroj se ne duhet të turpërohemi për gjendjen në arsim.

Kryeministri Haradinaj vazhdoi pastaj duke numëruar shkaqet që, sipas tij, na kanë sjellë në këtë gjendje, duke përmendur mësimdhënës me mesatare të ulët, mungesën e mundësisë për edukimin parafillor për fëmijët në Republikën e Kosovës, mungesën e bashkëpunimit të Ministrisë së Arsimit me DKA-të, plan-programe jo të mira, objekte, të cilat me infrastrukturën e tyre nuk mundësojnë një arsim cilësor dhe e vazhdoi këtë listë të shkaqeve, duke e përfunduar me deklaratën se arsimit në Republikën e Kosovës është i politizuar dhe ka shumë korrupsion në të gjitha nivelet e tij. Të them të drejtën, këto deklarata të kryeministrit më bënë optimiste, duke shpresuar se identifikimi i shkaqeve do të pasojë pastaj me përcjelljen e masave konkrete dhe me ndarjen e buxhetit për të realizuar aktivitete që do të mundësonin përmirësimin e arsimit. Edhe pse, dorën në zemër, shkaqet nuk është se janë të panjohura edhe për të tjerët, madje edhe për ata që nuk i përcjellin nga afër zhvillimet në sistemin e arsimit, vërehet se serioziteti dhe përkushtimi

i qeverisë në realizimin e atyre që ata i konstatojnë nuk është as për së afërmi ai që mundëson një arsimim më cilësor.

Pra, edhe për këtë qeveri arsimit po mbetet prioritet vetëm deklarativisht, edhe pse tashmë është e pranuar nga të gjithë se Kosova duhet të investojë më shumë në fushën e arsimit, pasi që arsimit do të ndihmojë në edukimin e të rinjve, të cilët janë gjeneratorë për zhvillimin e një vendi dhe një shoqërie, e ky buxhet nuk jep shpresë që do të sigurojë zhvillimin e arsimit cilësor.

Projektbuxheti 2018 për MASHT-in, gjegjësisht për sistemin e arsimit në të gjitha nivelet e tij, duke filluar prej arsimit parafillor e deri te arsimit i lartë parasheh gjithsej 54 milionë e 919 mijë e 448 euro. Nëse këtë e krahasojmë me buxhetin e planifikuar për Ministrinë e Infrastrukturës, i cili është pesë fish më i madh, apo në total 248 milionë e 382 mijë euro, lehtë mund të konkludojmë se edhe kjo mbetet një qeveri e asfaltit. Nëse e shohim se vetëm buxheti i planifikuar për rehabilitim të rrugëve është 54 milionë e 959 euro. Pra, kjo qeveri ka ndarë diku rreth 40 mijë euro më shumë, për rehabilitim të rrugëve se sa për gjithë buxhetin e planifikuar për arsim në të gjitha nivelet e tij. Dhe, nëse e shohim në raport me mjetet e planifikuara për ndërtimin e autostradave, atëherë dallimi bëhet edhe më i qartë. Janë paraparë 137 milionë euro për ndërtim të autostradave. Pra, saktë dy herë e gjysmë më shumë mjete të buxhetit të Republikës së Kosovës do të shkojnë për ndërtim të autostradave se sa për ndërtim të çerdheve, të shkollave, për përmirësim të infrastrukturës shkollore, zhvillim të plan-programeve e zhvillim profesional të mësimdhënësve.

Do të ndalem këtu de disa fusha specifike, e përmendën edhe disa nga parafolësit, për zhvillim të plan-programeve kjo qeveri ka paraparë 143 mijë euro, pra më pak edhe se buxheti që kishte planifikuar qeverisja e kaluar në vitet e fundit që ishte diku 200 mijë euro, e që edhe ashtu ishin shumë pak në krahasim me nevojat reale. Nëse kemi parasysh implementimin e kurrikulës së re, kurrikulat bërthamë dhe sfidat me të cilat po ballafaqohen mësimdhënësit e shkollave tona në këtë drejtim, duke e ditur se sivjet ka filluar implementimi i kurrikulës së re në të gjitha shkollat, ky buxhet i planifikuar as për së afërmi nuk i përmbush kërkesat dhe nevojat reale të mësimdhënësve në këtë drejtim. Duke e ditur se korniza e kurrikulës së re të Kosovës paraqet një zhvendosje nga mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në objektiva dhe përmbajte mësimore, drejt mësimdhënies dhe të nxënit të bazuar në rezultate të pritshme dhe zhvillim të kompetencave të nxënësve, një qasje e tillë implikon përgjegjësi shumë të madhe për shkollën dhe mësimdhënësit, të cilët ngarkohen edhe me përgatitjen e përmbajtjeve mësimore, përzgjedhjen e metodave të mësimdhënies dhe materiale dhe mjete mësimore.

E kjo, në fakt, nuk reflekton edhe me planifikim të buxhetit në këtë drejtim. Edhe pse për të mbështetur implementimin e suksesshëm të kurrikulës së re MASHT do të duhej të zhvillojë kurrikula dhe plan-program për çdo klasë dhe për çdo lëndë. Nëse këto, sjellim në vëmendje edhe arsimin e aftësimin profesional, ku mungon kurrikula bërthamë, atëherë shihet se mjetet e

planifikuara për këtë qëllim, gjegjësisht për zhvillimin e plan-programeve as për së afërmi nuk do të përmbushin nevojat reale.

Nëse shohim buxhetin e planifikuar për trajnimin e mësimitdhënësve, do të vërejmë se janë destinuar 382 291 euro. Këtu po ashtu dua të bëjmë një krahasim me buxhetin e planifikuar për një institucion të ngjashëm tjetër, për Akademinë Diplomatike, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e për të cilën është paraparë pothuajse buxhet i njëjtë, konkretisht 299 mijë euro.

Pra, për trajnimin dhe zhvillimin profesional të rreth 20 mijë mësimitdhënësve janë planifikuar vetëm 83 mijë euro më shumë se sa për Akademinë që ka për qëllim përgatitjen dhe trajnimin e anëtarëve të stafit diplomatik dhe zyrtarëve të tjerë që shërbejnë nëpër misione të Republikës së Kosovës jashtë vendit, e që në fakt, performansa e shumë prej tyre lë mjaft për të dëshiruar. Për më shumë, në kuadër të kësaj ministrie, pra Ministrisë së Punëve të Jashtme, janë paraparë edhe 3 milionë e 800 mijë euro për shërbime të konsulencës. Pse duhet të ndahen kaq shumë mjete për konsulencë, kur investohet edhe në trajnimin dhe edukimin e stafit diplomatik dhe nëse vazhdohet me krahasime, për arsimin për fëmijët me nevoja të veçanta në Republikën e Kosovës janë paraparë vetëm 1 milion e 700 mijë euro, pra gati përgjysmë më pak janë ndarë për edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta se sa për konsulencat e Ministrisë së Jashtme.

Unë nuk dua të ndalem sot me nevojat e shumta që kanë dhe përgjegjësinë që si shoqëri kemi për fëmijët me nevoja të veçanta, por dua të adresoj edhe problemet dhe sfidat serioze në shkollat tona, për shkak të mungesës së kuadrit profesional të këtij lëmi. Në fakt, një rritje më ra në sy kur krahasova buxhetin me atë të vitit të kaluar, ishte rritja e numrit të punësuarve, por jo për asistentë të fëmijëve me nevoja të veçanta, jo për pedagogë e psikologë, apo për persona të tjerë mbështetës, por rritje e numrin të të punësuarve në zyrën e ministrit, pra për stafin politik, sikurse edhe në të gjitha ministritë e tjera. Ajo që shihet nga ky projektligj i buxhetit është se edhe kjo qeveri nuk do të interesohet as për zbatimin e programit të saj qeverisës dhe objektivave që i ka përcaktuar në praktikë.

Po përmend si ilustrim, se përderisa në programin qeveritar parashihet si objektiv masivizimi i përfshirjes së fëmijëve në çerdhe, e sidomos parashkollorë dhe ndërtimi i godinave respektive që janë të qasshme për popullsinë, investimet kapitale në arsimin parauniversitar janë shumë të vogla. Rritja e përfshirjes së fëmijëve të moshës 0 deri në 5 vjeç në edukimin parashkollor në kopshte e çerdhe publike sot është vetëm 3%. Pra, përkundër rëndësisë së jashtëzakonshme që ka edukimi në këtë nivel, nuk u ofrohet mundësi të gjithë fëmijëve të vijnë në edukimin parafillor, duke shkelur kështu edhe obligimin ligjor që të gjithë fëmijët duhet të marrin pjesë në klasat parafillore.

Ministria e Arsimit ka paraqitur qëndrimet e saja edhe në lidhje me mësimin me një ndërrim ose tërëditor në të gjitha shkollat. Por, buxheti i planifikuar as për së afërmi nuk e mundëson realizimin e këtij qëllimi. Unë do të përmend këtu shkollat në komunën e Gjakovës, ku në qytet të gjitha punojnë me dy ndërrime dhe numri më i madh i tyre në zonat rurale po ashtu punojnë në dy ndërrime. Dhe, meqenëse edhe nga kolegët e mi që vijnë nga komuna e Gjakovës u përmend për qasjen diskriminuese që kjo qeveri e ka pasur ndaj investimeve në komunën e Gjakovës, pra vazhdon e njëjta traditë që të mos investohet në këtë rajon, përkundër nevojave të jashtëzakonshme, për më tepër nga kjo qeveri edhe është shkurtuar buxheti që ishte i planifikuar edhe më herët dhe meqenëse po flas për shkollat, unë dua të përmend që në shumicën e shkollave, të mos them në të gjitha, të komunës së Gjakovës mungojnë kabinetet, laboratorët dhe kushtet për mësim dhe edukim cilësor. Edhe në rastet kur është investuar, kryesisht kanë qenë me projekte të donacioneve të ndryshme.

Përkundër faktit që në komunën e Gjakovës tashmë është një mësimdhënie e bazuar cilësore, pra mësimdhënësit janë shumë të përkushtuar dhe ka rezultate në këtë fushë, mungon investimi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Fidan Rekaliu.

FIDAN REKALIU: Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Dua të shpreh shqetësimet e mia për Buxhetin 2018 lidhur me mungesën e fondeve që janë hequr nga parashikimet në kuadër të memorandumeve që janë nënshkruar mes Komunës së Podujevës dhe ministrive të linjave.

Memorandumet kanë qenë 3-vjeçare dhe sipas këtyre memorandumeve komuna ka qenë e obliguar t'i udhëheqë procedurat e prokurimit. Në bazë të këtyre procedurave ka nënshkruar kontratat dhe sipas obligimit ka njoftuar ministrinë e linjave për shumat buxhetore të kontratave për implementimin e projekteve në përputhje me kontratat. Mirëpo, në planifikimet buxhetore 2018-2020 ministrinë e linjave, ku ka pasur memorandum-kontrata, nuk iu kanë përmbajtur këtyre marrëveshjeve, edhe pse ishin të njoftuara me kohë. Në vazhdim do të cek projektet dhe shumat buxhetore që i janë hequr Komunës së Podujevës me këtë Projektbuxhet 2018: Ministria e Administratës Publike, kodi i projektit 14031, ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Bajçinë.

Vlera e kontratës 1 milion e 389 mijë e 566 euro, ishte projekt 3-vjeçar 2017-2019. Viti 2017 ka pasur një buxhet 200 mijë euro. Sipas projektit 2018-2020 ka një buxhet prej 990 mijë eurosh, që domethënë ka një mungesë të buxhetit për 199 mijë e 566 euro, sipas kësaj, ky projekt do zgjasë 4 vjet, por nuk ka siguri që do të kryhet edhe pas 4 vjetësh për shkak të mungesës së buxhetit për afërsisht në vlerë prej 200 mijë eurosh. Te Ministria e Infrastrukturës, projekti me kodin

15276, ndërtimi i rrugës Shajkofc - xeherore, vlera e kontratës 659 mijë e 315 euro, vlera e buxhetit 509 mijë e 315 euro, duke llogaritur edhe buxhetin e vitit 2017 që ishte 100 mijë euro, me rishikim është zvogëluar dhe është 50 mijë euro. Sipas kësaj, kemi një mungese prej 150 mijë eurosh.

Projekti me kodin 15277, ndërtimi i rrugës Pakashticë-Çenogë, vlera e kontratës 316 mijë e 192 euro, vlera e buxhetit 266 mijë e 192 euro, mungesa 50 mijë euro, kjo mungesë është si rezultat i shkurtimit të buxhetit të rishikuar në vlerë prej 100 mijë eurosh.

Projekti me kodin 14714, asfaltimi i rrugës Ballaban-Orllan te liqeni, me buxhet të planifikuar, duke përfshirë edhe vitin 2017 me vlerë 267 mijë e 400 euro, ndërsa vlera e kontratës është 455 mijë e 358 euro, domethënë se kemi një mungesë prej 187 mijë e 958 euro. Sipas memorandumit të Komunës dhe Ministrisë së Infrastrukturës, vlera e këtij projekti ishte parashikuar 1 milion euro.

Projekti me kodin 14762, asfaltimi i rrugëve të Podujevës me buxhet të planifikuar 387 mijë e 688 euro, duke pasur parasysh edhe planifikimin e buxhetit 2017 që është vlera 200 mijë euro, ka një mungese prej 100 mijë eurosh, sipas vlerës së kontratës që është 487 mijë 688 euro.

Te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, projekti me kodin 14557, ndërtimi i Palestrës Sporteve në Podujevë, buxheti i planifikuar 690 mijë euro, duke përfshirë edhe buxhetin e vitit 2017. Vlera e kontratës 1 milion 885 mijë e 110 euro, sipas kësaj del një mungesë prej 1 milion e 195 mijë 110 euro. Sipas memorandumit të nënshkruar mes Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është shuma 2 milionë e 500 euro.

Te Ministria e Arsimit, planifikon për vitin 2019-2020, ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Llaushë të Podujevës, objekti aktual është në gjendje shumë të rëndë. Kërkesa e Komunës për Ministrinë Arsimit ishte e kahershme, mirëpo asnjëherë nuk kemi hasur në mirëkuptim nga ministria në fjalë, gjë që mendoj se edhe me këtë planifikim nuk është menduar seriozisht që kjo shkollë të ndërtohet, sepse sipas gjendjes së shkollës, ajo ishte dashur të ndërtohet shumë më herët. Mirëpo, nëse Ministria e Arsimit e ka seriozisht, do të ishte mirë që ky buxhet në vlerë prej 300 mijë eurosh të planifikohet për vitin 2018.

Projekti me kodin 11450, shkolla e mesme në qendër të Podujevës, gjimnazi “Aleksandër Xhuvani”, projekt që ka filluar së ndërtuari në vitin 2009 dhe nuk i shihet fundi se kur do të përfundojë së ndërtuari. Këtë e mbështes në faktin se në vitin aktual 2017, ka qenë një buxhet i ndarë në vlerë prej 120 mijë euro dhe nuk është punuar asgjë, kështu që këto mjete do të shkojnë në suficit. Ndërkaq, Ministria e Arsimit për vitin 2018 planifikon vetëm 50 mijë euro, që sipas kësaj, kjo shkollë as në vitin 2018 nuk do të finalizohet.

Kërkoj nga ministrinë e linjave që t'i përmbushin obligimet në kuadër të memorandumeve që janë nënshkruar ndërmjet ministrive dhe Komunën e Podujevës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Valentina Bunjaku-Rexhepi!

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: E nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Pa dashur të përsëris të gjitha të metat e këtij projektbuxheti, të cilët i theksuan kolegët e mi, dua t'i tregoj arsyt pse nuk jemi të kënaqur me këtë projektbuxhet të vitit 2018.

Unë do të fokusohem në nevojat emergjente të Anamoravës që nuk janë pjesë e Projektbuxhetit 2018. Më lejoni t'i numëroj disa nga nevojat e mëdha dhe emergjente të Anamoravës që nuk janë pjesë e këtij projekti, që ndonëse janë projekte në Gjilan që ndërlidhen direkt dhe indirekt edhe me komunat e tjera, si e Dardanes, Vitisë, Artanës, Ferizajt, Kaçanikut, por edhe me bashkëkombësit e Luginës së Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës. Të fillojmë për nevojën urgjente të ndërtimit të Universitetit "Kadri Zeka", ku dihet se vetëm komuna e Gjilanit nuk e ka kampusin e Universitetit "Kadri Zeka" dhe është e pamundur, ky kampus ka penguar dhe mbarëvajtjen e kampusit të shkollave të mesme dhe Komuna e Gjilanit ka ndarë 8,2 hektarë tokë. Ende nuk kemi ndonjë lëvizje pozitive për ndërtimin e Universitetit "Kadri Zeka".

Po ashtu, duhet të ndahen mjete financiare për ndërtimin e konviktit të Universitetit "Kadri Zeka", ngase siç e thamë më lart, vijnë edhe studentë edhe nga Kosova Lindore dhe konvikti i tanishëm në komunën e Gjilanit që është ndërtuar për nevoja të nxënësve të arsimit parauniversitarë dhe nuk i plotëson nevojat për studentët e Universitetit "Kadri Zeka". Në vend të fjalëve të zbrazëta patriotike për Kosovën Lindore, kjo është një mundësi e mirë dhe praktike që të ndihmohen studentët e kësaj ane.

Tjetër projekt është edhe përfundimi i lumit Mirusha, të ndahen mjete buxhetore për përfundimin e shtratit të lumit Mirusha, të ndahen mjete buxhetore për fillimin e punimeve të lumit Stanishorka, sepse Komuna e Gjilanit është keq me këta dy lumenj, ku në Projektbuxhetin 2018 nuk është paraparë impianti i ujërave të zeza, e Komuna e Gjilanit ka jashtëzakonisht nevojë për impiante të ujërave të zeza.

Ne konsiderojmë se një pasuri tjetër kombëtare janë edhe klubet futbollistike Gjilani dhe Drita, të cilat përbëjnë sot një ndër derbet më të zjarrta në Kosovë, por edhe në rajon. Pra, duhet të mbështetet më tepër sektori i sportit, të financohet, edhe pse e falënderojmë Qeverinë Mustafa për ndërtimin e stadiumit të ri në komunën e Gjilanit, ku të gjitha klubet do ta shfrytëzojnë dhe do të kenë infrastrukturë të mirë për mbarëvajtjen e sportit në komunën tonë.

Po ashtu, duhet të rritet edhe buxheti për nevojat e arsimit, kur ne tërë ditën vajtojmë për rezultatet e PISA-s dhe nuk jemi të kënaqur aspak me këto rezultate e nuk parashikojmë të investojmë në nevojat për arsimin parauniversitar.

Duhet të ketë edhe një decentralizim të financave prej Ministrisë së Arsimit në komunat përkatëse. Po ashtu, teatrove të qyteteve kryesore t'u jepen mjete financiare edhe nga niveli qendror, pasi u janë lënë në kompetencë mbështetjet financiare me Ligjin për teatrot. Ndërsa, paradoksalisht nuk është rritur ky buxhet i drejtorive. Në Projektbuxhetin 2018 duhet të mbështeten edhe veteranët e luftës në përgjithësi e gratë, të cilat janë të torturuara nga lufta dhe nuk kemi arsytim për listat e fryra, tanimë temë shumë e njohur për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Komisioni dhe prokuroria duhet të merret me listat e fryra, ndërsa jona është që të ndajmë mjete buxhetore dhe të mos i diskutojmë shumë ato, sepse sa më tepër që ne të diskutojmë, listat e fryra të zonjave apo të grave të torturuara nga lufta, ato do të ndjehen më të fyera dhe më të nënçmuara.

Kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Determinues i suksesit është puna e mirë, planifikimi dhe shpenzimi i parasë publike në zhvillimin e Kosovës dhe Gjilanit, andaj i potencova këto projekte që të mos pengohet puna e mirë e kryetarit të komunës, zoti Lutfi Haziri, me një mbështetje gjithëpopullore në komunën e Gjilanit. Unë të gjitha këto projekte dhe kërkesa do t'i paraqes te Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe besoj shumë që këto kërkesa të Komunës së Gjilanit dhe Anamoravës të implementohen në Projektbuxhetin 2018. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka Andin Hoti.

ANDIN HOTI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Duke përshëndetur rritjen buxhetore dhe ndarjen e drejtë në institucione dhe profesionalizmin e ministrit Hamza, unë dua të them që është normale që ne nuk pajtohemi të gjithë me këtë projektbuxhet, shyqyr që s'pajtohemi, se s'kishim pasur çka të bëjmë këtu pastaj.

Megjithatë, unë kam disa kërkesa që i konsideroj primare, prioritete dhe do të duhej të ishin në pjesë e parashikimit buxhetor. Si mbështetje për lehtësimin e punës dhe të suksesit të njerëzve që punojnë tokën, konsideroj se Qeveria ka kapacitet dhe mund të gjejë mundësitë e subvencionimit të ujit të vades, si i themi ne andej, është ujitja e tokave e bujqësore për bujqit e Kosovës, të cilët furnizohen nga ujësjellësi i Radoniqit. Bujqit sot paguajnë deri në 150 euro për hektar për ujë dhe një mbështetje e tillë, një subvencionim i tillë do t'i ndihmonte shumë ata dhe do t'ua lehtësonte suksesin.

Gjithashtu, ka qenë edhe si lloj premtimi i kryeministrit Haradinaj në fushatën e kaluar dhe besoj që do të realizohet në një të ardhme të afërt edhe lirimi i naftës për bujqit e Kosovës. Prandaj, kërkoj që këto të dyja të kihen parasysh dhe këto dy pika do të thotë të futen në buxhet, nëse jo tash, vitin e ardhshëm në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, kërkoj nga Qeveria të shqyrtojë edhe mundësinë që të paktën pas rishikimit të buxhetit të vitit të ardhshëm të parashikojë edhe dy çështje të tjera: e para, është përgatitja e projektit të zgjerimit të rrugës Prizren - Rahovec - Gjakovë - Pejë, për shkak të ngufatjes së qarkullimit si pasojë e rritjes së komunikacionit, derisa në pjesë të tjera të vendit të Kosovës tashmë po zgjidhet çështja e lëvizjes së lirë dhe më të lehtë dhe qasjes më të mirë në infrastrukturë, rajoni i Anadrinisë ka mbetur më keq. Sidomos gjatë muajve të verës kur fluksi i qarkullimit rritet shumë si rezultat i bashkatdhetarëve tanë që vijnë në vendlindje.

Tjetra, që e konsideroj të papranueshme dhe e konsideroj që duhet të kemi fokusin më të qartë është për qytetin e dytë më të madh në Kosovë, ose ndryshe, si i them unë, kryeqytetin kulturor të Kosovës, Prizrenin. Ne e dimë të gjithë që Prizreni ende nuk ka çerdhe publike dhe konsideroj që nëse jo tash, së paku të parashikohet në buxhetin e vitit të ardhshëm që Prizreni të ketë edhe çerdhe publike, sepse fundja është e drejtë e secilit qytetar.

Unë, edhe pse vij nga ana e Rahovecit, kohën më të madhe e kaloj në Prishtinë dhe është pjesa e Gollakut, më saktësisht Ballabani me rrethinë, që e konsideroj si një pjesë shumë të rëndësishme, që e ka potencialin të jetë vend turistik. Prandaj, konsideroj që edhe kjo, pas rishikimit të Buxhetit të vitit të ardhshëm, nëse tash nuk ka mundësi, , të kihet parasysh dhe të ndahet një buxhet për ta futur edhe atë në zonë turistike për pjesën e Llapit, të Gollakut dhe Prishtinën, që është sot këtu.

Dhe, për fund, dua ta mbështes plotësisht zotin Nezir Çoçaj në fjalimin e djeshëm, kur kërkoi që të rregullohet shtrati i lumit Drin, sepse shtrati i tij, përveç që i furnizon tokat pjellore që janë në atë pjesë, është edhe vend atraksioni, siç ka qenë edhe para luftës, por duhet të jetë edhe tash dhe mund të përdoret për çështje tjera biznesore, të peshkimit e të tjera.

E dyta, dua ta mbështes edhe kolegën deputete sot që e pati fjalimin, zonjën Evgjenie Thaçi. Mua më ka rastisur të kaloj në të gjitha anët e Drenicës, gati nëpër të gjitha fshatrat e Drenicës në fushata dhe e kuptoj që propaganda e keqe ndaj Drenicës që është bërë deri sot prej pasluftës ka ndikuar keq, d.m.th. negativisht në mirëqenien e qytetarëve të atij vendi. Sot Drenica nuk e di saktësisht, por e di që i ka mbi 20-30 fshatra ende të paasfaltuara dhe i ka të gjitha fshatrat pothuajse pa rrjet të ujësjellësit. Prandaj, konsideroj që ta kemi fokusin edhe më të lartë në këtë pjesë. Nuk duhet të jetë propaganda si lloj motivi që ne t'ua keqësojmë mirëqenien e qytetarëve të asaj pjese, sidomos të pjesës së Skenderajt dhe Drenasit. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Salih Salihu.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Bujqësia do të duhej të ishte sektor strategjik për Qeverinë e Kosovës ashtu siç ishte proklamuar në Programin qeverisës, mirëpo me faktin se buxheti për bujqësi është shumë i vogël, rreth 2,4% të Buxhetit të përgjithshëm, duket se ky sektor nuk paraqet aspak prioritet për këtë qeveri. Ky buxhet është ende shumë i vogël në raport me nevojat që i ka ky sektor, por edhe në raport me buxhetin e shteteve fqinje, të cilat ndajnë më shumë për këtë sektor.

Pra, me këtë buxhet, bujqësia e Kosovës nuk mund të jetë e qëndrueshme dhe as e konkurrueshme me bujqësinë e vendeve të rajonit dhe si pasojë kemi invazion të produkteve bujqësore nga vendet fqinja, sidomos nga Maqedonia dhe Serbia, duke i shndërruar kështu produktet e tyre konkurrense kryesore në tregun tonë.

Këtu është e nevojshme ndërmarrja e hapave të shpejtë dhe konkretë në mbrojtjen e prodhimeve vendore, sepse sot problemin kryesor e kemi shitjen e produkteve vendore. Konkurrenca e produkteve të importuara nga kompanitë vendore dhe, në anën tjetër, mungesa e industrisë ushqimore, pra e përpunimit të produkteve bujqësore në vend, po e shkatërrojnë këtë sektor. Një ndarje e tillë e buxhetit është shumë jologjike, sidomos nëse krahasohet raporti ndërmjet buxhetit për bujqësi dhe infrastrukturës rrugore. Pjesëmarrja me vetëm 2,4% apo 47 milionë euro për bujqësi, që shkojnë direkt për grante dhe subvencione, është shumë e zhdrejtë në raport me ato që shkojnë rreth 400 000 000 euro për infrastrukturë rrugore, pra raporti është njëfish në bujqësi - dhjetëfish në asfalt.

Ndërkaq shifrat nga të dhënat doganore, sipas të cilat vetëm në vitin 2016 Kosova ka importuar produkte bujqësore dhe ushqimore me vlerë prej 670 milionë euro, do të duhej t'ju rikujtojë juve se këtë sektor duhet mbështetur shumë fuqishëm, si me buxhet, ashtu edhe me ndërmarrjen e masave për rritjen e prodhimit vendor dhe zëvendësimin e importit. Deri më tani asnjë indikator nuk e kemi se investimet e pakta në bujqësi janë duke u përkthyer në rritje ekonomike, prandaj vetëm shifrat dhe shumat që i diktohen bujqësisë nuk garantojnë zhvillim të saj, por duhet program dhe politika adekuate që ta orientojnë atë drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Përveç nevojës së investimeve kapitale në ngritjen e kapaciteteve përpunuese, pra rritjen e industrisë ushqimore, bujqësia e Kosovës ka nevojë për politika të mirëfillta që e mbrojnë prodhimin vendor. Ka nevojë për ndërtimin e sistemeve të ujitjes aty ku kemi burime të mjaftueshme të ujit, ka nevojë për ulje të kostos së prodhimit nëpërmjet subvencionimit të inpueteve apo prodhimit të inpueteve brenda vendit, ka nevojë për themelimin e një fondi të veçantë për zhvillimin e bujqësisë, krijimin e një fondi për kompensim të dëmeve të produkteve

bujqësore, në rast të fatkeqësive klimatike dhe sëmundjeve të kafshëve, si dhe ka nevojë për krijimin e një klime të favorshme investuese për investitorët shqiptarë dhe të huaj.

Por, të gjitha këto natyrisht që e kërkojnë një angazhim dhe koordinim më të mirë ndërinstitucional të Kryeministrit, në kuadër të të cilës janë Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Doganat dhe e Gjyqësori. Por, po themi koordinim më të mirë ndërinstitucional, sepse çdo vit Kosovës i humbin mesatarisht 1 000 hektarë tokë pjellore nga ndërtimet e egra dhe aktualisht në Ministrinë e Bujqësisë nuk është asnjë inspektor bujqësor për të bërë mbrojtjen e tokave bujqësore.

Pra, më mirë do të ishte që të bëhen 60 inspektorë bujqësorë për ta mbrojtur tokën bujqësore, se sa 60 zëvendësministra, që në fakt veç sa e ngarkojnë Buxhetin e Kosovës.

Kemi shkatërrim të shtratit të lumenjve dhe shkatërrim të mijëra hektarëve të pyjeve, duke e dëmtuar kështu ekonominë dhe ambientin e vendit tonë dhe askush deri më tash nuk merr përgjegjësi për këto veprime. Por, a mund të pritët një koordinim më i mirë ndërinstitucional në këtë qeveri? Është vështirë për të besuar, duke u bazuar në kompozimin kaq heterogjen të kësaj qeverie. Prandaj, shtrohet pyetja: Si mund të shpresohet që bujqësia e Kosovës do të ketë zhvillim, kur buxheti për bujqësi fare pak ndryshon nga viti paraprak, kur kjo ministri lihet për t'u udhëhequr nga Liste serbe dhe kur në këtë ministri janë ende të njëjtit njerëz nëpër departamente që kanë udhëhequr deri më tani me jokompetencën dhe papërgjegjësinë e tyre që ta kenë vullnet ta ndryshojnë gjendjen e rëndë të bujqësisë së Kosovës?

Pra, si përfundim, themi që bujqësia me këtë buxhet do ta vazhdojë këtë gjendje të rëndë, si në vitin që po e lëmë. Prodhimi vendor do të jetë i pabarabartë në treg. Importi nga kompanitë e lidhur me politikanët do të vazhdojë duke importuar produkte bujqësore nga Serbia me cilësi të dobët dhe shumë të pasigurt në aspektin e sigurisë ushqimore. Rrjedhimisht, prodhimet tona edhe më tutje do të mbeten në depo dhe, në fund, do të përfundojnë në mbeturina, ashtu siç ka përfunduar shpesh qumështi, patatja, qepa, rrushi i Kosovës, e kështu me radhë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Tani unë si deputet i zonës së Anamoravës, dua të ngre disa çështje që lidhen me shqetësimet e qytetarëve të komunës së Vitisë, të cilët po anashkalohej vazhdimisht nga Qeveria qendrore, duke e lënë komunën e Vitisë si një oazë të izoluar e të pazhvilluar.

Vitia ka nevojë për disa projekte të rëndësishme kapitale, që do t'i hapnin rrugë zhvillimit ekonomik të saj. Vitia ka nevojë për një sistem të ujitjes, sepse është rajon bujqësor dhe ka burime të mjaftueshme të ujit nga Morava e Epërme. Vitia ka nevojë për t'u lidhur me

Maqedoninë në dy drejtime, në njërin nga fshati Debëllde, për t'u lidhur me Shkupin, e tjetrin kah fshati Letnicë, për t'u lidhur me Kumanovën.

Por, projekti më i rëndësishëm për momentin, e që është lehtë për t'u realizuar, është që Vitia duhet të kyçet në autostradën "Arbër Xhaferi" në fshatin Gërlicë. Kjo është kërkesa kryesore e qytetarëve të Vitisë. Qeveria e kaluar nuk kishte vullnet për ta bërë këtë gjë, edhe pse kjo çështje është ngrehur shumë herë në Kuvendin e Kosovës, e tashmë punimet kanë avancuar dhe momentalisht Vitia nuk ka kyçje.

Janë rreth 60 mijë banorë tatimpagues në Buxhetin e Kosovës, mbi 8 mijë automjete të lehta dhe të rënda, që e paguajnë taksën rrugore. Prandaj, ata me të drejtë duan të trajtohen të barabartë në aspektin e investimeve kapitale.

Kërkoj nga ministri Pal Lekaj dhe nga kryeministri Haradinaj që t'i marrin për bazë kërkesat e qytetarëve të komunës së Vitisë dhe të ndajnë mjete për ta realizuar këtë projekt të rëndësishëm, jo vetëm për Vitinë, por edhe për fshatrat e komunës së Ferizajt Komogllavë, Gërlicë e Varosh dhe të komunës së Kaçanikut, Begracë dhe Kaçanik i Vjetër. Faleminderit!

KRYESUESJA: Fjalën e ka Haxhi Abdyl.

HAXHI ABDYLI: E nderuara kryesuese,

Të nderuar deputetë,

Kjo Qeveri tani e ka dërguar projektbuxhetin para nesh, që është një projektbuxhet i ndikuar edhe nga disiplina fiskale e Qeverisë së kaluar, por mund të themi që ky projektbuxhet është një projektbuxhet, i cili do të jetë në të shumtën në shumicë e shpenzuar në asfalt dhe luks qeveritar.

Qytetarët kanë shprehur që më në fund viti që vjen do të jetë fillimi i kalimit nga një buxhet i asfaltit në një buxhet të investimeve kapitale, në arsim, shëndetësi, bujqësi, në zhvillim ekonomik, por fatkeqësisht ende edhe më tutje 40% e Buxhetit do të shkojë për asfalt. Në të njëjtën kohë, kemi shumë autostrada të hapura dhe rrugë që do të ndërtohen, por unë po dua të ngre një çështje që besoj se secilit prej deputetëve dhe shumicës së qytetarëve të Kosovës u ka rënë në sy që autostrada Prizren - Prishtinë, apo Rruga e Kombit, që nuk është e përfunduar. Ne duhet ta themi hapur që autostrada Prizren apo Tiranë - Prishtinë është deri në Orllat dhe nga Orllati deri në Prishtinë e kemi një rrugë, e cila nuk i ngjan autostradës, sepse shpeshherë në atë rrugë kemi kafshë shtëpiake, janë duke u rrezikuar njerëzit, kemi aksidente dhe kemi vështirësi të asaj pjese të qytetarëve për të jetuar dhe është e pajetueshme ajo pjesë.

Mendoj që ne duhet që këtë pjesë të rëndësishme, sepse me këtë pjesë bashkohen Peja, Gjakova, Prizreni, bashkohen rrugët nacionale edhe për Mal të Zi edhe për Shqipëri dhe në këtë pjesë shumë fshatra, duke filluar nga Orllati, Komorani, Llapushniku, Sllatina... e kanë vështirë të

jetojnë dhe në të njëjtën kohë e pengojnë edhe pjesën e udhëtarëve me makina për të udhëtuar në një shpejtësi që duhet ta kishte një autostradë. Prandaj, zgjidhja mund të jetë edhe ndonjë rrugë alternative për këto fshatra dhe kjo rrugë të futet në buxhet dhe të mbyllet me aq sa ka mundësi të mbyllet, në mënyrë që në këtë pjesë të mos rrezikohemi, edhe ne si udhëtarë, por edhe këmbësorët.

Mendoj që Shëndetësia e ka një rritje të buxhetit, por kjo rritje është ende e vogël. Ne e dimë që në GDP, në bazë të GDP-së, kemi vetëm 3% të ndarë prej buxhetit për shëndetësi, ndërsa në të njëjtën kohë shtetet e rajonit kanë deri në 6% të GDP-së dhe kur e kthejmë këtë edhe në shuma monetare, vendet e rajonit ndajnë nga 600 deri në 1000 euro, ndërsa ne si Kosovë kemi të ndara vetëm 140 euro për kokë banori, gjë që tregon se Shëndetësia edhe më tutje është e nënfinancuar, por sidoqoftë një rritje e tillë e bërë është për t'u vlerësuar. Por, mendoj se duhet të vazhdohet të rritet edhe më tutje.

Ne e dimë se buxhetet për rrugë janë të rëndësishme, rrugët janë të rëndësishme, por njerëzit presin edhe shëndetësi të avancuar, spitale më cilësore, presin edhe shkolla më cilësore, presin edhe një ambient më të mirë e më të jetueshëm, pa ndotje, pa ndotje të ajrit, pa prishje të lumenjve, pa prishje të tokave bujqësore, prandaj ky buxhet duhet të kthehet në buxhet të krijimit të një Kosove më të mirë të jetueshme.

Të nderuar deputetë,

Përfundimisht, kjo qeveri, në bazë të programit ka hequr dorë nga sigurimet shëndetësore dhe mendoj se kjo nuk është bërë mirë. Është dashur të vazhdohet me reforma në shëndetësi dhe reformë financiare nëpërmjet sigurimeve shëndetësore. Ne e dimë dhe jemi të vetëdijshëm sesa veçanërisht për profesionistët shëndetësorë është vështirë dhe çfarë reforme e madhe është reforma në aspektin financiar. Është një reformë e gjatë, është një reformë me shumë vështirësi, kërkon njohuri të gjera, kërkon një angazhim të të gjithë aktorëve politikë, të partive, profesionistëve, shoqatave dhe gjithë shoqërisë, që të vihet deri te kjo reformë, por ne nuk guxojmë ta ndërpresim këtë reformë. Kjo qeveri, si duket e pandërprerë për momentin dhe nuk po shihet edhe në bazë të programit, por edhe në bazë të buxhetit.

Por, mund të themi që edhe një reformë, apo një sistem i cili i paraprin formimit apo implementimit të sigurimeve shëndetësore është edhe sistemi i informimit shëndetësor. Ky sistem ka ngecur në të gjitha etapat dhe po vazhdon të ngeçë. Buxheti i cili ndarë është 1 800 mijë, që mendoj se nuk është i mjaftueshëm, ndoshta do të ishte edhe më i madh, sepse kush merr vesh nga reforma financiare në shëndetësi, kjo është faza e parë, apo hapi i parë para se të fillojnë sigurimet shëndetësore. Pra, pa një sistem të informimit shëndetësor është e pamundur që të vijmë në fazën e sigurimeve shëndetësore, sepse po nuk e patëm një informim të saktë për shërbimet, një informim të saktë për mjekët, për të gjitha ato, nuk mund që edhe ne t'i rregullojmë çmimoret, apo çmimet e shërbimeve, të cilat duhet të vijnë.

Ka kode buxhetore për ndërtesa të reja, për ndërtesa të reja në spitale, në të njëjtën kohë mendoj që do të duhej që të investohet në ndërtesat aktuale, sepse ne e kemi një përqindje jo të madhe të shfrytëzueshmërisë së ndërtesave, kemi diku 50% të shfrytëzueshmërisë së hapësirave të spitaleve tona dhe të njëjtën kohë cilësia në këto spitale lë për të dëshiruar. Mendoj se duhet që të investohet edhe më shumë në spitalet aktuale, që të përmirësohet kualiteti i shërbimeve në to.

Po ashtu, mendoj se duhet ta kemi një rritje të investimeve në resurse humane në shëndetësi. Pse në resurse humane? Sepse, ata janë bartësit kryesorë të shërbimeve shëndetësore dhe ata janë që do ta rritin kualitetin e shërbimeve shëndetësore. Mendoj se duhet të krijohet një buxhet për performansë shëndetësore derisa të bëhen sigurimet shëndetësore. Kemi mjekë, kemi profesionistë, të cilët kryejnë shumë punë në spitale dhe paguhen njëjtë sikur ata që nuk kryejnë aq punë.

Mendoj që nëpërmjet pagesës, nëpërmjet performansës, ne mund të krijojmë kushtet që këta mjekë të qëndrojnë në sistemin publik dhe në të njëjtën kohë të mos lejojmë që këta mjekë të shkojnë në sektorin privat, apo të dalin jashtë shtetit. Mendoj që kemi shumë investime në shërimin jashtë shtetit. Është ky sistem shëndetësor, i cili edhe sot e kësaj dite po e kërkon këtë, sepse pacientët duhet të trajtohen, por mendoj që ne duhet ta rritim investimin në preventivë, në parandalim të sëmundjeve, sepse shumë më mirë është që të parandalohet, sesa të shërohet. Edhe tregimi i kardiokirurgjisë është një tregim i papërfunduar dhe me këtë buxhet nuk jep shpresë se do të përfundohet edhe më tutje dhe mendoj që në këtë drejtim ne duhet ta mbyllim tanimë kapitullin e kardiokirurgjisë.

Të nderuar deputetë,

Në Programin qeveritar është premtuar që në Prizren do të krijohet qendra e dytë klinike universitare. Ju lutem, në buxhet kjo nuk paraqitet askund dhe mendoj që ndoshta ka qenë një premtim paraelektoral dhe mendoj që në bazë të buxhetit shihet se ka qenë një premtim për qytetarët e Prizrenit dhe punëtorët shëndetësorë atje dhe mendoj se mund ta quajmë një flluskë sapuni paraelektorale, e asgjë më shumë.

Po ashtu, mund të themi që përkujdesja ndaj Qendrës Historike të Prizrenit është minimale. Kemi të ndarë vetëm 330 mijë euro për Qendrën Historike të Prizrenit, ndërsa kemi diku mbi 730 mijë nga buxheti të ndara për një teleferik, për të cilin mendoj se do t'ia shtojë shëmtinë kësaj qendre historike, do ta shëmtojë edhe pamjen e Kalasë dhe në të njëjtën kohë ne po e shohim që ky tender për teleferik është bllokuar për çështje klienteliste, e, në anën tjetër, për Qendrën Historike të Prizrenit janë ndarë vetëm 330 mijë euro, kur mendojmë se ajo është krenaria e Prizrenit, por edhe krenaria e krejt Kosovës, dhe duke marrë parasysh që kjo qendër historike është degraduar, mendoj se do të duhej që t'i rritet përqindja apo të rritet financimi për të, në mënyrë që sado pak ta rikthejmë pamjen e saj origjinale dhe ta ndalim degradimin e mëtutjeshëm, sepse mendoj që

dashuria ndaj Prizrenit shprehet edhe në këtë mënyrë, duke ia ruajtur vlerat autentike, por edhe duke i ruajtur vlerat tona historike.

Mendoj që ka shumë gjëra që do të duhej që në diskutimet e mëtutjeshme të diskutohen dhe të amendamentohen. Mendoj që edhe nga deputetët tjerë është cekur edhe rruga e fshatrave të Hasit, që është një rrugë shumë e dëmtuar dhe me investimin vetëm prej 50 mijë eurove nuk mund të rivitalizohet kjo rrugë, por ndoshta do të duhej një investim më i madh, i cili do ta rindërtojë apo do ta ndërtojë prej fillimit, sepse është një rrugë vitale që lidh shumë shatra. Mendoj që në regjionin e Prizrenit është edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Luljeta Veseli-Gutaj.

LULJETA VESELI-GUTAJ: Faleminderit, e nderuar kryesuese e seancës!

Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju, të nderuar qytetarë,

Gjatë gjithë ditës së djeshme e diskutuam projektligjin më të rëndësishëm të shtetit. U tha shumë, u diskutua shumë, por edhe u bë shumë politikë.

Unë mendoj që me këtë projektligj ne duhet t'i shohim nevojat e qytetarëve dhe t'i shohim përparësitë të cilat janë dhënë dhe ta lëmë politikën në Projektligjin e Buxhetit.

Projektligji për Buxhetin e shtetit për vitin 2018 nuk them as unë që është perfekt, por është më i larti dhe më i miri që ndonjëherë e ka pasur shteti i Kosovës dhe këtu shihet qartë se është punuar mirë, është punuar ndershëm në hartimin e këtij projektligji, për ç'gjë e përgëzoj ministrin Bedri Hamza. Me këtë buxhet inkurajohen shumë bizneset. Me këtë buxhet shihet qartë se e kemi një rritje të bazuar dhe reale me 4,6%.

Unë dua t'i theksoj disa nga shqetësimet që i kam ngrehur edhe më herët, por që janë vazhdimësi e problemeve dhe që nuk janë paraparë. Është mirë që është rritur buxheti për fushën e arsimit, që ka një rritje mjaft të lartë me 22%, por jam shumë skeptike se sa do të jetë cilësore fusha e arsimit dhe duke filluar nga arsimit parafillor deri te ai post-universitar, duke e ditur gjendjen e tanishme të cilën e kemi, optimizmin e ministrit për mosmarrjen e hapave konkretë, të cilët i kemi në këtë fushë.

Kërkesa ime te Ministria e Arsimit për Buxhetin është në ngritjen e kapaciteteve me edukimin parafillor, gjë që u tha nga shumë parafolës këtu në këtë sallë, e me fokus të veçantë në qytetin e

Prizrenit. Kolegia Millaku tha që nuk është ndarë, nuk ka asnjë çerdhe në Prizren, nuk është ndarë buxhet. Buxheti është ndarë për dy çerdhe në Prizren, një është nga Komuna e Prizrenit, e ju keni qenë pjesë e Asamblesë Komunale dhe e dini mirë këtë punë dhe tjetra ka qenë kërkesë imja dhe është ndarë nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Është e vërtetë që nuk është realizuar deri më tani, por shpresojmë që shumë shumë shpejt do të merren hapat konkretë dhe Prizreni do ta ketë çerdhen më të mirë në nivel vendi, të financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe IPA fondet, të cilat e kanë fokus edukimin parafillor.

Po ashtu, kërkesë imja është që unë nuk e pashë të parashikuar në Projektbuxhetin e vitit 2018 është përfshirja e bashkëpunëtorëve profesionalë, që është domosdoshmëri e një arsimit cilësor në vend, është pjesëmarrja e pedagogut, psikologut dhe sociologut në shkollë. Ne nuk mund të jemi funksionalë, nuk mund të nxjerrim arsim cilësor në qoftë se një shkollë me dymijë nxënës punon vetëm me një drejtor dhe një zëvendësdrejtor, apo administrator e koordinator.

Pastaj, në fushatën elektorale nga shumica e deputetëve të regjionit të Prizrenit dhe të Suharekës u premtua shumë në fushën e arsimit dhe në shkollë. Në shkollën fillore “Shkëndija”, paralele e ndarë në Reçan, shumë kolegë që janë këtu shkuan në shkollë, premtuan shumë, se kjo shkollë nuk duhet të jetë kështu, se në këtë shkollë nuk duhet të bjerë shi. Ajo shkollë nuk ka as ujë të pijshëm për nxënës. Ajo shkollë nuk ka as tualet për nxënës, të mos flasim për kabinete, të mos flasim për klasën parafillore dhe kabinetet e tjera, apo laboratorë. Nuk u ngrit nga askush zëri këtu për të. Gjatë gjithë fushatës u fol shumë.

Te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e thanë edhe disa kolegë parafolës se mungesa e ujit është shqetësim në gjithë Kosovën. Është një shqetësim i theksuar në Prizren, po është rrjetëzimi i ujës-jellësit nëpër lagje. Në Lagjen “2 Korriku” ka 17 vjet që ka mungesë të ujit, sikur edhe në lagjet tjera të Prizrenit, mirëpo Drejtoria Regjionale e Ujit e Prizrenit e ka dërguar projektin në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në vitin 2016 dhe ai projekt nuk ka ardhur, as në projektligjin e Buxhetit të vitit 2016, as në projektligjin e Buxhetit të vitit 2017 dhe nuk është as sot në projektligjin e Buxhetit për vitin 2018.

Unë i bëj pyetje ministrit të Zhvillimit Ekonomik, në cilët sirtarë ka mbetur ky projekt për rrjetëzimin e ujës-jellësit në qytetin e Prizrenit?

Dhe, do të bëj amendament për këtë projekt ndërmjet leximeve të projektligjit.

Te Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, unë e shoh një mundësi shumë të madhe për të rinjtë dhe të rejtat, të cilët kanë kapacitete dhe potenciale që t’i tregojnë nëpërmjet kësaj ministrie. E përgëzoj ministrin për të gjitha punët dhe përpjekjet që i ka bërë, që kjo ministri të reflektojë pozitivisht dhe të ju japë shumë mundësi të rinjve dhe të rejave, sepse ne duhet ta kemi një

ekonomi, e cila ka orientim me ekonominë digjitale. Kemi shumë të rinj dhe të reja që janë të përgatitur, kanë potenciale dhe mund të vazhdojnë të bëhen pjesë e ekonomisë digjitale.

Pra, këto janë kërkesat e mia dhe për fund dua ta bëj një replikë me dy kolegë deputetë nga Prizreni.

E para, unë shoh se ka shumë shqetësime për vlerat e luftës në këtë Kuvend dhe jashtë këtij Kuvendi dhe u pengon shumë që një veteran i luftës i merr 170 euro. I pengon ndoshta dikujt, edhe pse ne flasim shqip në këtë Kuvend, por ajo është minimale për atë se çfarë kanë bërë njerëzit që ne sot ta gëzojmë këtë liri dhe që ne sot të flasim shqip në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

E dyta, Drita Millaku e akuzoi kryetarin Veseli dhe presidentin Hashim Thaçi se ajo paska fakte dhe informacione se çka ka ndodhur me komandant “Drinin”.

Zonja Millaku, në qoftë se ju keni informacione dhe nuk i keni dërguar në Prokurori, atëherë ju keni bërë shkelje ligjore. Por, në qoftë se jeni bërë duke bërë shpifje dhe shantazhe, atëherë do të vazhdojmë me procedura ne dhe do të merremi me ju. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Fol të lutem, Zonja Millaku, replika për ty.

DRITA MILLAKU: Desha t’i drejtohem koleges Luljetë, se nuk është e vërtetë për atë çka po thotë, sepse në debatin tim sot për Projektligjin e Buxhetit nuk thashë që një herë, në radhë të parë, nuk është ndarë buxhet për çerdhe, dua të filloj te kjo, sepse buxheti është ndarë, por e keqja e kësaj është që nuk kanë bërë menaxhim ku do të ndërtojnë, nuk është ndarë vendi se ku do të ndërtohet çerdhja.

E sa i përket asaj për shpifje, lirisht i them zonjës Luljetë, le të ngrejë padi për shpifje, sepse gjatë kohës sa kam qenë në Asamblenë Komunale në Prizren, shumë kolegë të PDK-së kanë ngrehur padi për shpifje, por e dinë qysh kanë përfunduar. Kështu që i sugjeroj të ngrejë sa më shpejt, por përfundon edhe ti si kolegët e tu. Faleminderit!

KRYETARI: Çka është shpifja, se s’e morëm vesh? Për çka shpifje? Zonja Millaku, për çka shpifje? Edhe një herë ripërsërite, se s’kam qenë në seancë.

DRITA MILLAKU: E ka kuptuar, zonja ka qenë në seancë, e ka kuptuar, asaj iu drejtova.

KRYETARI: Edhe një herë a ka mundësi, se tani jam prezent, se m'u ka përmendur emri. Edhe një herë!

DRITA MILLAKU: Si kryetar i Parlamentit, në qoftë se do ta dish, është dashur të qëllosh këtu dhe të dëgjosh. Edhe një herë nuk e përsëris. Të tregon kolegja jote.

KRYETARI: Faleminderit! Dëgjo, ... vetëm pak...!

Është mirë kjo foltore të përdoret për gjëra të mirëqena dhe për dinjitet, pak a shumë. Po e vërej se është duke u përdorur për gjëra që nuk i takojnë. Megjithatë, mos e ndalni, veç nuk është mirë ta lëshoni fjalën sikur... po e dini. Po, është mirë të kemi dinjitet. Është mirë të merret përgjegjësi për gjëra që flisni, për arsye se.... dëgjo... është mirë të merret përgjegjësi dhe të merret përgjegjësi jashtë këtij Parlamenti e të shkohet diku tjetër. Sido që të jetë, përgjegjësia juaj, po kemi për të ardhur edhe te ato gjëra ngadalë-ngadalë, pritni se prej janarit kemi për të ardhur me të mira shumë. S' do të ikën kurrkush në këtë dynja çka ka bërë e çka flet, se ka marrë fund koha e ish-Serbisë. Ka marrë fund përgjithmonë dhe këtë mbajeni në kokë. E do të ballafaqohemi për të gjitha gjërat, te Zoti e te njeriu. E Kuvendi është për të folur për gjëra që kanë të bëjnë me qytetarët e Republikës sonë. Shqetësuese! Po të ketë shqetësim dikush për besë shkon edhe te Prokuroria.

Mund të thotë dikush që unë do të kisha thënë këqyr brenda vetes. E ka rrejtur kush i ka thënë diçka, se të shikosh brenda vetes e gjen më lehtë, e gjen shumë shpejt...

Po shkojmë në pauzë, mos ta çojmë më tutje. E në orën 14:00 pas drekës jemi këtu, vazhdojmë.

Dritë, më fal, pasi je në grup parlamentar, të mos e çojmë më tutje, janë gjëra që janë jashtë Parlamentit.

Vazhdojmë në orën 14:00!

* * *

Vazhdimi i seancës, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala

KRYESUESI KUJTIM SHALA: Të nderuar deputetë,

Ju lutem, t'i zini vendet,

Të vazhdojmë seancën,

Atëherë, sipas radhës në një shpërndarje të grupeve parlamentare, i jap fjalën deputetit Ilir Deda. Urdhëro, zoti deputet, e keni fjalën.

ILIR DEDA: Faleminderit, zoti kryesues!

Po më vjen mirë që është kryeministri këtu, me një ministër fatkeqësisht, mua po më duket këtë debat e kemi filluar pak mbrapsht, sepse sot po diskutojmë për buxhetin e programin e Qeverisë e kemi nesër, e realisht është dashur të jetë e kundërta. Së pari është dashur të diskutojmë për programin qeverisës, e mandej për buxhetin e të shihet a janë në përputhje njëra me tjetrën.

Nuk dua ta zgjas shumë, po dua të ndalem te 3-4 pika kyçe.

E para, dua të filloj me buxhetin e Kuvendit të Kosovës. Republika e Kosovës me vite e ka kusht që Kuvendi të ketë autonomi buxhetore, edhe këtë e kemi kusht edhe me Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim dhe është viti i tretë ku ne nuk e përmbushim këtë obligim. Për më tepër, përsëri Kuvendi i Kosovës ka buxhet më të ulët se disa institucione të tjera, për shembull, derisa ne i kemi të planifikuara 10.5 milionë euro për vitin e ardhshëm, Radiotelevizioni i Kosovës e ka 11.5 milionë, edhe unë nuk e di cili institucion është më i rëndësishëm në këtë vend, a është Kuvendi apo agjencitë e tjera, të cilat financohen nga buxheti i shtetit.

Dy, politika e jashtme ka ngecur apo nuk përkrahet mjaft me buxhetin për vitin e ardhshëm. Ne nuk mund të pretendojmë të kemi politikë të jashtme efektive duke marrë parasysh sfidat në të cilat gjendemi, duke marrë parasysh rolin agresiv të Serbisë.

Në qoftë se buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin e ardhshëm është vetëm 30 milionë euro, e sa për informatë, Republika e Serbisë i ka ndarë më shumë se 300 milionë euro që ta luftojë pavarësinë e Kosovës në vendet e ndryshme të botës, ndërsa ne e kemi bërë një buxhet minimal për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe kjo nuk është në rregull.

Tjetra, ne po themi që po e duam Ushtrinë e Kosovës, po as në Buxhetin 2018, e as për planifikime për vitin 2019 e 2020 nuk parashihet kontingjenti i rritjes së buxhetit të FSK-së, kur do të shndërrohet FSK-ja në ushtri.

Ministri i Financave më herët tha që lehtë do të gjenden paratë, vetëm kur ta vendosë Kuvendi transformimin e FSK-së, po ato para nuk mund të gjenden lehtë nëse nuk ekzistojnë në kategoritë

buxhetore, apo ndoshta ka menduar që do të përfundojë projekti me Behtel&Enkën dhe ato para, të cilat shkojnë aty, do të transferohen në ushtri një ditë.

Gjithashtu sundimi i ligjit, i cili proklamohet të jetë shtyllë e fokusit të qeverisë tuaj, zoti kryeministër, e Njësia e Krimeve Ekonomike i ka vetëm 58 mijë euro në vit.

Mendoj që ka mundur të bëhet një buxhet shtesë për Njësinë e Krimeve Ekonomike, në qoftë se e kemi seriozisht luftimin e korrupsionit e të krimit të organizuar.

Dhe, në fund, ne kemi dikastere, të cilat merren me zhvillimin ekonomik, i kanë 2,5% të buxhetit vjetor të vitit të ardhshëm.

Më falni, po bujqësia nuk mund të jetë motor i zhvillimit ekonomik në Kosovë, apo nuk mund të jetë i vetmi prodhues në Kosovë. Këtu edhe një herë kthehemi te pika fillestare e themelimit të Qeverisë, e ajo është rritja pa një racionalitet, e cila i është shpjeguar këtij Kuvendit pse i kemi pesë ministri, të cilat duhet të merren me zhvillim ekonomik dhe pse nuk reflektohet programi qeverisës për zhvillim ekonomik edhe në buxhet dhe në koordinim, a kanë koordinim këto ministri njëra me tjetrën apo jo.

Dhe, në fund, kthehem te integrimet evropiane. Ministria e Integritimit Evropian e ka buxhetin 2,2 milionë euro. Kjo tregon që Ministria e Integritimit Evropian nuk ka bërë planifikim të mirëfilltë për rritjen e kapaciteteve administrative, të cilat duhet t'i bëjë kjo ministri që t'u ofrojë shërbime pjesëve të tjera në vend që të përballen me zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim.

E, në fund, Alternativa nuk do ta votojë në lexim të parë projektbuxhetin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, i jap fjalën deputetit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, zotit Dardan Molliqaj.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës,

Të respektuar dy përfaqësues të Kabinetit qeveritar, përkatësisht kryeministër dhe ministër,

Do të doja të nisja me një replikë, po nuk është këtu kryetari i Kuvendit, nuk e di pse iku tash, edhe pse tha që do të kthehet. Unë nuk e di deri kur do ta ndalë praktikën e ofendimit të deputetëve? A po mendon që duhet bërë ashtu, a po mendon që guxon të bëjë ashtu apo është thjesht njeri i papërgjegjshëm dhe i pamoralshëm, sepse fjalët që i tha këtu nga kjo foltore janë absolutisht të papranueshme, por po e le për një herë tjetër, kur besoj që ai do të jetë këtu dhe do të tërhiqet nga ato fjalë që i tha ndaj deputetes Drita Millaku.

Është keq që Qeveria pak po rri gjatë debatit për buxhetin, i cili është ligji më i rëndësishëm edhe një herë në vit miratohet. Tash këtu e kemi kryeministrin, po s'i kemi ministrat, të cilët do të duhej të dëgjonin çka thonë deputetët nëse kemi diçka për të thënë.

U diskutua shumë gjatë në këto dy ditë të seancës se a është ndryshe ky buxhet nga buxhetet e tjera.

Unë bëj pjesë në grupin e atyre njerëzve, të cilët besojnë që buxheti nuk ka ndryshuar dhe po mundohem të shpjegoj çka nënkupton ndryshimi i buxhetit. Është e vërtetë që kanë ndërruar shifrat, është e vërtetë që diku janë rritur paratë për disa ministri, por kemi një mentalitet ose një bindje të njëjtë prej vitit 2007 e deri në vitin 2017, dhe kjo bindje është se shteti i Kosovës zhvillohet nëpërmjet investimeve në infrastrukturë.

Pra, 10 vjet paratë kryesore të investimeve kapitale kanë shkuar në infrastrukturë dhe sot, pas 10 vjetëve mund të flasim që mirëqenia dhe zhvillimi ekonomik nuk ka pësuar ndryshim cilësor dhe po prapë po vazhdojmë me të njëjtën qasje. Pra, që investimet tona kryesore po i çojmë në infrastrukturë, ani pse për vite të tëra po e shohim që kjo nuk është e duhur.

E kam lexuar me vëmendje programin e Qeverisë së zotit Haradinaj dhe po e shoh edhe buxhetin.

Në program, të gjithë, e dini, rritja ekonomike e premtuar dy muaj e gjysmë më herët ka qenë në pragun e ulët 5%, ndërsa në pragun e lartë 8%.

Dhe, sot buxhetin që na e ka paraqitur Qeveria e Republikës së Kosovës, rritja parashihet në maksimumin e saj 4,6%.

Qeveria do të duhej të mbajë përgjegjësi: ose na ka mashtruar me programin qeverisës para dy muaj e gjysmë, ose po na mashtron tash, sepse jemi nën pragun e ulët të rritjes ekonomike.

E kur jemi te mashtrimet, njëjtë është edhe te puna e vizave, njëjtë është edhe te puna e zëvendësministrave, po bëhet pak hajgare me këtë punë. Po, ne kemi qenë në opozitë atë kohë me zotin Haradinaj, Limajn, e në veçanti zotin Limaj, i cili pati propozuar të bëhen protesta për shkak të numrit të madh të zëvendësministrave. Zoti Haradinaj, me sa di unë, ia ke kapërcyer Qeverisë së kaluar, nuk jam krejt i sigurt, po ndoshta na jep një përgjigje. E tash a i bie që do ta bësh një protestë kundër vetes, apo po thua që ne nuk guxojmë të bëjmë protesta, e ndoshta për këtë po ndihesh rahat.

Problemi është që edhe këto investimet në infrastrukturë nuk po bëhen në rrugë me të cilat mund të kenë përfitime ekonomike.

Unë nuk e di edhe sot e kësaj dite pse po insistohet në zgjerimin e disa prej rrugëve magjistrale, të cilat në bazë të hulumtimeve që po dalin pas zgjerimeve nuk po shfrytëzohen as 1/3 e tyre dhe, e tha deputeti nga radhët e pushtetit, dje zoti Selmanaj qysh për rrugën, e cila mund të ketë përkthime ekonomike, ajo është rruga Deçan-Plavë, e cila mund të ketë ndikim në ekonomi, janë nda vetëm 2 milionë.

Pra, po ndahen miliona euro Pejë-Gjakovë, Prishtinë-Pejë, në fund përdoren 1/3 e kapacitetit të saj e nuk ka kurrfarë efekti ekonomik, por diku tjetër jo, a kjo pse është më lehtë të vidhet në këto rrugë, a është pse i interesojnë më shumë dikujt këto rrugë, sepse zgjedhjet janë kryer, dhe siç thotë Qeveria, katër vjet e ka mandatin, janë kryer zgjedhjet për komuna, atëherë mendoj që është gabim çka është duke ndodhur.

Problem tjetër i theksuar që nuk ka ndërruar hiq, përkundrazi është përkeqësuar nga kjo Qeveri është që në Projektbuxhetin 2018 rritja e të hyrave prapë parashihet që në masën më të madhe të jenë nga doganat.

Nuk do të ketë zhvillim ekonomik, nuk do të ketë rritje ekonomike derisa buxheti i Kosovës mbledhet në masën më të madhe nga të hyrat prej doganës, dhe nuk e ka ndërruar këtë qasje, përkundrazi e ka përkeqësuar. Gjithë ditën ministrat e kësaj Qeverie rrinë duke folur qysh do të ketë zhvillim ekonomik, a e dini që nuk e njoh ende ministrin e Zhvillimit Ekonomik, nuk di a ka qenë ndonjëherë në këtë seancë, kurrë nuk po e shoh, nuk di çka është duke bërë ai ministër.

Problemin tjetër që e ka bërë projektimi i buxhetit, përkatësisht ministria nëpërmjet ministrave të tjerë është se e ka rritur jashtëzakonisht shumë deficitin buxhetor.

Unë e kuptoj që është brenda hapësirës ligjore, por një rritje kaq e madhe përnjëherësh, pra prej 86 milionëve në 253 milionë, është rrezik, sa do të rritet vitin e ardhshëm dhe a do ta mbërrijmë kufirin e epërm, apo edhe do ta kalojmë, sepse me këtë trend është jashtëzakonisht rrezik dhe problem.

E kanë theksuar disa deputetë, e kam theksuar edhe në takim të komisionit se është joobligative që Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe as Qeveria t'i ndajnë fonde RTK-së. Nuk ka asnjë ligj që e obligon Kosovën t'i ndajë fonde RTK-së, është Ligji për hulumtime dhe shkencën që thotë të ndahen para për një gjë të tillë, por nuk ka ligj që na obligon dhe jemi duke i çuar miliona euro në një institucion, i cili është duke bërë propagandë sa herë ndërrohen qeveritë, herë për PDK-në, herë për LDK-në, herë për AAK-në, nesër për dikë tjetër mund të bëjë, po është gabim.

Dhe, në raportin që e kanë sjellë në komisionin tonë, ne kemi parë se ka keqpërdorime të jashtëzakonshme dhe Qeveria me të njëjtin avaz ndan miliona euro për një institucion, i cili është duke i bërë dëm shoqërisë dhe shtetit.

Problem i theksuar është çështja e veteranëve. Unë nuk po e kuptoj më qysh edhe në projektligjin e vitit 2018 nuk është adresuar kjo çështje.

Sipas përllogaritjes që duket do të jenë rreth 80 milionë euro, e në bazë të deklarimeve që i kemi dëgjuar nga komandantët gati është trefishuar numri i veteranëve, pra vetë thonë i kemi trefishuar, vetë thonë ka të jashtëligjshëm e vetë u japin para atyre.

Për mua, kjo është investim edhe financim i atyre të cilët janë jashtëligjshëm nëpër këto kategori.

Problem tjetër që e shoh me buxhetin po ashtu është edhe rritja e zërave për mallra dhe shërbime.

Në krahasim me vitin 2016, 30% është rritur shuma për këtë kategori, në ndërkohë që në bazë të përllogaritjeve inflacioni ka qenë vetëm 1%. Çka u bë, a na u kanë rritur objektet, a na u kanë rritur institucionet, të cilat jemi duke i mirëmbajtur, çka është duke ndodhur nuk po e kuptoj, 30% për dy vjet të rriten është e papranueshme.

Kjo i ka dy mundësi: po rialokohen nëpër vende të tjera, ose po i shpërndan kryeministri i Kosovës parat si të ishin të shtëpisë së vet, qysh ka nisur kohët e fundit një praktikë që të paktën publikisht nuk ka qenë deri më tash. Pra, vendos herë dikujt, herë dikujt t'i jepen shuma të caktuara të parave, që është krejtësisht e papranueshme.

Me këtë logjikë të këtij buxheti qysh e kemi ndarë nuk ka zhvillim ekonomik, madje, madje do të jetë më pak se 4.6% rritja në fund dhe të jeni të bindur që në rishikimin që do t'ia bëjmë vitin e ardhshëm, nuk do të arrijë 2 miliardë buxheti, do të jetë prapë nën 2 miliardë dhe unë nuk po e kuptoj qysh Qeverisë nuk po i vjen keq për dy muaj e gjysmë të na i sjellë dy dokumente të ndryshme: një që thotë rritja, po e përsëris është 5 deri 8% dhe, buxheti, që është reale, po thotë 4.6.

Unë nuk e di pse duhet të mashtrohen në periudha kaq të shkurtra qytetarët e Republikës së Kosovës, apo përnjëmend kjo ka qenë veç çështje e zgjedhjeve dhe tash pas zgjedhjeve thonë se kështu kanë qenë rrethanat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Ministër,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht përgëzoj ministrin Bedri Hamza për planifikimin e buxhetit dhe prezantimin në mënyrë të shkëlqyeshëm. Përfundimisht sot në Kosovë e kemi një buxhet real, projekte reale, të cilat bazohen në mundësitë e shtetit të Kosovës dhe absolutisht nuk kemi të bëjmë me premtime dhe projekte hipotetike ose thjesht imagjinare, siç na ka ndodhur në të kaluarën.

Unë sot do të ngre tri çështje sa i përket buxhetit, por fillimisht dua t'i përhëndes të gjitha ato çështje, të cilat u ngritën për komunën e Skenderajt nga deputetja Evgjenie Thaçi, Mërgim Lushtaku dhe gjithashtu Andin Hoti.

Kisha pasur shumë dëshirë që sot kur po debatohet Buxheti 2018 të diskutoj dhe të ngre shqetësimin tim, të kërkoj rritjen e buxhetit për zjarrfikësit në Kosovë.

Është e ditur që zjarrfikësit në Kosovë operojnë në gjendje të mjerueshme, pa kushte dhe pa kapacitete. Fatkeqësisht nëse sot ndodh një zjarr kudo në Kosovë, përveç që rrezikohen njerëzit, të cilët mund të ndodhen brenda atij zjarri, ne i kemi të rrezikuar edhe zjarrfikësit, të cilët do të mundohen me kapacitete të mangëta të operojnë në atë zonë ku është shfaqur zjarri eventual.

Fatkeqësisht edhe sot, statusi i padefinuar i kompetencave menaxhuese në mes të nivelit qendror dhe komunal na e pamundëson të kërkojmë ngritje konkrete të buxhetit për zjarrfikësit, duke ditur që zjarrfikësit kanë mbetur pa uniforma, pa pajisje personale të domosdoshme për mbrojtje dhe siguri në punë, me teknikë të stërvjetëruar, me pajisje të pasigurta për punë të pakontrolluar dhe të patestuara sipas deklaratës së prodhuesit, përdorimi i të cilave jo që ndihmon, por përkundrazi rrezikon jetën e zjarrfikësve, të cilët marrin pjesë në aksion.

Pagat e zjarrfikësve janë në gjendje të mjerueshme dhe unë mendoj që përfundimisht duhet të mendohet të ndahet një vijë buxhetore për zjarrfikësit dhe statusi i tyre përfundimisht të qartësohet, pra kompetencë e kujt janë zjarrfikësit në Kosovë.

E dyta, çka dua të përmend nga ky buxhet që e lexova me vëmendje dhe kam ngritur fatkeqësisht edhe herëve të tjera gjatë diskutimit të buxhetit dhe nuk po shoh ndonjë përmirësim është kompleksi memorial "Adem Jashari", ku totali i mjeteve të planifikuara në mes të vitit 2018 dhe 2020 e kap shumë prej 225 mijë eurosh.

Sinqerisht po e them, unë nuk di çka kanë planifikuar me këto ose çka kanë paraparë me këto mjete, kur ne e dimë shumë mirë që çdo gjë që bëhet në kompleksin memorial "Adem Jashari" nëse ne nuk intervenojmë në konservimin e kullave, të cilat rrezikojnë çdo ditë të shemben dhe të shkatërrohen, nuk e di se çka na duhen investime të tjera.

Ne po rrezikojmë ta humbim historinë tonë më të re, historinë me të cilën ne mburremi në botë dhe thjesht sot e gëzojmë edhe këtë liri.

Prandaj, unë mendoj që është momenti i fundit që Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ju, zoti kryeministër, të keni në vëmendje dhe prioritet konservimin e kullave muze të Jasharajve, të cilat tashmë janë shndërruar në simbol të Kosovës.

Pika e tretë që dua ta ngre zërin fuqishëm është gjimnazi “Hamzë Jashari” në Skenderaj.

Është një objekt i cili ka filluar që sa vjet dhe fatkeqësisht tashmë ka ardhur në atë pikë sa që ne nuk e kemi fare në buxhetin e Republikës së Kosovës. Kjo është hequr edhe nga buxheti i vitit 2017 dhe as sot nuk figuron në buxhetin për vitin 2018.

Unë mendoj që kjo është shumë emergjente dhe pa asnjë mëdyshje duhet të ndahet buxhet për shkollën “Hamzë Jashari”, sepse ai objekt tashmë është dashur të përfundojë para dy vjetëve dhe thjesht ka mbetur një godinë, e nxënësit atje rrezikojnë çdo ditë jetën e tyre në kushte joadekuate për punë, në kushte që nuk e meritojnë as shkolla, as nxënësit.

Prandaj, unë mendoj që mes dy leximeve ne do të gjejmë mundësi ta fusim gjimnazin “Hamzë Jashari” në Buxhetin 2018 dhe ky projekt të jetë i realizueshëm.

Edhe një herë i falënderoj edhe deputetët e tjerë, të cilët kanë përmendur, nuk po dua t’i përsëris projektet e tjera, siç janë kanalizimi, ujësjellësi, infrastruktura rrugore. Unë e di se për dikë kurrë s’ka qenë as s’do të jetë prioritet infrastruktura rrugore, sepse e kanë pasur ata edhe me ish-Jugosllavinë, por ne e dimë se fshatrat tona të lëna mbrapa, me apo pa tendencë nga dikush, kanë nevojë edhe për një metër asfalt, jo më për kilometra.

Kështu që unë konsideroj se vendi ynë, i cili ka dalë i shkatërruar nga lufta, ka nevojë edhe për rrugë, edhe ujësjellës, ka nevojë edhe për kanalizime, ka nevojë edhe për përmirësime shëndetësore, ka nevojë për çdo gjë që u duhet si bazë jetësore qytetarëve për të jetuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Haxhi Shala.

HAXHI SHALA: Të nderuar deputetë,
Kryeministër,
Ministra,
Ju përshëndes,
Sot po diskutohet ligji më i rëndësishëm i vendit, Buxheti 2018.

Në çdo linjë, nëse e diskutojmë një nga një, shohim se të gjitha linjat janë të arsyeshme siç janë parashikuar në këtë ligj të prezantuar nga ministri Hamza.

Unë dëshiroj që ky buxhet i varfër të shpërndahet në mënyrë proporcionale, e një gjë të tillë tashmë e ka bërë Qeveria.

Dhe, me të drejtë, nga dikasteret e Qeverisë dëshiroj të mos ketë keqpërdorime të buxhetit nga ministrat, kryetarë komunës si dhe nga agjenci të ndryshme.

Pa dyshim që ky buxhet në parim e ka përkrahjen time, por ajo që unë kërkoj nga ju, zoti kryeministër, është që në leximin e dytë, apo nëpër komisione apo çdonjëri prej ministrave të japë sqarime lidhur me detyrat e zëvendësministrave, e di që e ke kërkuar ti nga ministrat që të ketë përshkrim të detyrave për zëvendësministra, po së paku për opinionin të kemi një qartësim të qartë për zëvendësministra, sepse me të vërtetë është një ngarkesë e madhe për buxhetin. Zoti kryeministër... parasheh një numër të madh të projekteve të filluara nga qeveritë e kaluara, e kam parë gjatë mandatit tënd, do t'i përfundosh të gjitha këto projekte, të cilat kanë filluar në qeveritë e mëhershme, kur ato objekte asnjëherë nuk janë shfrytëzuar nga qytetarët tanë. Shpresoj që të gjitha këto projekte, salla sportive e shkolla të përfundojnë së paku në mandatin tuaj, ose në vitin 2018, siç është paraparë në Projektligjin e Buxhetit.

Në këtë ligj pa dyshim, e pashë edhe rritje në shëndetësi, dëshiroj që ajo rritje, edhe paksa e vogël të jetë një rritje e mirë dhe të shfrytëzohet në mënyrë racionale në shëndetësi, që qytetarët tanë të mos kenë nevojë të harxhojnë më shumë buxhet në shërim jashtë vendit sesa që është paraparë në buxhetin e shëndetësisë. Të krijohen kushtet për një shëndetësi të mirëfilltë.

Në bujqësi kemi pritur që do të ketë një rritje më të madhe të buxhetit, por edhe këtu ka një rritje të vogël, e cila nuk ngjall shpresa te bujqit për përkrahjen më të madhe se qeveritë e kaluara. Këtu kërkoj nga ministri i Bujqësisë që t'i ndërrojë kriteret dhe politikat në shfrytëzimin e këtyre granteve apo subvencioneve, sepse deri më tash kemi parë që buxheti i bujqësisë më shumë është shfrytëzuar për fushata sesa që t'u ndihmohet fermerëve tanë në bujqësi. Kështu që faleminderit, zoti kryeministër, dëshiroj që atë që e thashë më herët dhe që ke kërkuar ti nga ministrat, së paku t'i sqarojmë detyrat e zëvendësministrave, sepse edhe opinioni i gjerë e kërkon këtë gjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Ia jap fjalën deputetit Valon Ramadanit, Lëvizja "Vetëvendosje". Urdhëro!

VALON RAMADANI: Të nderuar deputetë!

Të dashur qytetarë,

Nuk mund assesi ta mohojmë faktin se kjo qeveri është qeveri e luksit. Pikërisht në shtetin më të varfër në Evropë, me popullsinë më të varfër në Evropë, ne e kemi qeverinë më të madhe, me 21 ministri dhe me 100 zëvendësministra.

Shpenzimet për këtë Kabinet qeveritar sigurisht që vijnë nga paratë e qytetarëve, por problemi qëndron që ato as nuk ua kanë kthyer as si përkushtim në punë e shërbim të ndershëm atyre dhe me çfarë po shohim as tash nuk do t'u kthehen. Kët paragjykim, do të thoni ju e kam të bazuar në natyrën e buxhetit që keni paraparë. Askush dhe askund nuk ka qoftë edhe një shenjë të vetme të projekteve zhvillimore që lidhen me prodhimin, apo me sektorë që do ta vendosnin Kosovën në përparësi krahasuese me vendet e rajonit. Ky buxhet assesi nuk mund të jetë as buxhet i shtetit të së drejtës, apo luftës kundër korrupsionit, siç dëgjohet nëpër fjalimet e shumë ministrave. Vetëm Zyrës së Presidentit i ndahen 3 milionë euro në vit. Zyrës së Kryeministrit dhe Kabinetit të tij u ndahen afro 4 milionë, e në anën tjetër Agjencisë Kundër Korrupsionit i ndahen vetëm 500 mijë euro.

Si mund të ecim përpara nëse në fushën për të cilën çdo qytetar është i brengosur dhe po ashtu në çdo raport të Komisionit Evropian na e përmend këtë në dhjetë vjetët e fundit. Sigurisht që nga një qeveri me përbërje të tillë nuk pritet luftë kundër korrupsionit, e as buxhet që e mbështet atë, ngase kjo luftë do të binte mbi vetë ata.

Një fakt tjetër shqetësues është edhe përkrahja që kjo Qeveri i ka dhënë Komunës së Ferizajt, ku, edhe pse qytetarët e sipërmarrësit nga kjo komunë janë kontribuuesit e dytë më të mëdhenj të arkës së shtetit dhe me mbi 360 milionë euro në vit, e me 3,6 miliardë euro nga taksat dhe të hyrat në dogana gjatë dhjetë vjetëve të fundit, për Komunën tonë janë planifikuar vetëm 24 milionë në vit nga Buxheti i shtetit. Nuk është që Komunës së Ferizajt nuk i dedikohen më shumë mjete për shkak se Qeveria mendon sipas parimit të solidaritetit me komunat më të varfra ose më të vogla. Jo, ne e dimë të gjithë që buxhetet për nivelin komunal ndahen vetëm sipas një parimi, atë të bastioneve të supozuara, apo zonave që tentojnë t'i kenë nën ndikim.

Ky buxhetim i zhbalancuar tash e një dekadë po i dëmton pakthyesëm qytetarët, nuk po i lejon bizneset e vogla që ta kalojnë pragun e mbijetesës, nuk po i mbështet gati asnjëherë ndërmarrjet e mesme që të rriten e të kalojnë në një fazë të avancuar, si dhe nuk po ia mundëson asnjë fermeri që të mbërrijë në stadin kur do të mund të ishte konkurrues edhe përtej rajonit të vet, por edhe jashtë Kosovës. Këta flasin gjithë ditën për tregun e lirë, por atë treg e kontrollojnë me sistemin e prokurimit, atë të subvencioneve. Sa janë ato lloj projektesh në Buxhetin e shtetit, të cilat i kanë gati kompanitë e preferuara, ku pronarët apo aksionarët e vërtetë janë ata që e përgatitin.

Nuk ka asnjë rritje të buxhetit për matjen e cilësisë, qoftë të ushqimit, qoftë të produkteve të tjera që ndikojnë direkt në mbështetjen e bizneseve të ndershme dhe në jetën e çdo qytetari. Kjo sepse askush nga këta nuk është i interesuar që këtë dukuri ta rregullojnë. Ky buxhet e bart logjikën e mbrapshtë qeverisëse të PDK-së, dikur, e cila u përcoll njëjtë në këto dhjetë vjet. Projektet kapitale që nuk prodhojnë asgjë, që nuk lidhen me asnjë sektor të zhvillimit, por i mirëmbajnë

vetëm bizneset që i kontrollojnë këta ose që llogaritin që do t'i shtrëngojnë me gjobën mujore apo vjetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ia jap fjalën deputetit Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Disa vrojtime të përgjithshme për Buxhetin do t'i filloj prej asaj për projektet e reja që janë përfshirë në Ministrinë e Infrastrukturës. Nëse ju kujtohet vitin e kaluar në Ministrinë e Infrastrukturës kanë qenë të përfshira 122 projekte të reja, kurse sivjet i kemi vetëm 10. Kjo domethënë se ose i kemi kryer krejt rrugët vitin e kaluar, ose sivjet s'dihet, komunat s'po duan të punojnë. Tash nëse flasim për zhvillimin ekonomik, nuk besoj që mungesa e projekteve të reja do të ndikojë në zhvillimin ekonomik, do ta pengojë zhvillimin ekonomik, apo thjesht do ta kemi një zvogëlim të zhvillimit ekonomik, në veçanti kur flasim se prej tyre 122 projekteve vitin e kaluar i kemi pasur 98 projekte me bashkëfinancim të komunave, të cilat u janë përcjell të gjitha komunave për t'i kryer procedurat, jam i bindur se shumica e tyre i kanë kryer procedurat dhe shumica e tyre janë marrë nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Kështu që do të ishte me rëndësi të shihet se pse sivjet nuk kemi kërkesa nga komunat, apo thjesht janë kryer të gjitha rrugët në mandatin e kaluar. Prej projekteve të reja, natyrisht që nevojitet të përmenden dy projekte që janë të mira, që natyrisht i përkrah: është zgjerimi i rrugës Dolc - Gjakovë, që është afro 33 milionë euro, dhe është Qarkorja e Gjakovës.

Për të parën është mirë megjithatë, tash po flas prej përvojës, besoj se është shumë më me rëndësi zgjerimi i rrugës Gjakovë - Prizren sesa zgjerimi i rrugës Dolc - Gjakovë. Ajo rrugë është shumë më e ngarkuar, me zgjerimin e asaj rruge do ta lidhte drejtpërdrejt atë pjesë me autostradën "Arbër Xhaferi", kurse për këtë pjesën tjetër do të duhej të pritej edhe një kohë, me faktin se po fillon zgjerimi i kësaj rruge. Qarkorja e Gjakovës vitin e kaluar është dorëzuar nga kryetarja në ministri dhe është përcjellë në Këshillin Nacional për Investime, e para se të hyj këtu është dashur thjesht ta kem një përgjigje, a do të përfshihet në klauzolën investive të financuar nga BERZH-i, apo do të shkohet drejtpërdrejt me financim nga Buxheti. Në anën tjetër, shuma e ndarë për vitin e ardhshëm 2018, qoftë për Dolc - Gjakovë, që është 5,9 milionë, apo për Qarkoren e Gjakovës 3 milionë, besoj se nuk do të mund të shfrytëzohet. Së pari duhet të bëhet projekti, e projektet zgjatin afro një vit, kështu që kjo shumë në shumicën e rasteve do të mbetet pa u shfrytëzuar, apo të mos them do të mbetet e këtillë.

Megjithëse ka rritje të shumave, në disa projekte është mirë të përmenden disa projekte, që së paku nuk e shoh arsyetimin logjik pse janë zvogëluar mjetet kur dihet rëndësia e disa rrugëve, po flas për rrugën Carralevë - Qafë e Duhlës, që ka qenë 1 milion, ka rënë në 550 mijë. Rruga

Prizren - Prevallë është zvogëluar për 200 mijë, rruga Bardh i Madh - Lismir ka qenë 450 mijë, ka rënë në 350 mijë, Stallovë - Zllash - Viti - Marec, ka qenë 450 mijë, ka rënë në 350 mijë, Breznje - Trokan - Brut, prej 700 mijë ka rënë në 150 mijë, Drekoc - Ura e Haxhisë prej 750 mijë ka rënë në 450 mijë, Dakovc - Smrekovnicë - Vushtrri, kanë qenë të parapara 4 milionë, tash janë 2 milionë e 400 mijë. Sa jam i informuar, edhe 4 milionë kanë qenë bile pak për atë pjesë, kështu që tash është për tre vjet është zvogëluar në 2 milionë e 400 mijë dhe është rruga Babush - Tërnluboc - Koshare - Slivovë, e cila prej 1 milion kanë mbetur veç në 50 mijë, kurse projekti ka qenë në procedurë të tenderimit, ka pasur probleme tenderimi, megjithatë nuk e shoh një arsyeshmëri logjike për zvogëlimin e këtyre shumave.

Do t'i përmend dy projekte, të cilat është dashur të përfshihen në buxhetin e vitit 2018. E para ka të bëjë me studimin e fizibilitetit për kalimin nëntokësor të hekurudhës në Ferizaj. Të gjithë e dimë sa është punuar që të mund ta kryejmë atë projekt, në bashkëpunim apo në biseda me Bankën Investive Evropiane dhe me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim jemi pajtuar që ta bëjmë studimin e fizibilitetit. Sa kam qenë në ministri kanë filluar procedurat, janë bartur mjetet në Departamentin e Transportit, por pasi jemi këtë vit, pasi kemi buxhet të ri do të ishte mirë që të ndahen 250 deri në 300 mijë euro që të kryhet studimi i fizibilitetit. Ai studim i fizibilitetit do të ishte përgjigjja më e mirë për çfarëdo investimi që bëhet në rehabilitimin e vijës hekurudhore dhe natyrisht do të ishte bazë që Qeveria ta marrë një vendim sesi të ecet tutje dhe qytetarët e Ferizajt ta kenë një përgjigje.

Përpos kësaj, është edhe vendimi i Komisionit Ndërministror për qasje të reja në autostradën "Arbër Xhaferi" në Ferizaj dhe Viti. Natyrisht, Komisioni Ndërministror duhet të vendosë në mënyrë decisive e cekur se është dashur të përfshihet në rishikimin e Buxhetit 2017, apo në Buxhetin e ri 2018. Komisioni Ndërministror duhet të vendosë, ose ta respektojë atë vendim, ose ta anulojë atë vendim. Nuk mund që vendimi si i tillë të mbetet pezull. Në fund, 3-4 çështje për ligjin që besoj se do të duhej të ishin çështje teknike. Ministër, ju e dini besoj më së miri këtë punë, po flas për nenin 12.2, numri i të punësuarve në një organizatë buxhetore, nëse kalimi i të punësuarve nga një departament në departamentin tjetër, për të thjeshtësuar do të duhej të bëhej me organogram, e organogrami të aprovohet në Qeveri dhe prapë lëvizja e punëtorëve të bëhet me pëlqim të ministrit.

Unë, thjesht prej përvojës, besoj se kjo duhet të jetë një çështje teknike në momentin kur një ministër e bën organogramin e një ministrie dhe në momentin kur aprovohet nga Qeveria natyrisht do të duhej të ishte vetëm çështje teknike, pa procedura tjera, që të aprovohet lëvizja e të punësuarve prej një departamenti apo prej një agjencie tjetër, që të ketë edhe procedura tjera për aprovim nga ministri.

Neni 13.1. flet për avancet apo paradhëniet. Sipas mendimit tim, paradhëniet duhet të hiqen krejt, Qeveria e Kosovë nuk ka nevojë të japë paradhënie, megjithatë edhe në rastet e caktuara, nëse

jepen, duhet të jetë e përcaktuar procedura me ligj, në cilat raste jepet ajo paradhënie dhe natyrisht si bëhet zbritja e paradhënies. Ka përvoja të ndryshme në Qeveri, nganjëherë paradhënia apo avanci zbriten në faturën e parë, por në shumicën e rasteve paradhënia zgjatet derisa të kryhet projekti, duke zbritur prej shumës së faturës. Kjo çështje do të duhej të rregullohej me ligj.

Dhe, e fundit, ndryshimet në projektet kapitale në kuadër të nënprogrameve do të duhej që kjo të bëheshin më shumë çështje teknike, kur që një ministri e caktuar ta ketë të drejtën e lëvizjes prej një projekti në projektin tjetër. Natyrisht, ju kuptoj ministër që deri në 15% ju e kryeni, 25% Qeveria, mbi 25% Kuvendi, por besoj që për një shfrytëzim më efikas të mjeteve dhe për realizim më të mirë të projekteve kjo çështje duhet të thjeshtësohet dhe natyrisht t'i lihet në dorë ministrisë që ajo t'i bartë mjetet në programe të ndryshme në përputhje me ekzekutimin e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nait Hasani. Naiti s'është këtu. Qëndron Kastrati, nuk është. Kalojmë te Grupi Parlamentar i LDK-së, Anton Quni, s'është. Korab Sejdiu, s'është. Veton Berisha, deputet pa grup parlamentar, e ka fjalën. Urdhëro, Veton!

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra, kolegë deputetë.

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që ta jap kontributin tim në këtë diskutim të këtij Projektligji për Buxhetin, i cili ka mjaft rëndësi dhe mendoj që është momenti që ndaj tij të kemi një qasje pak më ndryshe në kuptimin e asaj që të fillojë dhe të tentohet të ndryshohet gjendja vërtet në terren, në opinion.

Jam munduar pak a shumë për ta analizuar Projektbuxhetin. Faleminderit zoti ministër, janë disa çështje që më kanë pëlqyer, vërtetë ka mundësi në rast se arrin të ketë implementim, mendoj se edhe në komunitetet tona do të ketë efekt në jetën e përditshme, ndërsa kam qenë pak i brengosur për shkak që nuk kam parë shumë propozime të mira nga komunat, domethënë kryetarët e komunave ose propozimet që kanë ardhur prej kuvendeve komunale, të cilat kanë pasur mundësi të ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve, sidomos kur flas për fushën e infrastrukturës dhe strehimi i jetës së tyre. Domethënë, në këtë aspekt nuk e di se si do të procedohet dhe qysh është plani më tutje. Unë do ta jap kontributin tim ndërmjet dy leximeve, në mënyrë që ta kemi një plan të përbashkët për një qasje më të mirë që komunitetet tona, ose mundësia për t'u zhvillua këto komunitete, që të jenë më të mira.

Duke pasur përvojë nga mandati i kaluar dhe duke e takuar çdo institucion ose mekanizëm, i cili ka pasur për obligim punësimin e komuniteteve, sidomos duke u bazuar në Ligjin për shërbimin civil, neni 11., i cili thotë që deri në 10% të komuniteteve duhet të jenë të punësuar. Jemi

dëshmitarë, pasi edhe në mandatin e kaluar kemi dalë me një raport, i cili ka nxjerrë edhe rekomandime dhe jep rekomandime se si do të zgjidhet problemi i punësimit te komuniteteve tona, në këtë rast flas me përgjegjësi të plotë për komunitetin egjiptian, ku kemi dhe prapë vazhdon të jetë, domethënë është në rritje vetëm në një të punësuar, ndërsa rekomandimi nga ky Kuvend ka dalë që duhet të parashihet rritje e buxhetit. Domethënë, secili institucion, secili mekanizëm ka thënë që ne jemi të gatshëm që ta plotësojmë këtë ligj, nenin 11 të Ligjit për shërbyesit civilë, por nuk kemi mbështetje buxhetore. Domethënë, nuk kemi mundësi buxhetore.

Në anën tjetër, nuk lejohet prej Fondit Monetar Ndërkombëtar e tjera, e tjera. Por, ligji na obligon që të kemi deri në 10% të punësuar prej komuniteteve. Ndërsa, ne bashkërisht duhet ta shohim rrugën, se cila është rruga dhe mundësia më e mirë që komunitetet të jenë të punësuar, të plotësohet një ligj, sepse një obligim yni, edhe kushtetues, por edhe ligjor.

E dyta, jemi të interesuar shumë që të ndikojmë në Projektbuxhet drejtpërdrejt, në ngritje të edukimit, ngritje në fushën e shkollimit, sepse mendoj që shtylla kryesore për komunitetin tim - edukimi, ngritja e nivelit të edukimit në një bazë më të mirë dhe mbi këtë bazë mendoj që nuk duhet të kursehemi në buxhet, sepse është në interes të krejt neve, të shtetit në përgjithësi, që të mos kemi analfabetë më në rrugë, të kemi kuadro, të cilët vërtet do të kenë mundësi t'i nënshtrohen secilit konkurs të barabartë të punësimit, e pastaj nuk do të kemi nevojë të ketë vende të rezervuara, sepse ata do të jenë shumë në nivel me konkurrencën dhe s'do të kemi nevojë, pas pesë ose dhjetë vjetëve të kemi privilegje si komunitet, por mendoj që në këtë formë duhet të ndikojmë drejtpërdrejt në ngritjen e nivelit të edukimit.

Shëndetësia është gjithashtu një prej shqetësimeve tona, për shkak që duhet të shikohen ndoshta të ndryshohen, të përputhen edhe ligjet tjera, sepse ka shumë momente ose elemente që lidhen edhe me Ligjin për mbështetje sociale. Domethënë, në këto raste të kategorizohen ndoshta, ka nevojë edhe për buxhet, por të dihet kategorizimi i familjeve, në mënyrë që ndoshta ka nevojë një familje të lirohet ose të ketë mbështetje dhe të mos kemi nevojë ne të dalim në aksione humanitare e të mbledhim mjete financiare dhe të trajtohen...

Kështu, me ministrin për Shëndetësi besojmë në vazhdimësi që do të kemi mundësi dhe të koordinohemi. Unë, po ashtu, kam marrë një shqetësim prej Këshillit Konsultativ për Komunitete, është një këshill, po ashtu një kategori kushtetuese, Zyra e Presidentit do të duhej që kërkesën e tyre vërtet ta marrë për bazë. Ai është një këshill, një mekanizëm jashtëzakonisht i rëndësishëm i avokimit dhe lobimit të çështjeve tona. Ajo zyrë prej vitit në vit ballafaqohet me mungesë të buxhetit të mjaftueshëm. Domethënë, thuhet se ata janë të kufizuar për realizimin e programit të tyre vjetor për shkak se ata nuk kanë buxhet të mjaftueshëm. Andaj, mendoj që rekomandimi që do të vijë në amendamentim do të jetë njëri prej rekomandimeve që duhet ta kemi parasysh, sepse aty janë të përfshira të gjitha komunitetet dhe mendoj që është një mekanizëm jashtëzakonisht i rëndësishëm për ne.

Zoti ministër,

Dua të ju pyes se cila është arsyeja e largimit të nenit 12, domethënë neni që ka qenë në dy mandatet e kaluara, kur aty është paraparë një buxhet? Unë nuk kam qenë shumë ithtar i atij neni për shkak që jeta jonë nuk varet vetëm nga një ministri dhe nga një zyrë e komuniteteve. Mendoj që secila ministri duhet të ketë përgjegjësi buxhetore sesi të ndikojë në jetën e komuniteteve tona, por më intereson ta di se cila është arsyeja e largimit të atij neni, dhe mendoj se një nen, i cili na i ka dhënë mundësinë që ne të paktën të shpresojmë në një ndarje buxhetore të drejtë në raport me të gjitha komunitetet, e jo të përqendrohet vetëm në komunitetin serb. Tani ai nen është hequr krejt dhe vërtet e kemi humbur shpresën që ne tash e tutje, të paktën një pjesë, të kemi prej atij buxheti, po flas për Ministrinë për Kthim dhe Komunitete dhe Zyra e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve.

Domethënë, dy mekanizma që thirren në emër të komunitetet, ndërsa përfitimet dhe përqendrimi është kryekëput në një komunitet, pa qenë kundër atij komuniteti, por vërtet është e papranueshme që të investohet në një komunitet. Po dua të them, jo për shkak dhe në emër të lokalizimit, por vërtet mendoj që në dy rrugët duhet të shikohet mundësia e investimit. E di që ish-kryetarja është në ngjarje, zonja Kusari, ka investuar shumë në atë lagje, Lagjja Kolonia... por mendoj që për t'u përmbyllur ai projekt shumë i suksesshëm ka nevojë të investohet në rrugën e asaj që të çon në drejtim të asaj rruge dhe mendoj që këtu do të dalim me një amendamentim që do të plotësohet dhe mendoj që do t'ia dalim.

Po ashtu, Lagjja "7 Shtatori" në Pejë është lagje e cila duhet të urbanizohet sadopak. Mendoj që në këtë rast komunat duhet të jenë më përgjegjëse, sepse kryetarët e komunave kanë marrë votat e qytetarëve tonë baras dhe vërtet nuk ndihem mirë kur nuk shoh projekte, programe që i kanë premtuar në fushatë dhe tani nuk kam parë që ka pasur propozime, të cilat vërtet kanë qenë të lidhura me votën e tyre. Të shpresoj që kjo praktikë do të ndryshojë, që me kohë edhe programi, edhe plani të jenë në përputhje me interesat e tyre. Andaj, unë akoma pa qenë anëtar i ndonjë komisioni, nuk jam anëtar i komisionit, por do të mundohem në rrugë ligjore që ta jap kontributin tim për mundësinë e amendamentit ose të një plani të përbashkët, i cili vërtet do të mundësojë implementimin e këtij buxheti, i cili do ta ndryshojë gjendjen në fushën e punësimit, edukimit, strehimit, shëndetësisë dhe infrastrukturës. Janë pesë shtylla që janë jetike për komunitetin egjiptian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Mytaher Haskuka, s'është. Zenun Pajaziti, s'është. Time Kadrijaj nuk është. Imet Rrahmani, urdhëro!

IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë do të jem shumë konkret në atë çfarë kam vërejtur gjatë analizës së Projektligjit për Buxhetin e vitit 2018.

Natyrisht që jam fokusuar më shumë në Shëndetësi, sepse e njoh këtë fushë më mirë dhe po mendoj që është njëri nga prioritetet që duhet të trajtohet dhe Shëndetësia po zë vend në çdo prononcim, edhe të politikanëve, por jo vetëm të tyre, dhe në çdo dokument, qoftë qeveritar, qoftë tjetër. Dhe, nga kjo mund të themi që nga ajo fjala “kur të bëhet llaf, del diçka”, unë mendoj që është koha që ta marrim seriozisht çdo punë dhe të fillojmë t’i zgjidhim problemet në Shëndetësi një nga një. Nga ajo çka nuk desha, meqenëse e kemi seancën tjetër nesër, kur do të flasim për Programin e Qeverisë, sigurisht se aty do të flasim për çështje pak më gjerësisht, e unë sot do të koncentrohem vetëm në atë çka kam vërejtje në Projektligjin për Buxhetin.

E para, është në Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2017-2021 parashihet që Fondi i Sigurimeve Shëndetësore të ketë 75 të punësuar. Për vitin 2017, në Ligjin e Buxhetit janë paraparë 50 të punësuar. Ne e kemi lënë në proces të rekrutimit këtë staf dhe kjo është pezulluar. Sot fondi ka vetëm 28. Në fund të vitit do të duhej të ishin 50 të punësuar. Unë kisha propozuar që në Ligjin për Buxhetin për vitin 2018 të planifikohen edhe 25 pozita të reja në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore.

Gjithashtu, fondi prej 3 milionësh, që është paraparë në ligj, besoj që është për atë komponentin për pagesën për kapitacion duke u bazuar në performansë, sepse tashmë kemi obligime ndaj 6 komunave ku është duke u zhvilluar pilotimi i këtij komponenti të vetëm që lidh Fondin e Sigurimeve Shëndetësore me kujdesin parësor shëndetësor. Në dakordim me Bankën Botërore ne jemi pajtuar atëherë, që në vitin 2018 të shtohen edhe 14 komuna dhe numri prej 20 komunave t’i plotësojë kriteret e parashtruara më herët dhe t’i marrin fondet përkatëse.

Unë tash do t’i cekja disa nga projektet që janë paraparë, janë futur si të reja, dhe fatkeqësisht ndoshta edhe me ndikimin e individëve të caktuar, por pa ndonjë vlerësim se sa ato do të kenë impakt direkt në rritjen e shërbimeve, qoftë për nga numri, qoftë për nga cilësia. Nuk jam kundër këtyre projekteve, por mendoj se buxheti që është ndarë nuk është i mjaftueshëm dhe fillimi i shumë projekteve mundëson harxhimin e shumë mjeteve, nga pak mjete për shumë projekte, por prolongimin e realizimit të atyre projekteve dhe ofrimin e atyre objekteve për shfrytëzim edhe nga mantelbardhët, por edhe nga qytetarët e Kosovës.

I pari që më ka rënë mua në sy dhe dua shpjegim, sepse e kam parë në pozicion ku nuk do të duhej të ishte, është objekti i psikiatrisë në Mitrovicë. Nëse është fjala për repartin në Spitalin e Përgjithshëm të Mitrovicës, është OK, por prapë buxheti që është ndarë nuk është i mjaftueshëm. Por, nëse është fjala për kujdesin parësor, ku figuron, atëherë unë them që Mitrovica është i

vetmi qytet i Kosovës, që deri më tash i ka dy qendra të shëndetit mendor dhe nuk e ka asnjë psikiater që është i kyçur në proces të punës në institucione publike.

Në anën tjetër, në këtë sferë është larguar projekti i ndërtimit të kapaciteteve për trajtimin e sëmundjeve të varësisë, që ka qenë i paraparë të realizohet në vitet 2018, 2019 dhe 2020. Është projekti për ndërtimin e Spitalit të Prishtinës. Janë paraparë 500 mijë euro në vitin që po hyjmë dhe 4 430 000 euro deri në fund të vitit 2020. E para, unë them që nuk bëhet as me 500 mijë euro Spitali i Prishtinës, as me 4 430 000 euro për tre vjet, sepse ka një parallogarit për koston e këtij spitali, që është diku nja pesëfish më shumë, pra rreth 20 milionëve.

Dhe, e dyta, para pak ditësh ne e kemi kaluar këtu në Parlament të Kosovës, në shikim të parë, Projektligjin për Prishtinën, dhe aty shihet që funksionalizimi i Spitalit të Prishtinës të bëhet në një periudhë shumë më të shkurtër. Pra, nuk jemi seriozë kur i futim në projekt projektet, të cilat nuk mund të realizohen me kaq pak mjete.

Një tjetër, që është i nevojshëm si projekt, por sa ka kuptim që të zgjasë tre vjet renovimi dhe rivitalizimi i objektit të Kirurgjisë në Spitalin e Gjakovës. Nuk është mirë të parashihen shumë projekte dhe të mos ketë mundësi të ndahen mjete të mjaftueshme dhe realizimi i atyre projekteve të bëhet për shumë vite dhe shfrytëzimi nga qytetarët të mos mund të arrihet, sepse fundja krejt këto projekte bëhen për t'i rritur kapacitetet dhe për të ofruar shërbime shëndetësore më shumë për qytetarët, kuptohet edhe më cilësore.

Pastaj, në faqen 33 dhe në faqen 34 janë dy çështje që janë identike. Në faqen 33 shkruan "Autoambulancë, Spitali Pejë - 100 000 euro". Pse nuk janë bërë me një kod këto 100 000 me 225 000 në kodin programe tjera të figurojnë 325 000 e të blihen autoambulancat që janë të nevojshme, jo vetëm për Spitalin e Pejës, por edhe për shumë institucione tjera.

Askund nuk është theksuar, as nuk është specifikuar, mbyllja e projektit të Kardiologjisë Invazive në QKUK dhe funksionalizimi i kësaj njësie shumë të rëndësishme, e cila kishte do të kishte qenë dora e djathtë e Kardiokirurgjisë, që i ka bërë dy vjet së funksionuari në shtator, por tash janë paraparë 200 mijë euro me një vlerësim 200 000 edhe në vitin 2019 dhe 2020, 200 000 tjera për ndërtimin e kabinetit të Kardiologjisë Invazive në Spitalin e Prizrenit. Ka nevojë edhe atje, por të mbyllet një herë. Një herë të mbyllet dhe t'u ofrohet, t'u jepet në shërbim, në shfrytëzim edhe mantelbardhëve Kardiologjia Invazive në QKUK dhe mandej të shkohet edhe në hapjen e njësive tjera, që natyrisht ne duhet t'i përkrahim.

Është një dilemë tjetër, i nderuar ministër, për shembull, ndërtimi i Klinikës së Hemato-Onkologjisë figuron në dy pozita. Në njëren pozitë është në kujdesin parësor 150 000 euro më 2018, plus 150 000 edhe 150 000, e në anën tjetër figuron edhe në QKUK, por tash 170 000 plus 500, plus 1 000 000. A do të bëhet tash Klinika e Hemato-Onkologjisë me 450 000 euro, apo do

të bëhet me 1 670 000 euro? Unë mendoj që ajo do të bëhet me 1 670 000 euro, por pse në dy pozita?

U përmend shumë këtu edhe shtimi i numrit të punëtorëve. Ne e përshëndetim shtimin e pozitive të reja, sidomos për infermieri, por duhet ta dimë se ata 200 doktorë specialistë janë të punësuar në kohën e qeverisjes sonë. Faleminderit, ministër, që tash po sistemoni edhe me shifra dhe po i zgjidhni këto probleme të institucioneve spitalore.

I nderuar ministër,

Dua t'ju kujtoj që Ministria e Shëndetësisë, pas një analize nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, dhe me propozim të tyre për nevojat në aparaturë, ne e kemi kaluar në Komisionin Ndërmintor për Investime Strategjike projektin prej 50 milionë eurove me mundësi kredimarrje për aparaturë dhe pajisjen e institucioneve spitalore me aparaturë të nevojshme. Unë ju kisha lutur që aty ku kanë mbetur hapat të shtyhen përpara dhe të pajisen institucionet spitalore me aparaturën e nevojshme dhe të ecim tutje, sepse shëndetësia ka shumë probleme.

Unë edhe më herët kam thënë që në shëndetësi nuk mund të bëhen mrekulli, në shëndetësi nuk mund të ecet me hapa gjigantë dhe do të kritikohen edhe shumë ministra, jo veç pas meje dhe zotit Ismajli për situatën e shëndetësisë, sepse Shëndetësia i ka specifikat e veta. I ka specifikat të cilat e dallojnë prej shumë fushave tjera dhe nuk fillon, as nuk përfundon menaxhimi i fushës së shëndetësisë me ne. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën ia jap deputetes Blerta Deliu- Kodra. Urdhëro, Blertë!

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Ndonëse nga kolegët e mi u thanë shumë gjëra dhe për të mos i përsëritur do të ndalem në disa pika që janë më konkrete të Projektbuxhetit për vitin 2018.

Në radhë të parë shpresoj që ky projektbuxhet t'u ofrojë zgjidhje kërkesave të shumta të qytetarëve, të cilat nuk janë të pakta dhe janë vazhdimisht në rritje. Dua të vlerësoj po ashtu edhe rritjen buxhetore që është bërë për kulturë, 36% e buxhetit është rritur, dhe me këtë rast unë besoj se do të përmbushen edhe kërkesat e komunitetit artistik, edhe për rritje të pagave, por gjithsesi edhe për projekte, qoftë për shfaqje teatrore, por edhe për projekte kinematografike, që janë të nevojshme për komunitetin artistik.

Mendoj që është e rëndësishme edhe rritja e buxhetit në Shëndetësi, sidomos zgjidhja që u është bërë specializantëve të rinj. Është shpresë për shëndetësinë kosovare, është shpresë për kuadrot e reja, që të mos e braktisin Republikën e Kosovës dhe të vazhdojnë të punojnë në institucionet e Republikës së Kosovës. Mendoj se është një vlerësim i mirë për punën e re të ministrit që e ka bërë në këtë drejtim.

Ministri Hamza po ashtu ka marrë një vendim tejet të rëndësishëm për buxhetin për viktimat e dhunës seksuale, një buxhet i munguar kaq shumë vite. Mendoj se është një vlerësim i madh për këtë kategori tejet të ndjeshme dhe një punë e përkushtim i madh i Qeverisë për t'i mbështetur viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës me këtë projektbuxhet.

Unë shpresoj që edhe tani gjatë punës së komisionit Qeveria t'i ketë parasysh specifikat që kërkohen nga organizatat që tashmë janë përcaktuar të merren me këtë kategori.

Diçka tjetër që do ta diskutoj është edhe investimi në bujqësi, si investim tejet i rëndësishëm, veçanërisht për një pjesë të komunave. Këtu do të përmend një qendër për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve, si dhe produkteve tjera bujqësore për komunën e Skenderajt, Mitrovicës, Vushtrisë dhe Drenasit. Mendoj që një qendër grumbulluese e tillë me kapacitete të mëdha do të ndikonte po ashtu në rritjen e prodhimit dhe shitjen e këtyre produkteve nga fermerët. Po ashtu, kjo qendër do të ishte edhe konform prioriteteve të Qeverisë dhe politikave të saj, për t'i dhënë mbështetje sektorit privat.

Është proklamuar shumë që Qeveria do ta ketë parasysh sektorin privat dhe do ta mbështesë në mënyrë të veçantë sektorin e bujqësisë. Mendoj se me një qendër të tillë do të forcohej edhe më tej zhvillimi i agrobizneseve dhe forcimi i konkurrueshmërisë në treg. Po ashtu, përmirësimi i cilësisë së prodhimeve dhe rritja e punësimit, veçmas e punësimit të rinjve dhe e grave që do të mund ta gjenin një vend pune në këtë qendër. Krahas kësaj, mendoj që qendra të tilla të grumbullimit janë edhe një garanci shtesë për zëvendësim të importit me produktin vendor.

Po e them këtë, meqë ministri i Kulturës sot mungon, mirëpo në të kaluarën Ministria e Bujqësisë i ka mbështetur qendrat grumbulluese në rajonin e Anadrinisë, po ashtu e ka mbështetur financiarisht edhe ndërtimin e qendrës së tillë në rajonin e Dukagjinit, në rajonin e Anamoravës dhe për secilën prej tyre ministria asokohe ka ndarë rreth 1 000 000 euro, prandaj e vlerësoj tejet të rëndësishme që një qendër e tillë të jetë edhe në rajonin e Mitrovicës, Skenderajt dhe Vushtrisë. Natyrisht që Qeveria të vendosë vetë se në çfarë forme kjo do të vijë, si partneritet publiko-privat apo në formë të granteve, që do të ndihmonin në këtë drejtim.

U përmend me të drejtë nga kolegja ime deputete, zonja Thaçi, problemi i ujit të pijes dhe investimet që do të duhej të bëheshin në këtë drejtim në komunën e Skenderajt dhe një pjesë të madhe të fshatrave. Mendoj që këto investime do të ishin të mirëseardhura, e veçanërisht në

fshatrat që u përmendën, në Llaushë, në Rezallën e Re, në Vojnikë dhe Burojë, ku ka pasur disa probleme të theksuara me furnizimin me ujë të pijes.

Si deputete do ta mbështes amendamentin, duke kërkuar që edhe deputetët tjerë t'i mbështetin amendamente që sigurojnë që këta banorë të mos kenë telashe me furnizim me ujë të pijes.

Një prioritet tjetër që mendoj se Qeveria do të duhej ta kishte, veçanërisht Ministria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, te ndërtimi i sallave sportive nëpër lagje dhe fshatra, ku do të mund të stimulohen edhe aktivitete të shumta sportive dhe nxënësit e shkollave të kenë mundësi që në këto qendra të kenë aktivitete të shumta.

Do ta përmend një kërkesë tjetër, që po ashtu është në kornizën afatmesme të shpenzimeve, që ka qenë po ashtu i planifikuar edhe rehabilitimi i deponisë së mbeturinave në Mirash, ngase të gjithë ministrat paraprakë të Ambientit e kanë vlerësuar si tejet të rrezikshme për ambientin, jo vetëm në Obiliq, por edhe më gjerë. Prandaj, besoj se kjo duhet të përfshihet në investimet në rregullimin e saj dhe Qeveria t'i ketë parasysh këto investime.

Po ashtu, janë theksuar besoj nga kolegët e mi deputetë edhe investimet që ministria përkatëse duhet t'i kryejë në rregullimin e memorialëve në Marinë, në Polac, në rregullimin e varrezave dhe në planifikimin e mirë, që këto rregullime të kryhen sa më parë. E di që agjencia është përgjegjëse për këtë, por besoj që Agjencia për Rregullimin e Monumenteve dhe mirëmbajtjen e tyre duhet ta ketë parasysh që këto varreza e memorialë të mos i trajtojë në mënyrë të padinjitetshme, siç janë trajtuar deri më tani.

Njëra prej kolegeve deputete me të drejtë sot e përmendi edhe rritjen e numrit të inspektorëve dhe masat që ministria duhet t'i ndërmarrë në këtë drejtim. Mendoj që Qeveria duhet ta ketë parasysh, veçanërisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që ta rrisë numrin e inspektorëve, kjo për faktin se pasiguria në punë, e veçanërisht në sektorin privat, është në rritje. Nëse vetëm ndalemi dhe shohim sektorin e ndërtimeve, gjatë këtij viti e kanë humbur jetën gjithsej 7 persona si pasojë e pasigurisë në punë. Prandaj, inspektorët në fjalë duhet të jenë më të përgjegjshëm dhe ta kryejnë detyrën, për të cilën janë thirrur dhe sektori privat të mos jetë viktimë e pasigurisë në punë, por të ketë sanksione të nevojshme.

Fatkeqësisht, siguria në punë dhe shëndet ende vazhdon të jetë larg nivelit të dëshiruar.

Një fenomen tjetër, që mendoj se do ta ripërsëris ndoshta edhe nesër në Programin e Qeverisë, por po e them edhe tani, janë edhe rastet e përdorimit të narkotikëve, të cilat kohën e fundit janë shtuar shumë, veçanërisht nga fëmijët e shkollave të mesme, por ka edhe raste kur fëmijët e shkollave fillore po përdorin narkotikë. Nëse i shohim statistikat ato flasin për një rritje të madhe të numrit të atyre që janë të prekur me narkotikë. Më i rëndë është fakti se për çdo vit kryesisht

janë moshat më të reja që po preken, që po përdorin narkotikë. Rastet e fundit janë 232 raste vetëm gjatë 9 muajve, që janë të evidentuar si të rinj që përdorin narkotikë. Veçanërisht të prekura janë grupmoshat 14 dhe 16-vjeçare dhe përpos institucioneve të arsimit dhe të familjes, mendoj që edhe ne si Qeveri, si institucione, duhet të mendojmë pak më thellë për këtë grupmoshë, qoftë për qendra rekreative, sepse përveç institucionit të familjes dhe atyre arsimor, këto grupmosha nuk e kanë ndonjë aktivitet ku do të mund të kryenin aktivitete kreative dhe të mos jenë të përfshira në raste të tilla me narkotikë.

Mendoj se Qeveria duhet të jetë e vëmendshme karshi këtij fenomeni në rritje. Kaq! Të nderuar kolegë deputetë, faleminderit! Do të kem edhe amendamente dhe shpresoj që të kem mbështetje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zafir Berisha. Urdhëro, Zafir!

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Projektbuxheti natyrisht se nuk ka ndonjë ndryshim të madh nga buxhetet e viteve të kaluara, për arsytet që dihen. Por, sido që të jetë, unë mendova t'i them nja dy-tri fjalë te ajo që duhet të jetë prioritet i prioriteteve dhe që do të nënkuptohej edhe nëpërmjet kodeve buxhetore, se cilat do të jenë prioritetet e kësaj Qeverie për vitin 2018.

Mendoj se me buxhetin e njëjtë për organet e sigurisë së vendit, duke përfshirë Policinë, Ushtrinë dhe segmentet tjera të hallkës së sigurisë, mosrritja e buxhetit në këtë fushë, kjo Qeveri është duke ngecur në atë që është prioritet që siguron dhe qëndrimet publike dhe zotimet publike edhe të qeveritarëve, por edhe të klasës tjetër politike, që në vitin 2018 në fokus do të jetë zhvillimi ekonomik.

Unë mendoj se zhvillim në këtë vend nuk mund të ketë, në rast se nuk ka siguri fillimisht dhe mendoj se Policia, përpos në kapacitetet në burimet njerëzore dhe në infrastrukturë, është dashur të mbështetet edhe më shumë dhe për këtë unë mendoj se deri në leximin e dytë do të kemi edhe propozime konkrete.

Mosshiti i buxhetit për FSK-në tregon se deklaratat e deridjeshme kanë qenë vetëm deklarata kot, sepse vetë buxheti po tregon se në këtë drejtim nuk është paraparë ndonjë kapërcim, që me të drejtë e presin qytetarët e Kosovës rreth transformimit të FSK-së në ushtri.

Natyrisht si deputet që vij nga Prizreni nuk mund ta kaloj pa e përmendur buxhetin e Komunës së Prizrenit, i cili i ngjan një buxheti të fushatës elektorale. Kjo do të kuptohej deri diku si e natyrshme, për shkak se edhe vetë buxheti është miratuar në nivelin e komunës në prag të fushatës. Harta e investimeve në Prizren natyrshëm ka vend për t'u kritikuar, por në këtë rast nuk do ta kritikoj, meqë tashmë mundësitë dhe mrekullitë kanë ndodhur në Prizren dhe edhe nja

gjashtë muaj do të presin ato rajone që kanë qenë të anashkaluara qëllimisht, sepse me rishikimin e buxhetit do të ndërrojnë shumë vija buxhetore në nivelin e Prizrenit.

Rrugët vazhdimisht janë pjesë e debateve të nxehta në Parlament, shpesh asfalti përdoret me dy kute, edhe për t'u sulmuar Qeveria, por edhe për të kërkuar prej Qeverisë. Vërtet një numër i madh i kolegëve këtu, zakonisht e akuzojnë Qeverinë si “qeveri e asfaltit”, por në pjesën dërmuese të fjalimeve kurrkund rrugë nëpër lagje dhe mëhallë, edhe nëpër fshatra, edhe në qytete. Unë mendoj se kjo Qeveri tashmë duhet të ketë edhe prioritete tjera. Mendoj se për përmbushjen e standardeve dhe për ndikimin drejtpërdrejt në jetën sa më të mirë dhe në mirëqenien e qytetarëve, Qeveria Haradinaj për vitin 2018 duhet të mendojë edhe në këto fusha.

Urgjentisht të intervenohet në ruajtjen e ambientit, si njëri nga faktorët kyç edhe për shëndetin e qytetarëve, shëndet i cili gjithnjë e më tepër është duke u rrezikuar dhe sigurisht se disa nga prioritetet, sa për të thënë që janë në buxhet, të ndryshojnë dhe të përqendrohen në sigurimin e ujit të pijes për shumë vendbanime, të cilat që nga paslufta vuajnë për ujin e pijes, gjë që e paraqet një situatë jo të këndshme për një jetë normale. Përpos lagjeve nëpër qytete, shumë fshatra, veçanërisht nga rajoni nga vij, janë pa ujë të pijes dhe në këto kode buxhetore shumë pak ka, për të mos thënë s'ka asgjë të paraparë rreth ujit të pijes.

Çështja tjetër që lidhet me ambientin dhe ujin e pijes është sistemimi apo marrja më seriozisht me sistemimin e ujërave të zeza, sepse mungesa e kolektorëve në shumë projekte, të cilat janë kryer shkel e shko deri diku, e shkatërrojnë ambientin, e rrezikojnë jetën e qytetarëve, e kështu me radhë...

Unë mendoj se shtimi i vogël i disa milionëve në bujqësi nuk tregon se kjo qeveri e ka njërin nga segmentet e zhvillimit ekonomik prioritet dhe mendoj se edhe nesër sigurisht me Programin qeveritar Qeveria dhe kryeministri do ta tregojnë një qasje ndryshe për këtë mandat. Përndryshe, unë mendoj se jemi të lodhur nga “copy-paste”, edhe të programeve qeveritare, edhe të parashikimeve buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Qëndron Kastrati.

QËNDRON KASTRATI: Faleminderit!

I respektuar Kabinet i Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Mendoj se nuk ka ndonjë dallim të madh ndërmjet këtij buxheti dhe buxheteve të kaluara. Mendoj se ky fakt është shqetësues, sepse nëse Qeveria pretendon që të na përmirësojë në masë të dukshme rritjen ekonomike, atëherë duhet të ketë dallim në mënyrën e punës nga qeveritë e kaluara. Së paku, buxheti do të duhej të ishte i organizuar më ndryshe.

Po jap disa vërejtje, për çka kam parë se mund të bëhet më mirë. Së pari, mendoj se ka mospërputhje ndërmjet Programit të Qeverisë për 4 vjet dhe buxhetit të planifikuar. Për shembull, në Programin qeverisës është cilësuar si prioritet investimi në energji. Janë përmendur sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me energji, integrimi në tregun rajonal të energjisë, rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve termike, përfshirja e Kosovës në rrjetin rajonal të gazit natyror.

Mirëpo, kur e shohim buxhetin e planifikuar për vitin 2018 dhe vitet e mëpastajme shohim se vlera e propozuar në investime nuk është as për së afërmi e mjaftueshme për realizimin e këtyre projekteve. Në fakt, për vitin 2018, as 2% e buxhetit për investime kapitale nuk shkon për energjinë.

Një tjetër problem, që po përsëritet në buxhet, është shpërndarja e investimeve për projekte në disa vite. Mendoj se është më efektive dhe shumë më e lehtë, nëse buxheti për një projekt, për shembull, për një rrugë alokohet tërësisht brenda një viti. Nuk është mirë që vitin e parë të bëhen gërmimet, tjetrin vit të shtrohet zhavorri, e pastaj vitin e tretë të shtrohet asfalti, sepse kjo po u kushton banorëve probleme për tre vjet rresht. Më mirë është të mos nis një projekt për dy vjet, e pastaj vitin e tretë të përfundohet brenda gjashtë muajsh, sepse për të njëjtin projekt shkaktohet problem brenda tre vjetëve rresht.

Po e marr një shembull në Kamenicë, pasi jam më i informuar për atë komunë, në rrugën Kopërnice - Pusi i Zenelit, deri te shkolla fillore e mesme e ulët janë paraparë 100 000 euro për vitin 2018, ndërsa për vitin 2019 janë paraparë 300 000 euro. Sa i përket Komunës së Kamenicës, mendoj se ka nevojë të ketë buxhet me vëmendje më të madhe ndaj kësaj komune. Viteve të pasluftës, Kamenica është neglizhuar, ashtu si Anamorava në përgjithësi, për shkak se nuk ka qenë bastion i asnjë partie.

Si pasojë e kësaj, shumë kushte elementare nuk janë plotësuar, si për shembull, furnizimi me ujë apo kanalizimi. Disa fabrika që kanë qenë më herët, e që e kanë bërë Kamenicën një ndër komunat më të zhvilluara në Kosovë, tashmë janë shitur për metal, ose janë kthyer në restorante e markete dhe Kamenica ka mbetur me mbi 2/3-at e banorëve të papunësuar.

Si rezultat i këtyre faktorëve, gjysma e popullsisë së Kamenicës është shpërngulur që nga përfundimi i luftës dhe kjo është shumë shqetësuese, duke e pasur parasysh që Dardana është komunë kufitare.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, mendoj që është e nevojshme të investohet më shumë në këtë komunë.

I nderuar ministër i Financave,

Siç e dini edhe ju, Kuvendi Komunal i Kamenicës nuk e ka aprovuar buxhetin me kohë për shkak të inateve politike, kështu ka shkaktuar humbjen e një milion e 162 mijë eurove. Paramendojeni, buxheti për investime kapitale do të mbetet 124 mijë euro në një komunë me 420 kilometra katrorë sipërfaqe dhe me mbi 30 mijë banorë, ku mungon sistemi i ujës-jellësit dhe i kanalizimit, e të tjera, në një ndër komunat me papunësinë më të madhe dhe me shumë probleme të tjera.

Nëse e krahasojmë me investimet kapitale të të gjitha komunave të Kosovës, atëherë përqindja e buxhetit për investime kapitale për Kamenicën është vetëm 0,084%.

Ndërkaq, shuma e investimeve kapitale nga qeveria qendrore për vitin 2018 për Kamenicën është vetëm 870 mijë euro, ose 0.18% e buxhetit të të gjitha investimeve kapitale nga qeveria qendrore. Këto përqindje janë shqetësuese, kur e dimë se Kamenica ka 1,7% të popullsisë së Kosovës.

Unë e kuptoj, zoti ministër, që Kuvendi Komunal është vonuar me aprovimin e buxhetit dhe ju jeni të obliguar ta propozoni buxhetin me kufijtë e vitit paraprak.

Mirëpo, duke pasur parasysh këtë gjendje të vështirë buxhetore për Kamenicën, kisha kërkuar që të angazhoheni që kjo humbje të mos ndodhë.

Si zonë kufitare me Serbinë dhe me shpërnguljen më të madhe prej të gjitha komunave të Kosovës, Kamenica ka nevojë të ketë përkrahjen nga Qeveria, në mënyrë që të zvogëlohet shpërngulja e popullsisë.

Në funksion të kësaj, pasi që komuna nuk ka mjaftueshëm buxhet vetjak, mendoj se Qeveria duhet të investojë në lehtësimin e jetës së banorëve.

Për shembull, mund të kontribuojë nëpërmjet ndërtimit të pendës së Kremenadës, e cila siguron ujë të pijshëm dhe për ujitje në bujqësi si dhe ndërtimit të kolektorëve të kanalizimit.

Mendoj se duhet t'u ndihmojmë edhe fshatrave të Malësisë së Kamenicës, duke investuar në rrugët, sikur ajo e qarkores së kufirit nga Kapi e Sfirçës, Shahiq, Lisotk, Kiktë, Tërstenë, Kranidell, Karaqeva e Epërme.

Gjithashtu rruga Dugidell-Poliq-Kusar dhe Desivojcë, e tjetra Hogosht-Dazhnicë, Lisockë-Gjurishevc-Gmicë-Tugjec, Kamenicë-Moçar-Lagjja e Brahimëve, Hajnoc-Meshinë-Kremenatë-Zajçec, Pirevë-Hajnoc dhe Shipashnicë e Epërme-Hogosht. Asnjëra prej këtyre projekteve nuk është e përfshirë në këtë buxhet, po as në planifikimin për dy vjetët e ardhshme.

Pra, i nderuar kryeministër dhe ministra, mendoj se janë tri probleme themelore me këtë buxhet: mungesa e qasjes zhvillimore, mospërputhje me programin e Qeverisë si dhe shpërndarja e pabarabartë në investime.

Mendoj se kjo qeveri ka shumë punë për të bërë deri në hartimin e një projektligji të duhur që ka potencial të nisë një zhvillim të hovshëm ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Hamza e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, deputet Kastrati!

E di që buxheti i Komunës së Kamenicës nuk është aprovuar dhe saktë ashtu qysh e thatë edhe ju, ne kemi qenë të detyruar që mbi bazën e legjislacionit në fuqi të procedojmë tutje. Po unë ju siguroj që brenda mundësive ligjore ne si Ministri i Financave do të jemi në përkrahje të Komunës së Kamenicës, me qëllim që jo vetëm Komuna e Kamenicës, e cila ka një buxhet mjaft të vogël për shkak të resurseve të kufizuara, por asnjë komunë e Kosovës të mos dëmtohet.

Prandaj, ne do të shikojmë hapësirën ligjore që ta përkrahim komunën dhe t'i ndajmë mjetet, të cilat realisht i kanë munguar Komunës së Kamenicës si rezultat i mosaprovimit të buxhetit në kohë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Është diskutuar shumë për Ministrinë e Kthimit, për mua kjo ministri është vetëm ministri, për komunitetin tim konsiderohet si ministri e përrallave, sepse asnjëherë kurrë s'mendojmë të përfitojmë nga ajo ministri si komunitet, e as ta diskutojmë më asnjëherë, sepse Ministria e Kthimit nuk ka të bëjë me komunitetin tonë fare.

Desha të kyçem vetëm te një kërkesë që është bërë në Ministrinë e Planifikimit më herët.

Në këtë Kuvend është miratuar hapja e 30 bunarëve, janë ndarë mjetet financiare dhe asnjëherë nuk kanë filluar në komunën e Lipjanit, në fshatin Gadime.

Njerëzit, edhe të varfër, edhe pa ujë, ata me padurim e kanë pritur këtë projekt të realizohet dhe unë mendoj që duhet të mendojë edhe ministri Hamza për këtë projekt, të cilin e kemi kërkuar edhe më herët. Nuk është një shumë e madhe, shuma ka qenë deri në 30 mijë euro, ato mjete janë votuar në këtë Kuvend dhe nuk e dimë arsyen pse ato mjete... sipas mendimit tim, ato mjete janë avulluar dhe asnjëherë nuk ka pasur mundësi të fillojë projekti për ndërtimin e këtyre bunarëve,

edhe pse qytetarët me padurim i kanë pritur. Edhe pse një komision ka dalë në terren dhe i ka verifikuar ku duhet të bëhet hapja e atyre bunarëve, por familjet e varfra ende janë duke i pritur dhe nuk është mirë që të mbesin njerëzit pa ujë.

Pika tjetër, kemi diskutuar edhe për skemën sociale, që së paku kjo skemë të rrisë koston për këtë ministri sa i përket rasteve sociale, sepse kriteret që fëmijët duhet të jenë deri në 5 vjet, janë duke e rënduar skemën sociale, janë duke e rënduar jetën e komuniteteve, të të gjithë atyre që i gëzojnë.

Unë mendoj, ministër, është mirë të mendohet që ky kriter të ndryshohet dhe të rritet kostoja për këtë dhe për këta qytetarë, të cilët janë duke e gëzuar këtë skemë sociale, se me të vërtetë është kriter shumë i rëndë.

Unë po e përsëris, sepse asnjëherë nuk mund ta kuptoj që vetëm deri në 5 vjet ta gëzojnë fëmijët atë asistencë sociale, e si t'i bëjë 5 vjet e një ditë, unë nuk e di a po punësohet apo çka po ndodh me të. Ne e dimë që obligimet janë më të mëdha, por vërtet kjo skema sociale, e cila këtyre familjeve u ndërpritet mu në moshën më të vështirë, me të vërtetë është duke rënduar shumë komunitetet, por edhe të gjithë ata që e gëzojnë.

Ne kemi kërkuar buxhet edhe në zyrën e kryeministrit, atë për çështje të komuniteteve.

Unë mendoj, i nderuar kryeministër, që ajo zyrë duhet të jetë e barabartë për të gjitha komunitetet, jo vetëm për një komunitet, duhet ta gëzojnë atë buxhet të gjithë njësoj, me përjashtim, edhe pse nuk do të kërkojmë më nga Ministria e Kthimit asgjë, që së paku t'i kemi dyert e hapura nëpër këto ministri përkatëse, së paku të kërkojmë të mbështeten komunitetet sikur për të gjithë.

E falënderojmë këtu publikisht ministrin e Financave, i cili e ka marrë përsipër dhe e ka dhënë një shumë bukur të madhe për komunitetet për ndërtim, kërkesë e cila vazhdimisht është bërë nga ne dhe është ndarë një shumë e mirë për komunitetet këtu dhe unë besoj që ato mjete do të shkojnë në vendin e duhur sipas kërkesave, të cilët i kemi parashtruar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nait Hasani e ka fjalën, le të bëhet gati Gani Dreshaj.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për kryeministrin,

Kabinetin qeveritar,

Besoj se do të jem më i shkurtër prej kolegëve, po në shumë pika të buxhetit vërejtje kanë dhënë shumë kolegë.

Mua më intereson te kryeministri ta shtroj një çështje, kemi projekte që financohen nga dy herë.

Më intereson për stadiumin e Prishtinës, kryeministër, është ndarë projekti, është miratuar, kompania realizon punët, ndërsa përsëri kërkohet të shtohet edhe 4 milionë euro për të njëjtin projekt. A ka mundësi ta dimë, pse dy herë të njëjtin projekt ta financojmë, pra stadiumin e Prishtinës?

Tjetra është për qendrat e grumbullimit që i përmendi kolegja. Ne i kemi tri qendra dhe ato i ka financuar Qeveria, ndërsa bujqit paguajnë për produktet e tyre aty, domethënë ato janë privatizuar në formën më të egër të mundshme.

Tjetra është, mendoj që edhe në Mitrovicë është e njëjta gjë në stadiumin “Adem Jashari”, u financua dy herë. Do të thotë, dikush këtu, ose projektuesit, ose operatorët, dikush i ka bërë këto pazare.

Në komunën e Prizrenit, për dijeninë e koleges Drita, sigurisht që do ta merr fjalën prapë, që ne kemi nxjerrë amendament këtu në mandatin e kaluar për ndërtimin e dy çerdheve në Prizren, një nga buxheti i komunës dhe një nga bashkëfinancimi me memorandumun e bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit dhe komunës.

Atje është paraparë të ndërtohet në lagjen “Bajram Curri”, çerdhe për 250 fëmijë, një model i kohës.

Tjetra, mua më intereson që edhe fshatrat që janë sot, diku edhe 8-10 ditë e kemi përvjetorin e 40-të të të rënëve në Pashtrik dhe pikërisht rruga që e lidh nga Gorozhubi për te vendi i rënies është hapur, por nuk është financuar dhe rregulluar.
e ata njerëz që kanë rënë aty na e kanë mundësuar të jemi në këtë Kuvend.

Prandaj, kërkoj që të jetë pjesë e projektit të buxhetit shtrimi dhe zgjerimi i kësaj rruge deri te vendi i rënies, të paktën të shkojmë e të vendosim lule edhe në vjeshtë dhe në dimër.

Një tjetër rrugë që i lidh fshatrat dhe vizitat e lapidarëve, që është një nga rrugët kryesore të pjesës sonë atje, është rruga për Krushën e Madhe me Randobravën, ku është vendi i rënies së dëshmorëve, heronjve dhe Mensur Zymerit.

Tjetër që më intereson po ashtu nga ministri, pse zgjerimi i rrugës nga Arbana për Landovicë, e kontraktuar ose e projektuar, edhe pse i është ndarë buxheti, nuk është finalizuar dhe a do të shkojë ky buxhet në suficit apo jo?

Ne e kemi edhe Ligjin për fenë, është kërkuar që edhe aty të kemi zyrtarë që duhet të paguhen nga buxheti i shtetit, hoxhallarë, priftërinj të ndryshëm, të ndreqen objektet e kulteve të ndryshëm. Ne do ta kemi amendamentin sigurisht në komision, më intereson ta ndajmë edhe një buxhet për ndërtimin ose rivitalizimin e kishës që është te objekti i fakulteteve të Universitetit që ajo të jetë një kishë ortodokse shqiptare, ta kemi një qendër për ortodoksët shqiptarë që janë në Kosovë dhe një financim të saj, për shkak se ajo është ndërtuar dhe ajo mund të jetë në shërbim të kulturës ortodokse shqiptare, për shkak se Kisha serbe e ka manastirin e Graçanicës, Kisha katolike e ka Katedralen aty, Bashkësia Islame e ka atë pjesën e vet, kështu që është mirë të planifikohet që në buxhet ta kemi edhe Kishën ortodokse shqiptare në Kosovë që do t'i shërbejë kulturës dhe trashëgimisë kulturore mesjetare për të gjithë ortodoksët që kanë qenë këtu në Kosovë.

Ky buxhet, ashtu siç thanë edhe ministri edhe kryeministri në fjalën e vet më herët, është një buxhet prej 2 miliardë e 80 milionëve, jo i mjaftueshëm, po mund të jetë dhe i realizueshëm në projeksionet e veta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Gani Dreshaj, nënkryetari Kujtim Shala e ka kërkuar fjalën. Replikë. Urdhëro!

DRITA MILLAKU: Këtu desha vetëm një sqarim me deputetët e PDK-së, se nuk po di a nuk po mund a nuk po dinë të kuptojnë. Shqip thashë, në projekte nuk ka qenë inicimi juaj, inicimi ka qenë prej grave deputete në Asamblenë e Prizrenit, e kemi marrë një vendim në vitin e kaluar si asamblistë në nivelin lokal të Prizrenit, kemi marrë vendim unanim prej të gjitha subjekteve politike për ndërtimin e çerdheve, pastaj atë vendim e kemi bartur këtu në Kuvend për t'u amendamentuar.

E rëndësishmja është që mjetet janë ndarë, unë shumë mirë thashë, por lokacioni nuk është ndarë dhe nuk di çka keni hallin tash. Ne nuk kemi faj se për çerdhe është dashur të mendohet më herët, jo tash që e keni humbur Prizrenin, nuk i kemi faj, e mira e së mirës është që Prizrenin e ka fituar Lëvizja "Vetëvendosje" dhe në programin e saj qeverisës i ka edhe çerdhet, i ndërtojmë, mos keni siklet.

KRYETARI: Tash krejt PDK-ja kundër-replikë, se i ka përmendur krejt. Jo veç njëri, cili po e merrni, Naiti e ka pasur, një, dhe e përfundojmë.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Unë dua ta përshëndes përsëri, ta falënderoj që me dëshirë ajo thotë që e kemi fituar Prizrenin, por ne nuk kemi ndrequr për parti politike dhe as s'kemi insistuar për parti politike të ndreqim çerdhe, po ne kemi insistuar në Kuvendin e Kosovës, kemi nxjerrë amendament bashkë me

Nezirin edhe Lulën, edhe këta deputetë këtu kanë vendosur të ndërtohet një çerdhe për fëmijët e qytetit të Prizrenit.

Prandaj, nëse ata mendojnë që t'i çojnë fëmijët e "Vetëvendosjes" atje, mua më vjen keq, po ne i çojmë fëmijët e qytetit të Prizrenit dhe kemi punuar dhe punojmë për qytetarët e Prizrenit.

Ndërsa kush i ka fituar dhe i fiton zgjedhjet, janë çështje e organeve, po megjithatë nuk e keni menduar që do të fitoni as çka do të bëni. Mendoni që qyteti i Prizrenit ka nevojë për çerdhe, nuk ka nevojë për parti politike ekstreme, si thoni ju.

KRYETARI: Zonja deputete, sipas rregullit, ka replike, kundër-replikë dhe me kaç mbaron. Për besë, rregullorja është kështu. Nuk është veç për ty, po për të gjithë.

Gani Dreshaj e ka fjalën.

GANI DRESHAJ: Faleminderit!

Mua po më duket që nuk është duke më vëzhguar askush, e di që është, edhe pak fushatë po bëhet, i vetmi i cili është në balotazh jam unë.

Dëshira ime ishte t'i drejtohem kryeministrit që të mos na lërë mua e Gazin pa buxhet në Pejë, se jemi rekord me punët tona.

Unë kisha kërkuar nga ministri i Financave të miratohet një ligj që të ketë rrogë minimale, se nëse ka rrogë minimale, atëherë shtohet edhe buxheti i shtetit. Se njerëzit paguhen në dorë të zezën 100-150 euro, atëherë u ikin tatimeve dhe shumë e çuditshme është që asnjë firmë në Kosovë nuk paguan dividende, nuk po punojnë me fitim, nuk e di qysh do të shtohet buxheti. Nëse njerëzit presin për 6 muaj të bëhet revolucion ose për tre muaj, interes i të gjithë deputetëve duhet të jetë ngritja, rritja e buxhetit në Kosovë. Këtë mund ta bëjmë të gjithë së bashku nëse e luftojmë informalitetin dhe ikjen nga tatimet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nënkryetar, fjala për ju, nuk ka deputetë të tjetër të lajmëruar për çështje të buxhetit.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Kam kënaqësinë që po flas i fundit që edhe ta mbylлим debatin e gjatë për Buxhetin 2018.

Ky debat ishe aq i gjatë, sepse ne kemi përpara dokumentin themelor të politikave të Qeverisë për një vit të plotë, e që nuk nënkupton vetëm Qeverinë, por të gjitha institucionet e shtetit, përfshirë institucionet vartëse, agjencitë e tjerë.

Në këto debat disa herë është thënë që deputetët po pozicionohen politikisht përballë Projektligjit për buxhetin. Unë mendoj që pozicionime të tilla janë normale, sepse projektligji, buxheti është dokument i pastër politik dhe shifrat të cilat ne i lexojmë aty i analizojmë dhe i krahasojmë me ligjet e viteve paraprake, janë politika të kthyera në shifra.

Mbi këtë logjikë unë kam një vërejtje në metodën e paraqitjes dhe të mbrojtjes së këtij projektligji. E kam fjalën për krahasimet me Ligjin për buxhetin e këtij viti, të vitit 2017 të Qeverisë së mandatit të kaluar, të Qeverisë sonë.

Projektligji nuk mund të krahasohet me dokumentin e rishikuar në asnjë rast, pse? Sepse të gjitha dokumentet e kësaj natyre janë planifikime, që do të thotë janë projeksione dhe projeksionet janë synime. Nëse nuk realizohet, nëse nuk përmbushet 100%, i bie që aty ka probleme jo vetëm të një natyre.

E para, ka mundësi që projeksionet nuk janë bërë mirë;

E dyta, që nuk është administruar mirë;

E treta, që nuk është punuar mjaftueshëm, e të tjerë.

Tani pse është e rëndësishme dihet kjo, jo që të kontestohet metoda, por që të krahasojmë ligjet e kësaj natyre për të cilat unë po them që janë më të rëndësishme brenda një viti, hiq dokumentet strategjike dhe programin e Qeverisë, projektligji është dokumenti më i rëndësishëm politik i një qeverie dhe i një vendi, duhet të shihet dhe të krahasohet në tërësi.

Në këtë logjikë i bie që rritjet, të cilat paraqiten në raport me këtë vit, nuk janë reale. Pse? Sepse po krahasohet me buxhetin, me Ligjin për buxhetin e vitit 2017. të rishikuar.

Rishikimet bëhen në një logjikë normale, në një procedurë normale që të korrektohen mungesat, aty nuk ka buxhet të ri, aty nuk ka shtesa, por ka administrim më të mirë të asaj pjese të buxhetit që mbetet.

Unë do të përpiqem të flas shumë shkurt për disa nga fushat, të cilat mendoj që i njoh pak më saktë, sepse një dokument i kësaj natyre është shumë kompleks. Unë besoj që edhe për nga pozicionimet politike dhe për nga formimi kolegët deputetë kanë dhënë ide të mjaftueshme dhe shumë të dobishme dhe unë mendoj që Qeveria, kryeministri, e sidomos ministri i Financave duhet t'i kuptojnë si këshilla dhe të punojnë mbi to, normalisht në bazë të mundësive, por edhe

duke pasur parasysh dhe unë i kam parasysh edhe orientimet politike të kësaj Qeveria dhe të shumicës.

Unë kam një vërejtje thelbësore për projekte të rëndësishme, projekte të mëdha të Qeverisë, të cilat bëhen në bashkëpunim me komunat, e që lidhen me memorandumet e mirëkuptimit.

Unë e di që memorandumet e mirëkuptimit nuk krijojnë asnjë pasojë juridike dhe asnjë detyrim dhe secila prej dy palëve mund të tërhiqet në cilëndo fazë që të dojë, me përjashtim të rasteve kur mbi bazën e memorandumit lidhen kontrata dhe marrëveshje që përcillen dhe me buxhet, do të thotë, edhe me financa.

Tani pse po them këtë, sepse kam vërejtur që së paku në Ministrinë e Kulturës nuk janë respektuar memorandumet me komunat dhe projektet, të cilat janë të kontraktuara. Ka projekte të kontraktuara, të cilave u është hequr buxheti në tërësi, siç është rasti, për shembull, me stadiumin e Vitisë dhe projekte të tjera, të gjitha projektet e kontraktuara janë përgjysmuar.

Unë mendoj që është e domosdoshme që kjo të korrektohet, sepse komunat me lidhjen e kontratave kanë krijuar një detyrim ligjor dhe normalisht dhe një detyrim financiar.

Nëse atë buxhet s'ë ka komuna, ai buxhet do të merret nga ana e punëkryesit nëse në asnjë formë tjetër, përmes përmbaruesve dhe përmbaruesit marrin buxhet aty ku gjejnë dhe kjo i bie që mund të dëmtojnë dhe projekte të tjera që janë të rëndësishme, ndoshta edhe më të rëndësishme, më të mëdha se sa këto.

Një çështje e veçantë për të cilën po flitet jo vetëm këto dy ditë, po kohën e fundit është stadiumi nacional. Unë do të shoqëroj këtë fjalë timen edhe me disa shpjegime dhe për dy stadione të tjera, stadiumin e qytetit të Prishtinës dhe stadiumin olimpik "Adem Jashari" të Mitrovicës.

Është thënë që vendimi për ndërrimin e lokacionit të stadiumit nacional është politik, normalisht që është politik, sepse është vendim i Qeverisë dhe të gjitha vendimet e Qeverisë janë politike.

Problemi është arsyeshmëria. Ministria e Kulturës në këtë sektor, në këtë fushë në sektorin e sportit ka formuluar politika, të cilat janë afatgjate dhe që shkojnë përtej disa dekadave.

Në Bërnice nuk do të duhej të ndërtohej vetëm stadiumi nacional i futbollit, por Kampusi nacional i sporteve.

Stadiumi nacional përfshin vetëm një pjesë të saj, Kampusi nënkupton të gjitha objektet e rëndësisë nacionale, ky është shpjegimi i parë.

I dyti, ai lokacion nuk është vendosur nga ana e Qeverisë, po atë lokacion e ka zgjedhur Federata e Futbollit të Kosovës, s'jam i sigurt a e ka zgjedhur të dytin bashkë me Komunën e Prishtinës.

Shpjegimi i tretë, buxheti që kemi ne, sepse unë e njoh atë projekt dhe ai është i rëndësishëm, ai s'mund të bëhet me buxhetin tonë dhe ka rreth një vit e gjysmë që është negociuar një kredi me Qeverinë e Hungarisë.

Buxheti që kemi ne, zoti ministër i Financave, se ju keni thënë që do të fillojë ndërtimi i stadiumit, ai nuk mund të fillojë, sepse kushtet e kredisë të Qeverisë së Hungarisë janë të tilla që kërkojnë që ne në buxhet sivjet të kemi 15% të kredisë që do të japin ata. Duhet studim fizibiliteti që dihet me saktësi se sa duhet të financohet, llogaritet që ai stadium do të kushtojë rreth 60 milionë euro dhe nëse stadiumi kushton 60 milionë euro, ne duhet të kemi sivjet në buxhet detyrimisht 9 milionë euro. Ndryshe, nuk mund të shtyhen procedurat më tutje.

Për stadiumin e Prishtinës janë të domosdoshme edhe 4 milionë euro, jo një milion e 900 mijë euro. Këto nuk mjaftojnë as për stadiumin e Mitrovicës, edhe për stadiumin e Mitrovicës duhen rreth 2 milionë e 900 mijë euro. Pse? Sepse këto stadione në këto rrethana janë të kategorisë së dytë dhe ato duhet të shndërrohen në stadione të kategorisë së katërt.

UEF-a kërkon të licencojë stadiumin e Prishtinës në mars, do të thotë, deri në mars ne do të investojmë dhe 4 milionë euro. Nëse kjo nuk bëhet, kombëtarja e Kosovës do të vazhdojë të luajë jashtë territorit të Kosovës dhe ky është një dëm i madh.

Unë kam parë thirrje të njerëzve të politikës që janë përfshirë në institucionet themelore të sportit dhe në Komitetin Olimpik që atje flasin si përfaqësues të Komitetit Olimpik e si drejtues të tij dhe këtu si përfaqësues politikë. Minimalisht ky është një konflikt interesi, ndërsa optimalisht njerëzit e tillë bëhen të pabesueshëm në dy situata. Pse po them kështu, çka prodhon kjo, sepse të njëjtit njerëz kërkojnë që Qeveria dhe kur janë vetë pjesë të shumicës të shtojë buxhetin për komuna dhe komunat për sportin dhe për klubet, po s'mund t'u kërkon komunave nëse buxhetin nuk e rritni vetë. Komunat japin aq sa kanë mundësi.

Po ashtu është problematizuar çështja e pagave, të gjitha kategoritë e punonjësve të institucioneve të kulturës kanë qenë të diskriminuar sistematikisht dhe këto për shkak të një keqkuptimi. Ata nuk janë pjesë të administratës, ata nuk janë shërbyes civilë, ata janë krijues, performues dhe janë punonjës shkencorë.

Në Projektligjin për pagat, të cilin ne e patëm miratuar...

(Ndërprerje e incizimit)

Kam pas propozuar një nen të veçantë, është neni 3 i atij projektligji, të cilin e ka miratuar Qeveria dhe që thotë që ato kategori do të trajtohen si të veçanta dhe pastaj pagat e tyre do të rregullohen me një akt nënligjor. Pse është e rëndësishme kjo? Është e rëndësishme rritja e pagave, po rritja e pagave nuk e zgjidh atë problem në kuptimin sistemor, ata duhet të trajtohen ndryshe dhe duhet të trajtohen me anë të një rregulloreje.

Një vendim e zgjidh çështjen e tyre përkohësisht. Ndërkaq aktet e tilla pasi të miratohet Ligji për pagat, e zgjidhin atë problem përfundimisht.

Unë nuk dëshiroj të zgjas më shumë, sepse edhe ashtu jemi vonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ia ka përmendur emrin, nënkryetare... Ministri e ka fjalën. Të mos hyjmë në replikë tash, çdo diskutim... 88 deputetë janë në sallë.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

I nderuar kryeministër, zoti Haradinaj,

Të nderua ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

Dëshiroj të ju falënderoj shumë për diskutimet e juaja shumë korrekte, për kontributin e juaj gjatë diskutimeve për Buxhetin e vitit 2018. Me vëmendje i kemi përcjellë diskutimet unë dhe stafi i Ministrisë së Financave dhe ju siguroj se gjatë punës në komisionet e Kuvendit, gjithçka që është e mundur të akomodohet brenda mundësive reale, që është e arsyetuar, unë besoj edhe në vullnetin e anëtarëve të komisioneve, do t'i marrim në konsideratë, do t'i reflektojmë në Buxhetin e vitit 2018 dhe do ta përmirësojmë këtë dokument edhe më tepër sesa ka qenë në leximin e parë.

Edhe një herë ju falënderoj dhe besoj që bashkë në leximin e dytë do ta kemi një dokument edhe më të mirë sesa e patëm në leximin e parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit. 88 deputetë janë në sallë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

I kemi 60 deputetë që kanë marrë pjesë në proces të votimit.

58 për, 1 kundër, 1 abstenim.

A doni edhe një herë ta fus në votim, apo e lëmë tjetër ditë? Edhe një herë po e fus në votim formalisht. Po, s'ka lidhje, një deputet mund... plus - minus... Këtu janë 88 deputetë.

Atëherë, në ndërkohë unë do ta hedh në votim edhe një herë gjatë kësaj seance.

Urdhëroni, zoti Hoti. Shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së e ka kërkuar fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Pas dy ditësh diskutime për Buxhetin e vitit 2018 ne i kemi dhënë vlerësimet tona, ju sapo e nxorët në votim Buxhetin për vitin 2018 dhe votat nuk i keni. Ne mund të votojmë dhjetë herë deri në dymbëdhjetë të natës, por votat për të kaluar Buxheti 2018 sot nuk i keni. Mund ta përsëritni sa të doni këtë votim.

Këtu po shihet fuqia politike që ka kjo Qeveri. Është mirë të reflektoni se si të vazhdohet më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Paj... zoti Hoti, u pa që nuk ishin votat, por a ishte ndonjë vulë kështu... opozitare, apo...

Janë 88 deputetë, kush do voton, kush s' do s' voton. Edhe një herë e fus gjatë procesit.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për projektin e konkurrueshmërisë dhe gatishmërisë për eksport ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. E ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza...

Atëherë, e ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, për arsyetimin e raportit të Komisionit.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim ka për qëllim sigurimin e financimit me kushte të favorshme për realizimin e Projektit për konkurrueshmëri dhe gatishmëri për eksport, respektivisht për mbështetjen e certifikimit të produkteve për tregje eksporti, për forcimin e

kapaciteteve të kompanive me orientim kah eksporti, si dhe zvogëlimin e kostos së inspektimit të bizneseve.

Vlera e përgjithshme e marrëveshjes është 14,3 milionë euro, për periudhën 2017/2022. Sa u përket kushteve të kredisë, parashihet një greis-periudhë prej 5 vjetëve, amortizimi është 20 vjet, norma e interesit është 0,45% në shumën e tërhequr, tarifa e shërbimeve është 0,75% në shumën e tërhequr dhe tarifa e zotimit 0,5% vjetore në shumën e patërhequr.

Ministria e Financave në vlerësimin e ndikimit buxhetor ka konstatuar se kostoja buxhetore prej 7,9 milionë eurove është pjesë e projeksioneve buxhetore për vitin 2017/2020, ndërsa kostoja tjetër shtesë 6,3 milionë euro do të planifikohet në projeksionet buxhetore të vitit 2021/2022.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për projektin e konkurrueshmërisë dhe gatishmërisë për eksport ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim dhe e ka vlerësuar rëndësinë e realizimit të projektit dhe kushtet e kredisë dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e këtij projektligji.

Kryesues, nëse ka mundësi, do të flas edhe në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe meqenëse ky projektligj vjen nga qeverisja e kaluar dhe nga ministrja Bajrami, LDK e mbështet në plotësi projektligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Edhe ne do ta përkrahim këtë marrëveshje, meqenëse është edhe e rekomanduar prej institucioneve më të rëndësishme të Bashkimit Evropian dhe prej së cilës përfiton Kosova. Me këtë japim një shembull që për ato gjëra që pajtohemi mund t'i shtyjme përpara, por për dokumente siç ishte buxheti i mëparshëm nuk do ta keni përkrahjen tonë dhe në këtë rast opozita është krejtësisht e bashkuar për të ju treguar se keni mazhorancë fiktive në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Partia Demokratike e Kosovës, a ka dikush? Safete Hadërgjonaj, urdhëro!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për kredi për konkurrueshmëri dhe kujdesshmëri për eksport dhe ka ardhur në

përfundim që një marrëveshje e tillë është në interes për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe e përkrah në parim.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, duke e shqyrtuar këtë marrëveshje për konkurrueshmëri dhe kujdesshmëri për eksport do ta përkrahë këtë marrëveshje, duke u nisur nga fakti se projekti për konkurrueshmëri ka karakter zhvillimor që mundëson përforcimin dhe rritjen e bizneseve, duke bërë përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes dhe gatishmërinë për eksport, përmirësimin e infrastrukturës, mbështetjen dhe rritjen e cilësisë sipas normave ndërkombëtare, mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për gatishmërinë e tyre për eksport, përmirësimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe reformimin e sistemit të bizneseve.

Prandaj, ne si grup parlamentar do ta përkrahim dhe vota jonë është pro kësaj marrëveshjeje për kredi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të lajmëruar asnjë grup tjetër parlamentar. “Nisma”, Enver Hoti. Ahmet Isufi, nga AAK. Lajmërohuni, ju lutem! Atëherë Enver Hoti, në rend të parë.

ENVER HOTI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e përkrah këtë marrëveshje financiare plotësisht, e po ashtu disa parafolës e thanë “jemi të bashkuar si opozitë”. Është mirë të jetë opozitë konstruktive dhe të bashkohemi, sepse mendoj se kjo marrëveshje është në interes të qytetarëve, si edhe marrëveshja në të cilën ata nuk morën pjesë për votim.

Por, sido që të jetë, mbetet çështje e tyre, ndërsa kolegëve nga LDK-ja po e shfrytëzoj rastin edhe pak, kryetar, t’u them që të mos e përsëritin atë që ka ndodhur në rishikim të Buxhetit, që e patëm një muaj më herët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ahmet Isufi në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Nuk ka tjetër përfaqësues, përveç dy deputetëve.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti kryeministër,

Ministra,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, duke e ditur rëndësinë e këtij projektligji, e përkrah. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! S’ka nga grupet parlamentare. Kalojmë me diskutime te kolegët deputetë. Zonja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar përfaqësues të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

E mora fjalën vetëm për të ju njoftuar që ky është njëri nga projektet sipas klauzolës së investimeve, që u tha në pjesën e parë të kësaj dite, që Qeveria më herët nuk ka bërë asnjë projekt dhe nuk ka identifikuar. Ky është vetëm njëri prej shumë projekteve që i kemi bërë në bazë të klauzolës së investimeve.

Është projekt tepër i rëndësishëm, duke marrë parasysh edhe Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Që nga 1 prilli 2016, kur Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit ka hyrë në fuqi, ne kemi parë që nuk ka pasur përmirësim të raporteve tregtare në favor të Kosovës, për shkak se ndërmarrjet e Kosovës nuk janë të përgatitura për tregun e BE-së. Projekti për rritjen e konkurrueshmërisë ndërmjet Bankës Botërore, i cili do të implementohet kryesisht në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ka pikërisht këtë qëllim, rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve kosovare.

Projekti ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të Agjencisë së Akreditimit, Standardizimit dhe Metrologjisë, si dhe reforma në Inspektoratin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Qëllimi është që produktet kosovare të certifikohen brenda vendit me certifikata, të cilat do të jenë të pranueshme në tregun e Bashkësisë Evropiane dhe objektiv përfundimtar është që këto agjenci: Standardizimi, Metrologjia dhe Akreditimi, të anëtarësohen në unionet e këtyre agjencive në Bashkësinë Evropiane.

Andaj, u bëj thirrje të gjithë deputetëve që të ratifikojnë marrëveshjen ndërkombëtare dhe, gjithashtu, i bëj thirrje Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që të jetë shumë vigjilente në implementimin e këtij projekti, sepse është me rëndësi jetike për ndërmarrjet kosovare dhe depërtimin në tregjet e BE-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mimoza Kusari-Lila, dhe Milaim Zeka pastaj le të bëhet gati.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Konsiderojmë që shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për Projektin e konkurrueshmërisë dhe gatishmërisë për eksport ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim paraqet një hap konkret dhe një mekanizëm të drejtpërdrejtë të ndihmës ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe rritjes së konkurrueshmërisë së produkteve kosovare, një element i cili seriozisht është në deficit, si në programin e Qeverisë Haradinaj, si në Buxhetin për vitin 2018.

Konsiderojmë si përfaqësues të Alternativës në Kuvendin e Republikës së Kosovës se është i domosdoshëm votimi i kësaj marrëveshjeje, si dhe vetëdijesimi për mekanizma të mirëfilltë të

ndihmës së drejtpërdrejtë të sektorit privat dhe zhvillimit dhe krijimit të konkurrueshmërisë së produkteve kosovare.

Andaj, besojmë që ky është një moment shumë i mirë që të vlerësohet se pse nuk arrihet të kalohet, ose të votohet Buxheti i Republikës së Kosovës, një pozitë e cila nuk mund t'i ketë as 61 vota të thjeshta dhe pse duhet të votohet një marrëveshje ndërkombëtare që paraqet një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e ekonomisë kosovare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka, fjala për ju.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Në radhë të parë, kështu në parantezë dëshiroj të them që loja e Lidhjes Demokratike të Kosovës këtu në sallë, duke e luajtur rolin ndërmjet pozitës dhe opozitës, për mua është shumë e pakuptueshme dhe e pajustificueshme, sepse Lidhja Demokratike vazhdimisht kanë dëshirë të thirret si parti institucionale dhe nga kryetari i vet, në një anë, kanë presion për votimin e ratifikimit të marrëveshjes me Malin e Zi, dhe tash akoma nuk janë përcaktuar a duan ta rrëzojnë Qeverinë sot a nesër. Dhe, një marrëveshje e votojmë, tjetrën marrëveshje nuk e votojmë... kjo është lojë para opinionit.

Por, dëshiroj të them se jemi në vitin 2017 dhe nuk jemi në kohën e Shaban Polluzhës, kur pak njerëz kanë ditur të lexojnë dhe të kuptojnë se çfarë flasim ne në sallën e Parlamentit, e cila, për fat të keq, shpeshherë është shndërruar në sallë akuzash dhe kundërakuzash.

Tash, po dal te marrëveshja konkrete, për të cilën e kemi hapur debatin.

Zoti kryeministër,

Në bazë të njohurive të mia që i kam lidhur me këto marrëveshje që vijnë nga organizata të ndryshme botërore, qoftë nga Banka Botërore, në rastin konkret, dhe organizma tjerë ndërkombëtarë, është bërë një keqpërdorim shumë i madh i buxhetit nëpër ministri të ndryshme në të kaluarën, në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë, për shembull, janë bërë keqpërdorime të shumta në Ministrinë e Bujqësisë. Dhe, krejt kjo është si rezultat i komunikimit të institucioneve ndërkombëtare drejtpërdrejt me sekretarët permanentë të këtyre ministrive dhe sigurisht me miratimin absolut të ministrave të kaluar. Ndoshta, edhe ministri ynë aktual, zoti Bajrami, ishalla nuk e rrokë kjo sëmundje e së kaluarës, e vazhdon ashtu vallen e ministrave të kaluar. Por, dëshiroj ta them një shqetësim konkret: Banka Botërore e ka kërcënuar Qeverinë e Kosovës nëpërmjet një shkrese, e cila ka arritur që disa javë të sekretari permanent i Ministrisë së Bujqësisë, i cili për tekat e tij personale, jo vetëm që nuk ua ka treguar këtë shkresë eprorëve të vet, qoftë ministrit, qoftë kryeministrit, qoftë sekretarit permanent të Qeverisë së Kosovës, por e ka mbajtur në sirtarët e vet dhe për shkak të mosnënshkrimit të kontratave që 5-6 muaj të

konsulentëve të Bankës Botërore, të cilët i ka lënë pa kontrata, Banka Botërore ka kërcënuar me ndalimin e fondit 22 milionë euro ndihmë për zhvillimin e bujqësisë.

Prandaj, zoti kryeministër, këtë informacion po ta jap për t'i këqyrur pak disa fëmijë nëpër ministri, që "po ta pinë duhanin fshehtë", edhe po i bëjnë disa budallallëqe e marri me mentalitetin e tyre, që GPS-i i tyre nuk u kalon përtej Komoranit, se le më në Uashington për të komunikuar me Bankën Botërore. Prandaj, dëshiroj që ministrat të kenë kontroll më rigoroz në të ardhmen se në çfarë mënyre po shpërndahen këto fonde.

Ne kemi fakte se në fondin zhvillimor të bujqësisë, paratë e Bankës Botërore u janë dhënë atyre që kurrë në jetën e vet s'kanë pasur fermë, u janë dhënë bujqve që s'kanë pasur as 10 arë tokë, ose e kam thënë në një debat në të kaluarën, që një traktor, përpos që është shkruar çmimi 46 mijë euro i një traktori, i njëjti traktor ka kaluar nëpër tre bujq. Dhe, kur këto raporte i merr Banka Botërore dhe institucionet e ndryshme ndërkombëtare, atëherë ata tmerrohen.

Prandaj, ju lutem kryeministër, që të keni më shumë kontroll. Më së pari, disiplinoji edhe ministrat që s'po vijnë këtu gati kurrë, hiç s'po na bëjnë hesap në Parlament, dhe duhet ditur që ne edhe ju shkarkojmë, edhe ju rrëzojmë, edhe ju çojmë. Duhet ta dinë që ne jemi mbi ata, kështu që... E kam shumë seriozisht, me pozicione dhe pa pozicione, qysh të donë. Domethënë, ministrat të tregohen shumë-shumë më të përgjegjshëm, se kryeministri vjen vazhdimisht i dëgjon debatet e juaja, e ju kur të ju teket vini, kur s'ju teket s'vini dhe nuk ka debat më i rëndësishëm në Parlamentin e Kosovës sesa të vini ju këtu edhe ta dëgjoni debatin për Buxhetin e Qeverisë së Kosovës.

Çdo debat është i rëndësishëm, por ju kur nuk vini dhe nuk na respektoni këtu rreth Buxhetit, atëherë ne nuk e dimë pse të ju respektojmë juve. Prandaj, më kujdes, se mund edhe t'i lini veturat, edhe telefonat dhe të shkoni në shtëpi. Kaq! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nënkryetari Kujtim Shala e ka kërkuar fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e kam një tip replike shumë të shkurtër me përfaqësuesit e "Nismës për Kosovën".

Qëndrimet e LDK-së i bëjmë të njohura ne. Ju edhe mund t'i përshkruani ato, s'ua ndalon askush, por mësimet ne s'marrim. Dhe, ajo që e thatë ju në fund, dhe ai mësim që i dhatë ju Qeverisë, ju keni të drejtë, sepse ju jeni shumica. Është qëndrimi, sjellja politike, ose mësimi që po japim ne, që ne të marrim pjesë në votim, ju duhet të keni kuorum, që do të thotë ta dëshmoni që jeni shumicë. Nëse nuk jeni, është çështje për ju, pastaj bëhet edhe çështje për ne. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi e ka kërkuar fjalën.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje, kryetar!

Kolegë deputetë,

Po, çdo parti në Parlament ka të drejtë ta ketë pozicionin e vet për të gjitha çështjet. Askush nuk ka të drejtë të japë leksione se si duhet të mbajë, çfarë qëndrimi duhet të mbajë, a duhet të votojë për, a duhet të votojë kundër, apo të mos votojë fare, ama është njëfarë rendi kur ta japësh fjalën edhe ta mbash fjalën, të voglat se të mëdhatë s'është duke i mbajtur kurrkush.

Në bufe, Blerim Kuçi, deputeti, erdhi e më tha se kemi bërë një marrëveshje që LDK-ja të marrë pjesë në votim, se nuk i kemi të gjithë deputetët këtu. Unë i thashë, këqyr çka, nëse nuk i kemi deputetët, të mos e futim fare në votim, sepse jemi të vetëdijshëm që përgjegjësinë për ta kaluar Buxhetin e kemi ne, nuk e ka as LDK-ja, nuk e ka as VV-ja. Por, ata arritën një marrëveshje xhentëlmene që do të marrin pjesë në votim. Prandaj, u fut në votim, se po të kishin thënë nuk marrim pjesë në votim, sigurisht se nuk do ta kishim futur në votim, derisa të vijnë deputetët e mazhorancës, të cilët natyrisht e kanë për detyrë të marrin pjesë, jo vetëm në votim, por edhe gjatë debatit.

Këtë e bëra për sqarim në raport më shumë me publikun, se sa me... as qëllim polemike me deputetët e LDK-së, por thjesht për ta informuar publikun se përse në tentimin e parë dështoi votimi, sepse u premtua se do të marrin pjesë në votim, përndryshe do ta kishim thirrur edhe Blertën, që s'di kah ishte, do ta kishim ndalur edhe Agimin, që tash doli, në mënyrë që t'i kemi votat tona. E dimë që përgjegjësia jonë si mazhorancë është që t'i mbajmë votat tona, por ky ishte qëllimi. Pra, qëllimi është thjesht të shpjegoj publikun, e jo të polemizoj me askënd këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kundër-replikë, dhe me këtë përfundon.

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Kjo që tha përfaqësuesi i "Nismës" e dëshmon që ne e dhamë edhe një mësim shumë më të rëndësishëm, se sa atë të parin, që marrëveshjet për çështjet e kësaj natyre nuk bëhen në bufe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Armend Zemaj e ka fjalën.

A dalim prej kësaj situatë, ju kisha lutur! replikë - kundër-replikë mjaft! Kërkoj falje, se po futem në cikël të pandalshëm. S'ka më kurrkush s'ka kërkuar fjalën. Askush më nuk e ka fjalën.

A shkojmë në procesin votues. Sa veta jemi, se e ka njëfarë rregulli kjo puna e votimit. Jemi 84, mund të futemi në proces votues.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Janë 83 deputetë që kanë votuar, 83 për.

Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për Projektin e konkurrueshmërisë dhe gatishmërisë për eksport ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për financim shtesë për projekte për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim këtë projektligj.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, në qoftë se e dëshiron fjalën, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj është dizajnuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në mbështetjen e ekspertizës së Bankës Botërore, ku Ministria e Bujqësisë është implementuese e projektit.

Implementimi i projektit pritet të zgjasë 5 vjet nga data e nënshkrimit të marrëveshjes financiare. Objektivat e projektit janë ta ndihmojë Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ta përmirësojë produktivitetin si dhe qasjen në tregjet e përfituesve të projektit në sektorët e hortikulturës dhe blegtorisë në Kosovë, t'i konsolidojë kapacitetet institucionale të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Projekti përbëhet nga këto pjesë:

1. ngritja e kapaciteteve profesionale dhe teknike për sektorin rural dhe palët e ndërlidhura, në shumë prej 900 000 euro;
2. rritja e investimeve nëpërmjet granteve për zhvillim rural, 12 900 000 euro;
3. aktivitetet në përkrahje të skemave të ujitjes për Radoniqin dhe Dukagjinin 6 000 000 euro nga total shuma e kredisë; dhe

4. menaxhimi i projektit, monitorimi dhe vlerësimi gjatë implementimit, afro 1 000 000 euro.

Financimi i këtyre aktiviteteve do të mundësojë ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për programin dhe zbatimin më të efektshëm të politikave për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale. Mbështetja financiare për programin e granteve për zhvillim rural do të ndihmojë në rritjen e prodhimit të bujqësore dhe zgjerimin e kapaciteteve përpunuese, si dhe aplikimin e standardeve për cilësi dhe siguri në ushqim.

Mbështetja institucionale do të mundësojë edhe qasje në informacione dhe procese që ndihmojnë reformimin e sektorit në përputhshmëri me kërkesat dhe standardet e nivelit të BE-së dhe nevojat e sektorit privat.

Kushtet e kësaj kredie janë të favorshme, të listuara si në vijim:

- shuma 20,8 milionë euro,
- kohëzgjatja 25 vjet maturitet, ku 5 vjet janë greis periudhë, kurse 20 vjet janë amortizim me 40 këste gjysmëvjetore,
- norma e interesit 0,45 në shumën e tërhequr,
- tarifa e shërbimeve 0,75 në shumën e tërhequr,
- tarifa e zotimit 0,5 vjetore në shumën e patërhequr.

Projekti në fjalë kontribuon në rritjen e prodhimit të cilësisë së prodhimit, si dhe në rritjen e aftësive konkurruese nëpërmjet aplikimit të standardeve të tregut, duke krijuar kështu mundësi të reja për eksportet e produkteve kosovare.

Duke marrë për bazë të gjitha këto që u thanë si më lart, kërkoj që të ratifikohet kjo marrëveshje në dobi të vendit tonë dhe sektorit të bujqësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e kryetarit të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zotit Lumir Abdixhiku, për arsyetimin e raportit të komisionit.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Marrëveshja financiare e nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim ka për qëllim financimin shtesë për projektin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Objektivat që do të realizohen nëpërmjet implementimit të kësaj marrëveshjeje janë: transferimi i njohurive tek sektori rural; rritja e investimeve për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm rural;

përkrahja për ujitje dhe menaxhimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e projektit kapital që do të financohet.

Siç e tha ministri, kjo marrëveshje do të ketë një greis periudhë 5 vjet, amortizimi është 20 vite, norma e interesit është 0,45% në shumën e tërhequr, tarifa e shqyrtimit është 0,75 në shumën e tërhequr dhe tarifa e zotimit është 0,5% vjetore në shumën e patërhequr.

Ministria e Financave në vlerësimin e ndikimit buxhetor ka konstatuar se shuma prej 15 milionë eurove për shpenzime operative dhe subvencionimit të fermerëve do të akomodohet brenda kufirit buxhetor për periudhën 2018-2022 të buxhetit të Ministrisë së Bujqësisë, ndërsa shuma prej 5,8 milionë eurove do të jetë financim me mjete shtesë nga mekanizmi i klauzolës së investimeve publike.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe marrëveshjen dhe ka vlerësuar njëkohësisht rëndësinë e projektit dhe kushtet e kredisë dhe kështu i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë atë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nga “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Ne e kemi shqyrtuar këtë marrëveshje. Na është dukur shumë e nevojshme për Kosovën. Është e favorshme, me kushte të favorshme, prandaj e mbështetim.

KRYETARI: Faleminderit! Avdullah Hoti nga Lidhja Demokratike e Kosovës e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe marrëveshjen me të cilën ratifikohet ky projektligj. Unë dëshiroj ta përgëzoj tash krejt stafin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Bujqësisë, që kanë punuar shumë me Bankën Botërore për ta arritur këtë marrëveshje me kushte shumë të volitshme për dy qëllime, për të vazhduar financimin e aktiviteteve që janë në Ministrinë e Bujqësisë dhe e dyta, që është e re në këtë marrëveshje, për rehabilitimin e rritit ekzistues të ujitjes së tokave bujqësore në Radoniq, ashtu siç jemi dakorduar atëherë bashkë me Bankën Botërore, që ky projekt të jetë vetëm faza e parë drejt një master-plani për dyfishim të tokave bujqësore nën ujitje në regjionin e Gjakovës, Rahovecit dhe Prizrenit.

Ne vlerësojmë që kjo është mënyra më e mirë për t'i mbështetur prodhuesit bujqësorë, duke rritur produktivitetin në prodhime bujqësore deri në gjashtë herë për shkak se tokat mbulohen me sistem të ujitjes. Prandaj, Grupi ynë Parlamentar do ta mbështesë këtë marrëveshje pa asnjë hezitim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Desha në formë gjysmë shakaje, pasi falënderove, s'e dita ministrin e vjetër a të riun të Financave? Dytë, po e di, po e di, por ishte shprehje xhentëlmene. Shumë në rregull! Zoti Ahmet Isufi e keni fjalën. Në rregull, nëse e do fjalën vetëm për korrektësi për të të falënderuar, se e bëre për të dytë, e mora vesh.

AHMET ISUFI: Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah Projektligjin në fjalë.

KRYETARI: Bilall Sherifi, nga Grupi Parlamentar "Nisma", e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Kryetar, kur ta zbatosh Rregulloren, të lutem zbatoje strikt, nëse nuk i jep dikujt replikë mos i jep askujt, por jo dikujt t'i japësh dhe dikujt të mos i japësh, nën një.

Nën dy, kjo duke shikuar me çdo kusht të bëhesh i mirë me të gjithë, do të mbetesh me askënd. Kështu që më mirë përmbaju me Rregulloren dhe zbatoje mirë. Ndërsa tjetra, Kujtim, po të njëjtat ia thashë kolegut, i thashë që mos u beso se kanë për të mashtruar, tha "jo, jo, se jam marrë vesh". Ky nuk ju njeh si duket sikur unë. Ndërsa sa i përket Projektligjit të marrëveshjes, po edhe "Nisma për Kosovën" e mbështet. Faleminderit!

KRYETARI: Nënkryetar, të dyve na gjuajti pak po lëre, ka qenë këshilltar i kryetarit të Kuvendit gjatë dhe i di krejt. Si të duash! Nënkryetari e ka fjalën për replikë.

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Unë desha edhe në funksionin e nënkryetarit të Kuvendit që të ju ndihmoj ju, jo që të ju korrektoj, po ia përmend emrin kolegut Bilall Sherifit që t'ia jap një rast që të replikojë. Faleminderit!

KRYETARI: Këshilltari i kryetarit të Kuvendit e di si ka të drejtë për kundër-replikë. Urdhëro! Bilall Sherifit fjalën, regjia!

BILALL SHERIFI: Blerim, a të thashë?!

KRYETARI: Faleminderit! A vazhdojmë më tutje? Mërgim Lushtaku, nga Partia Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e kemi shqyrtuar këtë marrëveshje financiare ndërmjet Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për zhvillim dhe e kemi parë si të favorshme dhe e mbështetim këtë projekt.

KRYETARI: Dhe, në fund, Islam Pacolli në emër të deputetëve pa grup parlamentar.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritës ministër,

Deputetët,

Edhe ne e kemi shqyrtuar dhe për ne është e pranueshme dhe e përkrahim si AKR. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu është lajmëruar në ndërkohë. Urdhëro, fjala është për ju!

TEUTA HAXHIU: Kryetar e tha shefi i Grupit Parlamentar rreth marrëveshjes, por unë po dua të përmend këtu, a kur të përmenden deputetët flasin në emër të vet, e jo grup e pa grup, të mos bëhemi shumë joseriozë, sepse grupet parlamentare dihet që janë me Rregullore dhe nuk ka grup parlamentar as me një deputetë, as me dy deputetë. Prandaj, kot thirren në emër të grupeve, jo “x” grupi, “y” grupi. Ta bëjmë më serioze punën e deputetit, sepse sinqerisht është turp për emrin e deputetit, së pari. Prandaj, është joserioze për të gjithë ata që nuk kanë grup, e po thirren në emër të grupit, e po promovojnë edhe X parti, që ndoshta as një autobus kandidatë nuk i kanë, të mos them votues.

KRYETARI: Faleminderit! A shkojmë në proces votues, unë vetëm çka shoh në ekran e lexoj zakonisht. Kur janë me grup, ua lexoj grupin. Shkojmë në votim!

Faleminderit! Duhet 2/3 të votave. Në sallë janë të pranishëm 84 deputetë. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

84 deputetë kanë votuar. 84 vota janë për.

Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e kësaj Marrëveshjeje financiare.

Ndërkohë, më lejoni vetëm t’i bëj disa njoftime pa vazhduar edhe në pikën e fundit të rendit të ditës.

- Propozimi i Grupit Parlamentar të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Parlamentar

Grupi Parlamentar Lista serbe ka propozuar zëvendësimin e anëtarit për Komisionin për Legjislacion, në vend të deputetes Jelena Bontiq, deputetin Igor Simiq.

Të nderuar deputetë,

Kërkoj nga ju që me votim me ngritje dore formale të deklaroheni për propozimin e Grupit Parlamentar të Listës serbe. Në princip, a jeni për? Është votim formal. Kundër a ka? S'ka! Abstenim? Nuk ka!

Konstatoj se Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Legjislacion.

Edhe një njoftim tjetër është, për shefat e grupeve parlamentare dhe deputetët.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kërkojmë nga kryetarët e grupeve parlamentare që t'i propozojnë sa më shpejt deputetët për anëtarë të grupeve të miqësisë, sipas formularëve. Formularët janë dorëzuar sot, të cilët janë dërguar nga Administrata e Kuvendit. Ndërkohë, në qoftë s'e keni marrë i merrni, se vetëm sa janë dorëzuar, por është mirë që në bazë të formularit ta dorëzojë secili deputet Grupin e Miqësisë në të cilin pretendon të shkojë, pastaj Kryesia e Kuvendin e bën vendimin, e selekton në fakt.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit i ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës kanë dalë obligime edhe për Doganat e Kosovës në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian.

Kjo me qëllim të sigurimit të mbrojtjes ligjore për bartësit e së drejtës së pronësisë intelektuale nën kushtet e njëjta me ato të vendeve të Bashkimit Evropian. Projektligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale rregullon parimet, të drejtat, obligimet dhe procedurat doganore për veprim nga Doganat e Kosovës sipas detyrës zyrtare për mallrat, të cilat janë të dyshimta për shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Projektligji i cili është në diskutim sot ka për qëllim vendosjen e një sistemi efikas, të besueshëm, i cili është në pajtueshmëri me legjislacionin më të ri të Bashkimit Evropian për të krijuar një kornizë ligjore të duhur dhe më të avancuar për zhvillimin e një sistemi më të qëndrueshëm model për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në kontekstin e zbatimit të legjislacionit doganor.

Zbatimi efikas i të drejtave të pronësisë intelektuale nga institucionet përgjegjëse është një element shumë i rëndësishëm për progresin social, ekonomik, i cili do të garantojë konkurrencë të drejtë në tregun e vendit tonë. Implementimi i këtij legjislacioni kontribuon në krijimin e kushteve për tërheqjen e investimeve të huaja në Kosovë, duke i mbrojtur investitorët nga konkurrenca e padrejtë. Po ashtu, në të njëjtën kohë mbron konsumatorët apo qytetarët tanë nga mallrat e falsifikuara dhe pirate.

Qëllimi për të cilin është iniciuar ky projektligj u shërben prioriteteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave si pjesë e zotimeve dhe angazhimeve tona për krijimin e një ambienti të favorshëm për të bërit biznes në vendin tonë. Për ta realizuar këtë qëllim kemi harmonizuar projektligjin e ri me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian nr. 608/2013.

Andaj, ky projektligj do ta adresojë kërkesën e Bashkimit Evropian dhe do t'i shërbejë objektivit të Qeverisë së Kosovës në integrimet evropiane. Gjatë hartimit të projektligjit, Ministria e Financave i ka marrë parasysh dokumentet relevante të Këshillit të Evropës që e rregullojnë këtë fushë, si dhe praktikatat e mira evropiane dhe rajonale.

Vlen të theksohet se të gjitha institucionet për zbatimin e këtij projektligji dhe palët e interesit nga sektori privat kanë qenë të përfshira gjatë hartimit të tij. Po ashtu, në dy fazat e konsultimit publik janë përfshirë të gjitha palët e interesit, duke përfshirë edhe sektorin privat, andaj duke marrë për bazë arsyeshmërinë e lartshënuar, ju lus që ta votoni projektligjin për masat doganore për të drejtat e pronësisë intelektuale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zoti Lumir Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale rregullon të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat doganore për veprim nga Doganat e Kosovës për mallrat, të cilat janë të dyshimta për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale, të cilat duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes apo kontrollit doganor.

Projektligji i rregullon procedurat e suspendimit, të lirimit të mallrave në qarkullim të lirë derisa të kryhet verifikimi i origjinalitetit, procedurat e asgjësimit të mallrave, e kështu me radhë. Projektligji gjithashtu parasheh përgjegjësinë e Doganës dhe sanksionet. Në bazë të vlerësimit të ndikimit buxhetor, projektligji nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, dhe të gjitha aktivitetet për zbatimin e këtij projektligji do të mbulohen nga daljet buxhetore aktuale të Doganës së Kosovës për vitin 2017, si dhe projeksionet buxhetore për vitet 2018-2020.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar në parim projektligjin në fjalë dhe ka vlerësuar se i njëjti i plotëson kushtet formale juridike të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit ta miratojë në lexim të parë. Të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet që mund të bëhen gjatë leximit të parë në seancë plenare, pra sot, do të konsiderohen me kujdes gjatë amendamentimit të tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga grupet parlamentare s'është lajmëruar askush. Tash u lajmëruan Mërgim Lushtaku, Avdullah Hoti, Glauk Konjufca. Mërgim Lushtaku e ka fjalën, shkojmë në bazë të radhës si u paraqitën.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,
Shumë të nderuar qytetarë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe e kemi vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji, qoftë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, ashtu edhe për harmonizimin e ligjeve të Kosovës me standarde evropiane, si dhe rrugëtimin tonë drejt Bashkimit Evropian.

Është vlerësim yni si grup parlamentar se ky projektligj qartëson dhe lehtëson punën edhe për Doganën e Kosovës, një ndër institucionet më aktive dhe më të rëndësishme për Republikën e Kosovës.

Qëllimi i këtij projektligji është që t'i rregullojë të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat doganore për veprimin nga Doganat e Kosovës për mallrat, të cilat janë të dyshimta për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale. Ky projektligj vendos rregulloren e BE-së nr. 608/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 12 qershor 2013, lidhur me masat doganore për të drejtat e pronësisë intelektuale.

Dispozitat e këtij projektligji zbatohen ndaj mallrave të dyshuara për shkelje të së drejtës së pronësisë intelektuale, mallra të cilat duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes apo kontrollit doganor, e në veçanti ndaj mallrave në rrethanat, si në vijim: kur mallrat deklarohen për lirim në qarkullimin e lirë, eksport, apo riimporto, kur mallrat hyjnë apo dalin nga territori doganor i Republikës së

Kosovës dhe, nën 3, kur mallrat janë të vendosura nën procedurën e transitit, procedurat e magazinimit doganor, procedurat e përpunimit të brendshëm, përpunimit nën mbikëqyrjen doganore, importit të përkohshëm të vendosur në zonë të lirë, në depo të lira doganore në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Dispozitat e këtij projektligji parashohin në moszbatim për mallrat të cilat janë liruar në qarkullim të lirë nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar. Mallrat e atyre si jokomerciale që gjenden në bagazhin personal të udhëtarëve, mallrat të cilat janë prodhuar nga një person me pëlqim të bartësit të së drejtës, apo për mallrat të cilat janë prodhuar nga një person i autorizuar ligjërisht nga vartësit e së drejtës për prodhimin e një sasive të caktuar të mallrave në tejkalim të sasive për të cilët është rënë dakord ndërmjet personit dhe bartësit të së drejtës. Është e rëndësishme që ky projektligj në bazë të opinionit ligjor kontribuon në përafrimin e ‘acquis communautaire’ të BE-së dhe nuk i cenon parimet bazë të legjislacionit të BE-së, pasi projektligji është në përputhje të pjesshme me ‘acquis’.

Gjithashtu, ky projektligj në bazë të opinionit për vlerësimin buxhetor nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, pasi të gjitha aktivitetet për zbatimin e këtij projektligji do të mbulohen nga ndarjet buxhetore aktuale të Doganës së Kosovës.

Dua t’i falënderoj të gjithë ata që kanë punuar në këtë projektligj, që prej grupit punues, propozuesit, kontribuuesit, palët e interesit, komentuesit gjatë procesit të konsultimeve publike, ku janë përfshirë pjesërisht të 11 propozimet, të cilat janë konsideruar si relevante për temën që e rregullon këtë projektligj. Duke marrë parasysh nga gjithë këto që u thanë më sipër, ju ftoj ta votoni në lexim të parë Projektligjin në fjalë, pastaj nëse ka ndonjë gjë për të shtuar ose nëse ka nevojë për harmonizim të mëtejme mund ta bëjmë atë duke propozuar amendamente në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Avdullah Hoti e ka fjalën nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi ynë Parlamentar do ta mbështesë këtë projektligj, ky ligj specifik e përafron Kosovën me BE-në. Janë tri ngjarje të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë Qeverisë paraprake, që besoj asnjë institucion tjetër në Kosovë më shumë se sa Dogana e Kosovës nuk ka kontribuar në ato tri ngjarje: e para, nënshkrimi i Marrëveshjes së MSA-së, në tetor 2015, mandej fillimi i zbatimit të MSA-së më 1 prill 2016, kur Dogana ka luajtur rol kyç, dhe pastaj anëtarësimi i Doganës në Organizatën Botërore të Doganave në shkurt të këtij viti, me ç’rast dëshiroj ta falënderoj të gjithë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe partnerët tanë ndërkombëtarë për kontributin që kanë luajtur në këtë drejtim dhe normalisht e përgëzoj krejt stafin e Doganave të Kosovës që me një profesionalizëm shumë të lartë kanë arritur që t’i përafrojnë krejt procedurat doganore të

Kosovës me ato të BE-së dhe jam i bindur që edhe ky ligj do të kontribuojë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Kosova e ka pasur një ligj, i cili është marrë me këtë punë, pra me masat e nevojshme doganore, të cilat duhet të aplikohen për ta mbrojtur një të drejtë shumë të rëndësishme, që është e drejta e fushës së pronësisë intelektuale në Kosovë. Por, ligji në fjalë natyrisht që është shumë i nevojshëm, ama kjo fusha e të drejtës intelektuale në Kosovë është në gjendje shumë të keqe.

Unë nuk e di qysh kemi për të aplikuar masa shumë kontrolluese në kufi, kur brenda kufirit, pra po flas për territorin e shtetit, statusi i kësaj të drejte është prej të drejtave më të cenuara në Republikën e Kosovës. Secila e drejtë i ka disa mekanizma nëpërmjet të cilëve njeriu mbrohet. Personi juridik mbrohet në Kosovë. Ama unë nuk e di që ka ndonjë mekanizëm në Kosovë nëpërmjet të cilit mbrohet kjo e drejtë.

E drejta e autorit, e drejta e pronësisë intelektuale është e drejta më e shkelur në Kosovë. Edhe, e di ku është më e keqja? Jo që nuk ka mekanizma, por në Kosovë ka njëfarë konsensusi publik diqysh të nënkuptuar, dhe madje edhe institucional, që diqysh jemi në një nivel aq të largët për ta mbrojtur këtë të drejtë, sa që s'ka lidhje duhet mbyllur edhe sytë pse po shkelet. Kështu është gjendja shoqërore, gjendja shoqërore publike në Republikën e Kosovës sa i përket të drejtës së pronësisë intelektuale. Prej kulturës e filmit, e letërsisë, e publikimit, kjo e drejtë shkelet për çdo ditë. Kurrkush nuk e mbron këtë të drejtë, nuk ka mekanizma qeveritarë që e mbrojnë këtë të drejtë në Kosovë. E tash, po duam ta mbrojmë në kufi! Po duam ta mbrojmë në kufi kur kjo e drejtë qarkullon! E ne nuk e kemi të mbrojtur kur kjo e drejtë përdoret.

Këtu përdoret, stërpërdoret dhe keqpërdoret kjo pronësi intelektuale për çdo ditë. Dhe rastet qysh shkelen në Kosovë janë garant me mijëra herë në ditë, për çdo ditë, 24 orë. Kështu që sa i përket ligjit në fjalë, tash ky ligj në disa pjesë është shkruar mirë, por më është dukur që në disa pjesë është shkel e shko. Ministria e cila e ka pas përgjegjësi, është Ministria e Financave, sepse fusha e doganave bie drejtpërdrejt në përgjegjësinë e Ministrisë së Financave, duhet ta ketë parasysh që sidomos neni 32, më është dukur që është shkruar në mënyrë të pakujdesshme. Cili është ky nen 32?

Neni 32 është neni i cili e përcakton fushën e gjobave që shqiptohen. Pse po them është shkruar shkel e shko? Sepse, në pikën 32, 1.1. diferenca mes nivelit më të ulët edhe pragut të sipërm të gjobave lë mundësi shumë të mëdha për keqpërdorime dhe nuk i kategorizon gjobat. Domethënë, ti po thua aty dënohesh prej 500 deri në 5 mijë, dhe nuk kallëzon në cilat raste mund të dënohesh 500, në cilat raste mund të dënohesh 3 mijë, e në cilat raste 5 mijë. A këtu më poshtë te pika 1.4.

thotë personat tjerë, nuk kallëzon cilët, nuk kallëzon për çfarë arsye, nuk kallëzon cilat veprime që kategorizohen si të ndëshkueshme, thotë prej 1 mijë eurove deri në 10 mijë. Domethënë, s'po e di qysh, njëfarë lloj difference shumë e pakujdesshme, e cila kallëzon për një dhjetëfishim të dallimit të gjobave për të cilat ne nuk e dimë cilat veprime ashtu, e cilat veprime kështu.

Ma merr mendja që duhet të jemi më të kujdesshëm në këtë pikë, të tregohet më saktë çka po doni, dhe cilat veprime doni t'i ndëshkoni. Edhe tjetra, dhe me këtë po e përfundoj, te neni 34, në përkthimin shqip ka rrëshqitur aty një gabim teknik, që kallëzon që ky ligj është i përkthyer. Emri i nenit. Lexojeni me vëmendje, aty qysh ka rrëshqitur një gabim, dhe s'po e di prej cilës gjuhë është përkthyer ky ligj, por ju ka dalë njëfarë fjale prej gjuhës prej së cilës ata e kanë përkthyer. Ju lutem që ta përmirësoni.

KRYETARI: Faleminderit! Enver Hoti, në emër të Grupit Parlamentar "Nisma", bëhet gati Ahmet Isufi, në emër të AAK-së.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar i "Nismës për Kosovën" e ka trajtuar këtë projektligj dhe e mbështet dhe e konsiderojmë se është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe në mes të dy leximeve do ta japim kontributin tonë me vërejtjet dhe mendojmë që duhet ta mbështetim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Isufi, fjala për ju.

AHMET ISUFI: Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet këtë ligj, kurse kontributin tonë do ta japim gjatë procedurës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Kryetar!

E kam një shqetësim, dua ta pyes ministrin: Te pronësia intelektuale, është temë shumë e rëndë, domethënë për ne kjo temë diskutimi. Desha të pyes diçka në aspektin praktik, është shkelje, edhe Glauku e përmendi shumë mirë, kurrkund në dynja nuk bëhet hajni e pronësisë, e shkrimeve, e librave, e gjithçka çka prodhohet në botë sikur te ne dhe në Shqipëri.

Domethënë, në qoftë se ekziston një xhungël e hajnive, ne me këtë xhungël edhe 200 vjet në Evropë s'na pranon kurrkush, sepse juridikisht dhe logjikisht çdo muzikë e huaj që lëshohet në radio, televizion të Kosovës, në mënyrë automatike kudo në botë, autorit duhet t'i shkojë paraja, pagesa. Te ne kjo nuk përfillet fare, nuk përfillet as nga Radiotelevizioni Publik, e lëre më nga radio e televizionet e tjera. Kjo është tmerr, sepse një autor zotëri këtu i filmit, ose një këngëtar zotëri i muzikës, nuk do të kishte nevojë të shkojë të këndojë për shembull nëpër klube atje me

pijanecë, gjithë natën të thyejë shishe, por do ta kishte nxjerrë një këngë dhe radiostacionet çdoherë në transmetim ia kishin gjuajtur nga 1 euro dhe njeriu do të ishte bërë milioner.

Këtu domethënë njerëzit më të denigruar, më të fyerit, më të poshtëruarit në këtë shoqëri janë krijuesit. Bile-bile janë aq të poshtëruar, sa quhen budallenj: “Ja ky budallai, e ka bërë një këngë, një vjershë, atje poezi, një libër, ja qysh ecën rrugës i çatallavtë, i dredhtë, e tjera, tjera”. Krejt këtë e ka bërë shteti ynë sallamadi. Domethënë, shteti që veç i bën ligjet copy-past prej kroatëve e prej sllovenëve dhe pastaj nuk ka fare zbatim të ligjit. Këtu kemi goxha ligje të mira, por zbatim nuk kemi. Për shembull, Kosova është rast unikat në Evropë që kompjuterët nuk kanë adresë të IP-së. Imagjino kompjuteri, në qoftë se dikush ty të kërcënon, ose të fyen nëpërmjet kompjuterit, në çdo vend evropian për 30 sekonda policia e zbulon kush të ka kërcënuar, kush të ka fyer, kush ta ka vjedhur shkrimin, kush ta ka vjedhur muzikën. Ne nuk ekzistojmë fare në Google, nuk kemi të drejtë që Googles t’i japim konto numër të Kosovës për të na i paguar paratë kur prodhojmë filma. Ne duhet të shkojmë në Shqipëri për ta dhënë një numër të kontos së Shqipërisë, sepse Kosovën nuk e pranon.

Tani për të ardhur tani te ajo më e rënda që ndodh, a e dini zoti ministër, edhe ju Kabinet qeveritar, e sidomos ministri i Kulturës, që shkelja më e madhe e pronësisë së autorit që lidhet pikërisht te ligji aktual te Doganat, bëhet nëpërmjet sistemeve kabllore që vijnë nga Digit Albi, nga të gjitha sistemet që vijnë nga jashtë. Për shembull, Shqipëria e blen Kampionatin Botëror në Beograd, e pastaj Kosova e blen prej Beogradit, në vend që ta blejë në Beograd, e blen dyfishin në Shqipëri dhe krejt transmetimet e filmave që ju i shikoni çdo natë në kabllor a mendoni ndonjëherë që krejt janë të vjedhur? Krejt janë të vjedhur, krejt janë pa licenca, krejt është shkelje flagrante e të drejtave të pronësisë intelektuale. Prandaj, do të kishte qenë mirë që Qeveria të mendojë në këtë drejtim dhe unë e quaj absolutisht si ligj tepër të mirë, që duhet të aprovohet edhe shumë i vonuar, por pastaj të mendojmë edhe për punën e zbatimit dhe teknikisht ta qartësoj pyetjen: Si keni menduar t’i ndaloni me Doganë filmat dhe këta kabllorët që vijnë nga Shqipëria për shembull, nga Maqedonia ne këtu mund ta shohim Alsatin, mund t’i shohim emisionet e Beogradit, qysh do t’i ndaloni në Doganë? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nënkryetari Kujtim Shala e ka kërkuar fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e kërkoja fjalën që t’i bëj 2-3 saktësime, të cilat mendoj që do të jenë të dobishme për këtë pikë të rendit të ditës. Unë besoj që kolegët po flasin për çështje, të cilat janë shumë të rëndësishme, por që s’lidhen drejtpërdrejt me këtë dokument, me këtë projektligj.

Ajo fushë, fusha e drejtës së autorit është e rregulluar me një ligj tjetër. Ne kemi ligj për mbrojtjen e të drejtës së autorit, besoj është ligj shumë i mirë. Është plotësuar dhe është ndryshuar vitin e shkuar, ka problem me implementimin, sepse gjithë implementimi, përpos një

zyre teknike administrative brenda Qeverisë, u mbetet agjencive ose shoqatave të pavarura, të cilat në bazë të kushteve që përcakton ligji duhet të regjistrohen. Ndërkaq, ne sot këtu po flasim për diçka tjetër, domethënë po e shqyrtojmë Projektligjin për masat doganore, që s'e rregullon këtë fushë. Fusha është e rregulluar në kuptimin ligjor juridik.

Ndërkaq, çështjet të cilat i shtroi kolegu Konjufca, edhe unë mendoj që janë të rëndësishme, por ato nuk mund të normohen me ligj. Çështjet e asaj natyre zakonisht rregullohen me akte nënligjore, me rregullore, ose me udhëzime administrative, sepse lartësia e gjobës është edhe çështje e vlerësimit dhe duhet të vendosen kriteret e vlerësimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë?

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Presim të marrim numrin e saktë të deputetëve për çdo rast. Përgatiten për votim. Votojmë tash!

80 deputetë kanë votuar, 80 janë për.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet parlamentare që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Me këtë masivitet të votave mund t'i rikthehemi edhe një herë Buxhetit. Faleminderit!

Me këtë i mbyll punimet e seancës plenare. Mirupafshim në seancën e radhës!

* * *

E enjte, më 7 dhjetor 2017

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 dhe 6 dhjetor 2017

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Faleminderit!

Para se të procedojmë me seancën e re, jemi në vazhdimin e seancës, në votimin në parim të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të kërkoj nga kryetarët e grupeve parlamentare, a do të marrin pjesë në votim, përndryshe duhet të vazhdojmë seancën për ta kaluar këtë në bazë të Rregullores. Duhet qëndrimi i grupeve parlamentare, ose do të kalojmë pastaj në pikën e re të rendit të ditës, por duhet përcaktuar një seancë për ditën e diel, në orën 10:00 - votimi i Buxhetit të Republikës së Kosovës, vazhdimi i seancës.

I kisha lutur përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të deklarohen me “po - jo”, që vetëm formalisht ta kalojmë, pastaj, në fund të fundit, vijmë ditën e diel, dhe ashtu-kështu e kalojmë, se edhe populli dëshiron ta dijë a do të ketë buxhet për vitin 2018.

Zoti Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Unë nuk po di qysh kjo Qeveri ka për ta kaluar Buxhetin në ditë pushimi, kur nuk po mund ta kalojë në ditë punës. Domethënë, të dielën është edhe më problematike, njerëzit kanë qejf të pushojnë. E kam fjalën sidomos për këta të pushtetit, mazhoranca.

Kështu që nëse e merrni në kuptim e disiplinës dhe motivit për të ardhur të dielën, unë mendoj që do t’i keni më pak se 59 vota, apo 60.

KRYETARI: Faleminderit! Avdullah Hoti, Lidhja Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk e di, kjo tash është ndoshta një praktikë e re parlamentare që të pyeten kryetarët e grupeve parlamentare a do të votojnë e si do të votojnë. Janë më shumë se 61 deputetë në sallë, hidhe në votim, provoni a mund ta kaloni, duhet të siguroheni që nuk shkon Buxheti përpara me votat e opozitës. Ju duhet t’i keni në sallë 61 deputetë të pozitës dhe mandej ne do të votojmë, do ta japim fjalën tonë për këtë buxhet, po kjo praktikë nuk po më duket në rregull, që të pyeten kryetarët e grupeve parlamentare nëse do të votojnë e si do të votojnë.

Seanca duhet të vazhdojnë nëse janë 61 deputetë në sallë, provoni a mund ta çoni agjendën përpara, por një pozitë që mbetet me votat e opozitës për çështje kyçe është më mirë të lëshojë rruga sa më parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Partia Demokratike e Kosovës, deklarohuni edhe për të dielën, për seancën në orën 10:00.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i PDK-së është i gatshëm tash ta votojë Buxhetin, pavarësisht që nuk është buxhet i PDK-së, as i koalicionit qeverisës, por është buxhet i qytetarëve të Kosovës, edhe si pozita, si opozita, normalisht që duhet ta shfrytëzojnë dhe e shfrytëzojnë atë buxhet.

Esenca është që këtu ka pasur raste, se nuk është kjo legjislatura e parë, që opozita e ka votuar buxhetin dhe do të duhej vërtet që ka terrene tjera ku opozita mund ta zhvillojë betejën politike, por te buxheti do të duhej të jemi pak më të kujdesshëm.

Dhe, për fund, ne jemi kolegë dhe diskutojmë dhe kemi diskutuar edhe dje, por nuk është shumë mirë deri në momentin e fundit të thuhet, ose të deklarohet që do të votojmë kundër, pastaj për ta ndryshuar, për t'i numëruar deputetët nëse janë apo nuk janë këtu.

Përndryshe, nëse nuk votohet sot, ne jemi të gatshëm të dielën të jemi këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Ahmet Isufi, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën.

AHMET ISUFI: I nderuar kryetar,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne pajtohemi që të dielën ta mbajmë seancën për të treguar që kur duam ne mund t'i mbajmë seancat edhe ditëve të vikendit dhe dalim me sukses. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Sasha Milosavleviq nga Lista Serbe e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLEVIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

I Poslanička grupa Srpske liste spremna da danas glasa za Budžet, a ukoliko se danas ne izglasa u prvom čitanju mi smo za to se sednica održi u nedelju, ali ne u 10:00 časova, nego u 12:00 časa, ako bi moglo.

I ja bih želeo da se u ime Srpske liste izvinim svim građanima Kosova što se odugovlači usvajanje Budžeta. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Bilall Sherifi, Grupi Parlamentar “Nisma”, e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje,

“Nisma”, sikur partnerët tjerë të koalicionit, është e gatshme edhe sot, edhe nesër, edhe të dielën, kurdo që mazhoranca i bën deputetët e vet në sallë për ta votuar Buxhetin.

I përgëzoj kolegët nga LDK-ja, e paskan bërë një përparim nga “do të votojmë” në “provoni”. Jo nuk po provojmë hiç, do të provojmë kur t’i kemi votat tona këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Nga “6+” ju lutem! Albert Kinolli, fjala është për ju.

ALBERT KILLONI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” si zakonisht, edhe tradicionalisht gjithmonë e ka luajtur një rol konstruktiv nëpër të gjitha proceset, po ashtu edhe për këtë proces shumë me rëndësi për gtë gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Grupi Parlamentar “6+” është i gatshëm edhe sot, edhe në çdo kohë, edhe çdo ditë, edhe çdo moment, të votojë për Projektligjin me rëndësi të veçantë - Buxheti i Republikës së Kosovës. Edhe të dielën, edhe të hënën, edhe të shtunën, edhe të premtën, kur të na thirrni ne do t’i përgjigjemi ftesës. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk Konjufca, edhe një herë e dëshiron fjalën, se po i shoh edhe dy deputetë, megjithëse ishin grupet parlamentare, ua jap fjalën pasi e kanë kërkuar.

GLAUK KONJUFCA: M’u desh ta marrë fjalën, sepse ishte një ftesë publike nga Elmi Reçica. Domethënë, një ftesë për ta votuar Buxhetin, po nuk e kuptova a pse Buxheti është i mirë, a pse nuk i kanë votat? Këtë nuk e mora vesh bash mirë.

Mua po më duket më e vërtetë kjo e fundit, na thirri për arsye se nuk i kanë votat, jo pse Buxheti është shumë i mirë.

Tjetra, sa i përket asaj që seanca duhet të mbahet me pikë të zorit, siç u tha nga Aleanca, tash e kam pyetjen unë: A mund ta mbajnë në orën 10:00, apo në 12:00, qysh tha Lista serbe? Vetëm edhe këtë duhet specifikuar pak më saktë.

KRYETARI: Elmi Reçica e ka kërkuar fjalën. Po të shkojmë kah përfundimi.

ELMI REÇIKA: Shumë shkurt, kryetar!

Ne për Buxhetin kemi diskutuar dy ditë rresht dhe realisht dihet nëse është i mirë apo i keq. Buxheti është prezantuar para opinionit, është diskutuar dhe dihet saktësisht. Me rëndësi është që ne ta votojmë atë Buxhet dhe ta përmbylim këtë vit. Kjo është esenciale.

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, janë edhe katër deputetë, por kisha dëshiruar, në qoftë se ka mundësi të dalim në pikën e rendit të ditës që e kemi për sot, mundësisht. Unë fjalën do t'jua jap megjithatë, sa më shkurt. Armend Zemaj, bëhen gati Hykmete Bajrami, Islam Pacolli edhe Mialim Zeka.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Mendoj që mënyra e interpretimit të tillë e Rregullores së Punës së Kuvendit nga ju i tejkalon edhe ato kornizat, edhe të përgjegjësisë, apo më mirë të them të papërgjegjësisë politike, së pari mazhorancës, të Qeverisë, dhe atëherë grupeve politike që e përbëjnë mazhorancën në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Nuk është serioze që thuhet ligj i rëndësishëm apo pa i rëndësishëm, sepse sipas mendimit tim nuk ka ligje të rëndësishme dhe të parëndësishme, por ka përgjegjësi, ka përkushtim ndaj qytetarëve, apo popullit, siç ju e theksuat.

E para, tentimi që të imponohet apo të kërkohet paraprakisht mendimi, besoj që nuk përket as me logjikën institucionale, por as me Rregulloren e Kuvendit, dhe këto praktika besoj që duhet ndërpriten, e faji të kërkohet diku tjetër.

Pasqyra më e mirë është pjesëmarrja e Qeverisë dhe raporti që e ndërton me Kuvendin e Republikës së Kosovës. Dhe, ju i shihni që nga 22 ministra çdo ditë në seanca publike, pothuajse minimalisht është pjesëmarrja e tyre. Ne do t'i kishim arsyetuar po të ishin të vetëm duke e udhëhequr një dikaster qeveritar, pa marrë parasysh që i kanë edhe nga 5-6 zëvendësministra. Ne nuk e kuptojmë pse këta nuk gjenden para deputetëve edhe para përgjegjësive që kanë politike, nëse për ata është aq i rëndësishëm Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kështu që loja me data e me ditë, e me numra, tregojeni me votë, e jo me fjalë dhe me retorikë boshe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Hykmete Bajrami, le të bëhet gati Islam Pacolli.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Vetëm desha të jua përkujtoj që Qeveria Mustafa është rrëzuar për ta formuar një Qeveri të vendimeve të mëdha. Besoj të kujtohet turi i dëgjimit dhe të kujtohet Qeveria e vendimeve të mëdha. Një qeveri që nuk mund ta kalojë Buxhetin e saj në leximin e parë, besoj që jo që nuk është e vendimeve të mëdha, por nuk është e asnjë vendimi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryetar,

Kryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Medie,

Mendoj që ne kemi diskutuar dy ditë për Buxhetin dhe ka pasur jashtëzakonisht shumë debat, janë dhënë edhe sugjerime, e shpresoj që Qeveria do t'i marrë parasysh ato propozimet që janë bërë.

Megjithatë, ne jem obligues ndaj qytetarëve, se e kemi pranuar këtë detyrë që të jemi këtu dhe t'i mbrojmë interesat e tyre.

Ne jo vetëm që e përkrahim, por edhe të dielën e kurdo që të jetë e nevojshme ne do t'u përgjigjemi këtyre thirrjeve. Faleminderit!

KRYETARI: Milaim Zeka, zonja Teuta Haxhiu, bëhet gati Rexhep Selimi.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Kështu, në radhë të parë, unë mendoj që dita më e qëlluar për mbajtjen e kësaj seance është dita e diel për shkak të respektit ndaj opozitës, se këta ja futin gjumë të dielën dhe bëjnë pushim të qetë, kështu mund të na shohë kushdo nëpërmjet televizorit, nuk është rëndësi. Dihet që Buxheti është tepër i rëndësishëm për të gjithë.

Sa u përket numrave, unë mendoj që në asnjë fushë të jetës nuk kanë fort rëndësi numrat, madje as në letërsi. Ka shkrimtarë që veç një libër e ka shkruar dhe e ka marrë Çmimin Nobel, kështu që nuk është problem fort puna e numrave sa i kemi, kryesorja është që të dielën do të kalojë Buxheti dhe sa u përket numrave, prapë po them që edhe në luftë e dimë sa për qind kanë marrë pjesë në luftë, po megjithatë e kemi fituar luftën.

Edhe e fundit, sa i përket orës, në 10:00 a 12:00, tash mund të diskutojmë këtu nja tri orë për “dëgjueshmëri” ndaj Listës serbe, por ne nuk e kemi këtë qasje ndaj koleve tonë deputetë që janë

këtu të grupeve tjera etnike të Kosovës, sepse mua më duket kjo është një qasje raciste dhe e pakuptimtë.

Edhe, në fund, të dielën kështu do ta kalojmë dhe do ta kemi Buxhetin për popullin e Kosovës, por edhe për rrogat e deputetëve të opozitës.

KRYETARI: Faleminderit! Teuta Haxhiu, Rexhep Selimi, Arben Gashi...

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Ende nuk kemi kaluar në seancën e re, normalisht po diskutojmë prapë në vazhdimësi të dy ditëve diskutimi me përmbajtje e pa përmbajtje, me kërkesa e pa kërkesa të arsyeshme dhe, në fund të fundit, edhe takimet individuale të deputetëve të opozitës me ministra për t'i shtyrë projektet me interes që pretendojmë, të zonës apo lokalitetit nga vijnë, individuale, dhe tani një pasqyrë krejt tjetër, e sidomos krejtësisht e papranueshme e ish-ministrave, e sidomos e ish-ministrit të Financave, sinqerisht më së paku qytetarët dhe ne do ta kishim pritur, një qasje krejtësisht ndryshe. Ja kjo është një pasqyrë reale e ish-ministrave të Qeverisë të dështuar Mustafa, e cila, sinqerisht, ashtu siç ishte e dështuar në ditët e para, ajo dështoi edhe pse kishte numra. Ajo nuk ka pasur numra kurrë, edhe pse kanë qenë shumë ekonomistë aty, por nuk i kanë bërë matematikat kurrë me numra dhe kurrë nuk u kanë dalë matematikat reale. Nuk po u dalin as sot, por po çuditem se si po flasin pikërisht ata të cilët nuk e kanë këqyrë kur një realitet të opozitës, e cila e ka votua Buxhetin, se Buxheti është i qytetarëve, por çka do të bëhet me kërkesat e juaja, të cilat po i bëni në mënyrë individuale me ministra atje në bufe, siç e thatë ju dje, ju po i bëni ato pazare në bufe.

Atëherë, qytetarët le ta dinë se ju jeni ata që kryesisht po i bëni pazaret në bufe, ju deputetët të opozitës. Ju, ju të gjithë. Të gjithë po i bëni.

Prandaj, sinqerisht mos tentoni këtu të dukeni krejt diçka tjetër. Qeveria Mustafa ishte e dështuar dhe kë e ka marrë malli për ta parë numrin e ministrave, sado që janë shumë, e kam thënë edhe atëherë, bile të shumtën e kohës po vijnë shumë këtu, atëherë i shihje krejt karriget e zbrazëta, zoti Zemaj.

KRYETARI: Rexhep Selimi, pastaj fjalën e ka Arben Gashi dhe zoti Ismajl Kurteshi, se po gaboj në emra kur po i them, me emra e mbiemra.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Po mendoj që qytetarëve tash ua kemi borxh t'u sqarojmë diçka.

Ta dimë pse nuk po procedohet me votim. Pra, unë po di që s'ka kushte dhe mungesa e kushteve nuk është mungesë e kushteve juridike, kuorum ka, kushte juridike ka, vetëm duhet të tregohet pse nuk po procedohet.

Pra, këtë ne nuk e kemi për obligim ta themi para se ta thotë Qeveria, ose përfaqësuesit e mazhorancës, sepse po krijohet përshtypja sikur ne po kërkojmë disa kushte që mungojnë. Kushtet për votim mungojnë, por po shihet se çka mungon.

Kështu që unë mendoj që është dashur ta dimë që do të vijë një ditë, kurdo që është bërë Qeveria, atëherë është dashur të dihet që vjen kjo ditë.

Prandaj, unë po them edhe një herë që sqaroheni se për çfarë rrethanash nuk po procedohet me votim dhe jemi në rregull pastaj për të proceduar me gjëra tjera.

KRYETARI: Arben Gashi, të bëhet gati Ismajl Kurteshi, por në qoftë se ka mundësi të mos zgjatet kjo listë. Unë nuk e kam ndërmend të jua fjalën, dikush po e merr këtë pjesë, unë e bëj për vete, keqpërdoren sa të doni, flitni se kjo është përgjegjësi juaja, po unë e bëj për sjellje se jeni deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës sa të jem kryetar kujt fjalën nuk do t'ia ndal, por po shkon gjatë.

Arben Gashi e ka fjalën, bëhet gati Ismajl Kurteshi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Tash, që të jemi të qartë dhe direkt se çka po ndodh në seancë.

E vërteta është që Kuvendi ka kuorum për vendimmarrje dhe po ashtu e vërteta është që qeverisja është në vështirësi për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe unitetit për ta krijuar minimumin e domosdoshëm për t'i përkrahur vendimet të cilat i propozon.

Edhe përderisa flasin për vendime, të cilat i propozon Qeveria, unë mendoj se në aspektin politik vendimi më i rëndësishëm dhe projekti më i rëndësishëm politik i një qeverie është Buxheti.

Nëse Qeveria nuk arrin që për Buxhetin, si projektin e vet më të rëndësishëm politik, t'i mbledhë në sallë përkrahësit e vet politik, në këtë rast deputetët e vet, i bie që Qeveria nuk e ka minimumin kritik për të ekzistuar.

Në këto rrethana, jemi në një gjendje të tensionuar politike, sepse Qeveria nuk ka mundësi që të qeverisë dhe të njëjtën kohë mundohet që ta bartë problematikën te palët tjera në Kuvend.

Pra, situata është shumë e thjeshtë dhe shumë e qartë.

Qeveria Hardinaj nuk ka mundësi që projektin e vet kryesor për vitin 2018, që është Buxheti i Republikës së Kosovës, ta kalojë as në leximin e parë, e lëre më në leximin e dytë. I duhen tri ditë për të mbërrirë deri te pika kur ky buxhet të procedohet ligjërisht në Kuvend, e nuk arrin që këto çështje t'i trajtojë në mënyrën e duhur.

Pra, le të jemi të qartë dhe të saktë dhe direkt me njëri-tjetrin dhe ta kuptojmë situatën e rëndë në të cilën është Qeveria dhe për pasojë po e bartim situatën e rëndë edhe në vend.

Unë kërkoj që gjuha e cila përdoret këtu të mos jetë gjuhë e urrejtjes dhe gjuhë e sulmeve ndërpersonale me njëri-tjetrin, por problemet të identifikohen dhe të trajtohen ashtu siç janë.

Si përfundim, i nderuar kryetar, konkluzioni i kësaj situatë është që s'ka as mundësi interpretimi të Rregullores, as një gjë hiç. Shumë e thjeshtë është.

Zoti kryeministër, a i ke 61 deputetë që e përkrahin Qeverinë tënde?

Zoti kryeministër, a i ke 61 deputetë që e përkrahin projektin kryesor për vitin 2018, Projektligjin kryesor për vitin 2018?

Bëhet fjalë për leximin e parë, e lëre më për leximin e dytë. Unë kam parë këtu në seancën e kaluar kur është folur për Projektbuxhetin e vitit 2018 që kanë kërcënuar deputetët e mazhorancës, se kanë thënë në qoftë se nuk hyjnë këto projekte, interesa e të tjera, ne nuk e votojmë. Ato janë publike.

Ka deputetë të Koalicionit qeverisës, të cilët kanë kërcënuar publikisht që nuk e përkrahin Buxhetin.

Nuk keni pse kërkonin vota në opozitë. Opozita e kundërshton këtë lloj mentaliteti politik, opozita e kundërshton këtë koalicion dhe opozita po ashtu e kundërshton këtë mënyrë të qeverisjes dhe për pasojë e kundërshton edhe këtë Buxhet për vitin 2018.

Duke i kundërshtuar të gjitha këto, ju e keni shumë thjesht, mos kërkonin votë në opozitë, por votën mblidheni nga ato që i keni 61 dhe procedoni tutje.

KLRYETARI: Faleminderit! Është Ismajl Kurteshi, Driton Selmanaj, Kujtim Shala, Rasim Selmanaj, Lirije Kajtazi, Hajdar Beqa.

Unë kisha kërkuar nga ju, a dalim nga kjo pjesa, se e kemi debatin për Qeverinë, në qoftë se ju pajtoheni.

A dalim nga kjo pjesë? Kisha kërkuar nga deputetët të tërhiqen, nënkryetari i Kuvendit e merr ashtu-kështu fjalën, se është çështje procedurësh. Urdhëro, nënkryetar!

Deputetët që e kanë kërkuar fjalën nëse pranojnë, do të kishim vazhduar me pikën tjetër. Urdhëro nënkryetar, Kujtim!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë e kam fjalën për procedurën. Në këtë rrethanë, ju duhet të procedoni, ta hidhni në votim që Kuvendi të deklarohet për Projektligjin për Buxhetin, sepse kemi kuorum, nëse jo - seanca e ardhshme nuk mund të caktohet në këtë mënyrë, duhet të vendosin deputetët me votë, ose Kryesia e Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, nënkryetar!

A kisha mundur ta përmbyll këtë pjesë në bazë të Rregullores, në bazë të autoriteteve që i ka edhe Kryesia.

Kolegë deputetë,

A kisha mundur ta mbyll, në qoftë se bëhen të gjithë të katërtit që janë, po shoh që nuk ka reagim.

Kështu, sot nuk del në votim, për arsye se e kemi situatën e cila është po ashtu sikur ajo e djeshmja.

Atëherë vazhdimin e seancës, pasi është vazhdim, do ta kemi të dielën, në orën 15:00.

* * *

E diel, më 10 dhjetor 2017

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5, 6 dhe 7 dhjetor 2017

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Jemi në vazhdimin e seancës. Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 5 dhe 6 dhjetor 2017, me:

1. Votimi në parim i Projektligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2018

Ndërkohë e kam marrë një kërkesë jashtë seancës, në qoftë se kam mirëkuptimin Tuaj. Dy deputetë e kanë kërkuar fjalën që s'ka të bëjë me çështje politike, zoti Abdyl Salihu dhe zoti Sami Kureshi. Zoti Salihu, në rend të parë, urdhëro!

ABDYL SALIHU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të vendit tonë,

Me rastin e vdekjes së aktorit të dashur për ne dhe për gjithë popullin kosovar, Blerim Peci, ju ftoj për një minutë heshtje.

KRYETARI: Kolegë deputetë,

Ju ftoj për një minutë heshtje në nderim të aktorit!

(Një minutë heshtje)

Nderim!

Faleminderit! Në të njëjtën kohë, sot është Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, prandaj zoti Sami Kurtishi e ka kërkuar fjalën. Ia jap fjalën për këtë ditë.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Sot është 10-vjetori, Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut. Ne po hyjmë dalëngadalë në jubileun e 70-të të miratimit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, që përbën edhe dokumentin bazë, mbi të cilin mbështetet Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Ky dokument për herë të parë e pranon se dinjiteti i njeriut lind me të, është i paprekshëm dhe është i patjetërsueshëm. Ky dokument për herë të parë vendos të drejtat e njeriut mbi pushtetin shtetëror. Ky dokument obligon shtetin që të hartojë e të rregullojë ligje dhe të drejtat e njeriut, por të mos i shkelë ato.

Kjo deklaratë e vë njeriun mbi shtetin, e jo pushtetin mbi njeriun.

Kjo deklaratë e mban shtetin përgjegjës për atë që nuk bën dhe do të duhej ta bënte dhe për atë që është i obliguar ta bëjë e nuk e bën, si dhe për atë që gjithherë duhet ta ketë parasysh - konceptin kryesor, njeriun bashkë me pjesën që lind me të - dinjitetin e njeriut.

Ky dokument na obligon ne të gjithëve, institucionet shtetërore, e veçanërisht Kuvendin, që për çdo ditë, gjatë gjithë kohës, e veçanërisht sot të veprojmë me të gjitha kapacitetet tona njerëzore, politike, intelektuale, morale e institucionale për zbutjen dhe zhdukjen e dhunës sistemore si pushtet për luftimin e varfërisë, për luftimin e dhunës policore, ushtarake, ekonomike në të mirë të të varfërve, të pastrehëve, të punëve, të refugjatëve, të të përndjekurve dhe të burgosurve politikë, të të torturuarve nga policitë e uniformuara dhe ato sekrete për ndalimin e dhunës ndaj grave, ndaj fëmijëve, ndaj grupeve të marginalizuara.

Në ditën dhe datën e të drejtave të njeriut nga kjo foltore kërkoj edhe një herë më shumë lirim nga burgu të të gjithë përndjekurve politikë në Republikën e Kosovës, kërkoj lirim e përndjekjes politike të kundërshtarëve politikë, e në këtë mes të Adea Batushës, Albin Kurtit, Donika Kadajt, Egzon Halitit e Frashër Krasniqit. Kërkoj drejtësi për Astritin, drejtësi për Arbnorin, drejtësi për Monin, drejtësi për Arbenin, drejtësi për të gjithë ata që janë vrarë për arsye politike në Republikën e Kosovës.

Kërkoj që të respektohet, të nderohet dhe të vepohet për të gjithë të zhdukurit në Republikën e Kosovës si pasojë e luftës së egër kundër shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Në sallë aktualisht janë të pranishëm 91 deputetë.

1. Votimi në parim i Projektligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2018

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Jemi duke votuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Kanë votuar 61 deputetë, 62 janë për, 2 kundër, asnjë abstenim.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance. Mirupafshim të enjten!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë